

# ENVER HOXHA

VEPRA

40



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPERISË**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

40

JANAR 1969 — PRILL 1969

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1983



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 40-TË

Në këtë vëllim përfshihen dokumente dhe materiale të periudhës janar-prill 1969, shumica e të cilave botohen për herë të parë.

Edhe këto dokumente, që kanë një tematikë të gjerë e të larmishme, janë shprehje e vijës së drejtë largpamëse marksiste-leniniste të Partisë sonë, e politikës së saj parimore të brendshme e të jashtme, e udhëheqjes në rrugë të drejtë revolucionare të masave për thellimin e mëtejshëm dhe çuarjen përpara të revolucionit socialist. Në fjalimet, diskutimet, artikujt etj. shquhen analizat parimore e shkencore që u bëhen problemeve të ndryshme, idetë dhe konkluzionet teoriko-praktike me vlera të mëdha aktuale.

Në disa materiale të këtij vëllimi vëmendje e veçantë i kushtohet përtëritjes së vazhdueshme të Partisë me gjak të ri, si një faktor i rëndësishëm për ta mbajtur Partinë kurdoherë të re, të freskët, të gjallë dhe revolucionare. Pranimet e reja në Parti, theksohet në vëllim, kanë të bëjnë me vetë të ardhmen e Partisë dhe të vendit, ndaj ato janë një detyrë e përhershme e të gjitha organizatave të Partisë. Kur ato bëhen ritmiksht e në përputhje me kriteret dhe me nevojat e Partisë, kur punohet me kujdes për shtimin e radhëve të Partisë me elementë të rinj, kryesisht nga prodhimi,

dhe që i kanë cilësitë e duhura, organizata e Partisë forcohet pandërprerë.

Për forcimin e punës së Partisë, vihet në dukje në këtë vëllim, një rol të rëndësishëm luajnë edhe zgjedhja me kujdes dhe koordinimi i mirë i problemeve që studiohen në forumet udhëheqëse të Partisë në rrethe e në qendër, analiza e thellë e tyre dhe nxjerrja e konkluzioneve dhe e detyrave konkrete. Këto ndihmojnë jo vetëm për përdorimin me efektivitet të kohës së punës të organeve udhëheqëse të Partisë, por edhe për arritjen e rezultateve të duhura në luftën për zbatimin e vijës, të direktivave e të vendimeve të Partisë.

Në këtë periudhë Partia shtroi me forcë domosdoshmërinë e njohjes së ligjeve ekonomike të socializmit nga masat tona punonjëse. Në fjalën e mbajtur në Berat, më 26 shkurt 1969 «Si duhet t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim drejt disa çështje të ekonomisë sonë socialiste» shoku Enver Hoxha jep mësimë dhe orientime shumë të rëndësishme se si duhen kuptuar nga kuadrot, komunistët dhe masat çështjet e ekonomisë. Trajtim të gjerë në këtë fjalim gjejnë problemi i cilësisë dhe i sasisë, shikimi i çështjeve të ekonomisë nga njerëzit tanë nga pozitat edhe të konsumatorit, edhe të prodhuesit; domosdoshmëria e forcimit të përgjegjësisë kolektive dhe të asaj individuale për çdo gjë; nevoja për të kontrolluar punën e të tjerëve, duke bërë më parë secili vetëkontrollin e punëve të tij që, siç thekson shoku Enver Hoxha, do të thotë «autokritikë, korrigjim, kalitje e ndërëgjegjes socialiste». Po në këtë fjalim i bëhet një trajtim i thellë dhe i gjerë shkencor

marksist-leninist përmbajtjes ideologjike dhe politike të emulacionit socialist, të kësaj metode revolucionare të ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit, që nxit iniciativën dhe mendimin krijues të masave, mobilizon dhe vë në lëvizje masat e gjera punonjëse.

Në disa materiale vihet theksi në zhvillimin e ekonomisë, duke u mbështetur fort në të dyja këmbët, në industri dhe në bujqësi, duke iu përmbajtur parimit marksist-leninist që industria të ecë më përpara se degët e tjera. Shoku Enver Hoxha porositi që zhvillimin e ekonomisë ta mbështetim jo në dëshira subjektive, të pabazuara, por në interesat e ndërtimit të socializmit, në kushtet konkrete të vendit tonë, duke mbajtur parasysh edhe rrethimin kapitalisto-revizionist.

Një vend të rëndësishëm zënë në këtë vëllim edhe problemet e demokracisë kooperativiste, të disiplinës në punë, të organizimit e të drejtimit, të rritjes së vigjilencës dhe të përvetësimit të Artit tonë Ushtarak Popullor, të edukimit marksist-leninist. Në disa materiale flitet veçanërisht për punën e gjithanshme që duhet të bëjë Partia për kalitjen revolucionare të shkrimtarëve dhe të artistëve, të mësuesve e të pedagogëve, të cilët, me veprat dhe me punën e tyre, e ndihmojnë atë për edukimin e njerëzve tanë e veçanërisht të brezit të ri. Në to shtrohet qartë se përballimi i këtyre detyrave të rëndësishme arrihet kur mësuesit e pedagogët, shkrimtarët dhe artistët punojnë vazhdimisht për kalitjen e tyre si revolucionarë të vërtetë, për zotërimin dhe për zbatimin e vijës së Partisë, të orientimeve dhe të mësimëve të saj, për ngritjen e nivelit të tyre ideoshkencor.

Ideja e thellimit të pandërprerë të luftës kundër zakoneve prapanike dhe mbeturinave të psikologjisë mikroborgjeze haset në disa materiale të këtij vëllimi. Trajtimi filozofik dhe teoriko-praktik, që u bën shoku Enver Hoxha mbeturinave fetare e zakoneve prapanike, i armatos komunistët, kuadrot dhe masat për ta zhvilluar si duhet këtë luftë, për të interpretuar sa më drejt thelbin e tyre reaksionar e regresiv. Siç del dhe nga këto vepra, zhvillimit me sukses të kësaj lufte, përmirësimit të mënyrës së jetesës dhe futjes së normave të reja të jetës socialiste sidomos në fshat dhe në malësi, i shërbeu në atë kohë edhe lëvizja Veri-Jug.

Në disa fjalime të mbajtura para banorëve të zonave të dëmtuara nga tërmeti i prillit të vitit 1969 duket qartë kujdesi i veçantë i Partisë dhe i udhëheqësit të saj, shokut Enver Hoxha, për t'i ardhur në ndihmë popullit dhe për likuidimin sa më shpejt të pasojave të tërmetit.

Interes të veçantë paraqesin edhe materialet që trajtojnë probleme ndërkombëtare, të politikës së jashtme të PPSH, të luftës kundër politikës grabitqare dhe agresive të imperializmit, si dhe të luftës kundër revizionizmit modern. Në to, nga njëra anë, pasqyrohen qëndrimi i patundur marksist-leninist i Partisë sonë, vija dhe lufta e saj konsekuente dhe e vendosur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të çështjes së revolucionit, të socializmit dhe të komunizmit dhe, nga ana tjetër, u bëhet një demaskim i fuqishëm falsitetit të zhurmës demagogjike të revizionistëve sovjetikë, parullave të tyre pseudomarksiste për çështjet e partisë, të diktaturës së proletariatit, të socializmit etj. Objekt

*i kritikës parimore të shokut Enver Hoxha janë, gjithashtu, socialfashizmi në politikën e brendshme dhe socialimperializmi në politikën e jashtme të udhëheqjes revizioniste sovjetike, aventurat ushtarake dhe agresionet e armatosura të socialimperialistëve sovjetikë, të cilët ushtrojnë politikën e shantazhit jo vetëm në vendet e Traktatit të Varshavës, ku kanë dislokuar dhe mbajnë shumë forca ushtarake për të zbatuar me anë të tyre diktatin mbi popujt e këtyre vendeve, por edhe në pika të tjera të globit. Një demaskim dhe dënim i ashpër u bëhet edhe bashkëpunimit sovjeto-amerikan, pazarllëqeve imperialisto-revizioniste kundër paqes e veçanërisht kundër popujve arabë, synimeve dhe strategjisë globale të dy superfuqive për sundimin e botës dhe për ndarjen e zonave të influencës.*

*Duke marrë në dorë dhe duke e studiuar këtë vëllim, komunistët, kuadrot dhe mbarë punonjësit e vendit tonë do të njohin edhe më thellë rrugën e drejtë që ka ndjekur Partia për zgjidhjen e problemeve të shumta e të ndërlikuara, vijën e saj të patundur marksiste-leniniste dhe do të marrin forca të reja për të rritur edhe më shumë mobilizimin për realizimin e detyrave të kohës në të gjitha frontet.*



## KRIZA E LINDJES SË MESME

### Shënime

6 janar 1969

Lindja e Mesme është e populluar me popuj e me fise të ndryshme arabe. Të gjithë quhen arabë, por origjina e tyre nuk është e njëlojtë. Feja që i nanuris e i gënjen dhe gjoja i bashkon, është myslimanizmi, por një myslimanizëm i ndarë në sekte të ndryshme, të vjetra, që gjatë shekujve janë grirë me njëra-tjetrën, kanë shkaktuar gjakderdhje popujsh dhe bënë bajrakun e udhëheqësve të ndryshëm të mesjetës dhe të kohëve moderne, bile edhe të kohës sonë. Aktualisht, feja në Lindjen e Mesme, megjithëse është akoma akute dhe i frymëzon këta popuj, nuk paraqitet e përçarë nga sektet, sido që këto ekzistojnë dhe praktikohen. Në mes tyre ekziston, si me thënë, njëfarë bashkëkzistence nën mbulesën e përgjithshme të fesë myslimane. Por zhvillimi modern, përhapja e ideve materialiste dhe e shkencës e kanë dobësuar shumë ndikimin e fesë dhe e kanë detyruar atë të predikojë ide të përgjithshme dhe të ruajë formalisht zbatimin e praktikave të saj tradicionale. Megjithatë, jemi larg asaj që

të themi se popujt arabë të Lindjes së Mesme u kanë shpëtuar zinxhirëve të besimit fetar.

Në gjirin e këtyre popujve rrojnë edhe njerëz me besime ortodokse (koptët) dhe sionistët. Këta të fundit, me ndihmën e imperialistëve amerikano-anglezë, kanë krijuar shtetin e tyre të Izraelit, pjellë e manovrave të kapitalit ndërkombëtar e të sionizmit. Feja myslimane ka qenë toleruese dhe liberale ndaj besimeve të tjera dhe gjatë historisë nuk ka pasur probleme akute dhe të zjarrta në mes tyre, e kam fjalën për kohët moderne dhe jo për kohët e kryqëzatave. Tash konflikti arabo-izraelit është bërë një problem akut në Lindjen e Mesme.

Sipas mendimit tim, shkak u kryesor i krizës në Lindjen e Mesme nuk është shteti i Izraelit. Shteti i Izraelit është një nga arsyet, se, si një shtet kapitalist agresiv, dinamik, ai është rreshtuar në mënyrë aktive në planet skllavëruese të imperializmit botëror, dhe veçanërisht të atij amerikan, për ta mbajtur Lindjen e Mesme nën skllavërimin e imperializmit amerikan. Në këtë prizëm shteti i Izraelit, dhe ky nuk është i vetmi, është bërë «maja e shigjetës» e imperializmit amerikan. Izraeli ka qenë një satelit plotësisht i bindur i amerikanëve, ai është i detyruar të ndjekë dhe të zbatojë në vija të përgjithshme strategjinë amerikane, por kjo nuk ekskludon të ketë disa herë edhe taktikat e veta që ia imponojnë rrethanat dhe konditat e veta tokësore.

Arsyeja kryesore e krizës në Lindjen e Mesme është përpjekja për dominim e imperializmit amerikan dhe e forcave të tjera kolonialiste, të cilat luftojnë të



ruajnë dominimin e tyre të vjetër në këto zona, dominimin kolonialist ekonomik, politik, ushtarak etj. Këto fuqi imperialiste, përpara e kishin më lehtë të bënin ligjin në këto vende, se kishin plotësisht në zap jo vetëm ekonominë e këtyre vendeve, por, politikisht, ato kishin plotësisht të tyret mbretërit, feudalët, kishin, gjithashtu, ushtritë e veta të pushtimit. Të ashtuquajturat ushtri vendëse ishin në shërbim të plotë, të inkuadruara dhe të stërvitura apostafat për t'u shërbyer urdhrave të padronit të jashtëm të vërtetë.

Aktualisht, imperialistët e kanë më të vështirë dominimin në këto vende, prandaj manovrimet e tyre janë më të ndryshme, më të stërholluara. Tash shtetet që formojnë zonën që quhet Lindja e Mesme, janë organizativisht më të forta se më parë, kanë kufij më të përcaktuar, kanë një pushtet, një ushtri dhe një ekonomi më të organizuar. Këto shtete, në sipërfaqe, kanë një politikë të brendshme dhe të jashtme, të veçantë për çdo shtet, të cilën e quajnë «independente», «demokratike dhe sovrane». Pikërisht mbi këto të dhëna, mbi këto transformime, mbi këtë gjendje faktike të re, manovrojnë, manipulojnë, intrigojnë imperializmi dhe revizionizmi modern. Këto manovrime dhe intriga në mes fuqive të mëdha kolonialiste, në mes tyre dhe shteteve të zonës, janë të thella, janë antagonistë; po luftohet për të konservuar feudalizmin dhe përfaqësuesit e vjetër të tij, luftohet kundër zgjimit të popujve arabë, kundër revolucionit dhe kryengritjes së masave, luftohet për konsolidimin e zonave të influencës nga shtetet e mëdha imperialisto-revizioniste, luftohet për pozita strategjike ushtarake, në shikim të një lufte

të re botërore kapitaliste për të rindarë botën, që dhe kjo të transformohet.

Ky kompleks i tërë problemesh shkakton krizën në Lindjen e Mesme, që nuk është veçse një zonë e zjarhtë, e acaruar, e krizës së madhe, nga ku kalojnë bota kapitaliste dhe revizionizmi modern me atë sovjetik në krye.

Lindja e Mesme në krizën aktuale i përngjet krizës ballkanike me një ndryshim se në këtë të fundit, duke qenë e nxitur dhe e shkakuar nga fuqitë e mëdha imperialiste evropiane, pra duke qenë preludi i krizës së madhe evropiane që pati si përfundim logjik luftën 1914-1918, kufijtë e shteteve ballkanike nuk ishin edhe të përcaktuar mirë relativisht siç janë ato të shteteve aktuale të Lindjes së Mesme.

Popujt ballkanikë, të robëruar dhe të inkuadruar në perandorinë turke dhe austro-hungareze, shpërthyen kryengritjet dhe luftërat e tyre edhe kundër zgjedhës së okupatorëve të mëdhenj, por edhe kundër synimeve shovinisto-imperialiste të klikave shoviniste vendase, që përpiqeshin të rrëmbenin sa më shumë koncesione territoriale në kurriz të njëra-tjetrës. Imperialistët evropianë e kishin kthyer Ballkanin në një fushë intrigash dhe prandaj Ballkani s'kishte si të mos ishte një «fuçi baruti», siç e quanin. Fuçia ishte Ballkani, por pishtari më i madh, që i vinte zjarrin barutit, mbahej në dorë nga imperializmi botëror dhe, veçanërisht, nga fuqitë e mëdha kapitaliste të Evropës. Këtë çështje kryesore nuk e shohin, nuk duan ta shohin, ose nuk janë në gjendje ta shohin udhëheqësit aktualë të shteteve arabe të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Verio-

re. Ata nuk shohin dhe nuk mund ta shohin qartë se armiqtë kryesorë të tyre janë imperializmi dhe revizionizmi modern, imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik, imperializmi anglez dhe ai francez. Këtë nuk mund ta shohin dhe nuk mund ta luftojnë si duhet, se udhëheqjet e tyre janë përfaqësuese të feudalizmit dhe të borgjezisë së madhe kompradore vendase, janë udhëheqja antipopullore, antidemokratike, pavarësisht nga maskat dhe nga etiketat që përdorin.

Udhëheqësit e këtyre shteteve kanë frikë, në radhë të parë, nga popujt e tyre, ata nuk mbrojnë interesat e popujve të tyre, por të shtresave të tyre. Interesat e këtyre shtresave puqen me interesat e kapitalizmit botëror, ose më mirë janë të skllavëruar në interesat e kapitalizmit botëror; këto shtresa antipopullore rrojnë nën hijen e interesave të imperialistëve të ndryshëm, bëjnë një politikë klase, sipas rrethanave dhe koniunkturave, lidhen me njërin ose me tjetrin imperializëm, deri në varësi të plotë edhe në format e jashtme. Politika e tyre gjoja e pavarur është një valle në litar të nderur, një kërcim akrobatik, që kur bie ai që luan ose e rrëzojnë, zëvendësohet menjëherë nga shtresa, ose nga padroni i jashtëm, me një akrobat tjetër.

Në Lindjen e Mesme, pra, problemi shtrohet që të luftohet imperializmi amerikan, ai anglez, francez dhe veglat e tyre, një nga të cilat është dhe shteti i Izraelit, të luftohet imperializmi revizionist sovjetik, që, nën maskën e socializmit, kërkon vendin e tij nën diellin e Lindjes së Mesme dhe në kontinentin afrikan. Popujt e shteteve të ndryshme arabe nuk mund të dalin me

sukses nga kjo luftë, në rast se nuk dallojnë armikun kryesor të tyre dhe në rast se me luftën e tyre çlirimtare kundër armikut kryesor nuk llogaritin gjërat brendapërbrenda vendeve të tyre, domethënë në rast se udhëheqja e tyre nuk spastrohet nga ata aventurierë të shitur te të huajt, ose përfaqësues të shtresave kapitaliste antinacionale, antidemokratike dhe antisociale. Që të arrihet në këtë gjendje në vendet arabe, duhet një luftë e gjatë nga popujt e këtij rajoni, i cili aktualisht është në konfuzion të madh politiko-ideologjik.

Uniteti arab, domethënë uniteti i klikave në fuqi në shtetet arabe, u vërtetua se nuk ekzistonte, dhe kjo ishte e natyrshme, se klikat e ndryshme janë antagoniste dhe ato manipulohen nga imperializmi i huaj. Uniteti arab, kundër shtetit të Izraelit, u vërtetua se nuk vazhdoi veçse 5-6 ditë dhe u shemb tok me të ashtuquajturin unitet ushtarak. Kjo vërtetoi dhe atë që organizimi i brendshëm i vetë shteteve arabe ishte jashtëzakonisht i dobët, dhe mjaftoi një forcë e vogël ushtarake, si ajo e Izraelit, por forcë e organizuar në mënyrë të përsosur si ushtarakisht ashtu edhe politikisht, që ta shpartallonte kryesisht brenda 6 ditësh koalicionin e shteteve arabe.

Pra fitorja e Izraelit, «maja e shigjetës» imperialiste, i dha një goditje të rëndë fasadës së krimbur, plot llafologji të unitetit arab, por jo vetëm unitetit, por edhe gjendjes së brendshme politike, ekonomike dhe ushtarake të çdo shteti në veçanti. Kjo i duhej imperializmit botëror, atij amerikan dhe socialimperializmit sovjetik, për të rforcuar pozitat kolonialiste në këtë rajon, për të rindarë zonat e influencës, për të

shpartalluar unitetin e mundshëm arab, për të goditur revolucionin, për ta larguar atë etj.

Tani trumbetohet nga të gjithë se rreziku kryesor për popujt arabë është Izraeli dhe nën këtë moto gjoja po përgatitet «revanshi». Në këto parulla përgatiten zinxhirë të rinj më të fortë për popujt arabë. Për të përgatitur «revanshin» Naseri mbështetet te revizionistët sovjetikë, të cilët zunë vendin e tyre nën diellin e Egjiptit, të Sirisë dhe të Algjerisë. Politika gjoja e pavarur e Naserit kontrollohet nga Moska, e cila i jep disa armë por që s'mund t'i përdorë dot as si do ai, as kur do ai. Politika e RAB-it është e varur në qafën e sovjetikut, si mëlçia në qafën e ujkut. Izraeli është i siguruar nga kjo anë, se është më i fortë ushtarakisht, më kompakt, se bazohet fuqimisht në fitoren që arriti, se mbështetet nga imperializmi amerikan dhe nga socialimperializmi sovjetik. Izraeli e di se derisa Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, të cilët vendosin për çdo gjë në Lindjen e Mesme, nuk kanë vendosur të goditen me njëri-tjetrin, çështja e tij është e fituar. Çdo zgjidhje në Lindjen e Mesme, në këto situata, do të bëhet nga sovjeto-amerikanët, në interesin e tyre në radhë të parë, në interesin e Izraelit në radhë të dytë dhe në dëmin e shteteve dhe të popujve arabë.

Këtë kompleks gjërash vetëm lufta popullore e ndryshon. Natyrisht as mbreti Hysejn, agjent i anglezëve, as mbreti i Arabisë Saudite, as presidentët pseudodemokratë të Sirisë, të Egjiptit, të Libanit dhe të Irakut nuk mund ta udhëheqin këtë luftë çlirimtare të dyfishtë. Këtu nuk është vetëm çështje personash, por

është çështje lufte klasash e rreptë që duhet të fillohet, të organizohet, të zgjerohet dhe të kalitet. Kjo gjë do të bëhet, por natyrisht, do të dojë kohë, do të dojë përpjekje, gjak dhe sakrifica, por do të bëhet. Popujt arabë janë trima, janë të zgjuar, të vendosur dhe përparimtarë, janë, gjithashtu, të vuajtur, vetëm duhet të sqarohen. Nga gjiri i popullit arab do të dalin udhëheqës të vërtetë të tij, që do ta sqarojnë dhe do ta frymëzojnë në revolucion.

Të gjithë, aktualisht, paraqesin plane për zgjidhjen e problemit të Lindjes së Mesme. Këto plane mbajnë emrin e zgjidhjes së gjendjes së luftës në mes Izraelit e RAB-it dhe vendeve të tjera. Diplomacia revizioniste sovjetike është në lëvizje. Vetë Gromikoja shkoi te Naseri për t'i imponuar planin sovjetik, sigurisht, të koordinuar me amerikanët. Plani, në fund të fundit, do të jetë në favorin e Izraelit, ai do të fitojë të drejta dhe koncesione. Nëse krerët arabë do të gjunjzohen, kjo varet nga kërkesa e Izraelit. Edhe kërkesat e Izraelit janë të koordinuara me interesat imediatë dhe të perspektivës të imperializmit amerikan. Sovjetikët përipien të konkludohet shpejt se kanë frikë nga komplikacionet e mundshme, nga sulmet e izraelitëve dhe në një rast komplikacioni revizionistët sovjetikë do të demaskohen për të dytën herë në sy të arabëve, se ata do t'i lënë medoemos si zakonisht në baltë. Nga ana tjetër, sovjetikët duan të konsolidojnë pozitat e fituara në RAB e gjetkë, t'i konsolidojnë këto më mirë «në paqe e në qetësi» sesa në një terren me mina. Mirëpo, në brendinë e vet, Naseri e të tjerë si ai, janë njerëz që lëvizin sa andej-këndej dhe mund t'u kthejnë

krahët sovjetikëve dhe të afrohen me Uashingtonin. Naseri me shokë, derisa do të bëjnë koncesione ndaj Izraelit, do të preferonin të kishin sigurime më mirë nga padroni i Izraelit, domethënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Revizionistët e shohin këtë rrezik prandaj Gromikoja shkoi me vrap në Kajro, sigurisht mund ta ndjekin të tjerë dhe më të mëdhenj nga ai.

Naseri që ishte ftohur me Titon, ka filluar tash të afrohet. Shenjë e keqe për sovjetikët. Agjenti jugosllav i amerikanëve, nuk hyn në veprim pa qëllime dhe pa objektiva të caktuar nga padroni i tij. Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës çështja nuk shtrohet vetëm që Izraeli të fitojë të drejta, por të sigurojnë dhe të forcojnë pozitën e tyre, bile dhe të pastrojnë terrenin në Afrikë nga sovjetikët.

Këtë lëshim tragjik që bënë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkojnë ta riparojnë. Këtu qëndron lufta. Në këtë luftë, klikat arabe dhe izraelite janë gurët e shahut në lojën tragjike të imperializmit amerikan dhe të socialimperializmit sovjetik në kurriz të popujve arabë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **DEMAGOGJIA E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NUK MBULON DOT FYTYRËN E TYRE TRADHTARE**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**9 janar 1969**

Demagogjia ka qenë kurdoherë arma e preferuar e gjithë tradhtarëve. Ajo është shumë tipike për revizionistët modernë, veçanërisht për udhëheqjen revizioniste sovjetike. Kjo klikë renegatësh duke ecur gjithnjë në të njëjtën rrugë të tradhtisë, ka përdorur, sipas rrethanave, maska të ndryshme për të fshehur fytyrën e saj të vërtetë.

**Kthimi gjoja te politika e drejtë e Stalinit —  
hipokrizia më e ulët dhe manovra më e  
dëshpëruar e revizionistëve sovjetikë**

Revizionizmi hrushovian në Bashkimin Sovjetik ka kaluar nëpërmjet disa fazash, e në përshtatje me to kanë ndryshuar edhe format, metodat e taktikat e tij të luftës e të veprimit për të vënë në jetë kursin e tij antimarksist e tradhtar dhe për ta maskuar atë.



Faza e parë ishte ajo e ngritjes, e mëkëmbjes dhe e vendosjes së tradhtisë, e shoqëruar me një zhurmë të madhe e skandaloze dhe me një «optimizëm» të rremë për të çoroditur mendjet e njerëzve. Ajo karakterizohet nga fushata e shfrenuar e sulmeve kundër J. Stalinit për të shkurorëzuar idetë e marksizëm-leninizmit dhe veprën e Partisë Bolshevike, nën pretekstin mashtrues të «luftës kundër kultit të individit dhe pasojave të tij».

Por cila ishte vija e Partisë Bolshevike, vija e Stalinit, kundër së cilës u vërsulën me tërbim revizionistët hrushovianë dhe ç'pasoja pati ajo për zhvillimin e Bashkimit Sovjetik dhe të lëvizjes komuniste e revolucionare ndërkombëtare?

Në lëmin ideologjik vija që ndiqte Partia Bolshevike, e udhëhequr nga Stalini, ishte vija e mbrojtjes konsekuente dhe e zhvillimit krijues të marksizëm-leninizmit në një luftë të pamëshirshme kundër armiqve e shtrembëruesve të leninizmit në Bashkimin Sovjetik e jashtë tij — kundër trockistëve, buharinistëve, socialdemokratëve, titistëve etj., vija e luftës kundër presionit dhe ndikimeve të ideologjisë e të kulturës borgjeze, për rrënjosjen dhe zhvillimin e ideologjisë e të kulturës socialiste, vija e partishmërisë së lartë proletare në të gjitha sferat e jetës shpirtërore, për edukimin komunist të punonjësve.

Në lëmin politiko-shoqëror ajo ishte vija e forcimit të pareshtur të partisë proletare dhe të rolit të saj udhëheqës në tërë jetën e vendit, e forcimit dhe e konsolidimit të diktaturës së proletariatit, të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë, të miqësisë së po-

pujve të Bashkimit Sovjetik, të unitetit të të gjithë popullit sovjetik rreth partisë e pushtetit të sovjetëve nëpërmjet një lufte të ashpër klasore kundër klasave shfrytëzuese të përmbysura dhe mbeturinave të tyre jashtë partisë e brenda radhëve të saj, vija e forcimit të vazhdueshëm të fuqisë mbrojtëse të vendit për t'i bërë ballë çdo agresioni të mundshëm imperialist.

Në lëmin ekonomik ajo ishte vija e ndërtimit të socializmit me forcat e veta e me ritme të shpejta edhe në kushtet e rrethimit të plotë kapitalist dhe në një luftë për jetë a vdekje kundër valës së spontaneitetit mikroborgjez, vija e industrializimit socialist dhe e kolektivizimit të bujqësisë, e perfeksionimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve socialiste në prodhim, e zhvillimit të vrullshëm të prodhimit socialist dhe e rritjes së pandërprerë të mirëqenies së punonjësve.

Në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare ajo ishte vija e kundërshtimit të vendosur të imperializmit, të politikës së tij të luftës e të agresionit, si dhe e shfrytëzimit të kontradiktave në kampin imperialist për dobësimin e tij dhe për forcimin e pozitave të socializmit, vija internacionaliste e përkrahjes së fuqishme e pa rezerva të lëvizjes revolucionare e çlirimtare botërore, vija e marrëdhënieve vëllazërore të përkrahjes dhe të ndihmës reciproke me vendet socialiste dhe me partitë komuniste e punëtore motra, vija e forcimit të pareshtur të unitetit luftarak të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare mbi bazën e parimeve të marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, në luftën e përbashkët për fitoren e çështjes së socializmit në gjithë botën.

Si rezultat i zbatimit të vijës së drejtë revolucionare marksiste-leniniste të Partisë Bolshevike të udhëhequr nga Stalini, u kryen me sukses transformimet socialiste në tërë vendin, u likuidua brenda një kohe të shkurtër prapambetja e trashëguar nga regjimi carist dhe u shndërrua Bashkimi Sovjetik në një shtet socialist të fuqishëm, me industri moderne, me bujqësi të madhe të kolektivizuar, me teknikë e shkencë nga më të përparuarat, me potencial ekonomik e ushtarak kolosal, u arrit fitorja e madhe historike mbi fashizmin në vitet e Luftës së Dytë Botërore, u rritën së tepërmi roli dhe pesha e vendit sovjetik në jetën ndërkombëtare. Vijës revolucionare internacionaliste të zbatuar me konsekuencë nga J. Stalini, u detyrohen në një shkallë të konsiderueshme konsolidimi dhe rritja e influencës së lëvizjes komuniste në botë, krijimi dhe forcimi i kampit socialist pas Luftës së Dytë Botërore, dobësimi i përgjithshëm i pozitave të imperializmit ndërkombëtar dhe sukseset e mëdha në zhvillimin e revolucionit proletar botëror.

Revizionistët modernë hrushovianë, të cilët, pasi morën në dorë udhëheqjen e partisë e të shtetit, u mbështetën në rezultatet e mëdha të epokës staliniane dhe i përdorën ato për të përhapur e për të konsoliduar kursin e tyre revizionist e tradhtar, sulmuan frontalisht të gjitha parimet marksiste-leniniste që udhëhiqnin politikën e Stalinit dhe qëndronin në bazën e forcës kolosale të Bashkimit Sovjetik, që ata uzurpuan e përvetësuan.

Në lëmin ideologjik revizionistët zëvendësuan idetë dhe vijën marksiste-leniniste konsekuente të Stali-

nit, për të gjitha çështjet themelore, me idetë e me vijën antimarksiste të revizionizmit modern. U shpallën «viktima të Stalinit» dhe u ngritën në pedestalin e «martirëve» e të «heronjve» oportunistët dhe armiqtë e ndryshëm trockistë, buharinistë, zinovievistë, nacionalistë e të tjerë në Bashkimin Sovjetik. U rehabilitua klika renegate e Titos në Jugosllavi dhe titizmi u shpall si një variant i «marksizëm-leninizmit krijues» e i «socializmit». Në vendet e ndryshme ish-socialiste u rehabilituan tradhtarët e dënuar dhe u sollën në fuqi klika revizioniste të lidhura pas qerres së Hrushovit. U hodh parulla për unitetin me socialdemokratët në shkallë kombëtare e ndërkombëtare «në luftën e përbashkët për socializëm» dhe u hap rruga për afrimin dhe shkrirjen e plotë ideologjike, politike e organizative të partive komuniste me partinë socialdemokrate. U flak tej parimi i partishmërisë proletare dhe, nën parullën e liberalizimit e të «lirisë së mendimit krijues» u inkurajua gjallërimi i gjithfarë rrymave dekadente e antisocialiste në fushën e kulturës, të letërsisë dhe të arteve.

Në lëmin politik Hrushovi dhe grupi i tij njollosën e hodhën poshtë teorinë dhe praktikën marksiste-leniniste mbi luftën e klasave dhe diktaturën e proletariatit, duke e quajtur atë një «shtrembërim stalinist» dhe duke e shpallur tërë periudhën historike të udhëheqjes së Stalinit një «periudhë të errët, antidemokratike, periudhë shkeljesh të ligjshmërisë socialiste, terrori e vrasjesh, burgjesh e kampesh përqendrimi». U hap kështu rruga për likuidimin e diktaturës së proletariatit dhe për zëvendësimin e saj me diktaturën burokratike

e kundërrevolucionare të aristokracisë së re «socialiste» që kishte lindur e po zhvillohej, duke u mbuluar, e gjithë kjo, me parullat mashtruese të «demokratizimit» e të «rivendosjes së lirisë e të drejtësisë socialiste» gjoja të humbura e tani të rifituara.

Në lëmin ekonomik hrushovianët shpallën të gabuara e të shtrembra vijën dhe metodat staliniane të zhvillimit e të drejtimit të ekonomisë socialiste në të gjitha degët, veçanërisht në atë të bujqësisë, hodhën poshtë orientimet staliniane të perfeksionimit e të zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve socialiste në prodhim në periudhën historike të kalimit nga socializmi në komunizëm dhe, nën pretekstin e kapërcimit të «amullisë» e të vështirësive ekonomike të krijuara gjoja nga vija «dogmatike» e Stalinit, ndërmorën një varg «reformash», që hapën rrugën për degjenerimin gradual të rendit ekonomik socialist dhe për veprimin e pakontrolluar të ligjeve ekonomike të kapitalizmit.

Në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare revizionistët hrushovianë shpallën «të gabuar», «të ngurtë» e «dogmatike» vijën e politikës së jashtme staliniane, vijën e luftës thikë më thikë kundër imperializmit dhe të përkrahjes së vendosur internacionaliste të luftës revolucionare e çlirimtare, e zëvendësuan atë me politikën e «bashkekzistencës paqësore» si vijë e përgjithshme e politikës së jashtme të shtetit sovjetik, trumbetuan në të katër anët bashkekzistencën paqësore si një «zbulim të madh», si «kontribut të paçmuar në zhvillimin krijues të marksizëm-leninizmit» dhe si «fillimin e një epoke të re në marrëdhëniet ndërkombëtare». Çdo gjë — çështja e revolucionit, e çlirimit të popujve,

e pavarësisë dhe e sovranitetit të vendeve socialiste iu nënshtrua nevojave të «bashkekzistencës paqësore» e të «paqes me çdo kusht» me imperializmin, sidomos me atë amerikan. Kjo ishte, në fakt, vija e kapitullimit para imperializmit, e heqjes dorë nga lufta kundër tij, e afrimit dhe e bashkëpunimit me të.

Fushata antistaliniste u shërbeu renegatëve hrushovianë për të kaluar në fazën e dytë — në atë të orvatjeve për fuqizimin dhe për stabilizimin e tradhtisë në ekonomi, politikë e ideologji, brenda vendit e në marrëdhëniet e jashtme. Kjo ishte faza e kodifikimit të pikëpamjeve të revizionizmit hrushovian dhe e zbatimit në shkallë të gjerë të politikës së tij.

N. Hrushovi dhe grupi i tij likuiduan plotësisht partinë proletare marksiste-leniniste, e shndërruan atë në një armë të kundërrevolucionit revizionist, i zëvendësuan normat leniniste të ndërtimit të partisë me norma revizioniste dhe, më së fundi, e shpallën «parti të të gjithë popullit». U likuidua, gjithashtu, diktatura e proletariatit dhe u shpall ajo si një fazë e kapërcyer, nën pretekstin e shndërrimit të shtetit sovjetik në «shtet të të gjithë popullit», që s'është tjetër veçse një maskë «demokratike», prapa së cilës fshihet diktatura kundërrevolucionare e klasës së re borgjeze të përfaqësuar nga renegatët revizionistë. Filloi në shkallë të gjerë procesi i restaurimit të kapitalizmit në ekonomi. Shpallja e «fitimit» si kriteri dhe stimuli themelor i zhvillimit ekonomik, decentralizimi i disa hallkave jetësore të drejtimit të ekonomisë, inkurajimi i tendencave të pronës private, shndërrimi i pronës socialiste në një mjet të shfrytëzimit të punonjësve e të siguri-

mit të fitimeve të mëdha nga shtresat drejtuese të borgjezisë burokrate, hapja e dyerve për depërtimin e lirë të kapitaleve të huaja dhe, si pasojë e gjithë këtyre, veprimi gjithnjë më i fuqishëm i ligjeve kapitaliste të ekonomisë, anarkia në prodhim e konkurrenca midis ndërmarrjeve, gjallërimi i konsiderueshëm i tregut të zi, i spekulimit, i shpërdorimeve, i ryshfetit etj., — janë disa tipare themelore të degjenerimit borgjez të ekonomisë sovjetike. Krahas kësaj, kursi antimarksist i revizionistëve hrushovianë i hapi krejtësisht dyert për depërtimin e papërmbajtur të ideologjisë e të kulturës dekadente borgjeze, për degjenerimin moral të njerëzve, e në radhë të parë, të brezit të ri, për përhapjen e mënyrës perëndimore të jetesës.

Në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare kjo fazë u karakterizua nga vendosja e plotë e aleancës kundërrevolucionare të udhëheqjes sovjetike me imperializmin amerikan për ndarjen e sundimit botëror, në kurriz të lirisë e të pavarësisë së popujve, të interesave jetikë të vendeve socialiste, të çështjes së revolucionit e të socializmit. Shitja e interesave të luftës çlirimtare të popullit të Kongos, pazarllëqet me imperializmin amerikan e gjermanoperëndimor në dëm të interesave kombëtarë të Republikës Demokratike Gjermane, tradhtia ndaj popullit kuban në ditët e krizës së Karaibeve, komplotet e përbashkëta me imperialistët amerikanë e reaksionarët indianë kundër Republikës Popullore të Kinës, nënshkrimi i traktatit famëkeq sovjeto-amerikano-anglez për ndalimin e pjesshëm të provave të armëve bërthamore, sabotimi i luftës revolucionare të popullit vietnamez kundër agresorëve

amerikanë dhe i luftës së drejtë të popujve arabë kundër agresionit imperialisto-izraelit etj., — të gjitha këto dhe akte të tjera janë hallka të zinxhirit të gjatë të aleancës kundërrevolucionare të udhëheqjes revizioniste sovjetike me imperializmin amerikan.

Në këtë periudhë, kur revizionizmi hrushovian ishte akoma në ngjitje dhe i kishte pozitrat deri diku të forta, nuk ngurronte që, në mjaft raste, të hiqte maskën, të shfaqte hapur pikëpamjet e tij, të cilave përpiquej t'u vinte një bazë teorike «marksiste-leniniste» dhe t'i argumentonte me «kushtet e reja». Ishte pikërisht kjo kohë kur gjithë kori revizionist, nën drejtimin absolut të «shkopit të dirigjentit», Hrushovit, u këndonte me zë të lartë «bashkekzistencës paqësore», «garës paqësore», «rrugës paqësore», «shtetit e partisë të të gjithë popullit», «botës pa armë, pa ushtri e pa luftëra», kur flitej hapur se imperializmi dhe krerët e tij janë bërë «të arsyeshëm» e «paqedashës», se «fati i popujve vendosej nga rezolutat e Kombeve të Bashkuara», se «aleanca sovjeto-amerikane ishte garancia më e madhe e paqes në botë» etj., etj.

Gjithë kjo vijë kundërrevolucionare dhe pikëpamjet antimarksiste-leniniste të revizionistëve hrushovianë u konsakruan në vendimet e Kongresit të 22-të të PK të BS, sidomos në programin e PK të BS të adoptuar në këtë kongres, i cili, për shkak të pozitës dominuese të udhëheqjes sovjetike në kampin revizionist, u bë kodi kryesor i rrymës së revizionizmit modern ndërkombëtar.

Në këtë kongres famëkeq u ripërsëritën, tani hapazi, publikisht, sulmet dhe shpifjet e përbindshme ku-



ndër Stalinit. Kjo tregonte, së pari, se ndjenja e simpatisë ndaj J. V. Stalinit ishin kurdoherë të gjalla te populli sovjetik dhe kjo përbënte një preokupim të madh për klikën udhëheqëse hrushoviane; së dyti, se kjo klikë ecte me këmbëngulje në rrugën e saj anti-marksiste; dhe së treti, se ajo kishte nevojë për «gogolin e stalinizmit» për të mposhtur rezistencën gjithnjë më të vendosur që po ngrihej në lëvizjen komuniste ndërkombëtare kundër vijës së saj tradhtare.

Por logjika e tradhtisë është e tillë që sa më thellë futesh në llumin e saj, aq më shumë shtrëngohet litari në grykën e tradhtarëve. Revizionizmi lindi si një rrymë regresive për ta shpëtuar kapitalizmin nga kriza e tij e përgjithshme. Por në këtë rol ai u fut edhe vetë në një krizë të thellë e të përgjithshme, nga e cila nuk mund ta shpëtojë asgjë. Sidomos shumë e rëndë është bërë e po bëhet gjendja për kreun e revizionizmit, për klikën sunduese sovjetike.

Lufta e partive dhe e forcave marksiste-leniniste dhe vetë jeta, që është gjykatësi më i mirë i çdo politike, hodhën poshtë vijën dhe teorinë e udhëheqjes revizioniste sovjetike, demaskuan thelbin e tyre anti-marksist e kundërrevolucionar. Për revizionistët hrushovianë erdhën kohë të vështira. Revizionizmi hrushovian hyri në fazën e tij të tretë, që ishte faza e rënies, e krizës së tij të thellë e të përgjithshme, faza kur tradhtia zhvillohet, por jep fryte të hidhura dhe sjell disfata për revizionistët.

Dështuan me turp orvatjet e udhëheqjes revizioniste hrushoviane për t'i imponuar gjithë lëvizjes komuniste ndërkombëtare kursin revizionist dhe diktatin

e saj shovinist, u zhvillua me ritme të shpejta procesi i madh, i pandalshëm i diferencimit në lëvizjen komuniste në vendet e ndryshme e në shkallë botërore. Qëndrimi parimor dhe i vendosur i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe i partive të tjera marksiste-leniniste në mbrojtje të parimeve të pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe lufta e tyre konsekuente kundër tradhtisë së revizionizmit sovjetik luajtën rolin kryesor në këtë proces të rëndësishëm historik. Brenda pak vitesh u krijuan dhjetëra parti e organizata të reja marksiste-leniniste, që ngritën lart flamurin e luftës kundër revizionizmit modern dhe kanë marrë në duart e veta çështjen e revolucionit. Kjo është një disfatë e rëndë, e pandreqshme e me pasoja vdekjeprurëse për reneгатët revizionistë në të gjitha vendet.

Thellimi këmbëngulës i revizionistëve hrushovianë në rrugën kriminale të restaurimit kapitalist në Bashkimin Sovjetik, të aleancave kundërrevolucionare me imperializmin, të sabotimit e të përçarjes së lëvizjes komuniste e revolucionare botërore, disfatat e njëpasnjëshme të tyre në politikën e brendshme e të jashtme, të shoqëruara me vështirësi serioze ekonomike e politike — të gjitha këto e kanë futur udhëheqjen revizioniste sovjetike në një kontradiktë të thellë, të papajtueshme e gjithnjë më të ashpër me popullin sovjetik dhe me popujt revolucionarë të mbarë botës.

Janë acaruar, gjithashtu, së tepërmi kontradiktat e udhëheqjes revizioniste sovjetike me grupimet e tjera revizioniste, të cilat, në përputhje me interesat e veçantë të borgjezisë së tyre kombëtare, përfaqësuese të së cilës janë, kërkojnë ritme më të shpejta të degjene-

rimit të rendit socialist në një rend të demokracisë borgjeze dhe një pavarësi e liri veprimi më të madhe nga Moska. Po dobësohen e po shkallmohen dita-ditës më shumë pozitat sunduese të klikës hrushoviane të Bashkimit Sovjetik në stanin revizionist. Dëshmia më e qartë për këtë janë «rebelimet» e revizionistëve çekoslovakë e të tjerë kundër diktatit të udhëheqjes sovjetike dhe dështimet e vazhdueshme diskredituese të kësaj të fundit në orvatjet për organizimin e një mbledhjeje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore revizioniste.

Janë lëkundur nga themeli pozitat e klikave revizioniste në fuqi, veçanërisht të asaj sovjetike. Ato nuk janë më në gjendje të mbulojnë të çarat e thella dhe luftën për pushtet që po zhvillohet gjithnjë më me egërsi në gjirin e tyre. Falimentimi dhe rrëzimi i palavdishëm i frymëzuesit dhe i kryetarit të revizionistëve modernë sovjetikë, N. Hrushovit, ishin shprehja më e qartë e krizës së thellë dhe e paqëndrueshmërisë së tyre.

Pasardhësit e N. Hrushovit u detyruan të ndryshojnë taktikë. Ata i lanë në harresë parullat dhe predikimet e bujshme të N. Hrushovit dhe preferuan të kalojnë nga fjalët në vepra. Në qoftë se N. Hrushovit i përket «merita» e përpunimit të vijës së përgjithshme të revizionizmit modern, pasardhësve të tij, klikës së Brezhnjev-Kosiginit, u përket «merita» e zbatimit plotësisht në jetë të kësaj vije kundërrevolucionare.

Por as taktikat «e matura» të klikës së Brezhnjev-Kosiginit nuk e nxorën e nuk mund ta nxirrnin revizionizmin hrushovian nga bataku ku është fundosur.

Ligjet e hekurta të historisë çajnë në mënyrë të pandalshme rrugën e tyre, duke thelluar dita-ditës krizën dhe vështirësitë e renegatëve revizionistë.

Përballë disfatave të pariparueshme, si brenda edhe jashtë, përballë rezistencës dhe luftës revolucionare që u bëhet jashtë dhe brenda nga populli dhe revolucionarët sovjetikë, nga partitë marksiste-leniniste dhe nga revolucionarët marksistë-leninistë në gjithë botën, revizionistët hrushovianë përpiqen ta shpëtojnë sundimin e tyre duke vendosur diktaturën fashiste ushtarake. Kjo u duhet atyre për të shtypur revoltën e masave punonjëse, të popullit sovjetik dhe çdo veprimtari të marksistë-leninistëve revolucionarë, për të frenuar veprimet diskredituese të revizionistëve liberalë «të paduruar» brenda vendit, për të mbajtur nën kontroll klikat revizioniste të vendeve të tjera dhe për të rivendosur diktatin sovjetik mbi partnerët revizionistë.

Kjo politikë gjeti shprehjen e saj më flagrante në agresionin e revizionistëve sovjetikë dhe të satelitëve të tyre kundër popullit çekoslovak. Ky agresion ia çori krejt maskën klikës së Kremlinit. Metodrat e përdorura, që nga presionet, shantazhet, të puthurat e Juda Iskariotit në Çerna nad Tisu e në Bratislavë dhe deri te sulmi në befasi, në errësirën e natës, pa asnjë bazë, goftë edhe formale, që të justifikonte ndërhyrjen brutale me armë, i jep kësaj ndërhyrjeje kuptimin e vërtetë që ka: agresion imperialist, fashist.

Forcimi i tendencave agresive, imperialiste, fashiste, të politikës së brendshme e të jashtme të Bash-

kimit Sovjetik revizionist, që është shprehje jo e forcës, por e dobësisë së udhëheqjes hrushoviane, kërkon patjetër edhe bazën e vet ideologjike. Shërbëtorët ideologjikë të revizionizmit janë duke e plotësuar tani këtë nevojë. Për këtë qëllim kohët e fundit në shtypin sovjetik janë botuar një sërë artikujsh të ashtuquajtur teorikë, plot demagogji pseudorevolucionare, të cilët synojnë të krijojnë një perde tymi që njerëzit të mos shohin se çfarë fshihet në të vërtetë prapa saj. Fjala është për ta veshur tradhtinë revizioniste me maska të reja në këto momente shumë kritike që po kalon udhëheqja hrushoviane e Bashkimit Sovjetik. Mbi të gjitha, po orvaten që kalimin e plotë të klikës revizioniste sovjetike në diktaturën e metodat fashiste ta justifikojnë e ta fshehin me gjoja kthimin te Stalini dhe te vija e tij marksiste-leniniste.

Ta akuzosh me egërsinë më të shfrenuar Stalinin për politikën e tij të drejtë, revolucionare, marksiste-leniniste në të gjitha fushat, siç bënë renegatët revizionistë hrushovianë, dhe tani, përpara disfatës së tyre të plotë në të gjitha drejtimet, të orvatesh të fshihesh prapa emrit të Stalinit, duke pretenduar, ku haptazi e ku tërthorazi, se gjoja po kthehen në politikën e drejtë të Stalinit, ky është mashtrimi më i madh, hipokrizia më e paturpshme, demagogjia më e ulët dhe më e dëshpëruar e revizionistëve sovjetikë.

Detyra e marksistë-leninistëve është që këto orvatje mashtruese të revizionistëve sovjetikë ta demaskojnë katërcipërisht dhe t'ua heqin atyre nga duart këtë armë të rrezikshme.

## Vendosja e diktaturës fashiste ushtarake nën maskën e mbrojtjes së idesë të diktaturës së proletariatit

Një ndër manovrat demagogjike të klikës revizioniste sovjetike, për të justifikuar kalimin e saj në diktaturën fashiste, është zhurma që ajo po bën kohët e fundit gjoja në mbrojtje të mësimëve marksiste-leniniste për diktaturën e proletariatit, megjithëse, siç dihet, është pikërisht klika udhëheqëse sovjetike që vetë i ka vënë kazmën diktaturës së proletariatit në Bashkimin Sovjetik dhe ka hedhur kundër saj baltën më të ndyrë, duke e paraqitur atë si një «diktaturë të egër, barbare, çnjerëzore, që s'ka bërë gjë tjetër veçse krime kundër klasës punëtore e popullit punonjës».

Ata që sot po dalin me flamurin e mbrojtjes së diktaturës së proletariatit, janë pikërisht ata që e kanë shpallur të likuiduar atë në Bashkimin Sovjetik, nën pretekstin e shndërrimit të shtetit sovjetik në «shtet të të gjithë popullit». Revizionistët sovjetikë po përpiqen tani të krijojnë iluzionin se i ashtuquajhuri shtet i gjithë popullit na qenka «vazhdimi i drejtpërdrejtë i shtetit të diktaturës së proletariatit». Ky iluzion mund të mashtrojë vetëm naivët, sepse asgjë të përbashkët nuk ka e nuk mund të ketë midis diktaturës revolucionare të proletariatit dhe «shtetit të të gjithë popullit». Ky i fundit në të vërtetë është mohimi i plotë i diktaturës së proletariatit, kthimi i saj në diçka krejt të kundërt — në diktaturë kundërrevolucionare të borgjezisë së re, revizioniste.

«Vazhdimësia midis diktaturës së proletariatit dhe shtetit të të gjithë popullit, — shkruajnë kalemxinjtë e «Pravdës» së Moskës, — duket qartë në ruajtjen e rolit udhëheqës të klasës punëtore». Por si e luan këtë rol udhëheqës klasa punëtore kur shteti socialist dhe partia komuniste, siç thonë revizionistët, e kanë humbur karakterin e tyre klasor proletar dhe janë bërë «shtet e parti të të gjithë popullit»? Është e qartë se këtu kemi të bëjmë me një mashtrim tepër të trashë e banal. Në të vërtetë, klasa punëtore në Bashkimin Sovjetik ka kohë që nuk është më në fuqi. Ajo është tani një klasë që shtypet e shfrytëzohet, korruptohet e degjenerohet dhe është shndërruar, nga një forcë drejtuese, në një forcë thjesht prodhuese, nga një forcë politike në një apendiks ekonomik. Në të vërtetë, ajo që sundon e drejton tani në Bashkimin Sovjetik, është klasa e re borgjeze, e cila ka vendosur diktaturën e saj të egër mbi klasën punëtore dhe mbi popullin sovjetik.

Revizionistët hrushovianë sovjetikë, që sot luajnë me parullat e diktaturës së proletariatit, janë pikërisht ata që kanë mbrojtur e propaganduar me të madhe tezat revizioniste që predikojnë karakterin mbiklasor të shtetit të sotëm kapitalist dhe përdorimin e tij si një mjet për kalimin në socializëm, që mohojnë nevojën e thyerjes së makinës shtetërore borgjeze si kusht i domosdoshëm për vendosjen e diktaturës së proletariatit, që mohojnë rolin udhëheqës të partisë komuniste në sistemin e diktaturës së proletariatit, pa të cilin kjo e fundit nuk mund të ekzistojë etj.

Falsiteti i tërë zhurmës demagogjike të revizionistëve sovjetikë gjoja në mbrojtje të idesë së diktaturës

së proletariatit, duket fare qartë edhe në faktin që ata, si edhe më parë, bile me një intensitet akoma më të madh, vazhdojnë të na sulmojnë për besnikërinë tonë të patundur ndaj diktaturës së proletariatit. Ashtu si edhe në kohën e fushatës së egër kundër Stalinit dhe veprës së tij, ata sulen me tërbim kundër diktaturës së proletariatit në Shqipëri, duke e quajtur atë «regjim burokratiko-ushtarak, mbytës të lirisë e të demokracisë socialiste» etj. Veçanërisht ata sulmojnë tezën marksiste-leniniste të Partisë sonë se diktatura e proletaria-tit është e domosdoshme deri në fitoren e komunizmit në shkallë botërore, për arsye se gjatë tërë kësaj periudhe vazhdon lufta e klasave brenda e jashtë vendit, vazhdon lufta midis dy rrugëve — socialiste e kapitaliste, tezë që e ka vërtetuar plotësisht praktika revolucionare. Prova më bindëse e drejtësisë së kësaj teze është vetë fakti i kundërrevolucionit revizionist dhe i restaurimit të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik afro 40 vjet pas triumfit të Revolucionit Socialist të Tetorit.

Nga të gjitha këto është më se e qartë se në veprimtarinë e hrushovianëve nuk kemi të bëjmë aspak me një mohim të tezave të mëparshme revizioniste dhe me një rikthim në pozitën marksiste-leniniste mbi diktaturën e proletariatit, por me një orvatje mashtruese për të maskuar me parulla «revolucionare» atë që po ndodh në të vërtetë në Bashkimin Sovjetik: kalimin e plotë në metodat e diktaturës ushtarake fashiste. Veshja e fashizmit me frazeologji «socialiste» e «revolucionare» nuk është aspak një gjë e re. Këtë taktikë përdorën në kohën e tyre edhe Hitleri në Gjermani e Mussolini në Itali.



Masat shtrënguese, thirrjet për forcimin e luftës ideologjike, të disiplinës, të unitetit etj., janë masa që i shërbejnë konsolidimit të diktaturës fashiste të klikës revizioniste hrushoviane. Në të vërtetë, masat shtrënguese janë veprime të diktaturës fashiste për shtypjen e çdo veprimtarie revolucionare të popullit sovjetik e të bolshevikëve të vërtetë. Forcimi i luftës ideologjike nga ana e tyre në fakt është forcim i luftës kundër çdo mendimi me të vërtetë revolucionar. Disiplina që kërkohet udhëheqësit sovjetikë është disiplinë e «qindsheve të zeza» për të bërë zap çdo njeri që ngre krye kundër tradhtisë revizioniste. Uniteti për të cilin flasin revizionistët hrushovianë, është unitet mbi baza revizioniste rreth partisë revizioniste dhe për qëllimet kundërrevolucionare të revizionistëve.

Udhëheqja sovjetike po përpiqet të krijojë përshtypjen se masat e saj drejtohen kryesisht kundër ekstremistëve liberalë, të cilët, kohët e fundit, sidomos pas ngjarjeve në Çekoslovakia e në Poloni, janë aktivizuar akoma më shumë. Megjithëse në thelb udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe elementët liberalë ekstremistë ecin në të njëjtën rrugë antimarksiste e tradhtare, veprimtaria e këtyre elementëve është e padëshirueshme për udhëheqjen revizioniste. Kjo i trembet një tjetër kundërrevolucionari në kundërrevolucion, nuk do që të pësojë fatin e N. Hrushovit apo të klikës së Novotnit. Por ajo që e shqetëson më tepër udhëheqjen sovjetike, është fakti se veprimtaria e shfrenuar dhe e pamatur e këtyre elementëve i zbulon hapur kartërat e revizionistëve, bën të falimentojë demagogjia e tyre, nxjerr sheshit tradhtinë dhe kjo nuk mund të mos i

hapë sytë popullit sovjetik, nuk mund të mos rritë rezistencën dhe luftën e tij për të spastruar me fshesën e madhe të revolucionit si revizionistët liberalë ashtu edhe «konservatorët», si ultrat ashtu edhe «të moderuarit».

Prandaj pikërisht kundër këtij revolucion i drejtohen të gjitha masat dhe diktatura fashiste e udhëheqjes revizioniste sovjetike. Por, sido që të orvatet ajo ta mbytë këtë revolucion me shtypje e me mashtrim, ai është i pashmangshëm. Populli sovjetik nuk do ta durojë gjatë tradhtinë revizioniste, ai do ta thotë, më në fund, fjalën e vet vendimtare.

### **Degjenerimi i plotë i PK të BS nën thirrjen për mbrojtjen e parimeve të partisë**

Të gjithë armiqtë e klasës, për realizimin e qëllimeve të veta kundërrevolucionare, goditjen e tyre kryesore e kanë drejtuar kurdoherë kundër partisë revolucionare marksiste-leniniste, që është truri dhe zemra e klasës punëtore. Kështu e filluan tradhtinë e tyre edhe revizionistët modernë hrushovianë. Dhe tani pikërisht ata që Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit e kanë shndërruar në një parti revizioniste, kundërrevolucionare e antikomuniste, ata që i hapën rrugën degjenerimit revizionist e borgjez të shumë partive komuniste e punëtore të vendeve të tjera, pikërisht ata po na dalin sot gjoja në mbrojtje të mësimëve të mاركsizëm-leninizmit mbi partinë dhe po «kritikojnë» ata që i shkelin këto parime. Duke u përpjekur të gjejnë

justifikime për agresionin e tyre fashist në Çekoslovakë, ata akuzojnë në mënyrë të veçantë revizionistët çekoslovakë se «shpërthyen një fushatë të tërbuar kundër kuadrove të shëndoshë të partisë, që përbëjnë fondin e artë të saj», «u ngritën kundër rolit udhëheqës të partisë komuniste», «predikonin pluralizmin e partive politike», «kërkonin ta bënin partinë një lloj organizate kulturore-iluministe ose ideopredikuese», «ishin për të ashtuquajturin partneritet të barabartë të të gjitha organizatave shoqërore me partinë komuniste», «sulmonin normat leniniste të jetës së brendshme të partisë» etj.

Në gojën e renegatëve revizionistë sovjetikë akuza të tilla tingëllojnë si një hipokrizi e madhe dhe një cinizëm i pashoq, sepse janë pikërisht këta vetë dhe aleatët e tyre që, si më parë, edhe tani i predikojnë, i mbrojnë e i zbatojnë këto krime në partitë e veta.

Partia e Punës e Shqipërisë prej kohësh dhe më se një herë, ka vënë në dukje tradhtinë e plotë të udhëheqësve revizionistë sovjetikë ndaj mësimëve të marksizëm-leninizmit mbi partinë proletare. Po, për të demaskuar demagogjinë e madhe të revizionistëve se ata gjoja po rikthehen në pozitat e mbrojtjes së këtyre mësimëve, në zbatimin e normave leniniste të partisë, është e nevojshme të ndalemi edhe një herë rreth disa fakteve të njohura.

Në qoftë se kundërrevolucionarët dubçekistë sulmuan e spastruan agjunkturën sovjetike — kundërrevolucionarët novotnistë, të cilët udhëheqja sovjetike i quan «fondi i artë i partisë», klika kundërrevolucionare hrushoviane në Bashkimin Sovjetik sulmoi e spastroi

në vendin e vet kuadrot e vërtetë revolucionarë që u qëndronin besnikë vijës marksiste-leniniste të Partisë Bolshevike e idealeve të socializmit. Nën parullën e «luftës kundër kultit të individit të Stalinit», apo nën pretekstin e qarkullimit, revizionistët hrushovianë bënë kërdrinë në PK të BS. 70 për qind e anëtarëve të Komitetit Qendror të zgjedhur në Kongresin e 19-të të PK të BS më 1952, nuk figuronin më në listën e anëtarëve të KQ që u zgjodhën në Kongresin e 22-të më 1961. 60 për qind e anëtarëve të KQ që u zgjodhën në Kongresin e 20-të më 1956, nuk figuronin më në listën e anëtarëve të KQ që u zgjodhën në Kongresin e 23-të më 1966. Një spastrim akoma më i madh është bërë në organet më të ulëta të partisë. Kështu, për shembull, vetëm gjatë vitit 1963 më tepër se 50 për qind e anëtarëve të komiteteve qendrore dhe të komiteteve të qarqeve të partisë në republikat e Bashkimit Sovjetik u shkarkuan nga detyrat e tyre, kurse në komitetet e partisë të qyteteve dhe të rajoneve 3/4 e anëtarëve të tyre u zëvendësuan me të tjerë. Spastrimi i kuadrove revolucionarë është bërë në shkallë të gjerë edhe në organet e pushtetit, e sidomos të ushtrisë dhe të sigurimit të shtetit.

Për sa i përket çështjes së rolit udhëheqës të partisë komuniste, për mohimin e të cilit udhëheqja sovjetike akuzon revizionistët çekoslovakë, ky rol është likuiduar prej kohësh në vetë Bashkimin Sovjetik. Për çfarë roli udhëheqës të partisë revolucionare të klasës punëtore në Bashkimin Sovjetik mund të bëhet fjalë kur revizionistët hrushovianë kanë flakur tej vijën marksiste-leniniste dhe karakterin klasor proletar të

PK të BS, i kanë imponuar asaj një vijë revizioniste tradhtarë në shërbim të borgjezisë së re sovjetike e të imperializmit bolëror, me atë të SHBA-së në krye, dhe e kanë shndërruar atë në «parti të të gjithë popullit»?! Parulla «partia e të gjithë popullit» në thelb është jo mohim i karakterit klasor përgjithësisht, sepse nuk ka e nuk mund të ketë parti joklasore e mbiklasore, por mohim i karakterit klasor **proletar** të saj, është një etiketë për të fshehur shndërrimin e saj nga parti marksiste-leniniste proletare revolucionare në parti revizioniste borgjeze kundërrevolucionare.

Për çfarë normash mund të flasin revizionistët sovjetikë kur ata në partinë e tyre i kanë varrosur me kohë këto norma, i kanë shndërruar nga norma marksiste-leniniste në norma revizioniste, që u shërbejnë qëllimeve e vijës së tyre kundërrevolucionare? Revizionistët sovjetikë flasin për centralizëm demokratik, por në të vërtetë ai është centralizëm burokratik, flasin për kritikë e autokritikë bolshevike, por ato në të vërtetë janë hipokrite, flasin për disiplinë të ndërgjegjshme partie, por ajo në të vërtetë është fashiste, flasin për moral proletar, por në të vërtetë ai është borgjez, flasin për liri mendimi, por atje çdo shfaqje e lirë e mendimit marksist-leninist revolucionar të çon në burg, në çmendinë e në kampe përqendrimi. Pavarësisht nga maskat, normat e tanishme në PK të BS janë antileniniste, janë borgjeze, reaksionare, fashiste.

Është pikërisht kursi revizionist i Kongresit të 20-të të PK të BS që u hapi rrugën jo vetëm degjenerimit të vetë kësaj partie, por edhe degjenerimit të një sërë partish të tjera komuniste e punëtoresh në vendet

ish-socialiste e kapitaliste. Është pikërisht ky kurs kundërrevolucionar që frymëzoi e inkurajoi përhapjen e gjithfarë pikëpamjeve antimarksiste të revizionistëve të vendeve të ndryshme për kalimin në socializëm nën udhëheqjen e partive joproletare, që bile as e quajnë fare veten socialiste, për unitetin me renegatët social-demokratë deri në shkrirjen e plotë organizative me ta në një të ashtuquajtur parti unike të klasës punëtore, për likuidimin e partive komuniste dhe shkrirjen e tyre në frontet e udhëhequra nga borgjezia etj. Si rezultat i kësaj vije revizioniste, partitë komuniste në shumë vende kapitaliste në të vërtetë nuk ekzistojnë më si të tilla, ato janë shndërruar në një variant të ri të social-demokracisë së vjetër të diskredituar, që kanë braktisur çdo ideal revolucionar dhe bashkëpunojnë me borgjezinë për mbrojtjen e rendit kapitalist. Ndërsa në vendet ish-socialiste ato janë shndërruar nga parti të klasës punëtore për ndërtimin e socializmit në parti të borgjezisë së re për rivendosjen e plotë të kapitalizmit.

Pluralizmi, sistemi i shumë partive, kundër të cilit bëjnë sot zhurmë revizionistët sovjetikë, ekziston jo vetëm në Çekosllovakia, por edhe në shumë vende të tjera revizioniste dhe kudo duken shenjat e gjallërimit e të aktivizimit politik e organizativ të partive të tjera për të fituar pozita drejtuese e sunduese në «shtetin socialist», që po merr gjithnjë e më shumë tiparet e një shteti borgjez. Këto pikëpamje i mbrojnë e i propagandojnë me të madhe edhe shumë revizionistë të tjerë në vendet kapitaliste, sidomos në Itali e në Francë, të cilët u bëjnë presion kolegëve të tyre në vendet ish-socialiste që të ecin sa më shpejt në këtë rrugë, për

t'ia përshtatur sa më shumë «demokracinë socialiste» demokracisë borgjeze.

Përse, pra, pikërisht tani udhëheqja sovjetike tregohet kaq e shqetësuar për çështjen e rolit udhëheqës të partisë dhe ngrihet me forcë kundër pluralizmit? Revizionistët sovjetikë e bëjnë këtë jo vetëm për të gjetur një justifikim suplementar për përlligjjen e agresionit të tyre në Çekoslllovakë, por, me sa duket, këtu ka edhe shkaqe të tjera të thella. Klika e Brezhnjev-Kosiginit është tepër e shqetësuar për mbrojtjen e pozitës së saj sunduese nga rreziqet e mëdha që e kërcënojnë si brenda edhe jashtë partisë. Në partinë revizioniste sovjetike nuk ka dhe nuk mund të ketë unitet. Revizionizmi është përçarje e sigurt. Në Bashkimin Sovjetik, si dhe në çdo vend tjetër revizionist, ekziston lufta fraksioniste për pushtet midis grupeve e rrymave revizioniste, siç e vërtetojnë këtë qartë rrëzimi i N. Hrushovit dhe ndryshimet e tjera në udhëheqjen sovjetike. Ky proces shturjeje e dezintegrimi do të thellohet, gjithnjë e më shumë, në mënyrë të pashmangshme. Kursi i restaurimit kapitalist në Bashkimin Sovjetik nuk mund të mos çojë në gjallërimin e grupeve të ndryshme borgjeze e nacionaliste, gjë që përgatit kushtet objektive për lindjen, shpejt a vonë, edhe të sistemit borgjez të shumë partive. Klika revizioniste e Brezhnjev-Kosiginit, me qëllim që të ruajë pozitën e vet sunduese, përpiqet e do të përpiqet me të gjitha forcat, pa u ndalur as para mjeteve të dhunës, ta frenojë këtë proces. Për këtë qëllim ajo po përpiqet e do të përpiqet të shfrytëzojë edhe traditën e ekzistencës së një partie të vetme dhe të luftës së bolshevikëve

kundër fraksionistëve e deviatorëve. Shturja e partisë së vetme nuk i intereson klikës drejtuese sovjetike edhe nga pozita e Bashkimit Sovjetik si shtet i madh shumëkombësh, sepse ajo do të çonte në përçarjen e brendshme nacionale, si pasojë, edhe në minimin e rolit të Bashkimit Sovjetik revizionist në arenën ndërkombëtare si fuqi e madhe imperialiste.

Por mbi të gjitha, revizionistët hrushovianë përpiqen ta shfrytëzojnë traditën bolshevike të partisë së vetme, me të cilën janë brumosur komunistët dhe populli sovjetik, për t'i mbajtur ata të lidhur pas PK të BS, nga e cila nuk ka mbetur asgjë komuniste. Ata përpiqen ta shfrytëzojnë këtë traditë për të mos lejuar organizimin e revolucionarëve sovjetikë dhe krijimin e partisë së re marksiste-leniniste në Bashkimin Sovjetik. Me gjithë faktin që jo të gjithë komunistët dhe klasa punëtore në Bashkimin Sovjetik e shohin se Partia e sotme Komuniste e BS nuk ka asgjë të përbashkët me Partinë Bolshevike të Lenin-Stalinit, bolshevizmi është kurdoherë i gjallë në Bashkimin Sovjetik dhe revolucionarët bolshevikë sovjetikë nuk do të thyhen përballë tragjedisë që po jeton vendi i sovjetëve, por do të ripërtërijnë traditat e mëdha të Revolucionit të Tetorit, të kohëve heroike të Leninit e të Stalinit. Dhe rruga e vetme për këtë është rikrijimi i partisë revolucionare marksiste-leniniste-staliniane, që të marrë në duart e veta flamurin e luftës për përmbysjen e klikës revizioniste dhe për rivendosjen e diktaturës së proletariatit, për ta kthyer përsëri Bashkimin Sovjetik në rrugën e komunizmit.



## Revizionistët kundër revizionizmit!?

Revizionizmi, si rrymë ideologjike borgjeze, anti-marksiste e kundërrevolucionare, është diskredituar kaq keq sa që edhe vetë krerët e revizionizmit, sidomos ata të Bashkimit Sovjetik, po përdorin termin «revizionist» për të kritikuar aleatët e tyre më të papërmbajtur e më liberalë. Aty-këtu u shpëton bile edhe ndonjë fjalë se revizionizmi është sot rreziku kryesor dhe lufta kundër tij — detyra kryesore. Kjo u duhet si për të justifikuar agresionin e tyre në Çekosllovakë, ashtu edhe për konsum të brendshëm. Taktika e revizionistëve sovjetikë është taktika e hajdutit dhe e vrasësit që thërret: Kapni hajdutin dhe vrasësin! Ata akuzojnë të tjerët për të gjitha ato që kanë bërë ose bëjnë vetë.

Revizionizmi modern lindi pas Luftës së Dytë Botërore. Përfaqësuesit e tij të parë ishin Brauderi në Amerikë dhe Titoja në Evropë. Por në sajë të luftës së partive marksiste-leniniste, me Partinë Bolshevike në krye, të udhëhequr nga Stalini, as brauderizmi, as titizmi nuk mundën të merrnin një përhapje të gjerë, ata u izoluan dhe u demaskuan plotësisht. Revizionizmi modern u shndërrua në një rrymë ndërkombëtare vetëm pas Kongresit të 20-të të PK të BS dhe në sajë të këtij kongresi famëkeq. Pas këtij kongresi revizionizmi hrushovian u zhvillua dhe u ngrit në një sistem të tërë pikëpamjesh politike, ideologjike e ekonomike borgjeze. Por, ndërsa marrin poza «antirevizioniste», revizionistët sovjetikë vazhdojnë t'i përmbahen me këmbëngulje vijës fund e krye revizioniste të kongreseve të 20-të

e të 22-të. Kjo tregon se gjithë zhurma e tyre e sotme kundër «revizionizmit» është një bluf i madh.

Udhëheqësit sovjetikë akuzojnë revizionistët çekoslovakë se «nën flamurin e luftës kundër dogmatizmit hodhën poshtë besnikërinë ndaj parimeve, predikojnë likuidimin e bindjeve revolucionare, të bazave të ideologjisë socialiste» etj. Por a nuk janë vetë revizionistët sovjetikë ata që deri sot kanë shpallur si armik kryesor «dogmatizmin», duke nënkuptuar me këtë marksizëm-leninizmin, dhe a nuk janë vetë ata që nën flamurin e luftës kundër dogmatizmit, tradhtuan marksizëm-leninizmin, përhapën gjerësisht revizionizmin dhe u vërsulën me tërbim kundër vijës revolucionare të Stalinit, kundër PPSH dhe partive të tjera marksiste-leniniste? A nuk janë udhëheqësit revizionistë sovjetikë ata që, ndërsa hedhin fishekzjarrë «kundër revizionizmit», vazhdojnë me tërbim luftën kundër partive që qëndrojnë me të vërtetë në pozita marksiste-leniniste, që kanë zhvilluar e zhvillojnë një luftë konsekuente, parimore e të papërkulur kundër revizionizmit? Kjo është një provë tjetër që demaskon demagogjinë «antirevizioniste» të udhëheqjes sovjetike.

Kur revizionistët çekoslovakë, për realizimin e qëllimeve të tyre kundërrevolucionare, përdorën gjerësisht parullat false të «lirisë», «demokracisë», «liberalizmit», «humanizmit», këto parulla, sipas udhëheqjes sovjetike, janë maskë «për të mbuluar veprimtarinë kundërrevolucionare», ndërsa kur këto parulla i përdor vetë ajo, që është po aq kundërrevolucionare sa edhe udhëheqja çeke, këto parulla na qenkan revolucionare! Liria dhe demokracia në gojën e revizionistëve, qofshin

këta hrushovianë, titistë, novotnistë apo dubçekistë, do të thotë liri e demokraci për revizionistët, për tradhtarët e kundërrevolucionarët; liberalizim do të thotë shkallmim e likuidim i diktaturës së proletariatit; humanizëm do të thotë zëvendësim i luftës së klasave me paqen dhe dashurinë kristiane me të gjithë armiqtë e klasës.

Kur revizionistët çekoslovakë flasin për «gabime të rënda në të kaluarën», «shtrembërime të demokracisë e shkelje të ligjshmërisë» dhe i përdorin këto për të errësuar e për të minuar fitoret e socializmit, kjo, sipas udhëheqësve sovjetikë, është një «taktikë djallëzore» e armiqve të socializmit. Por klika hrushoviane a nuk ndoqi pikërisht këtë «taktikë djallëzore» në Bashkimin Sovjetik? Sulmet dhe shpifjet e bëra nga hrushovianët kundër së kaluarës heroike të Bashkimit Sovjetik nuk mund të krahasohen as me ato të armiqve më të tërbuar imperialistë të Bashkimit Sovjetik. Asnjëri tjetër nuk e ka diskredituar Bashkimin Sovjetik më shumë sesa klika hrushoviane. Raporti «sekret» i Kongresit të 20-të është një dokument që, tanimë, njihet nga të gjithë dhe këtë dokument pasardhësit e Hrushovit kurrë nuk e kanë vënë, sadopak, në dyshim. Manovrat e tyre për të botuar ndonjë shkrim apo për të bërë ndonjë film ku tregohet roli i madh historik i J.V. Stalinit gjatë Luftës së Madhe Patriotike, nuk mund të mbulojnë tradhtinë e tyre të madhe ndaj ideve e ndaj veprës së Stalinit. Ato janë vetëm një dëshmi se Stalini është kurdoherë i gjallë në mendjet e në zemrat e njerëzve sovjetikë dhe kanë për qëllim t'i hedhin pluhur syve e të shuajnë rezistencën e popullit

sovjetik ndaj klikës hrushoviane, që ka varrosur periudhën e lavdishme historike të udhëheqjes së Stalinit.

Po kaq demagogjike janë në gojën e renegatëve revizionistë sovjetikë edhe parullat e tyre për nevojën e forcimit të luftës kundër ideologjisë borgjeze dhe të orvatjeve për «erozionin e ideologjisë socialiste», «kundër pluralizmit të ideologjive socialiste e të socializmit» si rend shoqëror. Ata akuzojnë tani revizionistët çekoslovakë se i kishin hapur dyert vërshimit të ideologjisë perëndimore, se po orvateshin të likuidonin bazat e ideologjisë socialiste, se predikonin një model të ri të socializmit që nuk bazohet në marksizëm-leninizmin etj. Duke u ngritur kundër këtyre «mëkateve» të revizionistëve çekoslovakë, gazeta sovjetike «Pravda» «zbulon për së dyti Amerikën», duke theksuar se «nuk ka dhe nuk mund të ketë socializëm pa rolin udhëheqës të partisë komuniste, të armatosur me idetë e marksizëm-leninizmit», se «asnjë socializëm «tjetër» pas lindjes dhe zhvillimit të socializmit shkencor nuk mund të ketë, asnjë ideologji «tjetër» socialiste që të mos jetë e bazuar te marksizëm-leninizmi nuk mund të ekzistojë në kohën tonë»<sup>1</sup>.

Për çfarë lufte kundër ideologjisë borgjeze mund të flasin revizionistët sovjetikë kur revizionizmi s'është gjë tjetër veçse një shfaqje e ideologjisë borgjeze në teori e në praktikë, kur në Bashkimin Sovjetik lulëzojnë egoizmi dhe individualizmi, rendja pas parasë e përfitimeve të tjera materiale, kur zhvillohen karrierizmi e burokratizmi, teknokratizmi, ekonomizmi e inte-

---

1 Shih: «Pravda», 19 e 22 shtator 1968.

Ëktualizmi, kur ideali më i lartë i njerëzve janë bërë daçat, veturat dhe gratë e bukura, kur letërsia dhe artet sulmojnë socializmin, çdo gjë revolucionare dhe predikojnë pacifizmin dhe humanizmin borgjez, jetën e zbrazët e të shturur të njerëzve që mendojnë vetëm për vete, kur qindra mijë turistë perëndimorë që vizitojnë çdo vit Bashkimin Sovjetik, përhapin atje ideologjinë dhe mënyrën e jetesës borgjeze, kur filmat perëndimorë mbushin ekranet e kinemave sovjetike, kur orkestrat e xhazet amerikane e të vendeve të tjera kapitaliste janë bërë orkestrat e preferuara të rinisë dhe kur paradat e modës perëndimore janë bërë të modës në Bashkimin Sovjetik? Në qoftë se deri dje shfaqjet e ndryshme të ideologjisë borgjeze mund të quheshin mbeturina të së kaluarës, tani ideologjia borgjeze është bërë pjesë përbërëse e superstrukturës kapitaliste, e cila ngrihet mbi bazën kapitaliste-shtetërore, që është vendosur tanimë në Bashkimin Sovjetik.

Për sa u përket kritikave kundër «pluralizmit të ideologjive socialiste e të rendit socialist», janë vetë udhëheqësit sovjetikë ata që në teori e në praktikë kanë fshirë çdo dallim midis ideologjisë socialiste e asaj borgjeze, midis rendit socialist e atij kapitalist. Janë pikërisht revizionistët sovjetikë ata që kanë deklaruar e vazhdojnë të deklarojnë se shumë vende të porsaçliruara nga sundimi kolonial i imperializmit dhe ku sundojnë borgjezia e çifligarët dhe ideologjia e tyre reaksionare, janë futur në rrugën e socializmit, ose po ndërtojnë socializmin. A nuk tregon kjo se vetë udhëheqësit sovjetikë predikojnë se mund të kalohet në socializëm pa udhëheqjen e klasës punëtore, të partisë

së saj revolucionare e të ideologjisë së marksizëm-leninizmit, me fjalë të tjera, se mund të kalohet në socializëm nën udhëheqjen e klasave e të partive jo-proletare, se ka, pra, disa lloje socializmi e disa lloje ideologjish socialiste?

Ose të marrim rastin e Jugosllavisë. Duke «kritikuar» titistët jugosllavë, të cilët përkrahën klikën e Dubčekut dhe folën kundër agresionit sovjetik në Çekosllovakë, revizionistët sovjetikë u kujtuan të vënë në dukje se programi i LKJ është mishërimi i plotë i ideologjisë së revizionizmit. Por si përputhet kjo me deklaratat e tjera të udhëheqësve sovjetikë, të cilët, pasi u puthën e u përçafuan me klikën titiste, e shpallën dhe vazhdojnë, edhe sot e kësaj dite, ta quajnë Jugosllavinë një vend «socialist»? Ç'është ky socializëm që na u ndërtoka në Jugosllavi mbi bazën e ideologjisë revizioniste, e cila s'është gjë tjetër veçse një variant i ideologjisë borgjeze? A nuk pranon me këtë vetë udhëheqja sovjetike se socializmi gjoja u ndërtoka edhe mbi bazën e revizionizmit, domethënë të antimarksizmit, të ideologjisë borgjeze?

Duke shprehur pakënaqësinë për qëndrimin e klikës titiste ndaj ngjarjeve në Çekosllovakë, propaganda sovjetike i akuzon titistët si «frymëzues e përkrahës të kundërrevolucionarëve çekosllovakë». Po vetë udhëheqësit sovjetikë, të cilët, në mënyrë krejt arbitrare, e rehabilituan klikën titiste si një «viktimë të pafajshme», e futën në lëvizjen komuniste, e shpallën si «luftëtare për socializmin» dhe mbajnë me të lidhje të ngushta, a nuk janë vetë ata frymëzues e përkrahës të frymëzuesve e të përkrahësve të kundërrevolucionarë?

rëve, pra edhe vetë po aq kundërrevolucionarë sa edhe klika titiste? Edhe pas ngjarjeve në Hungari më 1956, klika hrushoviane e Bashkimit Sovjetik ndërmori një fushatë kritikash kundër revizionistëve jugosllavë, por vetëm sa për sy e faqe, sepse me ta ajo kishte bashkëpunuar në prapaskenë për të sjellë në fuqi kundërrevolucionarin Kadar dhe, me t'u ftohur ca gjakrat, filloi përsëri periudha e muajit të mjaltit. Me siguri kështu do të ndodhë edhe këtë radhë. Bile qysh tani toni i propagandës antijugosllave në Bashkimin Sovjetik ka rënë shumë. Klika e Brezhnev-Kosiginit nuk mund të mashtrjë njeri me pseudokritikat e saj kundër klikës titiste. Ato janë dy klika revizioniste që, me gjithë kontradiktat që kanë për çështjet e rrugëve të zhvillimit të revizionizmit dhe të marrëdhënieve midis vendeve e partive revizioniste, janë pjesëtare të një rryme të vetme kundërrevolucionare — të revizionizmit modern.

Revizionistët sovjetikë na paskan zbuluar në Çekosllovakia një formë «të re», «të panjohur» të kundërrevolucionit, kundërrevolucionin paqësor ose të qetë. E keqja e njerëzve që dënuan ndërhyrjen sovjetike në Çekosllovakia si agresion, thonë ata, na qenka «moskupertimi i thellë i thelbit të këtij fenomeni të ri historik», pasi njerëzit deri më sot qenkan mësuar «ta përfytyrojnë kundërrevolucionin vetëm në formën e tij të armatosur, me dhunë».

Duke përgjithësuar eksperiencën e tragjedisë revizioniste që ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste, ku në fuqi janë klikat revizioniste, marksistë-leninistët kanë nxjerrë prej kohësh konkluzionin se rreziku për fatet e socializmit nuk vjen

vetëm nga agresioni i jashtëm imperialist dhe as vetëm nga kundërrevolucioni i armatosur i klasave shfrytëzuese e i mbeturinave të tyre, por edhe nga degjenerimi paqësor borgjezo-revizionist, që është rezultat i ndikimit të ideologjisë borgjeze nga brenda dhe i presionit të imperializmit nga jashtë.

Shembullin e parë të kundërrevolucionit paqësor e dhanë titistët, pastaj këtë rrugë e ndoqi klika hrushoviane e Bashkimit Sovjetik e me radhë klikat e vendeve të tjera ish-socialiste të Evropës. Orvatja e revizionistëve sovjetikë për ta paraqitur kundërrevolucionin paqësor si një «fenomen të ri historik» që u vërtetua në ngjarjet e Çekosllovakisë, në të vërtetë është një orvatje, nga njëra anë, për të justifikuar agresionin e tyre kundër popullit çekoslovak dhe, nga ana tjetër, për të mbuluar kundërrevolucionin paqësor që ata vetë e kanë kryer në Bashkimin Sovjetik.

Megjithëse ideologët e revizionistëve sovjetikë flasin shumë për kundërrevolucionin paqësor, ata i vijnë vetëm rrotull këtij fenomeni, e paraqesin atë në mënyrë shumë të thjeshtë, si diçka të nxitur e të organizuar drejtpërdrejt nga mbeturinat e klasave shfrytëzuese dhe nga agjenturat e imperializmit. Në të vërtetë, kundërrevolucioni paqësor është një kundërrevolucion që bëhet nga lart, nga kuadrot e degjeneruar e të burokratizuar të vetë klasës e të partisë që është në fuqi. Dhe ky proces degjenerimi ka shkaqet e tij të thella socialekonomike të brendshme e të jashtme, ashtu siç ka edhe burimet e tij historike e ideologjike. Asnjë analizë të këtyre shkaqeve e burimeve nuk bëjnë revizionistët sovjetikë dhe as që mund ta bëjnë, sepse



kjo do të thoshte që ata t'i bënin autopsinë vetes së tyre. Autopsinë e lindjes së revizionizmit e kanë bërë dhe do ta bëjnë gjithnjë më të plotë vetëm marksistë-leninistët, revolucionarët bolshevikë, të cilët do ta flakin tej kërmën revizioniste dhe do të spastrojnë gjithë atmosferën nga era e saj e keqe.

Duke predikuar sa më sipër, revizionistët hrushovianë i nxjerrin sytë vetvetes, sepse në qoftë se pranohet rreziku i kundërrevolucionit paqësor edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, atëherë si mund të shpallet se «fitorja e socializmit është e plotë e përfundimtare», si mund të thuhet ajo që është thënë në programin e PK të BS të aprovuar në Kongresin e 22-të se «në vendet e demokracisë popullore janë zhdukur mundësitë shoqërore-ekonomike për restaurimin e kapitalizmit»? Një nga të dyja: ose teza e kundërrevolucionit paqësor është bluf, ose teza tjetër se është zhdukur çdo rrezik për fatet e socializmit është një mashtrim, një orvatje për të përligjur tradhtinë revizioniste, për të vënë në gjumë vigjilencën dhe veprimin revolucionar të komunistëve e të punonjësve.

Në kundërshtim me ato çka kanë predikuar më përpara se gjoja me zhdukjen e klasave shfrytëzuese merr fund edhe lufta e klasave dhe vendin e saj e zë uniteti politik e socialekonomik i shoqërisë, tani revizionistët sovjetikë nuk janë kundër të pranojnë luftën e klasave edhe pas zhdukjes së klasave shfrytëzuese si të tilla dhe të ngrihen edhe kundër «unitetit abstrakt kombëtar». Demagogjia s'ka fund. Ata flasin për luftë klase, por vetëm për vendet e tjera, kurse për luftën e klasave në Bashkimin Sovjetik asnjë gjysmë fjale,

sikur këtu të mbretëronin harmonia dhe paqja e amëshuar. Por lufta që ndërmorën vetë revizionistët hrushovianë në Bashkimin Sovjetik, pas vdekjes së J. V. Stalinit a nuk është një shprehje e hapët e luftës së armiqve të klasës të cilët i hapën rrugën rivendosjes së kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, shndërrimit të tij nga një shtet proletar socialist në një shtet të ri borgjez e imperialist? Këtë luftë klasash, por nga pozitë e borgjezisë së re e në interes të saj, udhëheqja revizioniste sovjetike vazhdon ta zhvillojë me egërsinë më të madhe kundër forcave të shëndosha revolucionare si brenda vendit ashtu dhe në arenën ndërkombëtare, duke përdorur të gjitha mjetet e diktaturës fashiste ushtarake.

Jeta, faktet, vetë eksperiencia e tradhtisë revizioniste tregojnë se lufta e klasave vazhdon jo vetëm pas zhdukjes së klasave shfrytëzuese si të tilla, jo vetëm pas fitores së socializmit, por bile, për një kohë, edhe pas fitores së komunizmit në shkallë ndërkombëtare, sa kohë do të vazhdojë të ekzistojnë ndikimet e ideologjisë borgjeze. Prandaj fitorja e plotë e socializmit dhe e komunizmit mund të arrihet dhe të jetë e garantuar vetëm atëherë kur, përveç të tjerave, të jetë siguruar fitorja e plotë e ideologjisë socialiste mbi ideologjinë borgjeze në çdo vend të veçantë e në shkallë botërore. Dhe përderisa vazhdon kjo luftë është e domosdoshme ekzistenca e diktaturës së proletariatit, si arma kryesore e luftës klasore të proletariatit për shtypjen e të gjithë armiqve të klasës dhe për ndërtimin e socializmit e të komunizmit.

Gjithë demagogjia e luftës gjoja kundër revizio-

nizmit dhe gjoja e kthimit në pozitë leniniste-staliniane i duhet udhëheqjes revizioniste sovjetike për të fshehur shndërrimin e saj të plotë në një klikë social-fashiste.

Por udhëheqësit sovjetikë, për vetë pozitën e tyre si klikë revizioniste, nuk mund të shkojnë shumë larg në të ashtuquajturën luftë kundër revizionizmit, sepse një gjë e tillë është mbarsur me pasoja tepër të rrezikshme, të papritura e të papëlqyera për ta. Prandaj ata, në të njëjtën kohë, vazhdojnë me tërbim luftën kundër marksizëm-leninizmit revolucionar dhe partive që i qëndrojnë besnike atij. Kjo tregon me qartësinë më të madhe falsitetin e zhurmës së saj demagogjike mbi «luftën kundër revizionizmit».

Pikërisht për ta fshehur blofin e saj udhëheqja sovjetike përpiqet të krijojë iluzionin se gjoja qëndron në pozitë leniniste të luftës në dy fronte, se gjoja lufton si kundër të djathtëve, revizionistëve, ashtu dhe kundër «majtistëve», «dogmatikëve», «aventurierëve» e të tjerëve. Kjo manovër e rrezikshme duhet demaskuar plotësisht dhe të zbulohet hapur fytyra e vërtetë socialfashiste e klikës udhëheqëse sovjetike.

## **Socialimperializmi nën maskën e internacionalizmit proletar**

Socialfashizmi në politikën e brendshme ka si vazhdim të drejtpërdrejtë në politikën e jashtme socialimperializmin; dhe, ndërsa fashizmin përpiqen ta maskojnë me frazeologji «socialiste», imperializmin e

tyre udhëheqësit sovjetikë përpiqen ta mbulojnë me parullat e «internacionalizmit proletar».

Dihet se tradhtinë e tyre revizionistët hrushovia-në e filluan me kapitullim e me lëshime para imperializmit dhe duke hequr dorë nga lufta kundër tij, kurse likuidimi i bazave të socializmit dhe restaurimi i kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, shndërrimi i tij nga një shtet socialist në një shtet kapitalist të fipit të ri krijoi premisat ekonomike, shoqërore e klasore për shndërrimin e tij në një fuqi të madhe imperialiste në arenën ndërkombëtare dhe për aleancën kundërrevolucionare me imperializmin amerikan. Bashkimi Sovjetik u bë një fuqi imperialiste që kërkon të ketë zonat e saj të influencës, që përpiqet të skllavërojë e të shfrytëzojë popujt e vendeve të tjera, që në aleancë me imperializmin amerikan lufton për vendosjen e sundimit botëror të dy fuqive të mëdha.

Por në qoftë se deri dje imperializmi sovjetik përpigëj të ruante e të shtrinte zonën e tij të influencës, t'u diktonte vullnetin e tij të tjerëve me anën e «mje-teve paqësore» — të depërtimit e të nënshtrimit ekonomik, të ndikimit e të presionit politik e ideologjik, të aleancave ushtarake e ekonomike etj., tani ai ka kaluar në metoda të hapëta fashiste, në përdorimin e dhunës së armatosur, në agresionin ushtarak të drejtpërdrejtë edhe kundër vetë aleatëve të tij. Pikërisht kjo është veçoria e re në evolucionin e imperializmit sovjetik. Shembulli më tipik në këtë drejtim është agresioni ushtarak fashist sovjetik në Çekosllovakia.

Me atë që bënë në Çekosllovakia, revizionistët sovjetikë vërtetuan fare lakuriq se tani për ta nuk ekzis-

tojnë as miqësi, aleanca e traktate, as liri e pavarësi dhe as sovranitet i popujve. I vetmi «parim» që ekziston për ta është e drejta e më të fortit për të bërë ligjin kudo, ndërsa gjithë parimet e tjera i shkelin, i marrin nëpër këmbë, i vënë nën çizme, me armë e me gjak.

Për të justifikuar këtë politikë cinike e fashiste revizionistët sovjetikë përpiqen t'u mbushin mendjen jo më të tjerëve, por edhe vetë alcatëve të tyre nga kampi revizionist, se pavarësia, vetëvendosja, sovraniteti i partive dhe i popujve të vendeve të ndryshme nuk kanë asnjë vlerë, ata duhet t'u nënshtrohen interesave të së ashtuquajturës bashkësi socialiste, me fjalë të tjera, interesave të fuqisë së madhe shoviniste të Bashkimit Sovjetik, se për hir të këtyre interesave kjo fuqi mund t'i shkelmojë këto parime kur, ku dhe si të dojë.

Demagogjia e agresorëve sovjetikë se duke sulmuar e duke pushtuar me armë Çekosllovakinë kryen detyrën e tyre internacionaliste ndaj popullit çekosllovak dhe ndaj çështjes së socializmit e të lëvizjes revolucionare botërore, pasi gjoja shpëtuan fitoret e socializmit në Çekosllovakë nga rreziku i kundërrevolucionit, nuk mund të mashtrojë njeri. Si mund të mbrojnë fitoret e socializmit në një vend tjetër ata që i kanë vënë këmbën socializmit në vendin e tyre, si mund të shmangin rrezikun e kundërrevolucionit ata që vetë janë koka e kundërrevolucionit?! Të gjitha ato, për të cilat revizionistët sovjetikë akuzuan ata çekosllovakë për të justifikuar agresionin, i kanë bërë e i bëjnë vetë. Prandaj të gjitha «argumentet» e udhëheqjes revizioniste sovje-

tike janë boshe e false. Veprimi i tyre nuk ka asnjë bazë politike, ideologjike, morale e ligjore.

U rrëzua plotësisht edhe argumenti «ligjor» i revizionistëve sovjetikë për të justifikuar agresionin e tyre në Çekosllovaki. Letra «e famshme» e disa personaliteve çekosllovake, që gjoja u kishin drejtuar sovjetikëve dhe disa vendeve të tjera të Traktatit të Varshavës «për të kërkuar ndihmën e tyre për shtypjen e kundër-revolucionit në Çekosllovaki», doli sheshit se ishte një bluf. Asnjëri nuk i doli për zot kësaj letre. Trupat sovjetike nuk i ftoi as qeveria çekosllovake, as presidenti i republikës, as parlamenti, as Komiteti Qendror i Partisë. Bile edhe Hitleri në kohën e vet veproi më me takt: të paktën ai i mori me forcë firmën presidentit të atëhershëm Hasha kur pushtoi Çekosllovakinë.

Për sa u përket popullit çekoslllovak dhe forcave të shëndosha socialiste në Çekosllovaki, ato nuk kishin përse t'u drejtoheshin për ndihmë renegatëve revizionistë sovjetikë e aleatëve të tyre për mbrojtjen e fitoreve të socializmit nga renegatët revizionistë çekoslllovakë, sepse si klika revizioniste sovjetike ashtu dhe klikat revizioniste të Novotnit apo Dubçekut ecin në të njëjtën rrugë antimarksiste e antisocialiste. Dhe jeta tregoi e po vërteton me fakte të shumta çdo ditë se me gjithë kapitullimin e klikës së Dubçekut, populli çekoslllovak i priti ushtritë e revizionistëve sovjetikë si pushtuese dhe, në forma të ndryshme, i rezistoi e po i reziston pushtimit. Për të po bëhet gjithnjë e më e qartë se veprimet e klikës së Dubçekut, që përmbysi atë të Novotnit, ishin një kundër-revolucion brenda në kundër-revolucion, ashtu si ndërhyrja ushtarake sovje-

tike ishte shtypja me forcën e armëve e këtij kundër-revolucioni të brendshëm çekoslovak nga kundër-revolucioni i jashtëm sovjetik.

Si një instrument të rëndësishëm për zbatimin e politikës së saj imperialiste, klika udhëheqëse sovjetike po përdor aleancën ushtarake të Traktatit të Varshavës. Ky Traktat, i cili ka ndryshuar fund e krye natyrën e tij nga një traktat paqeje në një mjet lufte, nga një traktat mbrojtës në një armë agresioni, po përdoret nga klika udhëheqëse sovjetike edhe kundër vetë pjesëmarrësve të këtij Traktati. Në të vërtetë, me përjash-tim të Rumanisë, të gjitha vendet e tjera, anëtare të këtij Traktati famëkeq, ndodhen nën kontrollin e forcave të armatosura të revizionizmit sovjetik. E ashtu-quajtura «familje» apo «bashkësi socialiste» përngjet me një kamp përqendrimi, me një burg popujsh, kudo janë të vendosur trupat sovjetike dhe ato bëjnë ligjin në këto vende. Në këto kushte liria, pavarësia, barazia e sovraniteti i popujve janë kthyer në parulla boshe, që përdoren për të mashtruar e për të vënë në gjumë popujt.

Por oreksi i imperializmit sovjetik i kalon kufijtë e zonës që ndodhet drejtpërdrejt nën influencën e tij. Ai po kërcënon hapur vendet e tjera të Ballkanit, sidomos Republikën Popullore të Shqipërisë. Sundimtarët revizionistë sovjetikë, në aleancë e në garë me imperialistët amerikanë, po zgjerojnë zonën e veprimit të flotës së tyre ushtarake, kanë futur anijet e fyre të luftës në Mesdhe si për të kërcënuar RP të Shqipërisë, ashtu edhe për shtrirjen e ekspansionit të tyre imperialist në kurriz të popujve arabë e të vendeve të tjera.

Kjo politikë tipike imperialiste e revizionistëve sovjetikë nuk mund të mbulohet me asgjë. Ajo nuk mund të mos hasë kundërshtimin dhe rezistencën e vendosur të të gjithë popujve, për të cilët janë të shenjta idealet e lirisë, të pavarësisë, të sovranitetit, të revolucionit e të socializmit. Kjo politikë po e demaskon dhe po e izolon gjithnjë e më shumë klikën udhëheqëse sovjetike para popujve të të gjithë botës.

Dhe jo vetëm kaq. Në zbatimin e kursit agresiv imperialist ajo ka hasur vështirësi të mëdha edhe me vetë aleatët e saj. Udhëheqja sovjetike, për të mbajtur nën fre klikat e tjera revizioniste, po kalon hapur në përdorimin e forcës, siç treguan ngjarjet në Çekosllovakia, të cilat janë një paralajmërim shumë serioz se ç'i pret ato në rast se do të ecin në rrugën e «policentrizmit», autonomisë etj. Por kjo në vend që të forcojë pozitën sunduese të klikës udhëheqëse revizioniste sovjetike, do të çojë në përçarjen e mëtejshme të frontit revizionist dhe do t'i minojë më tej pozitën e revizionizmit sovjetik. Kjo u duk fare qartë në reagimin e klikave revizioniste të vendeve të tjera, që në kor të përbashkët u ngritën kundër ndërhyrjes sovjetike në Çekosllovakia dhe e dënuan atë si agresion, duke marrë nën mbrojtje klikën e Dubçekut. Për këtë flasin edhe vështirësitë suplementare që iu krijuan udhëheqjes sovjetike për thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare të partive revizioniste, e cila përsëri u shty.

Ngjarjet e kohëve të fundit, veçanërisht ato në Çekosllovakia, janë një disfatë katastrofike për gjithë revizionizmin modern, që tregon me qartësinë më të madhe për degjenerimin e tij të plotë, sidomos të kokës



së revizionizmit modern, klikës hrushoviane të Bashkimit Sovjetik, në një klikë socialfashiste e socialimperialiste. Askush nuk duhet të mashtrohet nga manovrat për ta mbuluar këtë degjenerim me demagogji, me parullat e «internacionalizmit». Detyra e gjithë marksistë-leninistëve dhe e revolucionarëve të vërtetë është të demaskojnë e të shpartallojnë këtë manovër të rrezikshme. Në radhë të parë, vetë populli sovjetik duhet të ngrihet me vendosmëri kundër këtij kursi agresiv imperialist dhe të mos lejojë që klika renegate hrushoviane në fuqi t'i përdorë njerëzit sovjetikë, forcat e armatosura sovjetike për realizimin e synimeve të saj imperialiste e shtypëse. Nuk duhet harruar për asnjë çast mësimi i madh i Marksit se nuk është e nuk mund të jetë i lirë populli i atij vendi që shtyp popujt e tjerë.

### **Stalini u përket marksistë-leninistëve, i përket revolucionit proletar**

Analiza e fakteve tregon se për kurrfarë rishikimi të pozitave revizioniste të udhëheqjes renegate sovjetike nuk mund të bëhet fjalë. Të gjitha përpjekjet e saj për të krijuar përshtypjen se gjoja po rikthehet në pozitë e vjetra staliniane janë një blufë e madhe. Asnjë iluzion nuk duhet të ketë se ngjarjet në Çekosllovakë, në Poloni, dhe aktivizimi i ekstremistëve liberalë brenda në Bashkimin Sovjetik i hapën sytë dhe e kanë sjellë në vete klikën kundërrevolucionare sovjetike. Të gjitha këto vetëm e kanë detyruar atë të ndryshojë

taktikën e saj, të adoptojë një taktikë akoma më demagogjike për të vendosur e për të konsoliduar plotësisht diktaturën ushtarake fashiste të kapitalit revizionist dhe për ta maskuar atë.

Klika e Brezhnev-Kosiginit shpreson shumë t'ia arrijë këtij sukcesi brenda në Bashkimin Sovjetik, ku ka shtypje të madhe e censurë të tmerrshme, ku komunistët dhe njerëzit janë edukuar të përsëritin e jo të thellohen në përmbajtjen e formulave e të sloganeve dhe ku, më në fund, vazhdon të zhvillohet me të madhe kulti i megalomanisë i «shtetit të madh e të fuqishëm socialist». Ajo shpreson t'ia arrijë kësaj edhe duke folur me gjuhë të vogël për një «kthim te koha e Stalinit», për të kënaqur e për të gënjyer kështu naivët apolitikë e sentimentalë.

Është detyrë e gjithë marksistë-leninistëve, në radhë të parë e vetë revolucionarëve bolshevikë sovjetikë, të demaskojnë deri në fund këtë manovër djallëzore të klikës sunduese hrushoviane, të hedhin poshtë çdo iluzion për këtë klikë, të forcojnë luftën kundër saj, të zbulojnë lakuriq fytyrën e saj të vërtetë socialfashiste e socialimperialiste. Përballë faktit të shndërrimit të shtetit sovjetik në një diktaturë ushtarake të tipit fashist, revolucionarët sovjetikë duhet të ngrihen në këmbë, të organizohen dhe të hidhen në luftë e në revolucion. Përgjegjësia e tyre historike është sot më e madhe se kurrë. Nuk ka dyshim se kjo do të jetë një luftë e vështirë, që do të kërkojë vetëmohim e sakrifica të rënda. Por bolshevikëve leninistë-stalinianë kurrë nuk u janë dridhur zemra dhe dora. Ne shprehim bindjen e thellë se një ditë ata do ta

kryejnë me nder detyrën e tyre të madhe para popullit të vet dhe komunizmit ndërkombëtar. Dhe sa më parë ta bëjnë këtë, aq më mirë do të jetë.

Demagogjia e klikës udhëheqëse sovjetike për gjoja një rikthim në pozitë revolucionare të kohës së Stalinit duhet demaskuar edhe jashtë Bashkimit Sovjetik, ku, gjithashtu, mund të zërë vend e të përdoret nga klikat e tjera revizioniste. Por, nga ana tjetër, është e qartë se kjo taktikë do t'i acarojë kontradiktat në gjirin e revizionistëve, do të çojë në përçarjen e partive revizioniste në grupe prosovjetike e antisovjetike. Bile qysh tani në Çekosllovakia novotnistët, në Francë Vermeshin e torezistët kanë filluar t'i quajnë «të fortë», «stalinistë», sepse janë përkrahës të revizionistëve sovjetikë, agjentë të tyre. Këtyre elementëve klika udhëheqëse sovjetike u jep e do t'u japë gjithë përkrahjen, me qëllim që, nëpërmjet tyre, të vendosë kontrollin dhe sundimin e saj të lëkundur në partitë e tjera revizioniste. Kjo nuk mund të mos ndeshë në rezistencën e elementëve të tjerë revizionistë, gjë që do ta thellojë më tej përçarjen në kampin revizionist.

Detyra e marksistë-leninistëve në këto vende është të demaskojnë pa mëshirë frazeologjinë pseudorevolucionare të agjunkturës prosovjetike, të mos lejojnë krijimin e kurrfarë iluzioneve në këtë drejtim, të shfrytëzojnë thellimin e kontradiktave në gjirin e revizionistëve dhe të forcojnë luftën kundër gjithë renegatëve revizionistë për shpartallimin e tyre të plotë.

Për sa u përket vendeve të tjera që sundohen nga revizionistët sovjetikë dhe ku ata bëjnë ligjin me anën e forcave ushtarake që kanë vendosur atje, këtu kjo

manovër vështirë se mund të zërë vend, sepse forcimi i karakterit agresiv imperialisto-fashist të politikës që ndjek klika udhëheqëse sovjetike nuk mund të mos ngjallë zemërimin e protestën gjithnjë më të vendosur të popujve të këtyre vendeve. Bile edhe kuislingëve revizionistë, të cilët i binden klikës sovjetike nga halli, pasi pozitat e tyre sunduese janë ngritur mbi rërë, nuk u pëlqen të ndërmerret manovra gjoja e kthimit në kohën e Stalinit, qoftë edhe si bluf, sepse, nga njëra anë, kjo do t'i lidhte ata akoma më ngushtë pas qerres së sovjetikëve, nga të cilët ata duan të jenë sa më të pavarur, dhe, nga ana tjetër, kjo manovër do të minonte bazat e tyre, duke qenë se ata erdhën në fuqi pikërisht nën flamurin e luftës kundër stalinizmit. Prandaj edhe këtu do të acarohet e do të thellohet më tej përçarja, si brenda partive revizioniste, ashtu edhe midis klikave revizioniste sunduese e udhëheqjes sovjetike. Nënshtrimi i kuislingëve revizionistë ndaj diktaturës ushtarake fashiste sovjetike është i përkohshëm, midis tyre do të ketë grindje e goditje të ashpra, deri në përleshje me armë.

Të gjitha këto krijojnë kushte të favorshme për luftën revolucionare të popujve e të komunistëve të këtyre vendeve, për të demaskuar si kuislingët revizionistë vendës, ashtu edhe pushtuesit sovjetikë, për t'i shporrur jashtë vendit ushtritë pushtuese dhe për të përmbysur klikat renegate revizioniste në fuqi. Rruga e vetme e drejtë për arritjen e këtyre qëllimeve është krijimi kudo i partive marksiste-leniniste dhe organizimi i luftës revolucionare të armatosur.

Partia e Punës e Shqipërisë, e cila kurdoherë u

është përmbajtur me konsekuencë vijës e parimeve marksiste-leniniste dhe ka bërë e bën një luftë të vendosur kundër revizionizmit modern me udhëheqjen renegate sovjetike në krye, do të demaskojë pa mëshirë edhe taktikën e tanishme të rrezikshme pragmatiste të klikës së Brezhnjev-Kosiginit për gjoja një rikthim në pozitat revolucionare të Stalinit. Ajo nuk ka lejuar dhe nuk do të lejojë kurrë që emri dhe vepra e madhe revolucionare marksiste-leniniste e J. V. Stalinit të njollosen nga revizionistët hrushovianë dhe as të përdoren prej tyre si maskë për të mbuluar tradhtinë revizioniste. Stalini u përket marksistë-leninistëve, i përket revolucionit proletar.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 7 (6359), 9 janar 1969*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 285*

## **TË MENDOHET MIRË PËR ZGJEDHJEN DHE PËR KOORDINIMIN E PROBLEMEVE QË SHQYRTOHEN**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**13 janar 1969**

Në materialin e paraqitur konstatoj se ka më shumë probleme me karakter ekonomik, megjithatë është me interes të dimë formën dhe metodën e përgatitjes së planit të punës. Orientimi i dhënë është i drejtë; problemet që mendojmë të shqyrtojmë në udhëheqje gjatë vitit duhet të nxirren në bazë të vendimeve të Kongresit të Partisë dhe të plenumeve të Komitetit Qendror. Por dua të di për përgatitjen e projektit që na është paraqitur në këtë mbledhje, në u bë ndonjë analizë se si është realizuar plani i vitit 1968 jo vetëm sa çështje kemi marrë në shqyrtim, por çfarë konstatuam gjatë shqyrtimit të tyre, kurdoherë kjo në lidhje me nxjerrjen e konkluzioneve për planet e ardhshme.

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje, që u bë posaçërisht me kërkesën e shokut Enver Hoxha, u diskutua për përgatitjen e planit të çështjeve që do të shqyrtoheshin gjatë vitit 1969 në Sekretariatit e KQ të PPSH.

Është mirë të dimë, në radhë të parë, problemet e parashtruara në planin e vitit 1968, i morëm të gjitha në shqyrtim apo jo? Në qoftë se jo të gjitha, atëherë çfarë na mbeti pa shqyrtuar? Sigurisht kjo është gjëja më e lehtë që mund të bëjmë, por më me rëndësi është të dimë si u trajtuan problemet e shqyrtuara, paraqitja dhe shqyrtimi i tyre u bë mirë, apo çalonte dhe ku e pse çalonte, pastaj cilat nga problemet e planit ishin të panevojshme dhe u lanë.

Analiza do të na ndihmojë, gjithashtu, të dimë çfarë efekti kanë bërë në bazë çështjet që pamë të nevojshme dhe i shqyrtuam në udhëheqje, si i ka pritur dhe si i ka trajtuar ato baza dhe ç'rezultate janë arritur gjer tani. Nga analiza mund të mësojmë që disa nga problemet e shqyrtuara mbase janë marrë shumë herë në shqyrtim pa qenë nevoja, prandaj gjatë vitit 1969 nuk duhet t'i shqyrtojmë përsëri, por t'u rekomandojmë organizatave të Partisë të thellohen më tej në to. Kështu, çështjet e vogla dhe të përsëritura t'i heqim nga plani, aty të mbeten qoftë edhe pak probleme, por nga ato më të rëndësishmet. Boshllëku që do të krijohet, të plotësohet me informacione të shkurtra dhe të plota, me shkrim ose me gojë. Pastaj, në qoftë se do të kemi mundësi të njihemi edhe me projektplanet e komiteteve të Partisë të rretheve, ta plotësojmë projektin tonë edhe me disa çështje të tilla.

Me një fjalë, nga një analizë e tillë duhet të dalim me disa konkluzione konkrete, me qëllim që ta përmirësojmë më tej punën.

Ka mundësi që nga analiza të zbulojmë se mund të ketë vërejtje edhe për problemet që janë shqyrtuar,

pse mund të konstatojmë që kjo ose ajo anë e problemit nuk është parë, kurse del nevoja të trajtohet. Diskush, për shembull, mund të rekomandojë se është nevoja të marrim në shqyrtim probleme për rininë. Po në ç'aspekt? Kjo, sigurisht, nuk është një punë aq e lehtë, se po ta shqyrtojmë çështjen në përgjithësi, një punë e tillë do të jetë e kotë. Nga analiza duhet të nxjerrim, pra, cilat probleme kanë qenë të nevojshme për t'u shqyrtuar dhe na kanë dhënë rezultate, për të tjerat, që nuk na kanë dhënë rezultate, kuptohet se nuk kanë qenë të studiuara mirë apo kanë qenë të panevojshme.

Por do të ketë edhe probleme që duhet t'i vëmë në plan me qëllim informacioni.

Çështja tjetër lidhur me këtë problem ka të bëjë me metodën e punës të shokëve të aparatit të Komitetit Qendror.

Le të marrim sektorin e agjitacionit dhe të propagandës. Shokët e këtij sektori më duket se nuk e kanë aq lehtë të vendosin çfarë problemesh duhen propozuar për t'u vënë në planin e udhëheqjes. Këto çështje nuk mund të propozohen duke menduar nga tavolina. Në qoftë se veprohet kështu, nuk mund të themi se kanë bërë një punë të mirë. Por në qoftë se ata kanë bashkëpunuar ngushtë me punonjësit e sektorëve të shtypit, të propagandës dhe me udhëheqjet e tyre dhe në debate me ta për kërkesat e parashtruara është arritur në konkluzionin që në Byronë Politike ose në Sekretariatit e Komitetit Qendror duhet të merret në shqyrtim ky ose ai problem. atëherë mund të thuhet se kanë bërë me të vërtetë një punë të mirë.



Ose të marrim problemin e edukimit të Partisë, problem ky me rëndësi të madhe. Byroja Politike dhe Sekretariati i Komitetit Qendror këtë vit duhet të vihen në dijeni për këtë problem, shqyrtimi i të cilit do të na japë plotësisht situatën, pra edhe mundësinë që të ndihmojmë në këtë drejtim. Për këtë qëllim, duke filluar nga Shkolla e Partisë dhe gjer në bazë, duhet të dimë çka po bëhet për edukimin marksist-leninist të komunistëve. Ne si Sekretariat nuk dimë sa duhet çfarë bëhet, ta zëmë, në Shkollën e Partisë. Nuk e kam fjalën që të na thuhet vetëm që atje këtë vit shkollor ndoqën mësimet kaq komunistë dhe të gjithë kaluan. Puna është si kaluan, si janë trajtuar problemet gjatë kursit, ku ishin vështirësitë dhe përse kanë rrjedhur ato, për faj të teksteve, për dobësi të pedagogëve, apo për arsye të tjera. Pastaj të jepen mendime që, për t'i trajtuar mirë këto çështje ç'masa duhen marrë.

S'ka dyshim që çështja e shkollës është më e koncentruar, po ka probleme të tjera që janë shumë më të përhapura. Për shembull, ne nuk jemi si duhet në korent se si organizohet zbatimi dhe përhapja e iniciativave të shumta që merren nga masat. Pra, herë pas here duhet të informohemi dhe të na jepen në Sekretariat disa konkluzione për problemet kyç që kanë të bëjnë me këto iniciativa, janë këto të përshtatshme apo jo etj. Çështje të kësaj natyre shohim të trajtohen edhe në shtypin e përditshëm, po shkel e shko, bëhet shumë «propagandë», nuk jepet pra pasqyra e plotë e gjendjes, pse, po t'u futesh brenda këtyre shkrimeve, sheh se në to ka shumë kashtë. Synimi ynë duhet të jetë që t'u qëndrojmë në krye këtyre

punëve, të jemi të informuar mirë dhe të nxjerrim konkluzione.

Të shohim edhe një çështje tjetër. Në teatrot tona jepen shfaqje të ndryshme. Të gjithë ata që i ndjekin japin mendime për çdo pjesë, thuhet «Kjo ve-për është realizuar mirë, kjo tjetra nuk është e mirë», «ky artist luan bukur, tjetri jo» etj. Por, bashkë me këto mendime, duhet organizuar puna që të dalë përse kjo pjesë është e mirë dhe tjetra nuk është e mirë etj.

Estrada shfaq gjithashtu gjithfarë pjesësh, por duhet parë si janë trajtuar problemet në to. Po kështu edhe çështjet e muzikës, të arteve, të shkencave etj. janë me rëndësi të madhe për edukimin ideopolitik të punonjësve tanë.

Në Byronë Politike ose në Sekretariatit e Komitetit Qendror, kur i kemi shqyrtuar këto probleme, kemi dhënë orientime për të gjithë këta sektorë, por çfarë është bërë më vonë dhe ç'po bëhet tani, si po trajtohen problemet e artit, të kulturës, të letërsisë, çfarë vështirësish gjejnë punonjësit e këtyre sektorëve, ç'kërkesa kanë sot masat ndaj tyre etj., nuk jemi të informuar mirë si udhëheqje, pra, për rrjedhim, s'kemi as mundësi si të ndihmojmë. Rëndësi ka çështja që shokët të cilët punojnë në këta sektorë të marrin nga udhëheqja ndihmën për të cilën kanë nevojë.

Ka, pra, një sërë problemesh të rëndësishme, për të cilat ne duhet të jemi në dijeni, në mënyrë që t'u japim ndihmë të vazhdueshme sektorëve përkatës, ndryshe nuk e kemi kryer mirë detyrën tonë.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për problemet ekonomike. të bujqësisë, të industrisë etj., për të cilat,

gjithashtu, duhet të jemi të informuar, të dimë si na shkojnë punët në këta sektorë, që të mund të marrim masat përkatëse e të ndihmojmë kështu për të kapërcyer pengesat e vështirësitë që dalin përpara. Në të gjithë këta sektorë dalin vazhdimisht probleme që kërkojnë zgjidhje të drejtë dhe efektive nga ana e udhëheqjes së Partisë. Sigurisht, problemet ekonomike, që i paraqiten për shqyrtim udhëheqjes së Partisë, nuk do t'i marrim në shqyrtim në rrugë thjesht shtetërore, megjithëse kemi parasysh që edhe këtu duhet të ndihmojmë, se shokët e Qeverisë kanë nevojë për ndihmën tonë, ashtu siç kemi nevojë edhe ne për ndihmën e tyre.

Fjala është që për përgatitjen e planit të çështjeve që do të trajtojmë në udhëheqje, shokët tanë të aparatit të Komitetit Qendror të njihen më parë me planet dhe me problemet që preokupojnë komitetet e Partisë, institucionet e ndryshme dhe bazën. Prandaj është mirë që t'i dimë qysh më parë problemet që do të shtrojnë në këta gjatë vitit. Pa përjashtuar ndonjë sugjerim që mund të bëjmë, ne nuk duhet të ndërhyjmë në planet e tyre, por nga shikimi i këtyre planeve informohemi për çështjet që i preokupojnë. Komitetet e Partisë, sigurisht, planet i përgatitin në bazë të situatave konkrete. Është tjetër çështje nëse i përgatitin mirë ose me të meta këto plane, veç problemet që vënë në plan, në përgjithësi, pasqyrojnë dhe duhet të pasqyrojnë nevojat e bazës. Mirëpo, gjersa janë probleme që preokupojnë Partinë, çështjet që shtrojnë ata duhet të preokupojnë edhe udhëheqjen në qendër. Prandaj, kur shohim se të njëjtin problem e kanë vënë 3-4 ose më

shumë komitete partie, atëherë edhe në planin tonë duhet ta vëmë një problem të tillë, bile nga pikëpamja e kohës, po të jetë e mundur, t'i shqyrtojmë ca më përpara nga komitetet e Partisë, që, me punën tonë, të mund t'i ndihmojmë ata. Edhe në qoftë se nuk arrijmë t'i shqyrtojmë dot më përpara, nuk është keq t'i vëmë në plan që t'i shqyrtojmë edhe më pas, vetëm se objekti i problemit, që do të marrim në shqyrtim në këtë rast, duhet të jetë mënyra se si ta zbatojë baza çështjen që ka trajtuar. Kështu, duke pasur parasysh eksperiencën e bazës, kemi mundësi t'i shtojmë edhe disa pluse çështjes dhe të ndihmojmë më mirë në zgjidhjen e problemit të rëndësishëm që e ka preokupuar Partinë.

Gjatë studimit të planeve të komiteteve të Partisë të rretheve mund të konstatojmë se ato nuk po marrin në shqyrtim disa probleme kyç që shqyrtojmë ne në udhëheqje. Duke gjykuar se ato duhen ndjekur, ua rekomandojmë këto dhe në këtë mënyrë përsëri i ndihmojmë, u hapim perspektivën se cilat çështje duhet të shqyrtojnë e të ndjekin, dhe pas cilave probleme duhet të kapen më shumë.

Pra, me një punë të tillë përgatitore të bërë me kujdes, duke u konsultuar me shokët e sektorëve kryesorë, do të na dalin për të shqyrtuar jo një e dy, por edhe 10-15 probleme për çdo sektor. Bashkëpunëtorët tanë të aparatit, pra, pasi t'i kenë bërë këto çështje objekt të një diskutimi të veçantë me sektorët përkatës dhe pasi t'i kenë vënë në dijeni e të kenë marrë mendimin e sekretarëve të Komitetit Qendror për problemet që është me të vërtetë e domosdoshme të shqyrtohen në udhëheqje, na dalin me propozimin se cilat

prej tyre duhet të përfshihen në plan. Nëse një problem ose një tjetër do të vihet në plan, këtë s'mund ta vendosë *a priori* vetëm njëri, pa marrë mendimin e shokëve të aparatit, të sektorëve përkatës shtetërorë, apo të organizatave shoqërore, se mund të ketë edhe kundërshtime nga ana e tyre. Kur ka kundërshtime, duhen thirrur drejtuesit e organeve përkatëse, të dëgjohen fjalët e mendimet e tyre dhe pastaj të vendoset. Pra, duke qenë në dijeni të çështjeve, kur gjykohet se udhëheqja ka edhe shumë probleme të tjera që do të shqyrtojë, ndonjë çështje bisedohet e qartësohet pa qenë nevoja t'i paraqitet Sekretariatit si problem. Duke vepruar në këtë mënyrë për hartimin e planit, ky nuk bëhet *ex cathedra*, por është fryt i një punc kolektive.

Kursimi i kohës, për të cilin kemi folur shpeshherë, ka rëndësi shumë të madhe, prandaj të mendojmë mirë për zgjedhjen dhe për koordinimin e problemeve. Plani i çështjeve që do të shqyrtojmë është një plan orientues për gjithë vitin, është plani ynë kolegjal i punës. Por, natyrisht, këtu nuk mund të përcaktojmë planin individual të punës së përditshme për gjithsecilin nga ne. Ne sekretarët e Komitetit Qendror duhet të mendojmë dhe të diskutojmë edhe për këtë problem. Që ta bëjmë mirë këtë punë, duke harxhuar sa më pak kohë, mendoj se është nevoja të kemi kontakte më të shpeshta substanciale e jo për gjëra të vogla me njëri-tjetrin dhe me shokët e tjerë.

Më ndodh të thërres e të takohem nganjëherë me sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve, por kam vënë re se çështjet që më kanë shtruar ata në këto takime kanë qenë për gjëra të vogla. Ata vetë nuk

vijnë në takim. Nuk është çështja që t'i thërres unë, se këtë edhe e kam bërë, çështja është që, kur kanë probleme, ata duhet të vijnë vetë të m'i shtrojnë ato dhe të diskutojmë. Por edhe kur i thërres ose i takoj dhe i pyes si paraqitet gjendja në rrethin e tyre, çdo gjë ma raportojnë mirë, më tregojnë më shumë realizimet ekonomike dhe më pak problemet me rëndësi ideologjike, politike, organizative dhe sociale të Partisë.

Këtë shokët nuk e bëjnë jo se nuk janë në gjendje, por për arsye se për çështjet që kërkoj, u duhet të bëjnë një koncentrim të madh, duke menduar se për të më shtruar këtë ose atë problem, do t'u duhet të përgatiten shumë.

Unë mendoj ta ndryshojmë këtë situatë. Ne si sekretarë të Komitetit Qendror duhet të mendojmë sidomos për çështjet kryesore, për të tjerat, më me hollësi, mund të informohet e t'i ndjekë secili sipas sektorit që mbulon. Në qoftë se shkojmë me pikëpamjen që çështjet e parashikuara në plan do të na i përgatitin shokët me të cilët kemi të bëjmë dhe ne vetëm të mjaftohemi me shqyrtimin e tyre në mbledhje, nuk e kemi bërë si duhet detyrën.

Shokët përgjegjës të komiteteve të Partisë të rretheve, të cilët vijnë herë pas here në udhëheqje si të ftuar, kur shqyrtojmë probleme të ndryshme, ose që thirren në aparat, duhet të marrin dijeni me kohë edhe për planet tona të punës, sepse, duke u njohur me problemet që preokupojnë Komitetin Qendror, do të orientohen në punën e tyre. Në rast se parashikojmë, për shembull, të shqyrtojmë në Sekretariat një problem të caktuar, për të cilin mendojmë të vijnë në mbledhje

shokë të ftuar nga komitetet e Partisë të rretheve të Beratit, të Krujës dhe të Korçës, nuk do të thotë që sekretarët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Librazhdit ta flenë mendjen pse shohin që në planin tonë nuk parashikohet që të vijnë në raport për atë problem. Përkundrazi, edhe ata duhet të mendojnë, pasi nesër njëri nga sekretarët e Komitetit Qendror mund dhe duhet t'i thërresë për t'i pyetur ç'mendojnë dhe si po punojnë në rrethin e tyre po për këtë problem. Ndërsa, kështu si po veprohet, kur thirret ndonjë sekretar rrethi për një çështje të planifikuar, por që rrethi në fjalë nuk është parashikuar të raportojë, ai vjen fare i papërgatitur dhe nuk ndien asnjë përgjegjësi. Ne nuk do t'i kërkojmë atij diçka të jashtëzakonshme, po pikërisht për një çështje që është bërë ose do të bëhet objekt diskutimi në udhëheqje, prandaj kjo çështje duhet të preokupojë çdo organizatë partie rrethi.

Pra, çdo komitet partie, gjersa e di që kjo çështje figuron në planin e Komitetit Qendror, duhet të preokupohet me kohë, për ta ndjekur dhe për ta zgjidhur drejt problemin edhe në rrethin e vet, pavarësisht se nuk është parashikuar të raportojë. Kështu, po të njoftohet një nga sekretarët të vijë në mbledhje për këtë çështje ai të mos presë çfarë do t'i thotë ndonjëri nga ne, po si njeri me eksperiencë që është, të na e paraqesë gjendjen, të na japë eksperiencën, pse, në qoftë se nuk na jep gjë, edhe ne nuk kemi ç't'i japim.

Ne kemi shtruar vazhdimisht probleme të shumta, por duhet të shohim akoma ca më mirë si është organizuar, nga ana e shokëve të rretheve dhe të bazës, zgjidhja e problemeve të tjera që përfshihen në planet

tona vjetore. Kur vjen, për shembull, në aparatën e Komitetit Qendror sekretari i parë i komitetit të Partisë të një rrethi, ai duhet të jetë i përgatitur për të folur. Mund t'i themi atij që më parë përse do të vijë, por mund edhe të mos i themi fare. Në qoftë se ai një herë, dy herë, përgjigjet se nuk di ç'të thotë për atë problem që është thirrur, atëherë kemi të drejtë të nxjerrim konkluzionin se ai nuk është në rregull, nuk është në korent të situatës. Ai nuk duhet të përgatitet për një problem vetëm kur i kërkohet nga Sekretariati, por të jetë kurdoherë i përgatitur për të gjitha problemet. Kur ne i kërkojmë informata për një problem, sekretari i komitetit të Partisë duhet të na raportojë me hollësi, të na e bëjë të qartë gjendjen, që të mund të japim kështu ndihmën e duhur. Ne duhet t'i stërvitim shokët e rretheve në këtë drejtim.

Veç kësaj, duhen edukuar njerëzit, që, kur raportojnë për një problem, të flasin edhe për brendinë e metodën e punës që kanë ndjekur dhe të mos na mbushin me përqindje dhe me fjalë të panevojshme. Kur i pyesim shokët «Pse u realizua kjo detyrë?», ata përgjigjen menjëherë se «Mobilizimi ka qenë i mirë». Kur u thua «Po pse ka qenë i mirë ky mobilizim?», të thonë se «Është punuar mirë politikisht». Por ne duam të dimë si është bërë dhe si është organizuar puna politike edukative për arritjen e këtyre rezultateve. Këto na interesojnë shumë të na i thonë, që të nxjerrim eksperiencë, sepse që masat janë të mobilizuara për realizimin e detyrave, këtë e dimë mirë, po nga kjo nuk nxjerrim asnjë eksperiencë.

Sikur të thërresim, për shembull, ndonjë nga se-



kretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve të Jugut dhe t'i pyesim a janë interesuar apo jo për kontingjentin e dytë të bagëtive që do të dërgohen prej rretheve të tyre në zonat malore, jam i bindur se ata s'do të na japin përgjigje të plotë. Mirëpo që të kryhet me sukses ky aksion i madh politik, në radhë të parë, kërkon një përgatitje të mirë politike. Për këtë duhet punuar me njerëzit, sepse kjo është një çështje me rëndësi të madhe, është një punë jo fort e lehtë për t'u realizuar, prandaj sekretarëve të rretheve t'u kërkohet ç'kanë menduar të bëjnë për këtë problem dhe si duhet organizuar zgjidhja e tij. Duke i nxitur për këtë çështje, ata mund të bëjnë propozime konkrete dhe të japin mendime për ta pasuruar më tej eksperiencën e fituar. Përse të vijnë ata në Komitetin Qendror për gjëra të tjera të vogla, kur fare mirë mund të ngrenë probleme të mëdha si ky që përmenda?

Edhe me shokët e Qeverisë është e nevojshme ta koordinojmë këtë punë, të përcaktojmë çfarë duhet të shqyrtojmë ne e çfarë ata, si dhe të argumentojmë për ç'arsye t'i marrim ne disa dhe për ç'arsye ata të marrin disa të tjera.

Metoda efikase e punës së sekretarëve të Komitetit Qendror do të shmangë edhe presionin nga poshtë, edhe presionin e aparatit. Shokët e rretheve ose të aparatit mund të drejtohen për shumë gjëra të vogla, mirëpo për një gjë të vogël të harxhon tjetri shumë kohë. Ne e kritikojmë me të drejtë mënyrën se si shokët me përgjegjësi të Partisë, kur presin njerëzit, lejojnë që këta të parashatrojnë tërë historinë e çështjes, në vend që të përgatiten të flasin shkurt për esen-

cën e saj. Kështu, gjatë kohës së caktuar për pritje, mund të priten më shumë veta. Njerëz të tillë, që zgjaten, u hanë shumë kohë shokëve. Për më tepër, nga një «mënyrë» e tillë «të foluri» vuajnë edhe shokët e rretheve dhe të aparateve; të gjithë janë gati të raportojnë gjatë për çdo gjë. Kjo do të thotë të mos japësh atë që kërkohet dhe të shkarkosh nga vetja përgjegjësinë.

Duhet mësuar shokët e aparatit tonë si ta ndajnë më mirë punën. Atë që është për sekretarin e Komitetit Qendror, t'ia parashtrajnë atij, e kështu me radhë edhe për problemet e tjera; secili të bëjë atë që i takon. Jam i bindur se po të bëhet kështu, shokët kryesorë do të shpëtojnë nga presioni, do të shpëtojnë nga ky presion edhe vetë shokët e aparatit të Komitetit Qendror dhe të rretheve. Nuk është e drejtë që të gjithë ata që kanë lidhje me një instruktor të Komitetit Qendror, i cili merret, ta zëmë, me kulturën ose me propagandën, të vijnë t'i flasim këtij edhe për kamionët që duhen për të transportuar dherat që nxirren andej-këndeje. Një gjë e tillë s'duhet lejuar, prandaj secili ta kryejë mirë detyrën që i takon.

Por, punonjësi i aparatit të mos shkojë në anën tjetër dhe ta flejë mendjen që, kur një institucion që ishte më parë në varësi të Partisë, shkon në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, s'ka pse interesohet më si bëhet puna në to. Kudo ka çështje partie që duhen ndjekur e zgjidhur nga ana e punonjësve të Partisë, nga shokët e aparatit dhe të komiteteve të Partisë të rretheve.

Por të kemi parasysh se në aparat, në çdo sektor,

kemi nga një a dy shokë, prandaj të mendojmë mirë për metodën e punës dhe për problematikën që do të ndjekin. Këta duhet të mbështeten mirë te kuadrot që janë në krye të institucioneve të veçanta, por vetëm për probleme parimore, jo edhe për probleme të vogla, që u takon t'i zgjidhin vetë ose me ndihmën e organeve shtetërore përkatëse, ndryshe do të ngarkohen shumë dhe do të lënë mënjanë çështjet kryesore. Përveç atyre çështjeve që u kërkon e duhet t'u kërkojë sekretari përkatës i Komitetit Qendror, ata mund të sjellin probleme të tjera të reja. Për probleme të veçanta mund t'i përgatitet sekretarit një informacion i shkurtër dhe s'është nevoja që, bie fjala, një punonjës i ministrisë për diçka të thjeshtë të vijë t'i hajë kohën një sekretari të Komitetit Qendror duke i folur dy orë, por çështjen ai t'ia referojë instruktorit të caktuar, i cili më vonë t'ia paraqesë sekretarit të Komitetit Qendror shkurtimisht, vetëm esencën.

E theksoj këtë se shfrytëzimi racional i kohës është një problem i madh për ne dhe për të gjithë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

**KUSH MBRON INTERESAT E POPULLIT E LIDHET  
ME TË — MBETET KURDOHERË I GJALLË  
NË NDJENJAT DHE NË ZEMRËN E TIJ**

*Nga biseda me ambasadorin e Republikës Islamike  
të Pakistanit*

**15 janar 1969**

Na ka gëzuar ardhja juaj për t'u takuar me rastin e largimit për në vendin tuaj. Ne kemi simpati të madhe për popullin pakistanez dhe kurdoherë kemi dashur dhe duam t'i forcojmë sa më shumë marrëdhëniet me të. Edhe në të ardhmen ne do t'i shtojmë përpjekjet tona në këtë drejtim. Populli dhe Qeveria jonë kurdoherë kanë qenë për mbrojtjen e të drejtave të popullit të Pakistanit. Për çështjen e Kashmirit, për shembull, dhe në mjaft çështje të tjera, qëndrimet tona kanë qenë të afërta. Këto ia kemi shprehur edhe qeverisë suaj.

Popujt tanë njihen prej kohësh, qysh mijëra vjet përpara, kur jetonte Aleksandri i Madh. Historianë të ndryshëm të botës e quajnë grek Aleksandrin. Por po të fillojmë të flasim për gjenealogjinë e tij, nuk diskutohet se babai i tij ishte maqedonas, ndërsa nëna ishte nga një fis ilir, paraardhës i shqiptarëve. Në luftën

që ka bërë me Porosin<sup>1</sup> ai pa, dhe vetë e ka pohuar, trimërinë e popullit tuaj. Tërë jetën ka luftuar populli pakistanez kundër pushtuesve të huaj e, tash së fundi, kundër borgjezisë indiane. Kështu ka luftuar edhe populli shqiptar, më parë kundër pushtuesve turq e së fundi kundër imperialistëve italianë e gjermanë dhe ka fituar.

Mbi ju, ashtu si edhe mbi ne, kanë kaluar furtuna, por këto, sado që kanë qenë të mëdha, nuk kanë mundur t'i zhduknin popujt tanë. Njeriu juaj i madh Xhina<sup>2</sup> ka thënë se nuk ka forca në botë, sado të mëdha qofshin ato, që ta pengojnë Pakistanin për t'u bërë shtet i lirë. Kjo është e vërtetë. E fortë dukej Anglia, i fortë dukej pushteti i Nehrusë dhe i mikut të tij, politikanit reaksionar anglez, Bevinit, në kohën kur Pakistani ishte nën sundimin e tyre, po ja, më në fund, vendi juaj u bë i lirë dhe i pavarur.

Lexoj nganjëherë antologji të përkthyer nga persishtja. Midis tyre kam kënduar disa pjesë të poetit tuaj, filozofit Ikbali<sup>3</sup>, që predikonte në Lahorë<sup>4</sup>. Shkrimet e tij janë idealiste, por në to ka edhe ide përparimtare. Me sa më kujtohet, në një vend Ikbali u drej-

---

1 Mbret indian, sundimtar në Penxhab. Ekspeditave të Aleksandrit të Maqedonisë u bëri një rezistencë të fortë, por në vitin 326 para erës së re u mund dhe Aleksandri e emëroi administrator civil të guvernatorit të tij në Penxhab.

2 Guvernatori i parë i përgjithshëm i qeverisë angleze në Pakistan pas shkëputjes së tij nga India më 1947, themelues i shtetit të Pakistanit.

3 Muhamed Ikbali (1873-1938).

4 Kryeqendër e hershme e Penxhabit.

tohet kapitalistëve të Perëndimit dhe u thotë: «Ju njerëzit e Oksidentit, në tokën tonë, — që ekzaktësisht ai e quan «tokë e zotit», — ku keni shtrirë kthetrat, keni ndërtuar një fole siç e ndërtojnë zogjtë mbi një kallam të hollë, prandaj mos kujtoni se te ne do të kenë jetë të gjatë regjimet që ju vetë keni krijuar, se ju keni përgatitur në të njëjtën kohë edhe thikën me të cilën do t'ju vrasin».

Këto parashikime të Ikbalit u bënë realitet. Popujt e varfër, të etur për liri, u ngritën dhe luftuan. Ashtu siç bëri Pakistani po luftojnë edhe vende të tjera dhe dita-ditës po fitojnë. Të gjithë popujt të bashkuar janë më të fortë nga imperializmi dhe kur këta vendosin të luftojnë, imperializmi është i destinuar të humbasë. Edhe nga pikëpamja strategjike e taktike, imperializmi po humbet, sepse popujt nuk mund të mbahen të shtypur. Nuk mund të luhet sot as me fatin e të drejtat e Shqipërisë së vogël, as me të drejtat e Pakistanit për Kashmirin. Çdo përpjekje për të marrë nëpër këmbë popujt e botës nga kushdo qoftë është e kotë. Është e vërtetë se sot ka shumë fuqi të mëdha lakmitare, por këto fuqi të mëdha nuk mund të veprojnë si dikur. Ato çdo ditë e më shumë po dobësohen. Fuqi e madhe ishte dikur Anglia, fuqi të mëdha ishin dikur Gjermania hitleriane dhe Italia fashiste, fuqi të mëdha janë sot imperializmi amerikan dhe social-imperializmi sovjetik. Por këto fuqi, megjithëse kanë pasur gjithmonë synime grabitqare ndaj Shqipërisë së vogël, nuk kanë mundur kurrë ta robërojnë dhe as do të mund ta robërojnë asnjëherë popullin shqiptar, i cili di shumë mirë të mbrojë lirinë, pavarësinë e demokracinë e

tij dhe është gati në çdo moment t'u bëjë ballë të gjithë armiqve. Ja, për shembull, populli ynë i vogël, vetëm gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli dy herë me radhë i ka hedhur në det ushtritë e imperializmit italian. Për fatin e tij të keq ky akoma s'ka vënë mend. Tash ai, për realizimin e ëndrrave të tij të vjetra ndaj Shqipërisë, shpresat i ka varur tek imperializmi amerikan. Po të jetë i sigurt, ai dhe kushdo tjetër, se nuk do t'ia arrijnë dot kurrë qëllimeve të tyre, as të na frikësojnë e jo më të na pushtojnë.

Ju thatë më parë se jeni gati të luftoni po t'ju preken liria dhe interesat tuaj, sepse doni të rroni në të drejtën tuaj. Edhe ne jemi gati të luftojmë për lirinë dhe idealet tona dhe po të na prekë kush jemi të bindur në fitoren tonë, pse jemi me të drejtën tonë dhe më të fortë se kurrë. Kujtdo që do të përpiqet të na shkelë të drejtat, kujtdo që do të përpiqet të na cenojë tokën tonë të shenjtë, ne do t'ia presim duart. Kështu do të ngjasë te ne në rast se do të na sulmojnë imperialistët ose revizionistët. Toka e mëmës dhe e babait është e shenjtë, interesat, e ardhmja dhe jeta e popullit tonë janë të shenjta. Populli shqiptar ka po ato të drejta që ka çdo popull, i madh apo i vogël qoftë, të rrojë i lirë dhe të ndërtojë jetën e tij ashtu siç e mendon ai vetë më mirë. Për këtë ne jemi të vendosur. Se sa të vendosur jemi ne në rrugën tonë, këtë e dinë shumë mirë edhe armiqtë tanë. Ata e dinë mirë që pa luftë nuk shkelet Shqipëria, që asnjë pëllëmbë tokë shqiptare nuk do të lëshohet pa u derdhur gjak. Po ta shpërthejnë luftën armiqtë, ajo me siguri do të përfundojë me fitoren e shqiptarëve dhe

në dëmin e atyre që do të guxojnë të prekin kufijtë tanë.

Ne kemi besim në forcat e popullit tonë, i cili ka dhënë prova gjatë gjithë historisë sonë mijëravjeçare, që ka qenë e mbushur me luftëra për liri. Ne kemi besim edhe në solidaritetin e të gjithë popujve të botës, të cilët do të jenë përkrah nesh për mbrojtjen tonë. Ne besojmë, gjithashtu, se, po të preken interesat e popullit shqiptar, populli pakistanez do të revoltohet dhe do të marrë anën tonë, sepse e di që ne jemi një popull paqedashës, që duam të jetojmë të lirë dhe të lumtur në punën tonë.

Prandaj ne vendim dhe popullin tonë, të vendosur për rrugën në të cilën ecim, i konsiderojmë jo të pafuqishëm dhe të vegjël. Është e njohur nga historia, dhe faktet e çdo epike e kanë treguar, se vendimtare në luftë nuk janë armatimet, por vendosmëria dhe forca morale e popullit që lufton për të drejtat e tij.

Imperialistët e rinj, revizionistët sovjetikë, menduan se Shqipëria do t'u nënshtrohej këtyre ose do të shitej te miqtë e tyre, tek imperialistët e Perëndimit «për 30 aspra»<sup>1</sup>. Por nuk ndodhi as njëra, as tjetra. Ajo vazhdon me konsekuencë rrugën e saj socialiste, ndërton me sukses socializmin në vendin e vet, megjithëse e rrethuar nga armiq.

Nuk e di nëse patët rast të shëtitnit nëpër Shqipëri gjatë kësaj kohe që qëndruat në vendin tonë. Jam i bindur se ju, si mik i Shqipërisë, dini ta gjykoni rea-

---

1 Kështu e akuzoi udhëheqjen shqiptare renegati N. Hrushov më 1961.



lisht gjendjen dhe jetën e popullit tonë, gjithnjë duke e krahasuar me kohën e paraçlirimit. E kaluara e popullit tonë është pak a shumë e ngjashme me atë të popullit tuaj. Ne, vetë populli ynë, kemi bërë gjëra shumë të mira. Është e vërtetë se kemi pasur ndihmë edhe nga Bashkimi Sovjetik në kohën e Stalinit, kurse ndihma e dhënë në kohën e Hrushovit jo vetëm që ka qenë e vogël, po ajo nuk ka qenë aspak e sigurtë, megjithatë, asnjëherë ne nuk i kemi vënë shpresat e së ardhmes sonë në ndihmën e të tjerëve, pavarësisht nga cilësia dhe sasia e ndihmës. Populli ynë ka një fjalë të urtë që thotë: «Nuk mbahet shtëpia me miell hua». Dua të them me këtë se rezultatet madhështore të arritura gjer më sot, u detyrohen, në radhë të parë, forcës dhe energjisë së popullit tonë, pushtetit popullor, i detyrohen njeriut tonë të përtërirë i cili punon e transformon vendin dhe siguron te ne atë forcë të madhe shtytjeje që ndihmon kombin të çajë përpara dhe të lulëzojë.

Natyrisht ajo që kemi arritur s'na kënaq. Ne akoma kemi shumë për të bërë, kemi shumë nevoja për të plotësuar, por ne do të ecim gjithnjë e më përpara, pse kemi besim në sistemin tonë socialist. Përparimi është rezultat i përpjekjeve të njerëzve që dinë dhe kuptojnë mirë ligjet e zhvillimit të natyrës e të shoqërisë dhe luftojnë për suksese gjithnjë e më të mëdha.

Ne mendojmë se popujt tanë të lirë, punëtorë dhe me energji të pashtershme, do t'i përvetësojnë shkencën dhe teknikën moderne, të cilat do t'i vënë në shërbim të tyre. Kjo është vetëm çështje kohe.

Kush mbron interesat e popullit e lidhet me të, ai

mbetet kurdoherë i gjallë në ndjenjat dhe në zemrën e tij. Le të bëjmë një krahasim. Kush do të rrojë në historinë e popullit tuaj, Kiplingu<sup>1</sup> apo Ikbali? Patjetër Ikbali. Emri i tij do të mbetet i pavdekshëm pse ky i këndoi popullit, lirisë e pavarësisë së atdheut, kurse emri i Kiplingut që i këndoi imperializmit, do të fshihet.

Ne kemi besim se populli juaj do t'u bëjë ballë kërcënimeve të imperializmit anglez, ekspansionizmit indian dhe intrigave të revizionizmit sovjetik. Të gjithë këta kërkojnë që ne popujt e vegjël të na bëjnë gur shahu. Në momente të tilla kruciale njerëzit që mbrojnë interesat e popujve ngrihen dhe luftojnë për interesat e tyre.

Ashtu siç thashë dhe më parë, ne kemi besim të madh në popullin tonë, pse është një popull i mrekullueshëm, i etshëm për dituri dhe i shkathët për vënie në jetë të qëllimeve të tij të larta. Prandaj ne mbështetemi në popull, te njerëzit e mirë, të cilët i do shumë populli.

Ne urojmë që populli i Pakistanit të përparojë, të rrojë i lumtur e i gëzuar në atdheun e tij të lirë. Ne, me gjithë zemër dëshirojmë që miqësia e singertë midis dy popujve tanë të zgjerohet dhe të forcohet, sepse është në interesin e tyre, të luftës për paqe e përparim. Lufta jonë është me të vërtetë një luftë e singertë për paqen, por për atë paqe që do të sjellë zhdukjen e luftës. Popujt nuk e duan luftën, këtë e

---

<sup>1</sup> Shkrimtar reaksionar anglez (1865-1936), ekzaltues i ideologjisë së ekspansionit imperialist britanik dhe i kolonializmit.

duan vetëm armiqtë e popujve që kërkojnë të sigurojnë fitime. Ndjenja të tilla miqësore ne jemi të bindur se edhe populli i Pakistanit do të ushqejë ndaj popullit shqiptar. Jam i bindur se ju, si mik i sinqertë i Shqipërisë, nuk do ta harroni këtë. Po të keni rast të vini përsëri në Evropë, ne do të gëzohemi në qoftë se do të ndalonit si mik edhe në vendin tonë për aq kohë sa të kishit mundësi.

Le ta pimë këtë gotë për miqësinë e dy popujve tanë!

Mos e harroni Shqipërinë! Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në  
këtë takim që gjenden në AQP*

## DREJTIMI MË I PËRSOSUR QËNDRON NË VEPRIMTARINË KRIJUESE TË PËRBASHKËT

*Letër drejtuar brigadierit Alo Qosja nga Sojniku  
i Gramshit*

23 janar 1969

I DASHURI SHOKU BRIGADIER ALO QOSJA,

Të çoj shumë të fala të përzemërta. Me punën tënde u njoha nga shkrimi i korrespondentit të «Zërit të popullit», Jorgji Papa, i cili shkruan për ty realisht dhe me entuziazëm.

Jam gëzuar shumë dhe Partia jonë duhet të mburret me anëtarët e saj si ti, që e kuptojnë dhe e zbatojnë aq drejt dhe me aq sukses në jetë vijën e saj. Ti, me punën, me guximin tënd prej komunisti dhe me rezultate konkrete jo vetëm nderon Partinë dhe popullin në detyrën që të kanë besuar, por me shembullin e punës që po bën, vërteton njëkohësisht drejtësinë e orientimeve të Partisë në bujqësi, u tregon të tjerëve se mund të drejtosh, por edhe të prodhosh dhe se ai që prodhon, drejton më mirë. Dhe ky është drejtimi më i mirë, se është antiburokratik.

Puna jote vërteton, gjithashtu, sa vlera të mëdha materiale dhe morale krijon dhe nxit një drejtim joburokratik, kur ai përputhet ngushtë me punën konkrete, me njerëzit e thjeshtë që punojnë, luftojnë e që krijojnë dhe, kur njerëzit e punës shikojnë punën e

mirë të drejtuesve të tyre, binden se drejtimi më i përsosur qëndron në veprimtarinë krijuese të përbashkët.

Udhëheqës i mirë nuk është ai që jep urdhra dhe direktiva nga larg, por ai që i zbaton edhe vetë këto direktiva, që i vërteton këta urdhra e direktiva me zbatimin konkret të tyre, që merr pjesë aktivisht në zbatimin e tyre dhe jep i pari shembullin dhe shembullin e mirë, që dëgjon me kujdes zërin e masës, se masa është njëkohësisht prodhuesi dhe drejtuesi kryesor. Të gjitha këto çështje ti po i zbaton në mënyrë shembullore, prandaj unë jam aq shumë i gëzuar me punën tënde dhe frymëzohem prej saj, shoku komunist Alo Qose.

Kur ishe kooperativist i thjeshtë, ti bëje 400 ditë-punë në vit dhe në frontet më të vështira, kurse shokët e tu kooperativistë me vështirësi i plotësonin 280 ditë-punë. Kur shokët kooperativistë të caktuan si brigadierin e tyre, ty nuk t'u rrit mendja, por t'u rrit ndjenja e përgjegjësisë për të kryer detyrën, t'u shtua guximi, t'u shumëfishuan forcat fizike dhe morale. «Vështirë të dalloje brigadierin nga kooperativistët në punë», shkruan korrespondenti i «Zërit të popullit».

Edhe gjatë vitit 1967, si brigadier, ti bëre 180 ditë-punë të normuara, kurse brigadierët e tjerë mezi bëjnë 60. Por ti nuk fjete mbi dafina. Si njeri i talentuar i punës dhe i drejtimit që kudo ku shkoje kazmën dhe shatin i mbaje me vete, ti kontrolloje, këshilloje dhe punoje, nuk ishe i kënaqur me veten tënde, prandaj në vitin 1968 bëre 230 ditë-punë të normuara. Me shembullin e mirë, ti jo vetëm u fitoje zemrën kooperativistëve, por rezultatet e tua në punë tronditën edhe një dembel të brigadës. Ti, shoku Alo Qosja, kur

u diskutua në brigadë çështja e tij, e trajtove drejt atë, si komunist, dhe me këtë bëre që ai të ndryshonte nga dembel në një punëtor të dalluar.

Tok me kolektivin me të cilin punuat së bashku, ti vërtetove gjithashtu të mirën e normave kolektive, që të kuptohej se thelbi i këtyre normave është puna fizike, por edhe puna politike për ngritjen e ndërjegjes komuniste të kooperativistëve. Kjo bëri që çdo gjë në brigadën tuaj të ngrihej lart, të rritej rendimenti i punës, të hapeshin toka të reja dhe të tejkalohesh plani i tyre dhe i prodhimeve.

Shembulli yt personal në punë mobilizon brigadën. Nga 15 metra qilizëm në ditë që bënte një pjesëtar brigade, ti propozove që norma të ngrihej në 25 metra. Dikush në brigadë tha se 25 metra qilizëm në ditë në pyll nuk bëheshin dot. Por ti more kazmën dhe realizove 35 metra. Me shembullin tënd frymëzues dhe me shpirtin tënd prej organizatori të talentuar, shokë të tjerë të brigadës e tejkaluan normën, ata arritën të bëjnë 38 metra dhe s'ka dyshim që kjo ty të gëzoi. Në brigadë bëheshin 350 metra prashitje misri në ditë. Ti gjykove se kjo ishte pak dhe propozove të ngrihej norma në 500 metra në ditë. Si shumë e ngrite, të thanë disa kooperativistë. Por ti more vetë shatin dhe duke bërë 700 metra në ditë vërtetove në praktikë se propozimi yt ishte real. Dhe në shembullin tënd kooperativistët arritën të bëjnë edhe më shumë nga sa propozove ti, nga 500 metra ata prashitën 600, pati bile të tjerë që ta kaluan edhe ty, brigadierit të talentuar, dhe bënë 800 metra.

Shembulli yt kaq i mirë, i frymëzoi e i mobilizoi

gjithë brigadierët e tjerë të kooperativës malore të Sojnikut, të cilët e ngritën pjesëmarrjen e tyre në punën drejtpërdrejt në prodhim në 180 ditë-punë në vit, kurse ti u zotove që këtë vit të bësh 300 ditë-punë.

Të përgëzoj me gjithë zemër, i dashuri shok komunist, dhe uroj që gjithë brigadierët, kooperativistët, kryetarët e kooperativave dhe drejtorët e të gjitha ndërmarrjeve shtetërore të ndjekin shembullin tënd në punë dhe në drejtim.

Unë personalisht ruaj kujtime nga më të mirat të kohës heroike të Luftës Nacionalçlirimtare, që kam kaluar në fshatrat e malësisë së Gramshit, ku kam jetuar dhe luftuar tok me fshatarët e Holtit, Poroçanit, Kishtës, Sojnikut, Grabovës, Shënepremtes etj. dhe nga afër kam ndier të rrahin zemrat trime dhe bujare të fshatarëve dhe të fshatareve patriote të këtij rrethi për Partinë Komuniste, tash Partia e Punës e Shqipërisë.

Sot edhe rrethi i Gramshit po zhvillohet, po përparon e po lulëzon. Një e ardhme akoma më e bukur e pret popullin e asaj krahine. Këtë e siguron dhe po e bën Partia jonë e madhe në krye të popullit tonë të mrekullueshëm.

Të përqafoj, i dashuri shok, dhe të uroj shëndet dhe shumë suksese në shërbim të popullit, në rrugën e nën udhëheqjen e Partisë.

Yti

*Enver*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 21 (6373), 25 janar 1969*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha: «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 5*

## GJYKATA ËSHTE PJESE E PANDARË E PUSHTETIT POPULLOR

*Nga diskutimi në mbledhjen e Presidiumit  
të Kuvendit Popullor<sup>1</sup>*

**25 janar 1969**

Pas suprimimit të gjykatave të qarqeve, Gjykatës së Lartë i është shtuar punë, prandaj, për ta lehtësuar, është e nevojshme që puna të organizohet më mirë e të pakësohen gjykimet në shkallën e dytë.

Disa ditë më parë pata një bisedë me një shok, i cili më tregoi për një rast që gjykata kishte për të marrë një vendim që më duket i padrejtë. Konkretisht çështja ishte për ndarjen e një shtëpie me dy dhoma e një kuzhinë midis bashkëshortëve. Për pjesëtimin e shtëpisë akoma nuk ishte marrë vendim përfundimtar, por gjatë zhvillimit të procedurës gjykata kishte vendosur, provizorisht, që gruaja me kalamajtë, pra pjesa më e madhe e familjes, të qëndronin vetëm në një dhomë. Kështu gruaja dhe fëmijët mbeteshin pa kuzhinë!

---

<sup>1</sup> Ky diskutim u zhvillua rreth çështjes së parë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje: «Informacion i Gjykatës së Lartë për gjykatat e fshatrave, të qyteleve e të lagjeve të qyteteve».



Në qoftë se çështjet që kanë objekt shkurorëzimin, për rëndësinë shoqërore që paraqesin, mund të shqyrtohen në shkallë të dytë nga Gjykata e Lartë, disa padi të tjera për të drejta pronësie ose për detyrime, sidomos midis shtetasve, mund të mos shikohen nga Gjykata e Lartë. Sipas ligjit, kur ankohen palët, çështja shkon për shqyrtim në shkallë të dytë, në Gjykatën e Lartë. Mund të ketë shumë padi, edhe për çështje të vogla, me të cilat nuk ka përse të merret Gjykata e Lartë. Kam përshtypjen se shumë çështje që shqyrtojnë sot gjykatat popullore mund të zgjidheshin nga organet e administratës shtetërore. Në gjyq është e nevojshme të shkojnë vetëm konfliktet civile që nga natyra e tyre kërkojnë zgjidhje gjyqësore. Kështu mund të lehtësoheshin në punë edhe gjykatat e rretheve edhe Gjykata e Lartë. Në këtë drejtim, mbase, mund të ndryshohej Kodi i Procedurës Civile. Unë e kam fjalën këtu për ndryshimin e ligjit që rregullon këtë procedurë, se gjersa ligji parashikon të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, shtetasi doemos atje do të drejtohet.

Mendoj se akoma nuk është kuptuar drejt se gjykatat janë organe shtetërore që realizojnë dhënien e të drejtës. Gjykata, ashtu si këshilli popullor, është e zgjedhur nga populli. Ajo nuk është e huaj për organet shtetërore, por është pjesë e pandarë e pushtetit popullor.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## SUKSESET TONA JANË REZULTAT I VIJËS SË DREJTË TË PARTISË

*Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit  
të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë<sup>1</sup>*

29 janar 1969

Kjo mbledhje, sikurse e thanë edhe shokët që diskutuan, ka një rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e punës që na ka ngarkuar organizata e Frontit.

Mendoj se problemet që u shtruan këtu, i kemi për detyrë t'i shpiem në bazë, te masat, që këto të njihen me to. Ne duhet ta bëjmë këtë edhe me qëllim që masat të shfrytëzojnë eksperiencën shumë të pasur

---

1 Në këtë mbledhje Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Demokratik të Shqipërisë shqyrtoi punën e organizatave të Frontit për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit dhe detyrat që dilnin për vitin jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Në këtë mbledhje u miratua Thirrja e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë «Për ta pritur 25-vjetorin e Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor me suksese sa më të mëdha në të gjitha fushat e jetës». (Shih: «Zëri i popullit», nr. 26 (0378), 31 janar 1969.)

të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit tonë Demokratik. Kjo praktikë nuk është diçka e re, por e kemi vënë në jetë edhe më parë, sepse na e kanë diktuar nevojat e punës sonë të përditshme.

Shokët, në diskutimet e tyre, treguan se organizatat e Frontit, në sajë të punës së vazhdueshme që kanë bërë me anëtarët, kanë arritur rezultate të rëndësishme në të gjitha drejtimet, në mënyrë të veçantë në ngritjen e nivelit ideologjik dhe politik të tyre, në luftën kundër prapambetjes dhe zakoneve të vjetra, si dhe në përpjekjet e mëdha për të arritur sa më shumë rezultate edhe në sektorët e ndryshëm të ekonomisë. Këto rezultate tregojnë për sukseset e mëdha që kemi arritur në të gjitha drejtimet. Por këto suksese nuk na dehin, nuk na e rritin mendjen, përkundrazi na japin forca të reja që të ecim edhe më përpara për të vënë në jetë porositë e Partisë, për lulëzimin dhe begatinë e atdheut.

Të gjitha këto suksese janë rezultat i vijës së drejtë që ndjek Partia jonë, e cila, duke u qëndruar gjithmonë besnike parimeve të marksizëm-leninizmit, i ka dhënë një hov të papërshkruar zhvillimit ekonomik të vendit, revolucionarizimit të jetës së masave tona punonjëse. Në gjithë këtë punë të madhe një kontribut të vlefshëm ka dhënë edhe organizata jonë e madhe dhe e fuqishme e Frontit Demokratik.

Si anëtarë të kësaj organizate masive luftarake, ne, duke u mbështetur në eksperiencën që kemi fituar, do të punojmë vazhdimisht për të vënë në jetë direktivat e qarta dhe mobilizuese të Partisë, si dhe për të realizuar detyrat që na dalin nga kjo mbledhje

dhe nga Thirrja që aprovuam këtu. Ne do të luftojmë, siç e kanë theksuar Partia dhe Qeveria në Vendimin<sup>1</sup> e tyre të përbashkët, që festën e jubileut të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut ta bëjmë një datë historike të popullit tonë. Kjo do të arrihet, në radhë të parë, duke punuar për ngritjen e nivelit të gjithanshëm të popullit tonë nga ana ideologjike dhe politike, si dhe me përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të jetesës së tij, si të atyre ekonomike, edhe atyre shpirtërore. Realizimi i këtij synimi do të arrihet, sepse e tillë është vija e Partisë sonë, të cilën e ndjek me besnikëri mbarë populli ynë. Prandaj neve na del detyrë të luftojmë me të gjitha forcat që ta zbatojmë këtë vijë dhe të arrijmë rezultate sa më të mëdha.

Ne, anëtarët e Frontit Demokratik jemi ushtarët e Partisë dhe do të bëjmë të gjitha përpjekjet për të realizuar sa më mirë të gjitha detyrat që na ngarkon Partia.

Me kaq, shoqe dhe shokë, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, duke ju uruar të gjithëve punë të mbarë!  
Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

1 «Vendim i Komitetit Qendror të PPSH dhe i Këshillit të Ministrave të RPSH për ta shpallur vitin 1969 vit jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor». (Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. V, f. 545. Tiranë, 1974.)

# LËNDA E DRURIT ËSHTË SI BUKA PËR INDUSTRINË DHE PËR NEVOJAT E TJERA TË POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

30 janar 1969

Në radhë të parë, mendoj se duhet të bëhet një kthesë rrënjësore në të gjitha masat tona punonjëse për kuptimin e drejtë të kësaj pasurie të madhe të popullit, të kësaj pasurie të madhe prodhuese të lëndës së drurit, e cila hyn kudo në nevojat e jetës sonë të përditshme. Kudo dhe nga çdo sektor kërkohet përditë lëndë druri, bruto ose e përpunuar, por interesimi, kujdesi, vëmendja e gjithsecilit, që nga mbirja dhe deri te konsumi i lëndës në forma të ndryshme, nuk janë në nivelin e kërkesave dhe të konsumit. Bile edhe konsumatorët e mëdhenj, siç janë ndërmarrjet e ndryshme të industrisë dhe të ekonomisë kombëtare, nuk

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti për vlerësimin e gjendjes reale të pasurisë pyjore dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese të pyjeve të vendit.

mendojnë veçse të konsumojnë, qahen që nuk i furnizojnë sa më shumë, por nuk mendojnë si duhet jo vetëm për shfrytëzimin e lëndës së drurit me kritere të drejta dhe për përdorimin e saj me nikoqirllëk, por pak u shkon në mend të ndihmojnë konkretisht dhe me shumë forma e mënyra burimin mëmë nga del ky material i parë, që përbën bazën e punës së tyre. Jo, këtë as që e mendojnë, «lëndën e prodhon pylli, thonë ata, ne duhet vetëm ta harxhojmë, prandaj tjetërkush le të interesohet për të».

Të gjithë, në përgjithësi, që nga zdrukthëtari e deri te fshatari kështu mendojnë dhe presin, presin e presin me kriter dhe pa kriter, si në «mallin e shtetit». Sigurisht pyjet janë prona e shtetit tonë socialist, domethënë pronë e gjithë popullit. Por në këtë çështje ekziston një dozë e theksuar e kuptimit të vjetër borgjez të «pronës së shtetit», ekziston ajo mbeturinë e vjetër që, meqë «ishte pronë e shtetit borgjez», të interesohemi sa më pak për të dhe ta shfrytëzojmë sa më shumë. Ekziston, gjithashtu, pikëpamja popullore, për ata që nuk shohin më larg se horizonti i fshatit ose i fabrikës së tyre, se «pyje ka boll, ato janë pambarim, shumëzohen në mënyrë natyrore, prandaj përse nuk presim më shumë, përse nuk na furnizojnë sa duhet etj., etj.».

Këto pikëpamje, natyrisht, i pengojnë njerëzit dhe kolektivat ta shohin dhe ta gjykojnë në tërësi këtë problem të madh, ta shikojnë problemin në veçanti dhe realisht edhe në platformën ekonomike, agroteknike, të kuptojnë, gjithashtu, edhe anën politike të çështjes. Këto pikëpamje të paqarta dhe masat jorrënjësore tek-

nike, organizative, propagandistike të marra për zgjidhjen e këtij problemi, bëjnë që në mbjelljen, në mbarështimin dhe në kujdesin për rritjen e pyjeve ne nuk kemi atë sukses dhe hov revolucionar që tregohet për problemet e tjera të ekonomisë.

Për problemin e pyjeve dhe të lëndës së tyre, kaq shumë të vlefshme dhe të nevojshme, tregohet vallë po ai kujdes, si për drithërat, për kafshët e prodhimit, për hapjen e tokave të reja etj.? Jo! Këtu s'mund të bëhet asnjë barazim. Po përse? Unë mendoj se shkakun duhet ta kërkojmë në ato që thashë më lart.

Prandaj, ne duhet të bëjmë një kthesë të madhe në këtë çështje, kthesë në kuptimin e drejtë të politikës ndaj pyjeve, në teknikën, në organizimin, në propagandën, në edukatën teorike dhe praktike, të punojmë që të rrënjosim në popull dashurinë e madhe për pyllin, por jo një dashuri vetëm sa për ta ngrënë, siç ekziston sot në përgjithësi. Edhe misrin e grurin i hamë, por që të kemi të hamë, për këta kujdesemi t'i mbjellim çdo vit. Kështu duhet të kujdesemi edhe për drurët e pyllit, për të cilët, për fat të keq, nuk duhet një sezon kohe për t'u rritur e për t'u shfrytëzuar nga njerëzit sa edhe për grurin e misrin, po të paktën 20-25 vjet. Vetëm të hash dhe të mos mbjellësh, do të thotë të mos kesh të hash nesër, se lënda e drurit është si buka për industrinë dhe për nevojat e tjera të popullit.

Këtë problem të madh ne nuk po e marrim për herë të parë në studim. Ai vazhdimisht ka preokupuar bazën dhe udhëheqjen e Partisë në qendër dhe në rrethë; janë bërë studime, janë caktuar fonde e mjete, janë caktuar e zbatuar plane, të cilat kanë dhënë rezultate

pozitive dhe kanë vënë në rrugë të mirë shumë çështje që kanë të bëjnë me këtë problem.

Sot, me studimin që na paraqitet, unë mendoj se po bëjmë një rishikim të gjendjes, një analizë që na tregon më qartë në përgjithësi ku gjendemi dhe ç'duhet të bëjmë paskëtaj. Rëndësi, mendoj, ka mobilizimi i një mase të gjerë kuadrosh, organesh të pushtetit dhe të Partisë, si dhe masa kooperativistësh për të bërë këtë studim dhe për të formuluar sa më saktësisht gjendjen, për të marrë masa dhe për të zgjidhur detyrat që na vihen përpara. Tash kemi më qartë dhe të përcaktuara më mirë sipërfaqet e pyjeve, në pyje me lëndë e me shkurre, me çfarë lloj lënde, dhe çfarë lloj lënde duhet të përmirësojmë e të shtojmë, sa duhet të presim, ku duhet dhe kur duhet të presim dhe sa e si duhet të mbjellim.

Ne, sigurisht, kemi vijat dhe shifrat e përgjithshme për të cilat po diskutojmë dhe do të vendosim. Por unë mendoj se i gjithë studimi i ekipeve ka një vlerë të madhe shkencore, teorike dhe praktike, për Ministrinë e Bujqësisë, e cila duhet të mbështetet vazhdimisht në të dhe jo ta lërë të zërë pluhur. Ky studim, propozoj të bëhet objekt i rëndësishëm temash të ndryshme për punonjësit, tema me karakter të përgjithshëm dhe të veçantë, tema për teknikët e pyjeve, për shkollat e këtij profili, tema për rrethet e veçanta me karakteristikat, këshillimet dhe rekomandimet e veçanta për specifikën e tyre.

Ku jemi pra? Në përgjithësi me pyjet nuk jemi mirë as si sasi as si cilësi. Ne kemi boshllëqe të mëdha, kemi deficite. Nevojat tona, megjithëse janë parë kur-



doherë shtrënguar dhe me ekonomi të madhe, janë të mëdha përpara gjendjes së prodhimit. Studimi na nxjerr në shesh se sipërfaqet e pyjeve janë më të vogla nga vlerësimi i bërë më 1953, kurse lënda e drurit në këto pyje na del më e madhe. Fakti që kemi 13 milionë metër kub lëndë druri më shumë, nga të cilat 7 milionë lëndë punimi, nuk duhet të na bëjë të harrojmë atë që ne nuk jemi mirë me pyjet.

Tani, përpara kësaj gjendjeje, përpara nevojave imediate dhe të së ardhmes, ç'duhet të bëjmë? Raporti që na paraqit Ministria e Bujqësisë përcakton orientimet dhe detyrat kryesore që duhet të ndjekim dhe të zbatojmë. Për mendimin tim në përgjithësi ato janë të drejta dhe unë jam dakord me to. Dëshiroj vetëm të ndalem në disa çështje:

1. — Duke i konsideruar këto orientime të drejta, Ministria e Bujqësisë, seksionet e saj në rrethe, komitetet e Partisë, komitetet ekzekutive dhe kryesitë e kooperativave bujqësore nuk duhet të mjaftohen vetëm duke i aprovuar këto si të drejta në përgjithësi, por masat dhe detyrat t'i detajojnë e t'i konkretizojnë një nga një dhe pastaj të kontrollojnë zbatimin e tyre, të bëjnë edukimin e punonjësve, të forcojnë propagandën në këtë drejtim etj., ashtu siç bëhet edhe për sektorët e tjerë të bujqësisë. Këtë duhet ta bëjmë jo se nuk kemi një metodë pune për këtë aktivitet bujqësor, por sepse në këtë sektor ka akoma shumë boshllëqe e të meta, ai nuk kontrollohet dhe, meqë pyjet japin fryt pas një periudhe të gjatë, harrohet, dobësohet kujdesi për to, fidanët i hanë dhinë, bie emulacioni etj., etj., pra të gjitha ato mbeturina që thashë më lart, të cilat du-

het t'i luftojmë dhe të marrim masa e të caktojmë detyra që t'i futim në planin e ri të punës. Pra plani i ri që ne duhet të ndërtojmë dhe të zbatojmë, të jetë më revolucionar, më i studiuar, më shkencor e më mobilizues, sesa ai që kemi përdorur deri tash.

2. — Në planin e bujqësisë të çdo viti ne përfshijmë edhe planin e pyjeve me investimet përkatëse në këtë drejtim, me planin e shfrytëzimit të tyre, me planin e shkollave, të kuadrit etj., etj. Kjo kështu është, po interesimi në drejtim të pyjeve nuk është në nivelin e duhur, sepse drejtimet e tjera të bujqësisë e errësojnë, e mbulojnë këtë problem të madh. Për drithërat, për lopët, për delet interesohemi çdo ditë, çdo orë, kurse për pyjet jo. Këtu nuk është çështja vetëm në drejtorinë, në zyrat funksionale përkatëse, ose në pasjen, apo në mospasjen sa duhet të kuadrove specialistë (gjë që edhe kjo duhet rishikuar), por është më shumë te mentaliteti që ekziston për këtë problem, i cili duhet luftuar.

Unë mendoj se në punën dhe në planet e bujqësisë, plani i veçantë i pyjeve duhet të vihet më në relief, të jetë më konciz, më i detajuar, këtij sektori t'i vihet më shumë rëndësi dhe jo me disa fjalë, por realisht, në nivelin e rëndësisë së madhe që ka problemi. Në qoftë se veprojmë kështu, atëherë do të na dalin më mirë në dukje dobësitë në investime, në shkolla, në kuadro, në specifikime e të tjera e të tjera probleme të shumta, që me një fjalë, kanë lidhje me pyjet e që tash edhe i kemi parë, por edhe nuk i kemi parë si duhet.

3. — Çështja e pyjeve është e lidhur ngushtë veçanërisht me Ministrinë e Industrisë e të Minierave, si dhe me Ministrinë e Komunikacionit që është e intere-

suar për ndërtimin e rrugëve që të çojnë në pyje dhe për transportin. Sa interesohen këto dikastere për këtë problem, nuk mund të them dot gjë, se nuk e di sa kanë marrë pjesë ato në këtë studim, por ma ha mendja se interesimi i tyre nuk duhet të jetë shumë i madh dhe i organizuar bashkërisht se, pavarësisht që cilado prej tyre ka planet e veta për këtë problem, koordinimi i punës midis tyre në këtë drejtim, sipas mendimit tim, duhet të jetë më i mirë. Ne nuk i kemi lënë pyjet në varësi të Ministrisë së Industrisë për arsyen e natyrës bujqësore të tyre, por edhe për arsyen që ajo të mos jetë vetë zot, vetë shkop, por në fakt ne kemi një industri pyjore me rëndësi.

Në raport Ministria e Bujqësisë shtron disa detyra edhe për Ministrinë e Industrisë dhe të Minierave. Unë mendoj se ato mund të jenë më të mëdha jo vetëm brendapërbrenda sektorit të dikasterit, por edhe në lidhje me atë pjesë të punës që i përket bujqësisë. Kam frikë se lidhjet qëndrojnë vetëm në marrëdhënie «tregtare» si me thënë, m'i damkos ti dhe unë t'i pres dhe puna të mbarojë me kaq. Besoj se kjo nuk është e mjaftueshme.

Pylli është burimi i vetëm i lëndës së parë për industrinë e drurit, ai është si një minierë që furnizon fabrikat e kësaj dege të industrisë sonë, prandaj duhet trajtuar ashtu siç trajtohen minierat dhe fabrikat jo vetëm nga ana e furnizimit ose e prerjes së thjeshtë të lëndës, por sidomos nga ana e rritjes dhe e shtimit të tij. Sa bëhet ky interesim dhe ky kontroll, sa jepet, kontrollohet dhe koordinohet kjo ndihmë nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave, këtë nuk e di, por unë

gjykoj se këto çështje me shumë rëndësi duhen rishikuar dhe konkretizuar më mirë. Me pak fjalë, mendimi im është që Ministria e Industrisë dhe e Minierave jo vetëm duhet të rishikojë dhe të marrë masa për ta modernizuar industrinë e rëndësishme të drurit, që nga natyra e saj është shumë e rëndë, por duhet t'i japë dhe një ndihmë të madhe e konkrete drejtpërdrejt rritjes, mbarështimit, mirëmbajtjes dhe shtimit të pyjeve.

Ministria e Komunikacionit, përveç masave më të mira që duhet të marrë për transportimin e mirë dhe të shpejtë të lëndës, duhet të preokupohet seriozisht edhe për ndërtimin e rrugëve pyjore. Ajo mund të thotë se e ka planin e këtyre rrugëve, por unë mendoj se nuk do të jetë keq sikur ta rishikojë edhe një herë këtë plan në lidhje me studimin, të rikonsultohet me Ministrinë e Bujqësisë dhe me atë të Industrisë e të Minierave, sidomos për sa u përket drejtimeve dhe realizimit me kohë të rrugëve në fjalë.

Komisioni i Planit të Shtetit mendoj se duhet të ndihmojë në mbarëvajtjen e këtij problemi dhe Qeveria të kontrollojë detajimin dhe zbatimin e detyrave nga ministrinë në fjalë, duke i thirrur në raport sa herë që do ta gjejë të volitshme e të nevojshme.

4. — Unë nuk i di ekzaktesisht metodat konkrete, përqindjet e ndryshme të pyllëzimeve me këto metoda, se këtu na flitet vetëm si të përmirësojmë shkurret, por mendoj se kjo është një detyrë e gjerë, e rëndë dhe, sado që të shtojmë personelin pyjor, pa ndihmën e masave të gjera të popullit, do të jetë e zorshme t'ia arrijmë qëllimit që duam. Nuk e kam çështjen vetëm në hapjen e gropave, të mbjelljes dhe të ruajtjes së fi-

danëve, që edhe këto përbëjnë një punë të madhe dhe nga më kryesoret, por mendoj, gjithashtu, të tregohet kujdes edhe për grumbullimin e farërave dhe për krijimin e një numri të madh fidanishtesh pyjore, për të mos folur pastaj për dashurinë për pyjet dhe kontrollin e rreptë që duhet ushtruar në prerjen e lëndës së drurit nga kooperativat. Përpjesëtimet e mbjelljeve natyrore, me farë e me fidanë, duhen rishikuar, mendoj unë, dhe kjo punë duhet ndihmuar seriozisht me një agroteknikë moderne, në mënyrë serioze dhe jo prej diletantësh.

Me njerëzit që punojnë në pyjet nga Partia duhet të bëhet një punë edukative më serioze dhe shumë më e mirë se deri tani, sepse më duket që nuk ka një interesim të dukshëm për edukimin politik, ideologjik dhe për perfeksionimin e tyre teknik. Organizatat e Partisë duhet të mos harrojnë pastaj edhe punën e vështirë të këtyre njerëzve.

Duke e parë problemin e pyjeve në tërësi, ne duhet të gjykojmë se detyrat e Partisë për të janë të mëdha, se problemi është i gjerë, i përhapur në sipërfaqe të mëdha dhe i vështirë për t'u kontrolluar. Vetëm masat e gjera të popullit, të organizuara, të drejtuara dhe të edukuara nga Partia si dhe nga organet e pushtetit, mund dhe duhet ta zgjidhin drejt dhe shpejt këtë detyrë të rëndësishme.

Partia duhet të ngrejë në këmbë popullin në kooperativat bujqësore, të cilat duhet të hartojnë plane pyllëzimesh, si ato që kanë pyllin afër, ashtu edhe ato që nuk e kanë, dhe këto plane që do të hartojnë, t'i zbatojnë, domethënë të krijojnë fidanishte (jo fidanishte si shami xhepi), ku të mbjellin fidanë, t'i ruajnë këto nga

dëmtuesit dhe t'u bëjnë të gjitha shërbimet e duhura.

Ne duhet t'i shtojmë pyjet me drurë të përshtatshëm për tokën dhe klimën tonë, por edhe për industrinë tonë, sepse as industria, as kërkesat e popullit nuk do të qëndrojnë në vend, qoftë nga sasia, qoftë edhe nga cilësia. Në këtë drejtim më duket se nuk po shkojmë me kritere shumë shkencore. Po u vëmë rëndësi disa lloj drurëve që ekzistojnë në vendin tonë, lloje natyrisht të mirë, të vlefshëm, të cilët edhe po i shtojmë, por kjo nuk do të thotë të heqim dorë nga varietete të tjera të reja, të cilat nuk gjenden në vend dhe që, për t'i pasur, na duhet të importojmë farëra nga jashtë. Duhet të ketë varietete drunjsh të bukur, të fortë, që vijnë shpejt, ose me vonesë, por që kur të rriten, mund të kenë një fuqi mbirëse natyrore shumë më të madhe nga llojet që kemi sot në vend, fara e të cilave edhe mund të jetë degjeneruar. Kjo anë e këtij problemi, sipas mendimit tim, ka një rëndësi të madhe industriale, ekonomike, financiare dhe shkencore, por që nuk po i vihet rëndësi. Ne duhet të punojmë seriozisht për të hedhur baza të mira dhe shkencore për të ardhmen e pyjeve, sepse tash vetëm konsumojmë ato që kemi gjetur dhe ashtu si i kemi gjetur nga gjyshërit e stërgjyshërit tanë. Prandaj puna e Partisë sonë duhet të bëhet shumë e frytshme dhe e kualifikuar edhe në këtë çështje.

5. — Kur flasim për pyjet, ne duhet të mendojmë edhe për kafshët e pyllit. Pyll pa kafshë dhe pa zogj nuk ka dhe s'duhet të ketë. Për ne ky problem është, si të thuash, «vrima e fundit e kavallit». Mendojmë vetëm për t'i gjuajtur këto kafshë. Çdo njeriu, gjahtar ose

jo, me pushkë ose pa pushkë, kur i del ndonjë lepur o ndonjë mëllenjë në rrugë, po pati çiften me vete e qëllon dhe po nuk pati armë, shprehja e tij e parë është «Ah, kur nuk kam çiften ta vras!».

Njerëzit që merren me pyjet, janë kthyer në «gjahtarë të talentuar» për të vrrarë sa më shumë dhe pa kontroll, si në mall të huaj, janë kthyer po ashtu në kuzhinierë «me shije të holla» për të gatuar dhe shijuar mishin e gjahut. Në gazetën «Përpara» të Korçës të javës së fundit lexova diçka të rëndë për agronomin e Zvarishtit që, si duket, ka harruar fare detyrën e tij dhe ushtron vetëm profesionin e gjahtarit e bën ahengje gjahu me «shokë» si ai. Këto janë skandaloze, shokë.

Kështu siç po ecim, ne do t'i shfarosim kafshët dhe zogjtë e pyjeve tona të cilët duhet t'i konsiderojmë si banorët e tyre. Ne kemi nxjerrë dhe vazhdimisht po nxjerrim rregullore gjahu, por kurdoherë dëgjojmë zëra alarmi se po na zhduken kafshët e pyjeve.

Duhet të kuptohet se kafshët dhe zogjtë e pyjeve nuk duhet të rriten dhe të shumëzohen vetëm për t'i zhdukur. Këto janë pronë e gjithë popullit dhe e shtetit, kurse tash, në fakt, janë objekt i gjahtarëve. Kjo të marrë fund, mendoj unë. Po si do të marrë fund? Duhet të ndryshojë krejt mentaliteti ekzistues për kafshët e pyllit. Kjo lyp një propagandë të madhe politike me të gjitha format dhe metodat që deri tash as që ekzistojnë fare. Të punohet që në popull të ngjallet dashuria për kafshët e pyllit. Të dalin njëkohësisht ligje të rrepta dhe të reduktohen në minimum çiftet dhe municioni i tyre dhe ata që do të mbajnë çifte, të vrasin aq sa u lejojnë rregulloret, ato kafshë dhe në ato vende të

caktuara që u lejon rregullorja. Pastaj të krijojmë kudo rezerva të mëdha. Me këtë duhet kuptuar që të caktojmë pyje të tëra ku të ndalohet gjuetia dhe ata që do të kenë çifte e leje gjuetie ta kenë të qartë se do të lejohen aq dhe atje ku lejohet, duke u kontrolluar. Vetëm kështu ne do t'i popullojmë pyjet me banorët e tyre natyrorë.

Kafshët e zogjtë e pyllit nuk formojnë vetëm një të ardhur të mirë për shtetin, por ata përbëjnë edhe një hijeshi për pyllin dhe i japin atij një ndihmë direkte. Masave për ruajtjen e kafshëve të pyllit duhet t'u shtohet edhe kujdesi i veçantë për shtimin e llojeve të reja të tyre që sot janë zhdukur në vendin tonë, ose që nuk kanë ekzistuar, por që mund të rriten fare mirë edhe te ne. Gjithashtu, duhet të kujdesemi në mënyrë të veçantë për ushqimin e tyre, sidomos në stinën e dimrit për disa lloj kafshësh që e kanë vështirë të rrojnë. Por për ushqimin e këtyre kafshëve as nuk mendohet fare. «Le të lindë, le të ushqehet dhe le të ngordhë si të dojë», i tillë është mentaliteti që ekziston sot për këtë pasuri të madhe të popullit tonë, për këtë hijeshi të madhe të natyrës së begatshme të atdheut tonë socialist.

Prandaj unë mendoj se duhet të marrim masa më serioze edhe për këtë problem që është i lidhur ngushtë me pyjet.

6. — Mekanizimi i punëve në pyje është një problem krejt i lënë pas dore. Këtu nuk e kam çështjen te mekanizimi i industrisë së drurit, domethënë për sektorin e shfrytëzimit që i përket Ministrisë së Industrisë dhe të Minerave, por për anën bujqësore të pyjeve.



Dhe në qoftë se na shkon ndonjëherë nëpër mend se duhet të bëjmë diçka në këtë drejtim, ky mendim fshihet përnjëherë dhe nuk konkretizohet sepse, e para, konfondohet me mekanizimin e industrisë së drurit që e ka bazën në pyll dhe nuk tregohet asnjë interesim në drejtimin që ngre unë, dhe, e dyta, kjo çështje errësohet nga ajo se pyjet janë të shtrirë në hapësira të gjera dhe në vende malore, kështu që gjejmë menjëherë arsyen më të lehtë «atje nuk shkon mekanika». Unë nuk jam specialist i pyjeve, nuk i njoh këto probleme, por, po të pyeten specialistët, do të na thonë se mekanizimi edhe në këtë sektor është i domosdoshëm, pyjet pa mekanizim nuk ecin dhe, pavarësisht se janë në male, mekanizma të përshtatshëm ka edhe për to.

Këto duhet t'i studiojmë, t'i kërkojmë dhe t'i gjejmë. Çështja është të interesohemi më parë, pastaj do t'i sjellim a do t'i bëjmë në vend, sa dhe kur, ky është një problem që duhet ta diskutojmë dhe pastaj të vendosim. Unë e kam fjalën te disa shërbime të thjeshta bazë të pyjeve.

Të marrim çështjen e fidanëve dhe mbjelljen e tyre. Për këtë qëllim duhen hapur me miliona e me miliona gropa. A mund të bëhen të gjitha këto vetëm me krahë? A mund të jetë ekonomike kjo mënyrë të punuari? Jo! Duhet, pra, mekanizim për hapjen e gropave. Po ka vallë mjete të tilla për këtë qëllim? Unë mendoj se ka. Atëherë ta shikojmë edhe këtë problem, se do të shpejtojmë procesin, do të pyllëzojmë hapësira të mëdha, punë kjo që do të jetë më ekonomike.

Të marrim, gjithashtu, mbjelljen e drurëve me farë, që edhe këtë lypset ta aktivizojmë. Do të na duhet

ta gërvishim atë të shkretë tokë në mal. Por me se? Me traktorët që kemi? Jo! Kjo nuk është e mundur. Unë mendoj se duhet të ketë për këtë qëllim traktorë ose makina speciale të përgatitura për vende shumë të thyera.

Por këto pyje që kemi, që përmirësojmë, që mbjellim të rinj, nuk preken vallë nga sëmundjet e ndryshme etj.? Pra nuk lind nevoja që këto të mbrohen, të spërkatën, të shërohen? Po të marrim seriozisht vetëm spërkatjen e tyre në një shkallë të gjerë, atëherë del vetvetiu nevoja që kjo punë duhet mekanizuar. Vetëm pompa të thjeshta po të mendojmë, sa do të na duhen për këtë punë, kurse unë mendoj se do të duhen edhe mjete të tjera, bile do të vijë koha që do të na duhet të përdorim dhe avionë e helikopterë për shumë nga këto shërbime.

Prandaj, problemin e pyjeve Ministria e Bujqësisë duhet ta shohë në të gjithë kompleksin e madh të tij, jo vetëm në ato që thashë më lart, por edhe në funksione më shkencore, me përmirësimin e tokave, ujërave, klimës e florës pyjore, probleme këto shumë të rëndësishme, jo të thjeshta, të rastit ose që gjejnë zgjidhje spontane. Këto zhvillohen sipas disa cikleve e ligjeve natyrore dhe të praktikës që duhen ditur e plotësuar me studime teorike e praktike, për zbatimin e të cilave të merren masat e duhura.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha.  
«Raporte e fjalime 1969-  
-1970», f. 10*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverballi i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## PËR LUFTËN KUNDËR ZAKONEVE PRAPANIKE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

31 janar 1969

Siç del nga raportet e shokëve të Kukësit, të Lezhës dhe të Gramshit, shumë përparime janë bërë në këtë fushë të rëndësishme të problemeve shoqërore. Në përgjithësi vija e Partisë zbatohet me sukses, kuptohet dhe aprovohet. Kjo nuk do të thotë se nuk haset akoma në shumë vështirësi, keqkuptime, rezistencë dhe shtrembërime, të cilat në mjaft raste vijnë nga padituria, nga mungesa e një pune të gjallë, të thelluar e të vazhdueshme politiko-ideologjike. Kështu, puna e pamjaf-tueshme edukative nuk ia ka arritur dot të sqarojë dhe të spastrojë normat e vjetra të zbatuara për një kohë të gjatë në fushën e problemeve shoqërore, në marrëdhëniet në shoqëri të atyre normave që ne i quajmë zakone ose ligje të pashkruara, por që shumë prej të

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua për vënien në jetë të de-tyrave të Kongresit të 5-të të PPSH për luftën kundër zakoneve prapanike dhe besimeve fetare.

cilave janë në fakt refleks edhe i ligjeve feudalo-borgjeze të shkruara.

Pikërisht këto ligje të një shoqërie materialisht të perënduar te ne shprehin botëkuptimin feudalo-borgjez mbi shoqërinë dhe marrëdhëniet shoqërore në prodhim të asaj kohe, ato janë shprehjet politiko-ideologjike dhe etike të superstrukturës së asaj periudhe të shoqërisë dhe të atij sistemi shoqëror që Partia i përmbysi me luftën e saj klasore.

Ne shohim (dhe do të jetë një gabim i madh të mos shohim realitetin me sy) se ekzistojnë akoma dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë mbeturina të këtyre botëkuptimeve idealiste, zakonet e këqija të periudhës feudo-borgjeze. Natyrisht, nga puna e palodhur, e zgjuar dhe bindëse e Partisë, këto mbeturina do të vijnë vazhdimisht duke u dobësuar, ato do të humbasin mprehtësinë e tyre, disa do të zhduken më parë, disa të tjera më vonë dhe do të zëvendësohen kështu, rrjedhimisht, me ligjet, zakonet, botëkuptimet, format e metodat e zbatimit në jetë, në praktikë, të shoqërisë sonë të re socialiste, të marrëdhënieve të reja në prodhim. Ky është një proces i gjatë e i vazhdueshëm që do të mbarojë vetëm në shoqërinë komuniste pa klasa, kur në botëkuptimet filozofike të njerëzve do të sundojnë plotësisht botëkuptimet shkencore materialiste. Gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të socializmit do të zhvillohet procesi që çon drejt zhdukjes së botëkuptimeve idealiste dhe mbeturinave të çdollojta në çdo fushë të veprimtarisë njerëzore, njëkohësisht, tok me ndryshimet dhe me perfeksionimin materialist të shoqërisë sonë, do të

afirmohen e do të perfeksionohen edhe normat e superstrukturës sonë marksiste-leniniste.

Duke ditur se ndryshimet materiale të shoqërisë sonë bëhen më shpejt se transformimet ideopolitike në ndërgjegjen e njerëzve, duke llogaritur gjithashtu sa përpjekje, sa mund e sa djersë, sa luftë e madhe u duhen popullit dhe Partisë për t'i realizuar këto ndryshime materiale, kuptohet sa të mëdha e të thella duhet të jenë përpjekjet dhe lufta e Partisë për ngritjen e ndërgjegjes komuniste të popullit.

Prandaj lufta në këtë drejtim kurrë nuk duhet t'i lihet spontaneitetit, lufta dhe zjarri i saj nuk duhet lënë asnjëherë të shuhet ose të mbulohet me hi, sepse kjo do të çonte në këtë rast në vetëkënaqësi, në punë të përciptë e të paorganizuar, në tërheqje përpara rezistencës të së vjetrës që mundohet të mos vdesë, në qëndrime oportuniste ndaj së vjetrës kryeneçe që maskohet gjoja me «politikë» për të mos acaruar gjendjen me bartësit e këtyre mbeturinave se janë njerëzit tanë etj., etj.

Siç e tregon realiteti e siç e theksova edhe më lart, Partia ka korrur suksese të mëdha në edukimin ideologjik e politik të masave të gjera të popullit me normat dhe me etikën marksiste-leniniste. Të dukshme janë këto suksese në të rinjtë dhe në të rejat, të dukshme janë këto suksese në përgjithësi edhe në moshat mesatare, por në këto ekzistojnë akoma mbeturina të botëkuptimeve të kaluara që shfaqen e ushtrojnë presion, pra pengojnë, ku më shumë e ku më pak, ku hapur, ku në mënyrë të maskuar, ose këta njerëz bëjnë përpjekje që botëkuptimet e vjetra t'ua adaptojnë në mënyrë

eklektike botëkuptimeve të reja materialiste. Kurse brezi i vjetër është, natyrisht, më i prekur, ky i reziston më shumë së resë, disa herë e pranon këtë pa bindje dhe pa një shpjegim racional.

Propaganda e Partisë duhet të ketë parasysh zhvillime të tilla jouniforme, ajo duhet të ketë, gjithashtu, parasysh se këto shtresa nuk ndahen me mure nga njëra-tjetra, por janë të pleksura në një të tërë e të pandarë që formon shoqërinë tonë me lidhjet e saj të shumta ekonomike, shpirtërore, familjare, gjinie etj., etj.

Ndikimet, si pozitivet ashtu edhe negativet, janë reciproke. Na vihet, pra, si detyrë të punojmë që pozitivet të sundojnë dhe të zhdukim negativet, na vihet si detyrë që të shtyjmë në pararojë të luftës bartësit e fenomeneve pozitive dhe si në çdo luftë t'u mësojmë atyre strategjinë dhe taktikën që duhet të përdorin dhe të veprojmë si në kohë lufte që të ngremë lart moralin dhe t'i futim të gjithë në betejat kundër armikut të përbashkët. Në këtë mënyrë, të gjitha masat ne duhet t'i futim në një luftë të madhe ideologjiko-politike kundër armiqve kryesorë të ideologjisë dhe të politikës sonë.

Mund të themi se Partia i ka ngritur në këtë luftë të madhe të gjitha masat e popullit, të gjithë marrin pjesë në të, asnjë, që nga pionieri e fatosi i vogël e deri te plaku më i motshëm, nuk ka mbetur pa u përfshirë. Pikërisht për këtë arsye ky revolucion quhet me tërë kuptimin e fjalës popullor. Ai quhet revolucion se përmbys të vjetrën dhe vendos të renë. Si për çdo revolucion të vërtetë, edhe për këtë, Partia jonë ka përcaktuar qartë strategjinë e qëllimet e tij. Këto, gjatë luftës,

absolutisht duhet t'i kesh të qarta, që të mos hutohesh, t'i kesh si udhërrëfyese për taktikat që do të përdorësh, të cilat janë të shumta, jo të njëjlojta dhe të ngjashme për çdo kohë, për çdo vend e për çdo problem. Uniformiteti, shabllonizmi në taktikat, jashtë parimeve bazë dhe pa pasur parasysh strategjinë, jashtë realitetit objektiv, tëndit, të armikut, të kohës, të vendit e të mjaft të dhënave të tjera materiale dhe morale që duhet të kihen kurdoherë parasysh, nuk japin rezultat e dëshiruara.

Pra, që të kemi sukses në luftën tonë kundër zakoneve të këqija, kundër botëkuptimeve të vjetra idealiste në ndërgjegjen e njerëzve, çdo njeri e të gjithë ne duhet ta kemi të qartë, në radhë të parë, strategjinë e Partisë për këto çështje, që të mund të ndërtojmë taktika të ndryshme dhe të përshtatshme për të fituar beteja dhe luftën.

Të marrim gështjen e luftës kundër fesë. Partia e ka të qartë e të përcaktuar mirë luftën kundër fesë, ajo ka të qartë thelbin dhe qëllimet e saj idealiste, reaksionare dhe armiqësore. Ajo ka caktuar strategjinë e luftës kundër fesë dhe taktikat që ka përdorur dhe përdor në këtë luftë. Por a mund të themi se të gjithë komunistët dhe masat e popullit i kanë të qarta si duhet këto gjëra? Derisa ka komunistë të cilët nuk luftojnë si duhet, janë konservatorë, ruajnë dhe praktikojnë disa zakone fetare, goftë edhe të fshehura në ndërgjegjen e tyre, derisa në masat e popullit ka njerëz që besojnë në fenë dhe vazhdojnë të praktikojnë, goftë edhe në mënyrë jo të mprehtë, por të heshtur, ritet fetare. atëherë ne duhet të mendojmë se jo të gjithë i kanë të

qarla ato që thashë më sipër. Na vihet, pra, detyrë të analizojmë arsyet, shkaqet, dobësitë e punës sonë dhe t'i korrigjojmë. Në këto çështje nuk mjafton vetëm të konstatojmë, por, duke u bazuar në analiza, të veprojmë dhe të përdorim metoda të reja pune, domethënë taktika të reja lufte që të na japin rezultate.

Edhe nga raportet del një optimizëm jo i peshuar. Likuidimi i kishave dhe i xhamive vërtet është një sukses dhe ka ndihmuar në luftën kundër fesë dhe ndërhyrjes së saj shpirtërisht dhe materialisht në fenomenet shoqërore, mirëpo kjo të mos na bëjë të harrojmë se lufta më e madhe kundër fesë duhet bërë në ndërgjegjen, në botëkuptimet e njerëzve. Dhe zhdukja vetëm e ndërtesës së kishës nuk zhduk njëkohësisht edhe besimin idealist nga ndërgjegjja e njerëzve. Fakt është se kishat dhe xhamitë materialisht u zhdukën shpejt. Po vallë, a është zhdukur tok me to dhe në një kohë të shkurtër besimi nga ndërgjegjja e njerëzve? Sigurisht jo. Duke e gzykuar atëherë këtë vështirësi, a kanë organizuar Partia dhe organizatat e masave një luftë politike dhe ideologjike të koordinuar mirë kundër fesë? Jo, kjo lë shumë për të dëshiruar.

E kam theksuar edhe herë të tjera se duhet atakuar dogma, duhet demaskuar filozofia e saj idealiste, duhen shkatërruar metoda e interpretimit të kësaj filozofie dhe interpretimet vetë në praktikën e jetës që përbëjnë një mori gjërash të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme.

Disa u vënë pak rëndësi një sërë zakonesh që kanë një kuptim fetar. Ka ndonjë plak që në heshtje vazhdon të marrë, siç i thonë, avdes. Ç'të keqe ka këtu, tho-



në disa egzegjetë<sup>1</sup>, ai lahet, mbahet pastër. Në fakt ai vërtet lahet, por kjo nuk është si çdo larje, por veprim që bën pjesë në një rit fetar. Në këtë çështje rëndësi ka që ne të shohim se, kur ky njeri e zbaton këtë rit fetar, ai mendon dhe e shikon zhvillimin e botës nën prizmin e «plotfuqishmërisë» së zotit, të një fuqie mbinjerëzore, së cilës duhet t'i bindemi.

Nuk duhen nënvleftësuar, pra, kuptimi i vërtetë dhe lidhjet e njerëzve me fenë dhe me botëkuptimet e saj filozofike, praktikat e jetës nuk duhen nënvleftësuar, duke thënë se këto mbeturina nuk influencojnë në qëndrimet patriotike të bartësve të tyre. Këtu nuk është çështja për t'u alarmuar, por këtë shembull e solla për t'u thelluar në atë që këto mbeturina, qoftë edhe disa herë të parrezikshme, përmbajnë helmin e rrezikshmërisë fetare.

Në një nga raportet që na paraqesin shokët, më ra në sy një diçka «e vogël», si e parëndësishme, por, po të ndalemi e ta analizojmë, ka rëndësi filozofike. Në kohët e para nusja merrej me duvak, tash ky është hequr dhe nuses i hidhet vetëm një shami në kokë. Ç'rëndësi ka një gjë e tillë, ç'ndikim e ç'rol negativ mund të luajë në gjithë këtë zhvillim të vrullshëm revolucionar një mbeturinë e tillë e një zakoni të kaluar dhe që për më shumë ata që e praktikojnë janë njerëz të popullit, kooperativistë, bile ka ndërmjet tyre edhe komunistë, që nuk besojnë, që janë kundër skllavërimit të gruas, që luftojnë për të drejtat e saj etj.? Mirëpo, po t'i shkohet thellë kësaj praktike që duket kaq e

---

1 Interpret i riteve fetare.

thjeshtë, por që ka kaluar nga shumë faza, që nga mbyllja e gruas në harem me të drejtat e një skllaveje të thjeshtë, deri te marrja e nuses së mbuluar me çarçaf, me çatore si në shkretëtirat e Arabisë, më pas me vello të bardhë dhe tash me një shami të thjeshtë në kokë, do të arrijmë në atë që kjo është një praktikë e skllavërimit të gruas nga burri, pra mbeturinë e një filozofie idealiste, reaksionare, një praktikë fetare që e shprehte në jetë dhe e mbronte këtë filozofi.

Problemi shtrohet kështu: A e kupton rrezikshmërinë dhe thelbin reaksionar të këtij botëkuptimi fetar, të shprehur në këtë praktikë të thjeshtë, ai që e praktikon? A i shpjegohet atij filozofikisht prejardhja e saj apo nuk e kupton? Sidoqoftë ne duhet të konkludojmë se ai nuk e kupton dhe këtu nuk është çështja e një cope shamie mbi kokën e një vajze, por është mbeturina e një filozofie të tërë reaksionare fetare që mbyste lirinë dhe personalitetin e gruas, mbeturinë që qëndron e struktur në ndërgjegjen e njerëzve. Po të ishte vetëm kjo mbeturinë, nuk prishte edhe aq punë, por ka edhe mjaft të tjera që, në rast se nuk shpjegohen, nuk luftohen dhe nuk spastrohen nga rrënjët, ato mblihen në një lëmsh që të qepet si ferra dhe nuk të lë të ecësh përpara, se të çjerr e të gjakos.

Të marrim çështjen e familjes patriarkale, sidomos në zonat e thella. Raporti i Kukësit na jep shifra që tregojnë se kooperativizmi, dhe në përgjithësi e gjithë vija e Partisë, e kanë likuiduar shumicën e kësaj familjeje. Kjo është një gjë e mirë, një anë pozitive. Por problemi më i madh nuk qëndron në atë që familja të përbëhet në pak veta, që nën një çati të mos rrojnë së

toku shumë kurorë. Problemi qëndron në botëkuptimet e familjes patriarkale me ligjet dhe zakonet e saj, se mund të shpëtosh nga kuptimi i thjeshtë «i sundimit të plakut», por familja, qoftë edhe pa shumë kurorë, mund të hyjë dhe hyn përsëri nën sundimin e një plaku, këtë herë në moshë të re, por me pikëpamjet e vjetra të plakut të qëmotshëm.

Sigurisht, ndarja e kurorëve në familjet tona është një proces zhvillimi, një proces i drejtë, përparimtar, që ndihmon në shpartallimin e pikëpamjeve patriarkale të familjes. Por ne nuk duhet ta flemë mendjen se, me ndarjen fizike të familjes, ia arritëm zhdukjes së plotë të botëkuptimeve të saj të vjetra. Na duhet një punë e palodhur, e organizuar dhe sistematike, politike dhe ideologjike, për spastrimin e mbeturinave të vjetra. E gjithë jeta e re që po ndërtojmë, kriteret e reja të saj dhe filozofia marksiste-leniniste që e frymëzon dhe e udhëheq, janë mjetet dhe metodat e sprovuara për arritjen e rezultateve të mira. Kolektivizimi, lufta dhe jeta kulturore e përbashkët, shkolla, edukimi etj., shërbejnë mirë e si duhet në rast se dihet të organizohet dhe të lidhet mirë puna fizike me punën mendore, veprimi praktik me sqarimin ideopolitik.

Ne duhet të na bëjë të mendojmë thellë përse ndodh, siç thuhet në raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Kukësit, që 300 kuadro të lartë që ka rrethi, dhe veçanërisht ata që punojnë në fshat, nuk shpëputen nga mentalitetet e edukatës së familjes patriarkale. Ne duhet të gjejmë arsyet dhe shkaqet që e shkaktojnë këtë gjë. Nuk mundet dhe as nuk është e rekomandueshme që, për arsye se puna edukative ideopolitike në

rrethin e Kukësit ka dobësi të theksuara, të vendosim një ligj të ri për martesat, siç na propozojnë drejtuesit e këtij rrethi, ose rregulla e ligje të tjera të veçanta për ndjekjen e shkollës tetëvjeçare nga vajzat, mbasi prindërit e tyre i fejojnë. Jo! Kështu nuk mund të zgjidhen këto probleme shoqërore, por duhen vënë në baza të drejta zgjidhjeje ekonomike, politike dhe ideologjike, se kur njëra prej këtyre çalon, rezultati del i pakënaqshëm.

Na raportohet me entuziazëm se u prishën fejesat e vajzave të mitura, dhe s'ka dyshim që shumë prej tyre në fakt u prishën dhe ky është një sukses, por në një nga rrethet që na raportojnë na del se, kur vjen puna që vajzat të ndjekin shkollën tetëvjeçare, gati të gjitha na dalin të fejuara që në moshë të vogël nga prindërit e tyre, të cilët, për të qenë në rregull me vijën e Partisë, kanë bërë deklarata fiktive, kurse në heshtje kanë vazhduar punën e tyre të vjetër. Përse? Sepse nuk është vazhduar puna për edukimin e tyre politiko-ideologjik, është marrë kjo çështje shumë përciptas, si një problem i shkëputur, lehtësisht i zgjidhshëm dhe jo si një anë e një problemi të madh shoqëror, ekonomik, ideologjik dhe politik.

Qahemi se ka thashetheme të dëmshme e të rrezikshme dhe kërkojmë t'i zgjidhim këto një nga një e disa herë me masa administrative. Zgjidhje të tilla nuk duhen lënë mënjanë, por vetëm me këto nuk mund t'i zhdukim. Ne duhet të arrijmë në konkluzionin e drejtë se atje ku ka thashetheme, nuk ka punë edukative, politike dhe ideologjike të organizuar dhe të shëndoshë. Thashethemet lulëzojnë atje ku mbretërojnë mbeturinat

mikroborgjeze, ato janë produkt i këtij mentaliteti mikroborgjez, i kësaj mënyre jetese, i këtij ambienti. Shumë njerëz, e ndër këta edhe komunistë e njerëz të ndershëm, e dinë, e kuptojnë të keqen e këtyre gjërave, por prapëseprapë bien në gabime, i praktikojnë ato edhe vetë.

Si përfundim, unë mendoj se Partia, në të tri rrethet që kemi sot në studim, ka punuar mirë për këto probleme shoqërore të rëndësishme, pavarësisht nga të metat dhe dobësitë në punë. Përnjëherë dhe si do Partia, të jemi realistë, nuk zgjidhen këto probleme. Ky është një proces i tërë dhe i gjatë. Fakt është se vija e Partisë për zgjidhjen e këtyre problemeve është e drejtë dhe janë arritur rezultate shumë të mira. Çështja qëndron që, duke u mbështetur në këtë vijë dhe në këto rezultate, të ecim përpara, të plotësojmë si duhet boshllëqet dhe të metat e punës sonë.

Meqë këto janë probleme të përhershme dhe shumë të rëndësishme, do të propozoja që sivjet, duke marrë parasysh edhe mobilizimin e madh për 25-vjetorin e Çlirimit, komitetet e Partisë të rretheve, pasi ta kenë përcaktuar vetë kohën se kur, të bëjnë një analizë të shëndoshë kritike si kanë punuar për këto probleme, në ç'stad zhvillimi ndodhen këto dhe si duhet ta organizojmë punën paskëtaj dhe ta lidhim zgjidhjen e tyre me të gjitha problemet e vitit dhe të 25-vjetorit të Çlirimit.

Ky rishikim i punës të udhëhiqet nga Partia, por konkretisht të bëhet nga organizatat e bashkimeve profesionale, të Frontit, të rinisë dhe të gruas. Unë propozoj që të përdoret një metodë pune më e gjallë dhe jo stereotipe. Të heqim dorë nga raportet e shkruara në-

për zyra nga përgjegjësit e këtyre organizatave dhe e nxjerrjes së konkluzioneve të vjetruara dhe të gjitha këto të servirura në një mbledhje të përgjithshme ku njerëzit vijnë me duar në xhepa dhe me kokë jo shumë «të vrarë» dhe të preokupuar nga problemi.

Unë propozoj se do të jetë e mjaftueshme të jepet orientimi për çështjen, të lihet kohë që gjithsecili të reflektojë dhe pastaj të diskutohet pa raporte stereotipe, lirisht, të ndizen diskutimet, nga të cilat të dalin vendime dhe të merren masat që do të duken më të arsyeshme. Çdo organizatë masash të nxjerrë konkluzionet, por jo konkluzione të paracaktuara që më parë, por konkluzionet që do të nxjerrë diskutimi i zjarrtë. Pasi të bëhet kjo nga çdo organizatë, komiteti i Partisë të thërresë në një mbledhje të përbashkët në qendrën e rrethit drejtues dhe aktivistë të këtyre organizatave dhe së bashku të diskutojnë rezultatet e diskutimeve, të shtrojnë problemet si janë dhe si duhet të jenë, të bëjnë kritika dhe propozime dhe të merren vendime të reja për veprim.

Një punë e tillë mendoj se do të jetë e frytshme dhe do ta ndihmojë punën e Partisë dhe të organizatave të masave.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha.  
«Raporte e fjalime 1969-  
-1970», f. 24*

*Botohet sipas tekstit të librit:  
Enver Hoxha. «Raporte e fja-  
lime 1969-1970», f. 24*

## ZBËRTHIMI I DIREKTIVAVE TË PARTISË S'ËSHTE DETYRË VETËM E PROPAGANDËS

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

10 shkurt 1969

Për mbledhje të këtij karakteri si aktivi për revolucionin tekniko-shkencor, por sidomos për propagandën tonë, kam një vërejtje të përgjithshme. Propaganda ka për detyrë t'u japë rëndësinë e duhur punimeve të plenumeve të Komitetit Qendror, të cilat kanë një rëndësi shumë të madhe, pse në to pasqyrohen në mënyrë të përqendruar jeta e Partisë dhe mendimi kolektiv i udhëheqjes.

Kam biseduar edhe një herë tjetër me shokun Ramiz [Alia] për këtë çështje dhe këtë që do të them nuk e kam për punë modestie. Propaganda jonë nuk duhet të kufizohet duke u bërë jehonë vetëm fjalimeve

---

1 Në këtë mbledhje, që u bë me kërkesën e shokut Enver Hoxha, u diskutua rreth disa vërejtjeve për propagandën në lidhje me punimet e plenumeve të Komitetit Qendror të PPSH, si dhe për detyrat e anëtarëve të Byrosë Politike për zbërthimin e tezave të raporteve të këtyre plenumeve dhe të materialeve të tjera të udhëheqjes së Partisë.

e raporteve të mia, por, edhe kur mban një raport në emër të udhëheqjes së Partisë ndonjë shok tjetër duhet të ndodhë e njëjta gjë. Punonjësve të propagandës t'u thuhet në mënyrë të veçantë për të folur për këto raporte që mbajnë shokët, pse ato janë, gjithashtu, fryt i mendimit kolegjal dhe i eksperiencës së udhëheqjes së Partisë, e cila, pasi diskuton e vendos, ngarkon njërin nga anëtarët e saj të mbajë raportin.

Në shtypin tonë duhet të reflektohen mirë sidomos punimet e Plenumit të Komitetit Qendror, tezat që përmban raporti, sepse edhe në këto raste konstatohet se, kur nuk e mbaj unë raportin, flitet vetëm me fjalë të përgjithshme. Kjo nuk është e drejtë, puna e propagandës sonë nuk duhet të kufizohet me kaq. Të kemi kurdoherë parasysh që në shtyp të flitet, në radhë të parë, për raportin e udhëheqjes. Me këtë s'dua të them se nuk duhet folur për një fjalim që kam mbajtur unë në këtë ose atë plenum, pse edhe ai është mbajtur me porosi të udhëheqjes së Partisë, por, në radhë të parë, të flitet për raportin e plenumit, pse atje caktohen vijat kryesore të rrugës që duhet të ndjekë Partia në këtë ose atë fushë të veprimtarisë, pastaj të flitet për fjalimin që, në fund të diskutimeve, kam mbajtur unë. Në raste të tilla, propaganda jonë të vërë në dukje që, në vijën e raportit të Byrosë Politike, foli për disa probleme të veçanta edhe shoku Enver Hoxha.

Disa kohë më parë bëmë Plenumin e Komitetit Qendror për problemet e planit<sup>1</sup>, por konstatoj se në shtyp nuk flitet sa e si duhet për sa u ngritën atje, me-

---

1 Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH, që zhvilloi



gjithëse çështjet që u shtruan janë nga më kryesoret për Partinë.

Qëndrimin komunist ndaj punës të brigadierit Alo Qose mendoj se vepruam mirë që e bëmë shembull, veçse propaganda për këto raste duhet të bëjë kujdes, se, më duket, po kalohet në teprime, deri edhe në njëfarë gare. Kuadro, që gjer tani bënin nga 80 ditë-punë në vit, nën presionin e gjithë kësaj propagande, kanë marrë zotime të bëjnë nga 360 ditë-punë, çështje kjo që duhet parë, se mund të na dëmtojë, në vend që të na bëjë mirë.

Në punën e saj, propaganda, të kuptohemi drejt, nuk është çështja të kufizohet, bie fjala, duke marrë diçka si spunto nga raporti i plenumit sa për të thënë «Siç u tha edhe në plenumin e fundit. . .», po, për problemet e trajtuara në atë plenum, të bëhet një punë e menduar dhe e organizuar mirë, të ndërtohen për këto qëllime tema të veçanta që t'u përgjigjen tezave të raportit të atij plenumi. Në mos gabohem, nuk është kuptuar mirë kjo çështje dhe këtë e vërteton fakti që, probleme me kaq rëndësi, siç janë ato që ngrihen në plenumin e fundit për planin, ua lëmë në dorë vetëm gazetarëve e disa kuadrove të bazës, të cilët kanë format e tyre të paraqitjes në shtyp dhe mund të themi se nuk punojnë keq, por ka vend që nga ana jonë kjo punë të përmirësohet më shumë.

---

punimet më 26-27 dhjetor 1968, shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi plotësimin e planit dhe të buxhetit të shtetit për vitin 1968 dhe detyrat e projektplanit e të projektbuxhetit të shtetit për vitin 1969». (Shih: Dokumente kryesore të PPSH, vëll. V, f. 507. Tiranë, 1974.)

E kam fjalën këtu, që në këtë drejtim vetë shokët e udhëheqjes t'i përvishen ca punës. Po në ç'mënyrë? Shokët tanë kryesorë, që merren konkretisht me problemet ekonomike, kur bëhet plenumi i Komitetit Qendror për të tilla probleme, duhet personalisht të mendojnë dhe të punojnë për trajtimin e çështjeve që kanë lidhje me planin dhe të shkruajnë konkretisht e me shembuj, jo në forma gazetareske, jo me shprehjet e përgjithshme të gazetave, sepse ata janë në gjendje të trajtojnë edhe çështje që gazetarët nuk i njohin sa dhe si duhet. Nuk them se gazetarët tanë nuk i shohin drejt politikisht këto probleme, po ata nuk janë në gjendje të trajtojnë gjithçka në prizmin e gjerë dhe me të tëra kompetencat, siç mund t'i trajtojë, bie fjala, shoku Adil Çarçani<sup>1</sup> çështjet e industrisë dhe të minierave, pse ai e di mirë ku na dhemb dhëmballa, gjë që gazetari nuk e njeh si duhet. Prandaj shokët kryesorë të udhëheqjes, të bazuar në raportin e Plenumit, në vendimet e Komitetit Qendror dhe në diskutimet e bëra edhe për shtypin, t'i trajtojnë vetë problemet dhe për këto çështje të mos veprohet si deri tani.

Në shtypin tonë gazetarë e bashkëpunëtorë botojnë shkrime me përmbajtje të mirë teorike, pse tani kemi shokë të ngritur teorikisht, bile jo pak, të cilët nuk shkruajnë pa e studiuar mirë problemin që trajtojnë. Mirëpo shkrimeve të tilla, sado të mira të jenë, nuk u vihet rëndësia e duhur, prandaj zakonisht kalojnë pa gjetur jehonë. Ndërsa, kur mbahet një fjalim, kur jepet një orientim ose bëhet një artikull nga një shok

---

1 Në atë kohë zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.

i Byrosë Politike, është ndryshe, ai bën shumë jehonë, për arsye se Partia është edukuar dhe ndalet shumë në të tilla materiale mjaft të rëndësishme, i vlerëson ato si duhet. Prandaj, duke marrë parasysh këtë nevojë dhe kërkesë të Partisë, ne, shokët kryesorë, të trajtojmë vetë në shtyp çështje që ngrihen në mbledhjet e udhëheqjes, si edhe për probleme që dalin më pas, me të cilat ndeshemi gjatë punës së përditshme operative. Ta shfrytëzojmë, pra, më gjerë shtypin, të ngremë e të nxjerrim detyra, duke treguar edhe rrugët për t'i zgjidhur ato.

Në një dikaster, për shembull, ministri organizon një mbledhje pune me bashkëpunëtorët e tij më të afërt, por problemet që shqyrtohen në këtë mbledhje nuk trajtohen në shtyp nga ana e punonjësve kryesorë të dikasterit, pa lëre nga vetë ministri. Ky, si drejtuesi kryesor, problemet më të mprehta korente që dalin, zgjidhja e të cilave ka një rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e punës, do të bënte mirë t'i përpunonte e t'ia dërgonte gazetës për botim me emrin e tij, në mënyrë që gjithë Partia dhe sidomos ata që kanë të bëjnë me to, të lexojnë me vëmendje ato që ngre drejtuesi i dikasterit dhe detyrat që ai shtron për t'i zgjidhur të merren seriozisht. Mirëpo nuk veprohet kështu, këto çështje u lihen të tjerëve, sidomos punonjësve të shtypit, të cilët mund të shkruajnë mirë, por problemi i trajtuar prej tyre nuk e tërheq në atë shkallë vëmendjen siç mund ta tërheqë kur trajtohet nga një anëtar i Byrosë Politike ose i Komitetit Qendror.

Aktualisht kemi kuadro të kualifikuar, të cilët orientimet e udhëheqjes së Partisë mund t'i thellojnë

nga ana teorike dhe teknike, por është krejt ndryshe çështja kur këto orientime i trajton shoku Ramiz ose shoku Hysni, në këto raste, është e kuptueshme, anëtar i Partisë i lexon ato më me vëmendje. Prandaj unë mendoj që ato të zbërthehen, në radhë të parë, nga shokët kryesorë.

Për t'i dhënë problemit shpjegime më të detajuara e teorikisht më të thella, mund të ngarkohen më pas specialistët tanë t'i trajtojnë ato më tej. Në këtë rast lexuesi do ta lexojë më me kujdes edhe materialin e botuar në emër të specialistit, pse e di se problemi, që trajtohet tani në detaje, është ngritur më parë nga një anëtar i udhëheqjes, pra, është i rëndësishëm.

Për problemin që do të trajtojë specialisti në detaje duhet të bëhet kujdes që deri edhe titulli i materialit t'i përshtatet artikullit ose fjalimit që ka mbajtur për këtë çështje anëtar i kryesor i udhëheqjes, pse kështu ai do të tërheqë më shumë interesimin, vëmendjen dhe kujdesin e lexuesve.

Të gjithë e kemi të qartë se, kur japim një direktivë, komunisti në bazë ka nevojë të sqarohet. Prandaj këto që u thanë mendoj se duhet të futen në praktikën e punës sonë, të koordinuara mirë, që çdo gjë të bëhet në kohë, pse në qoftë se për një problem del një artikull me vonesë, kur ka dalë në shesh një problem tjetër më i madh, ai nuk ka si tërheq vëmendjen e duhur dhe do të mbetet pa jehonë.

Për mënyrën si janë trajtuar problemet në raportin që do të mbajë shoku Xhafer [Spahiu]<sup>1</sup> në akti-

---

1 Në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror të PPSH.

vin kombëtar për revolucionin tekniko-shkencor<sup>1</sup> nuk kam ndonjë vërejtje, vetëm dua të theksoj se çështja ka një rëndësi të madhe për Partinë. Me këtë rast të nënvizojmë rëndësinë e madhe që kanë vendimet e plenumit që u bë për këtë problem<sup>2</sup>, të cilat, mendoj, duhet t'i japin tonin aktiv, në mënyrë që Partia të shohë se këto vendime të Komitetit Qendror kanë rëndësi të posaçme, ndryshe nuk do të kuptohet drejt nga të gjithë rëndësia e problemeve të tilla.

Për sa i përket propagandës, kur të trajtohen probleme që do të ngrihen në aktiv, nga ana e shtypit të mos përdoren shprehje standard, si për shembull: «Siç u tha edhe në raportin e mbajtur nga shoku Xhafer...» etj., por të zërthehet çështja në esencë. Në raportin që do të mbahet në aktiv ngrihen probleme të rëndësishme, të cilat i trajton një nga sekretarët e Komitetit Qendror, prandaj ato duhet të trajtohen dhe të gjejnë zgjidhje. Disa nga këto probleme i përkasin Ministrisë së Industrisë, të tjera asaj të Bujqësisë e kështu me radhë. Rëndësi ka çështja që, pas aktivit, këto probleme të zërthehen nga përgjegjësit kryesorë të secilit sektor

---

1 Ky aktiv u zhvillua në datën 21 dhe 22 shkurt 1969.

2 Plenumi i 3-të i Komitetit Qendror të PPSH që zhvilloi punimet në datën 13 dhe 14 tetor 1967 shqyrtoi raportet e Byrosë Politike të KQ të PPSH: «Mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë për shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese në industrinë mekanike për specializimin dhe kooperimin e mëtejshëm të saj» dhe «Mbi punën e organizatave të Partisë, organizatave të masave dhe organeve shtetërore për shpikjet, racionalizimet dhe kursimet në industri e në ndërtim dhe mbi masat e mëtejshme që duhen marrë për zhvillimin e kësaj lëvizjeje».

e të mos ngjasë që, pasi të thuhet vetëm disa gjëra të përgjithshme nga shtypi, të ecet me rutinën e vjetër. Çështjet që ngrihen në mënyrë të përqendruar në raport, duhen zhvilluar në hollësi, duke mos u kufizuar vetëm në format e zakonshme, siç bëhet nga gazetat «filan punëtor për këtë problem që u ngrit në aktiv ka bërë kështu ose ashtu». Edhe këtë do ta themi, se është e domosdoshme, pse janë masat punonjëse ato që do të punojnë dhe do të zbatojnë direktivat e Partisë në çdo fushë, prandaj ato të vihen medoemos në dukje, por edhe vetë ne shokët e udhëheqjes t'u biem në kokë problemeve, të mos kënaqemi se i trajtojnë vetëm specialistët.

Secili nga ne e ka për detyrë të bashkëpunojë me organet e shtypit. Kryeredaktori i një gazete, natyrisht, nuk bën keq që ua kujton herë pas here përgjegjësve kryesorë këtë punë, por ta lërë veten drejtuesi sa t'i kërkojë redaksia e gazetës një artikull për të trajtuar një problem që ka të bëjë me sektorin që i ka ngarkuar Partia të drejtojë, do të thotë që ai të harrojë detyrën e tij si kuadër partie. Veç kësaj, kur vjen puna sa t'i kërkohet nga organet e shtypit të përgatitë këtë ose atë artikull, do të thotë që ai të bëjë një punë angari dhe sa për të shkuar radhën, kurse kjo është një nga detyrat më të rëndësishme.

Zbërthimi i direktivave të Partisë nuk është detyrë që i takon vetëm propagandës sonë. Mos vallë kryeredaktori i një gazete është kompetent të mësojë ministrin e Industrisë dhe të Minierave ku i dhemb për problemet e sektorit që drejton dhe çfarë duhet të trajtojë ai vetë personalisht? Ministri, kur mbledh kuadrot

kryesorë të dikasterit për të rrahur një problem që ka një rëndësi të madhe dhe sheh se gjatë diskutimeve dalin këto ose ato të meta e dobësi, ngarkon drejtorin përkatës t'i përgatitë për to një material me të dhëna të plota dhe, mbi këtë bazë, përgatit artikullin, në të cilin nxjerr konkluzione dhe detyra që duhen zgjidhur nga të gjithë punonjësit e këtij sektori në qendër e në bazë. Në qoftë se do të shkruajnë vetëm disa ekonomistë gazetarë për këtë problem, së pari, më duket se ata nuk janë në gjendje ta njohin në thellësi çështjen, ashtu siç e njeh përgjegjësi kryesor, sepse gazetarët kryesisht mbajnë lidhje me bazën. Së dyti, nuk kam dëgjuar që Koço Theodhosi<sup>1</sup>, bie fjala, të thërresë ndonjë gazetar, t'ia bëjë të njohur hollësisht një problem që e preokupon dhe ta ngarkojë të përgatitë një artikull.

Çështja si të mësohen kuadrot të punojnë dhe të drejtojnë, shpesh, kuptohet shumë ngushtë, vetëm me ndonjë mbledhje kur shkohet në bazë, kur u thonë ç'kanë për t'u thënë dhe aq. Kjo është e pamjaftueshme, pse një udhëheqës nuk është e mundur të vejë kudo e në çdo kohë në bazë, për më tepër s'mund të thuhet të gjitha çështjet e menjëherë. Prandaj orientimet mund e duhet të jepen edhe me të shkruar. Ne japim herë pas here direktiva, të cilat duhen zëbërthyer dhe u duhen bërë të njohura Partisë dhe masave për zbatim, edhe duke vajtur në bazë, edhe duke bërë bi-

---

1 Në atë kohë ish-ministër i Industrisë së Rëndë e të Minierave, pjesëtar i grupit armiqësor të A. Këllezit; më vonë u përjashtua nga Partia e u dënua për krime kundër shtetit.

седа, por, kur e lyp nevoja, edhe nëpërmjet artikujve dhe konferencave.

Për zbërthimin e problemeve që ngre Partia të përdorim forma të gjalla e të larmishme pune, por të kemi parasysh që sidomos të mos kufizohemi vetëm me mbledhje, sepse, nga këto më duket se po bëhen shumë. Për t'i evituar mbledhjet e tepërta, të mendojmë si të punohet për zbatimin e direktivave. Në qoftë se do të punohet me format e praktikuara gjer tani, vetëm duke dërguar poshtë materiale e duke bërë mbledhje, të kihet parasysh se njerëzit janë të ngarkuar. Atëherë si do të dilet nga kjo gjendje? Partia, punonjësit në bazë kanë shumë nevojë për t'u sqaruar për këto probleme, prandaj duhet menduar më shumë për të gjetur format e metodat se si të asimilohen materialet që dërgojmë.

Ja, shembulli i Alo Qoses u ngrit për një qëllim të caktuar, për t'i shërbyer ngritjes në një shkallë më të lartë të hovit të punës në bujqësi, prandaj drejtuesit e këtij sektori mund dhe duhet ta lidhin atë edhe me çështjet aktuale të realizimit të planeve në lëmin e bujqësisë. Mirëpo në shtypin tonë për këto plane mund të themi se po flitet thjesht në mënyrë gazetareske, nuk po tërhiqet vëmendja e punonjësve se cilat janë sot problemet aktuale të bujqësisë. Në këto kushte, do të mjaftohemi vetëm me reportazhet që botojnë gazetatat, apo vetë ministri i Bujqësisë t'i përvishet punës dhe të bëjë një artikull përgjithësues për detyrat e stinës që kemi përpara në bujqësi, duke e lidhur zbatimin e tyre edhe me shembullin e mirë të Alo Qoses?

Konkretisht, artikujt e parë të shkruar për Alo Qo-



sen e Athina Milen ishin të mirë, mirëpo qysh të nesërmen gazetat filluan të vënë nëpër materialet që botojnë për këta të dy, citate të mëdha të nxjerra nga letrat e mia. Duke punuar në këtë mënyrë, materialet që botohen nuk paraqesin interes, pse letrën time të gjithë e kanë kënduar, prandaj prej tyre ndonjë citat edhe mund të merret, por vetëm kur është nevoja dhe jo e tërë tirada.

Citatet në vetvete nuk kanë vlerë, kurse po të mendohet mirë, për të theksuar ndonjë ide ose mendim, mund të vihen citate në krye ose në mes të një shkrimi. Të shfrytëzuara në këtë formë ato kanë rëndësi, pse kur autori pas citatit zberthen idenë, lexuesit i ngulet në mendje problemi kryesor që trajtohet. Citati është një ide e shkurtër. Mirëpo në shtypin tonë vëmë re se botohen edhe disa citate fare të përgjithshme, pikërisht sepse kjo punë nuk bëhet në rregull. Kam përgatitur një material<sup>1</sup> se si duhen kuptuar disa probleme ekonomike të ndërtimit tonë socialist, në të cilin ka disa fraza që janë thënë e përsëritur, por vihen për të bërë lidhjen e problemeve. Nga materialet të tilla s'ka pse të merren citatet që janë përsëritur kushti sa herë, siç është për shembull këtu fraza: «Pas Luftës Nacionalçlirimtare dhe fitores së revolucionit popullor. . .». Me këtë dua të them se nuk kanë rëndësi citatet në vetvete, po zberthimi i idesë, në funksion të së cilës sa për spunto merret citati.

---

1 «Si duhet t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim disa çështje të ekonomisë sonë socialiste». Fjala në mbledhjen me punëtorë, kooperativistë dhe kuadro të rrethit të Beratit, 26 shkurt 1969. Shih në këtë vëllim f. 175.

Kur punohet për të zbërthyer një direktivë të Komitetit Qendror, duhet të largohemi nga format e trajtimit të përgjithshëm të çështjeve, duke vënë në dukje vetëm vijat kryesore të tyre, pse këto i vë në dukje udhëheqja, e cila nuk ndalet dhe s'ka si ndalet për t'i zbërthyer në detaje: Shokët e tjerë, që kanë lidhje me atë problem, kanë për detyrë ta zbërthejnë më tej direktivën dhe jo të kënaqen me aq sa është thënë në dokumentin e plenumit, pse po mbetën edhe ata në forma të përgjithshme pune, ta kemi të qartë se nuk bëhet gjë.

Edhe kur flitet për emulacionin socialist, nuk ka pse të bëhen teorira, apo të përdoren fraza të përgjithshme, por të flitet konkretisht, që të mësohen njerëzit të punojnë me kokën e tyre, të mos kënaqen se mbajnë mend disa citate dhe me kaq ta konsiderojnë të mbaruar punën. Kjo nuk është një punë e shëndoshë. Si përfundim, po e theksoj edhe një herë që për aktivin ku do të flasë shoku Xhafer, të përgatiten mirë edhe shokët e tjerë. E kam çështjen që ta vëmë në zbatim konkretisht dhe menjëherë këtë që diskutuam sot. Kur bëhet një kongres ose konferencë për problemet e gruas, të rinisë apo të shkrimtarëve, zakonisht ndiqet kjo rrugë: mbledhen delegatët ose përfaqësuesit dhe aty u lexohet raporti. Pastaj lihet në dëshirën e çdo delegati apo të ftuari nëse do të diskutojë ose jo. Po përse të flasim vetëm këta në të tilla mbledhje? Natyrisht edhe ata duhet të flasim, se sjellin aty zërin dhe eksperiencën e masave që përfaqësojnë, por, në radhë të parë, dhe bile e domosdoshme është të flasim anëtarët e Byrosë Politike, të cilët në diskutimet e tyre duhet të japin

vijat kryesore për problemin që trajtohet. Kur bëhet një aktiv me karakter ekonomik ose teknik, si ky që do të bëjmë pas disa ditësh, të flasë në radhë të parë shoku Adil, natyrisht pa përsëritur ato që do të thuhën në përshëndetjen e Komitetit Qendror, mund të flasin dhe shokë të tjerë të udhëheqjes që merren me drejtimin e sektorëve ekonomikë.

Me një fjalë, kudo ku ka interes Partia, të depërtojë fjala e saj, të sundojë fryma e saj. Kjo realizohet edhe nëpërmjet zbërthimit që i bëjnë vijës e direktivave të Partisë shokët kryesorë që marrin pjesë në mbledhje të ndryshme. Prandaj, për aktivin që do të bëhet pas disa ditësh, mendoj t'ua japim që tani tezat e raportit shokëve kryesorë, që kanë të bëjnë me problemet që do të trajtohen, të cilët duhet të marrin pjesë gjallërisht në punimet e tij. Kjo do t'i ndihmojë pjesëmarrësit e aktivitetit që, kur të kthehen nëpër qendrat e tyre të punës, për çështjet konkrete që i takojnë secilit, të kenë edhe zbërthimin e tezave të veçanta nga ana e udhëheqësit përkatës. Për sa i përket pjesëmarrjes, të mos veprohet njëllë për të gjitha rrethet, por sipas përbërjes së kuadrit, me qëllim që ai që do të vijë, të përfitojë sa më shumë. Petro Dode<sup>1</sup>, për shebull, vërtet nuk merret me ekonominë në Komitetin e Partisë të Rrethit të Vlorës, por jam i mendimit të vijë më mirë ai në aktiv, sesa sekretari që merret në Vlorë me çështjet ekonomike, sepse Petroja ka punuar një kohë të gjatë në Komisionin e Planit dhe i

---

<sup>1</sup> Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.

njuh mirë çështjet ekonomike. Kështu është më mirë të veprohet në raste të tilla, prandaj, po të jeni edhe ju dakord, mendoj ta fillojmë këtë metodë pune që me aktivin e ardhshëm.

Ta bëjmë metodë pune praktikën që udhëheqësit kryesorë jo vetëm të dëgjojnë në mbledhje, konferenca e aktive të rëndësishme si ky, po, duke diskutuar me përgjegjësi, të zbërthejnë tezat e raporteve, ku pasqyrohet mendimi kolegjal i gjithë udhëheqjes. Në raporte tezat jepen në mënyrë shumë koncize, gjë që, për t'u kuptuar nga masat, e bën të domosdoshme zberthimin e tyre. Këtë punë mund ta bëjnë më mirë se kushdo, në radhë të parë, shokët përgjegjës, të cilët, duke trajtuar çështjet që u takojnë sipas sektorëve që mbulojnë, mbështetin njëkohësisht edhe mendimin e përgjithshëm kolegjal të udhëheqjes.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## PARTIA U BESON MËSUESVE EDUKIMIN DHE RRIJTJEN E BREZIT TË RI

*Bisedë me arsimtaren Athina Mile dhe  
bashkëshortin e saj, Frrok Gjnin<sup>1</sup>*

12 shkurt 1969

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kur lexova në gazetë shkrimin që bënte fjalë për martesën tuaj u gëzova shumë se, siç e them edhe në letër<sup>2</sup>, veprimi juaj është shumë pozitiv dhe duhet të merret si shembull nga të gjithë mësuesit, të rejat e të rinjtë e tjerë që punojnë në fshatra, në degët e ndryshme të ekonomisë dhe në ato të kulturës, si në shëndetësi, në miniera, në ekspedita gjeologjike etj. Ata shkojnë nga qyteti për të punuar në kooperativë apo gjetkë, ku mund të martohen dhe të krijojnë familjen e re.

Shembulli juaj ka rëndësi të madhe, sepse thyen mentalitetin e vjetër të disave, që kërkojnë të martohen vetëm me njerëz nga vendlindja, duke i konside-

---

1 Kjo bisedë u zhvillua në selinë e Komitetit Qendror të Partisë.

2 Shih: «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 36.

ruar si të panjohur ata të vendit ku shkojnë për të punuar. Por, ti Athina vajte në Orosh, u njohe me shokun tënd Frrokun, u dashuruat, u pëlqyet dhe kështu krijuat familjen. Kjo është një gjë shumë e mirë. Sa kohë ke që punon si arsimtare në Orosh?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Një vit e gjysmë dhe gjatë kësaj kohe, në punë e sipër, u njoha dhe me Frrokun.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Më kanë thënë se ti Frrok ke ardhur këtu në Tiranë dhe mëson në shkollë për t'u bërë oficer.

*SHOKU FRROK GJINI:* Po, shoku Enver, vazhdoj Shkollën e Bashkuar të Oficerëve «Enver Hoxha». Jam i gatshëm të shkoj kudo ku të ketë nevojë Partia<sup>1</sup>.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë shkolle ke kryer?

*SHOKU FRROK GJINI:* Kam kryer gjimnazin «Bardhok Biba» në Rrëshen. Pasi kreuva mësimet në gjimnaz, më caktuan arsimtar dhe 10 ditë më vonë si u martova, më morën ushtar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po ty Athina si të duket Mirdita?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Shumë e mirë dhe pikërisht sepse më pëlqeu vendosa të martohem atje.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në cilat fshatra të tjera të Mirditës ke qenë?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Kam qenë në Prosek, në Kaçinar, në Shtrazë etj. Atje kam shkuar me nxënësit dhe me grupin e arsimtarëve.

---

<sup>1</sup> Më vonë, me kërkesën e tij shoku Frrok Gjini u bë arsimtar në fshatin e lindjes në Orosh.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa mësuese jeni në Orosh dhe nga janë?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Dy mësuese dhe pesë mësues. Mësuesja tjetër është vendase, kurse mësuesit janë të ardhur nga Durrësi e nga Lezha, po ka edhe vendës.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa nxënës ka shkolla në Orosh?

*SHOQJA ATHINA MILE:* 150 nxënës.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë njerëz ke në shtëpinë tënde në Përmet?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Prindërit, babanë dhe nënën.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po vëllezër ke?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Kam dy. Ata punojnë në kooperativë. Edhe babai vazhdon të punojë në kooperativë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po ti Frrok kë ke në familje?

*SHOKU FRROK GJINI:* Kam nënën, babanë, një motër të martuar, dy vëllezër dhe kunatat, njëri prej tyre ka edhe një djalë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa vjeç janë baba dhe nëna juaj?

*SHOKU FRROK GJINI:* Baba është 70 vjeç, kurse nëna 60.

*SHOKU ENVER HOXHA:* U gëzuan ata kur u fejove me Athinanë?

*SHOKU FRROK GJINI:* U gëzuan. Të them të drejtën, ne, shoku Enver, bëmë një dasëm pa shumë ceremoni.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, kështu duhen bërë

dasmat sot, të thjeshta e pa shpenzime të mëdha. Vëllezërit e tu në bujqësi punojnë?

*SHOKU FRROK GJINI:* Po, shoku Enver, janë anëtarë të kooperativës bujqësore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në Orosh nuk kam qenë, por në përgjithësi Mirditën e njoh mirë, se e kam vizituar më se një herë. Është një vend me bukuri të mëdha natyrore dhe me një të ardhme të shkëlqyer, në radhë të parë, se ka njerëz të mrekullueshëm, punëtorë, trima e bujarë, si edhe pasuri të mëdha. Mirdita është një vendburim i rëndësishëm mineralesh. Pasuritë e nëntokës së saj po ndihmojnë e do të ndihmojnë për të ngritur vazhdimisht më lart nivelin ekonomik të mirditorëve dhe të të gjithë vendit njëkohësisht. Në të ardhmen në rrethin tuaj do të ngrihen fabrika të tjera moderne, që do t'ua kalojnë atyre ekzistueseve të Kurbneshit dhe të Rubikut. Edhe bujqësia do të përparojë në Mirditë, sepse toka e saj është e mirë. Si thua ti Athina?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Po, ashtu është shoku Enver, toka e Mirditës është e mirë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nga anët tona, nga Jugu, ka një gjë të mirë, fshatrat janë më të grumbulluara dhe sigurisht më të rregullta. Ti Frrok ke qenë ndonjëherë nga Jugu, i ke parë ato anë?

*SHOKU FRROK GJINI:* Po, kam qenë në Gjirokastër dhe në Përmet.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë e ka njohur fshatin tënd Frroku.

*SHOQJA ATHINA MILE:* Po, kemi shkuar bashkë në shtëpinë e prindërve të mi.



*SHOKU ENVER HOXHA:* E pëlqeu nëna dhe babai shokun që kishe zgjedhur?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Po, e pëlqyen, gjersa e pëlqeu vajza e tyre, isha e bindur se do ta pëlqenin edhe ata.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ç'mendon ti Athina, do të ketë vajza të tjera arsimtare, të cilat do të ndjekin shembullin tënd, duke u martuar me djem fshatarë?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Sigurisht që do të ketë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe unë ashtu mendoj, do të ketë, siç do të ketë edhe vajza fshatare që do të martohen me qytetarë. Shumë vajza fshatare po shkojnë tani të punojnë në qytete. Në Kombinatin e Tekstileve në Berat, për shembull, kanë shkuar të punojnë shumë vajza nga rrethet e tjera. Megjithatë ne duhet të kemi parasysh që fshatin të mos e braktisim, përkundrazi, të bëjmë përpjekje ta popullojmë sa më shumë, se po të ketë popullsi të mjaftueshme, punët në fshat do të na ecin më mirë. Detyra jonë është që fshatin jo vetëm ta rregullojmë sa më mirë, por, në radhë të parë, të edukojmë njerëzit që jetojnë atje.

Në rrethin e Përmetit shtëpitë në fshatra janë të grumbulluara, kurse në fshatrat e Mirditës ato janë larg njëra-tjetrës. Kur isha herën e fundit në rrethin tuaj, u takova me babën e gruas së Bardhok Bibës<sup>1</sup>, i cili më tregoi se, kur kishte qenë i ri, e kishte bërë

---

1 Më 29 maj 1968 shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në familjen e heroit Bardhok Biba dhe zhvilloi një bisedë të përzemërt me pjesëtarët e familjes së tij.

ushtrinë në Sarandë. Qysh në atë kohë atij i kishin bërë përshtypje ndërtimet në fshatrat e Jugut, ato i ishin dukur tamam si qytete. Unë i thashë se edhe fshatrat e Mirditës do t'i bëjmë njëlloj si të Jugut.

Kam kënduar kohët e fundit në gazetë se në Prosek kooperativistët kanë grumbulluar gurë dhe materiale të tjera ndërtimi, me qëllim që brenda 3-4 vjetëve të ndërtojnë fshatra të bukura, me shtëpi të grumbulluara pranë njëra-tjetrës si në qytete. Proseku do të bëhet me siguri shembull edhe për fshatrat e tjera të Veriut. Ka shumë anë pozitive kur shtëpitë në fshatra janë të grumbulluara. Kjo, veç të tjerash, ndihmon edhe në grumbullimin e fëmijëve në shkollë. A gjeni vështirësi për këtë?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Jo, sepse shtëpitë në Orosh nuk janë shumë të përhapura.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si duken djemtë dhe vajzat në Orosh? Në përgjithësi mirditorët qysh fëmijë janë shumë të mprehtë, të zgjuar e të shkathët. Ata në të kaluarën kanë vuajtur shumë nga bajraktarët dhe vetëm Partia u solli lirinë. Sot fëmijët e malësive të Veriut, ashtu si të gjithë Shqipërisë, i kanë të gjitha mundësitë të jetojnë e të mësojnë të lirë e të lumtur. Te malësorët gjen karakteristika shumë të mira. Ti Athina i njeh më mirë ata dhe në mes tyre zgjedhe shokun e jetës, në karakterin e tij gjete gjëra të përba-shkëta me veten tënde. Mirditorët janë të ndershëm, besnikë, luftëtarë të zotë dhe punëtorë të palodhur, cilësi këto që duhet të karakterizojnë të gjithë njerëzit tanë. Prandaj të jesh e lumtur që zgjedhe një vend aq të mirë dhe të bukur. Je e kënaqur për këtë?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Po, shoku Enver, shumë e kënaqur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po nëna jote ka ardhur ndonjëherë në Orosh, t'ju shikojë si jetoni?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Po, ka ardhur.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ka bërë shumë mirë.

*SHOKU FRROK GJINI:* Kur u caktova arsimtar në Orosh, me shokët e tjerë, pas mësimit punonim edhe në kooperativë, merreshim me punë të bujqësisë dhe me aktivitete të tjera shoqërore e kulturore që zhvilloheshin në shtëpinë e kulturës. Nga Oroshi më vonë më dërguan arsimtar në Gur të Spaçit...

Thirrja për të kryer shërbimin ushtarak më detyroi të largohem nga profesioni i arsimtarit, dhe pas një viti të shërbimit ushtarak më caktuan të vazhdoj mësimit në Shkollën e Bashkuar.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë e ke bërë një vit ushtar. Ke dëshirë të bëhesh oficer, apo dëshiron të shërbesh në ndonjë sektor tjetër?

*SHOKU FRROK GJINI:* Partia mendon më mirë dhe më drejt për çdo njeri, por që t'ia shpërblejmë këtë nder të madh që na kanë bërë neve të dyve Partia dhe Ju, shoku Enver, (dhe në fakt si unë, ashtu dhe Athinaja nuk kemi bërë asgjë), mendoj të shkojmë të punojmë atje ku ka nevojë atdheu në punët më të vështira, siç shkruani ju në letrën që na dërguat, me të cilën u njoh gjithë Shqipëria. Dëshiroj të punoj me të gjitha mundësitë në fshatin tim, në Orosh. Mirdita tani kudo është e bukur. Kur isha fëmijë fshatrat tona nuk kanë qenë si sot, ato tani kanë ndryshuar shumë, kanë ecur shumë përpara. Të gjitha

këto ndryshime u bënë vetëm në sajë të Partisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mirë, do ta bisedoj me shokët se ku do të vendosesh në punë. Bisedoni, shoku Haxhi [Kroi], me shokët e Komitetit të Partisë të Mirëditës që të realizohet kjo dëshirë e Frrokut. Të trashëgojeni, jetë të lumtur, plot punë e shëndet, kudo që të jeni.

*SHOKU FRROK GJINI:* Faleminderit, të rrojë Partia! Partia është ajo që e bëri lule Oroshin.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa vjeç je ti Frrok?

*SHOKU FRROK GJINI:* 23 vjeç.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë je i brezit të pasqirimit. Po si ke qejf, ku dëshiron atëherë të punosh?

*SHOKU FRROK GJINI:* Letrën që na dërguat ju, nuk e prisnim. Ajo që për ne dhe për të gjithë familjen tonë një nder i madh. Për ne, gjatë gjithë jetës nuk do të ketë gëzim më të madh sesa ajo. Sikur edhe me shekuj të jetojmë, unë e Athinaja nuk mund t'ia shpërblejmë dot Partisë atë që ka bërë për ne.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kështu i do Partia njerëzit të thjeshtë si ju.

*SHOKU FRROK GJINI:* Fjalët tuaja shumë të ngrohta në adresën tonë, shoku Enver, na kanë rritur ndjenjën e përgjegjësisë së madhe përpara Partisë, prandaj po mendojmë vazhdimisht, a do të jemi vallë në gjendje t'ia shpërblejmë asaj këtë nder që na bëri?

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ju e kryet porosinë e Partisë. Kudo ku duhej dhe ku ju caktoi ajo, ju keni shkuar pa hezitim dhe keni punuar mirë. Besoj se ty

Athina të pëlqen profesioni i arsimtares. Është profesion jo vetëm i bukur, por dhe shumë i nderuar.

*SHOQJA ATHINA MILE:* Më pëlqen, mendoj se nuk ka detyrë më të mirë sesa të edukosh brezin e ri!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe unë kam qenë mësues. Partia u beson mësuesve edukimin dhe rritjen e brezit të ri që nga koha e vegjëlisë e deri sa vajza dhe djali dalin në jetë. Që brezi i ri të edukohet si duhet me frymën e Partisë, varet shumë edhe nga puna që bën mësuesi. Prandaj detyra e çdo arsimtari është ta njohë mirë misionin e tij të lartë dhe rolin që luan si edukues dhe përçues i vijës së Partisë te brezi i ri. Kur Gjergj Dimitrovi, ish-shok dhe nxënës i Stalinit, u kthye nga Bashkimi Sovjetik në Bullgari dhe mori përsipër drejtimin e partisë e të qeverisë, kur e pyetën, sikur ta lejonin, çfarë profesioni do t'i pëlqente më shumë të ushtronte, ai u përgjigj: «Po të më pyesnin, do të zgjidhja profesionin e mësuesit». Me këtë dua të them se puna e mësuesit ka rëndësi shumë të madhe.

Partia, juve mësuesve nuk ju ka ngarkuar vetëm detyrën të mësoni djemtë dhe vajzat e popullit. Natyrisht, kjo është detyra juaj kryesore, por ju keni edhe një barrë tjetër të madhe shoqërore po aq të rëndësishme: të punoni që me diturinë, me sjelljen dhe me veprimtarinë tuaj politike të edukoni në mënyrë të gjithanshme edhe të tjerët, në rastin tuaj kooperativistët. Edhe nëpërmjet jush ata duhet të njihen me politikën e Partisë, të dinë dhe të preokupohen për problemet shoqërore, se ka shumë të tilla, sidomos në fshat. Pra, nuk janë vetëm problemet politike, me të

cilat duhet të merret arsimtari, por edhe shumë probleme të tjera, nganjëherë edhe çështje që duken të vogla, dhe që kanë të bëjnë me prapambetjen e njerëzve, me zakonet e vjetra. Lufta kundër zakoneve prapanike ka rëndësi të madhe, se ato nuk zhduken lehtë, sidomos në zonat e thella malore. Për këtë qëllim do të duhet punë e luftë e vazhdueshme dhe për një kohë të gjatë. Kjo do të thotë të punohet mirë e thellë politikisht me njerëzit. Kjo barrë, në mënyrë të veçantë, bie mbi ju mësuesit dhe mësueset. Edhe vetë mësuesi, megjithëse ka kryer shkollën e mesme, nganjëherë duhet të luftojë për të zhdukur nga koka e vet shumë mendime të mykura, me qëllim që të ketë kurdoherë pikëpamje të qarta për zhvillimin e natyrës e të shoqërisë. Ato që di vetë, ai duhet të përpiqet t'ua futë në ndërgjegje edhe masave. Prandaj kontaktet e tij të vazhdueshme me to kanë rëndësi të madhe.

Problemet e shkollës, në asnjë mënyrë, nuk duhet të mbeten të shkëputura nga jeta e kooperativës. Zakonisht, në fshat familjet kanë ose lidhin miqësi me njëra-tjetrën, shkëmbejnë vizita miqësore midis tyre. Mësuesit dhe mësueset duhet të gjejnë kohë që edhe ata të miqësohen me familjet e fshatarëve, t'i vizitojnë ato herë pas here, jo vetëm në raste festash, ose kur diku lind një fëmijë, por edhe në ditë të zakonshme. Këto vizita mësuesi nuk duhet t'i bëjë pa kriter, po me qëllim të caktuar, dua të them që ai të mos vejë ku t'i qëllojë rruga e sipas rastit, po të shkojë atje ku e gjykon se është e nevojshme prania e tij, me qëllim që edhe gjatë bisedave të çojë në këto rrethe të ngushta familjare fjalën e Partisë. Kështu mësuesi

me fjalën dhe me sjelljen e tij duhet të fitojë zemrat e njerëzve, të lërë tek ata përshtypje të mira. Me këtë nuk dua të them që mësuesi t'u bëjë qejfin njerëzve kur nuk kanë të drejtë. Të jesh i dashur me njerëzit, nuk do të thotë të mbash qëndrim oportunist, t'i bësh qejfin njerit apo tjetrit, por t'u flasësh drejt e, kur është nevoja, edhe rreptë. Populli ynë është shumë i zgjuar, ai të kupton kur e qorton me arsye. Prandaj megjithëse në fillim ndonjërit mund t'i vijë keq, më vonë do të reflektojë drejt dhe do të thotë se nuk e ka keq ai që e kritikoi aq rreptë. Edhe kur një njeri e lavdëron pa arsye, populli përsëri e kupton se një lavdërim i tillë nuk është me vend.

Partia kërkon që i gjithë populli dhe, në mënyrë të veçantë rinia, të punojë dhe të edukohet sipas mësimëve të saj. Ju jeni të rinj dhe keni përpara një të ardhme të shkëlqyer, prandaj punoni, mësoni, edukohuni dhe hidhuni në luftë për të kryer detyrat sa më mirë, me ndërgjegje të pastër bolshevike, sepse vetëm kështu jeta bëhet më e lumtur, atdheu më i begatshëm e më i bukur. Kur njeriu e kryen detyrën si duhet, ndien kënaqësi të madhe.

Të marrim, për shembull, punën tënde, Athina. Si mësuese ti kalon nëpër duar lloj-lloj librash e tekstesh shkollore, të aritmetikës, të historisë, të gjeografisë etj. Këto ti i mëson njëherë vetë dhe pastaj ua shpjegon nxënësve në shkollë duke u dhënë mësim sipas programit. Pas kësaj ti pyet nxënësit, vlerëson dijet e tyre, i vë secilit notën përkatëse dhe në fund të tremujorit nxjerr përqindjen, sheh rezultatin e punës tënde.

Por Partia mendon se detyra e mësuesit nuk duhet të kufizohet me kaq. Mësuesi duhet të jetë si një pus diturish, të studiojë jo vetëm librat e tekstet shkollore, po edhe gazetën, artikujt që përmban ajo, libra të tjerë, të zgjerojë horizontin kulturor, të përpiqet për kualifikimin e tij të vazhdueshëm dhe kurdoherë të luftojë për zbatimin e direktivave të Partisë. Mund të të bjerë rasti të lexosh, për shembull, në gazetë një direktivë të Partisë, ta zëmë për pyjet, ku mund të theksohet se pyjet duhet të ruhen, të luftohen në to sëmundjet, t'u bëhen atyre të gjitha shërbimet e nevojshme etj. Mësuesi, pasi ta lexojë këtë direktivë, duhet të thellohet, të nxjerrë detyra për punën që ai duhet të bëjë vetë me njerëzit në fshat. Këtë punë ai do ta bëjë pas zhvillimit të orëve të mësimit në shkollë, dhe kjo është një nga rrugët për të arritur qëllimin që cakton direktiva. Si ky mund të trajtohen në shtyp edhe probleme të tjera, të cilat edhe arsimtari duhet t'i ndjekë me vëmendje.

Pra, mësuesi duhet të jetë edhe një aktivist i shquar, edhe një njeri që bën përpjekje të vazhdueshme për ngritjen e nivelit ideoprofesional të tij. Ai nuk duhet të kënaqet me ato që ka mësuar në shkollë. Kështu, për shembull, njohuritë që ka marrë kur ka qenë nxënës, fjala vjen, për gjeografinë, për gjuhën shqipe, për historinë, për biologjinë etj., janë akoma të kufizuara, prandaj pasi të dalë në jetë, ai, si çdo punonjës tjetër, duhet të bëjë përpjekje që t'i pasurojë njohuritë me materiale të reja, me qëllim që të zgjerojë horizontin e dijenive. Pas kësaj do të shihen përmirësime të mëtejshme dhe në zhvillimin e mësimit.



Duke marrë njohuri të gjithanshme e më të gjera, mësuesi, pa dyshim, do ta bëjë mësimin më të qartë dhe do të dijë të gjejë mënyrën më të bukur për ta shpjeguar. Këtë shpjegim të bukur e të zgjuar nxënësit do ta dëgjojnë me interesim e me vëmendje, si rrjedhim do të përfitojnë më shumë, nuk do t'i mësojnë gjërat përmendsh, do t'u mbeten, pra, në kokë shumë njohuri. Vetëm duke punuar në këtë mënyrë, mund të themi se mësuesi e kryen detyrën si duhet ndaj nxënësve, ndaj Partisë, ndaj popullit e vetes së tij dhe bëhet njëkohësisht edhe propagandist i shquar i vijës së Partisë. Për mësues të tillë ka nevojë Partia.

Dhe e vërteta është që mësuesit tanë patriotë e revolucionarë nuk mbeten gjithmonë në një nivel, ata punojnë vazhdimisht për të zgjeruar njohuritë dhe për të pasuruar eksperiencën e tyre. Njëkohësisht vendi ynë zhvillohet, zgjerohen aktivitetet, prandaj atje ku lind nevoja, atje ku ka më shumë vështirësi e kërkohet pjekuri më e madhe Partia çon kadro me eksperiencë. Përse vepron kështu Partia? Sepse e shikon që shumë nga kadrot tanë nuk mbeten në vend, por në punë e sipër dhe në luftë me vështirësitë mësojnë, përparojnë, kaliten e bëhen më të zotë. Këtë proces Partia e shikon edhe tek arsimtarët. Një pjesë e mirë e tyre nuk kufizohen vetëm në punën që bëjnë në klasë, por marrin pjesë aktive edhe në aktivitete të ndryshme jashtë shkollës në jetën shoqërore, si: në mbledhjet e konferencat politiko-kulturore, që zhvillohen në fshat, në zhvillimin e gjithanshëm të fshatit, në luftën kundër zakoneve prapanike, kundër fesë etj. Në të gjithë këtë veprimtari Partia vlerëson kontributin që japin më-

suesit, agronomët, punonjësit e sektorit të shëndetësisë etj. Ajo nuk ndjek vetëm forcimin e gjykimit, aftësitë e organizimit të punës dhe të diturive të këtyre, nuk e vlerëson mësuesin vetëm në punën që bën brenda mureve të shkollës, por në gjithë veprimtarinë që zhvillon sipas porosive dhe kërkesave të Partisë edhe në jetën shoqërore. Gjithsecili duhet të specializohet në një drejtim, por njëkohësisht të dijë edhe më shumë.

*SHOKU FRROK GJINI:* Ardhja juaj në Mirditë pati një rëndësi të madhe, shoku Enver. Në gjithë Mirditën ka shpërthyer tani një hov dhe entuziazëm i madh në punë. Njerëzit punojnë në miniera, në fabrika e në kooperativa bujqësore me një vrull të paparë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Vajzat dhe gratë e Oroshit a gjejnë pengesa e vështirësi në ecjen e tyre përpara?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Ato janë shumë të mira, e përqafojnë shpejt të renë, prandaj ne nuk gjejmë pengesa si më parë për edukimin e aktivizimin e tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Tregojnë interesim fshatarët mirditorë për mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë?

*SHOQJA ATHINA MILE:* Në Orosh ata vijnë vazhdimisht në shkollë dhe pyesin si shkojnë fëmijët e tyre në mësim, bile disa ndjekin edhe vetë shkollën e natës. Në qoftë se ne mësuesit nuk lidhemi ngushtë me prindërit e nxënësve, sado mirë që të punojmë, nuk do të arrijmë rezultatet e duhura.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Për çështjen e higjienës personale nuk duhet të jemi të kënaqur. Ju mësueset, në mënyrë të veçantë, duhet të bëni një punë

të madhe në këtë drejtim me masën e grave fshatare, se gruaja ka influencë të madhe te burri dhe në familje. Të gjitha gratë intelektuale që punojnë në fshat, duhet të bëjnë shumë kujdes me masën e grave fshatare, të futen thellë në shpirtin e tyre. Ju mund të bisedoni me to edhe për disa probleme të higjienës e të pastërtisë personale, se ia thoni lehtë dhe ia shpjegoni më mirë njëra-tjetrës.

Janë të rëndësishme këto çështje për ruajtjen e shëndetit të gruas e të kalamanëve, ato kanë të bëjnë me higjienën personale të rekomanduar nga shkenca. Si rezultat i moszbatimit të këtyre rregullave në vitet e para të Çlirimit shumë gra e fëmijë, sidomos para dhe fill pas lindjes, vdisnin dhe kjo vinte thjesht nga padija, nga papastërtia e pakujdesia. Prandaj prej jush duhet luftuar shumë e me guxim në këto drejtime. Kur puna që bëjmë është për të mirën e popullit, të mos kemi asnjë frikë nga thashethemet, t'i luftojmë këto se na prishin. Ai që përpiqet për diçka të mirë, në fund të fundit, do të fitojë, sepse njerëzit, herët ose vonë, do ta kuptojnë. Mund të themi se në drejtim të pastërtisë ne kemi shumë për të bërë. Ka krahina të vendit tonë që akoma harxhojnë pak sapun, por ka edhe krahina me tradita të mira edhe në drejtim të pastërtisë, siç është për shembull Gjirokastra.

*SHOKU FRROK GJINI:* Krahinat e Jugut në këtë drejtim kanë qenë shumë të përparuara, qysh më parë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ka pasur në Jug krahina të përparuara nga pikëpamja e pastërtisë, por

në mjaft drejtime edhe ato kanë qenë të prapambetura. Pastërtia ka qenë karakteristikë jo vetëm e gjirokastritëve, por edhe e dibranëve, e korçarëve, e kolonjarëve, e përmetarëve. Ndryshimi midis krahinave të Jugut dhe atyre të Veriut natyrisht vinte nga ndryshimi që ekzistonte në kushtet ekonomiko-shoqërore. Nga krahinat e Jugut burrat shkonin shumë në kurbet, si: në Turqi, në Greqi, në Amerikë etj., ku punonin si punëtorë, në profesione të ndryshme. Kjo vinte ngaqë vendi ishte shumë i varfër, punë s'kishte e ata nuk kishin si mbanin familjet me bukë. Nga gjirokastritët disa kanë qenë «kadilerë» (gjykatës), domethënë ishin ca më të gjezdisur. Kurse tani në vendin tonë po bëhen shumë gjëra dhe punë ka për të gjithë: fshatrat po zhvillohen nga viti në vit, ata që i kanë shtëpitë të shpërndara do të grumbullohen gradualisht, drita elektrike po hyn edhe në fshatra, zhduken zakonet e këqija, prapambetja, dhe kështu përparimi futet kudo. Ku ka pasur më përpara kaq shumë shkolla e njerëz të mësuar! Por tani po bëhen shumë gjëra të reja, se kemi Partinë të fortë që na udhëheq. Në kohën e regjimeve antipopullore ka pasur një përparim të përceptë, zhvillimi atëherë ishte i njëanshëm, për ngritjen ideologjike të masave sidomos nuk bëhej asgjë.

Në Gjirokastrë, siç jua kam përmendur në letër, zakonet e egra nuk e linin djalin ta shikonte të fejuarën, ata e merrnin njëri-tjetrin, siç i thonë, si derri në thes, sepse martesat bëheshin me mblesëri. Bile sikur vjehrra të kishte dëshirë ta shikonte nusen e të birit, në qoftë se kjo ishte e çalë ose e verbër, i nxirr-

nin në oborr një vajzë tjetër në vend të nuses. Ligjet e egra të sheriatit e të kanunit i lejonin burrat t'i ndanin gratë pa ndonjë arsye. Burri kishte të drejtën t'i jepte gruas një letër, boçen me plaçka në krahë dhe e çonte në shtëpinë e prindërve. Kuptohet ç'fatkeqësi e priste gruan ose nusen e re po të dilte një çikë të dera. Pra po t'i thoshin burrit se e kishin parë nusen e tij të fliste me një burrë tjetër, ai vetëm me kaq e dërgonte tek i ati. Më parë kishte zakone të turpshme, sipas të cilave, sidomos agallarëve myslimanë u lejohej në bazë të fesë të merrnin nga dy-tri gra. Tani këto zakone janë duke u zhdukur. Megjithatë ka akoma mbeturina të tyre që duhen luftuar. Prandaj t'u kushtojmë këtyre vëmendje të madhe, të punojmë me dashuri të madhe për popullin, t'i njohim këto rrugë të ndritura që na ka hapur Partia, të hidhemi në punë, në luftë, në mësim, në edukim, sepse kështu jeta në vendin tonë do të lulëzojë nga dita në ditë.

U gëzova shumë që erdhët për t'u takuar dhe që m'u dha rasti t'ju njoh personalisht. Ju uroj shëndet, jetë të lumtur e të gëzuar. Bëni edhe fëmijë! Kjo është e natyrshme, por nga ana tjetër fëmijët janë gëzimi i familjes. Qeshin muret e shtëpisë, thotë populli, kur lind një fëmijë. Lindja e fëmijëve është njëkohësisht detyrë patriotike për vendin tonë. Ne kemi nevojë të shtohemi dhe nuk kemi frikë nga shtimi i popullsisë. Ne marksistët jemi kundër pikëpamjeve reaksionare të Maltusit, që propagandon idenë reaksionare të kufizimit të lindjeve. Sa më shumë të jemi në numër, aq më i lulëzuar dhe më i fortë do të bë-

het atdheu ynë, aq më shpejt do të ndërtohet socializmi në Shqipëri.

Ju uroj edhe një herë jetë të lumtur, plot punë e shëndet që të dyve. Prindërve tuaj, vëllezërve si dhe shokëve dhe shoqeve mësuese, u bëni shumë të fala nga ana ime.

*Pastaj shoku Enver u dhuron të dyve nga një libër të Historisë së PPSH.*

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

## PARTIA KËRKON PËRPIKËRI NË KRYERJEN E DETYRAVE LUFTARAKE

*Bisedë me oficerët dhe punonjësit e repartit «N»  
të aviacionit*

25 shkurt 1969

U gëzova shumë për punën e mirë që keni bërë, duke mbajtur në gatishmëri të plotë këtë armë të fuqishme të ushtrisë sonë, siç është aviacioni. Ashtu siç kemi korrur gjer tani suksese dhe fitore, pavarësisht nga vështirësitë e pengesat, ashtu do të korrim vazhdimisht, edhe këtej e tutje, se jemi në rrugë të drejtë, në rrugën e revolucionit dhe të socializmit, kurse shtetet kapitaliste e revizioniste janë në krizë të rëndë dhe do të shkojnë gjithnjë e më poshtë, deri në disfatë e në shkatërrim të plotë.

Në armën e aviacionit, zakonisht bien në sy ata që fluturojnë, kurse punën për përgatitjen e avionëve për fluturim e bëni të gjithë ju. Kjo do të thotë se në aviacion nuk punojnë vetëm pilotët, po edhe mekanikët, radistët e të tjerë, e të tjerë. Pa punën e të gjithë punonjësve e të specialistëve të tjerë të aviacionit, pilotët nuk fluturojnë dot. Të gjithë ju, që jetoni dhe

punoni këtu, jeni të lidhur si mishi me kockën me njëri-tjetrin, se punoni dhe luftoni për një qëllim të lartë, për mbrojtjen e atdheut tonë socialist. Sa më të zotë, të mësuar e me eksperiencë të jenë djemtë e vajzat e kolektivit tuaj, aq më lart do të fluturoni ju pilotët, aq më të guximshëm do të jeni ju në kryerjen e detyrave të mëdha e të rëndësishme që ju ka ngarkuar Partia.

Shokë e shoqe punonjës të aviacionit,

Ju e kuptoni mirë detyrën shumë delikate të pilotëve. Këta, që tani fluturojnë me lehtësi në qiellin e bukur të atdheut, në kohë të rrezikshme, në rast se na sulmojnë armiqtë, në krahasim me ne që do luftojmë në tokë, do të jenë më në rrezik se do të luftojnë në ajër dhe të parët. Atyre do t'u duhet të ndeshen me avionët armiq, duke u përpjekur të rrëzojnë sa më shumë prej tyre dhe të shpëtojnë veten bashkë me avionët që drejtojnë. Por edhe armiku lufton, edhe ai është i përgatitur nga ana e vet për të na goditur, prandaj nga pilotët tanë kërkohen përgatitje e shëndoshë, zotësi, guxim e heroizëm i lartë.

Lufta kërkon zgjuarsi dhe manovrim të shpejtë. Vetëm kështu dhe me trimëri mund ta asgjësojmë armikun, por edhe ai nga ana e tij përpiket të na vrasë, të na djegë e të na shkatërrojë. Prandaj pilotët tanë, kur fluturojnë, duhet të ushtrohen me pikësynim që të bëjnë sa më shumë manovra në qiell. Manovrimet e tyre në luftë kanë të bëjnë me përpjekjet për të



shpëtuar popullin dhe atdheun tonë socialist, në rast rreziku. Instruktorët, të cilët u japin mësim pilotëve tanë të rinj i mësojnë këta të mendojnë e të përgatitin kurthe në çdo rast e rrethanë për ta gënjyer e për ta mundur armikun.

Me këto dua të them që puna e gjithë punonjësve të aviacionit, e kombinuar më së miri me atë të pilotëve, ka rëndësi të madhe për mbrojtjen e atdheut. Pilotët tanë kanë mësuar të fluturojnë shumë mirë; megjithatë duhet t'u ruhen rreziqeve në ajër. Kam lexuar në shtyp se një pilotit tonë gjatë fluturimit i pësoi avioni defekt, mirëpo ai u tregua gjakftohtë dhe me heroizëm të shquar i kaloi vështirësitë. Këto cilësi e ndihmuan ta ulte avionin pa u dëmtuar fare, duke shpëtuar kështu, në radhë të parë, veten e tij, pastaj edhe avionin, që është një pasuri shumë e vlefshme për mbrojtjen e atdheut. Sidoqoftë, duhet treguar kujdes i madh që të na ndodhin sa më pak gjëra të tilla. Kontrolli teknik i çdo vegle e detaji në avion duhet bërë me rreptësinë më të madhe para fluturimit. Mund të ngjasë që defekti të ndodhë në ajër, si në rastin që thashë, por ma merr mendja se po t'i ishte bërë avionit një kontroll shumë i imët dhe me kujdes të madh, avaria do të ishte shmangur. Po të mos ishin cilësitë e larta të pilotit tonë, me siguri ai do të kishte pësuar katastrofë. Në këtë çështje duhet shumë kujdes dhe, për pakujdesinë më të vogël, të merren masa të rrepta, sepse nuk mund të lejojmë të na sakrifikohen pilotët tanë.

Partia kërkon nga të gjithë ju, shokë komunistë, që punoni në këtë armë të lavdishme të ushtrisë sonë,

të jeni shumë të përpiktë në kryerjen e detyrës. Ju pilotët duhet të bëni të gjitha përpjekjet e të mësoni me zell për ta drejtuar avionin gjatë fluturimit me zotësi e me shkathtësi të madhe, kurse mekanikët dhe punonjësit e tjerë të të gjitha shkallëve e sektorëve, që lidhen me këtë armë, duhet të jenë shumë kërkues ndaj vetes në zbatimin e rregullave teknike, në mirëmbajtjen dhe në sigurimin e çdo vegle e makinerie.

Veçanërisht, ju pilotët, duhet të jeni të kujdesshëm në çdo gjë, se, siç e dini, është ndryshe kur ecën me automobil në tokë dhe krejt ndryshe kur fluturon me avion në ajër, ku kërkohet kurdoherë vëmendje e përqendruar, kujdes e precizion shumë i madh, se atje lart, në qiell, vetëm një herë mund të gabosh. Për të mos ndodhur katastrofa duhet mësuar vazhdimisht, duhet rritur pandërprerë niveli i aftësive tuaja profesionale. Prandaj mësimet që ju japin shokët oficerë, të cilët kanë një përvojë të madhe në teknikë, duhet të përvetësohen më së miri nga ana juaj. I dëgjoni ata me vëmendje, se shokët instruktorë që keni pranë janë nga kuadrot më të mirë, që kanë një eksperiencë të gjatë, prandaj përfitoni nga dituritë dhe nga aftësitë e tyre praktike. Si kudo edhe këtu te ju duhet të punohet, në radhë të parë e mbi të gjitha, për kalitjen e ndërgjegjes, për edukimin tuaj komunist, për ngritjen e pandërprerë ideologjike nëpërmjet përvetësimit të mësimëve të Partisë dhe të teorisë sonë marksiste-leniniste.

Me këtë rast dëshiroj t'ju shpreh vlerësimin e lartë që u bën Partia punës suaj, patriotizmit, gati-

shmërisë luftarake dhe kujdesit tuaj për të qenë kurdoherë gati për mbrojtjen e atdheut dhe mposhtjen e çdo armiku. Ju falënderoj dhe ju përgëzoj nga zemra!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në*

*AQP*

## ESHTË JASHTËZAKONISHT MIRË KUR MENDIMET TË HEN HAPUR

*Nga diskutimi në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë  
së Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit<sup>1</sup>*

25 shkurt 1969

Dëshiroj të them edhe unë diçka në këtë mbledhje. Çështjet që trajtuat ju sot këtu, në detaje nuk i kam ditur, prandaj gjithçka e mora vesh nga zhvillimi i kësaj mbledhjeje të byrosë. Nga shpjegimet e qarta të gjendjes moralo-politike, organizative e teknike të zhvillimit të punimeve në sektorin e naftës, krijova tani një përshtypje shumë më të gjerë nga ajo që kisha më parë.

Ajo që më ra në sy, në radhë të parë është prania këtu e shokëve të rinj e të mirë, të cilët janë zgjedhur në byronë e komitetit të Partisë. Me ardhjen e tyre në udhëheqje ata do të bëhen një mbështetje e madhe për organizatën e Partisë të rrethit, si dhe për shokët e vjetër të byrosë. Shokët e rinj që janë zgjedhur duket

---

<sup>1</sup> Kjo mbledhje u zhvillua në Qytetin Stalin.

që kanë një eksperiencë të mirë në punët shtetërore dhe të Partisë. Ky nuk është një konkluzion i rastit, këtë e nxjerr nga përshtypja që më lanë ata shokë, të cilët edhe pa qenë specialistë të naftës i trajtuan shumë mirë problemet. Njerëzit e rinj që kanë ardhur në udhëheqje, janë një shpresë e madhe për organizatën e Partisë, ata do ta ndihmojnë shumë komitetin e Partisë për zbërthimin dhe realizimin e detyrave të mëdha që ka përpara.

Problemi i naftës, siç e theksuat të gjithë ju shokë, është një nga më të mëdhenjtë për Partinë dhe shtetin tonë, pse nafta është lënda djegëse më e rëndësishme për ekonominë popullore. Në këtë sektor janë bërë e po bëhen investime të mëdha, të cilat duhet të shlyejnë veten në mënyrë të shumëfishtë. Por, që të arrihet kjo, çështja varet nga organizimi i punës, nga drejtimi i mirë i Partisë, nga drejtimi teknik dhe nga drejtim i punëtor. Punonjësit tanë të naftës janë treguar vazhdimisht të zotë. Është e padiskutueshme se, në përgjithësi, ata i kanë kryer mirë detyrat e mëdha që u kanë ngarkuar Partia dhe shteti. Në sajë të punës së tyre të palodhur atdheu asnjëherë nuk ka mbetur pa naftë. Kjo u detyrohet punës, përpjekjeve dhe zotësisë që kanë treguar naftëtarët, punëtorët dhe inxhinierët tanë të këtij sektori.

Siç e theksuat ju vetë, neve tani na vihet detyra të nxjerrim naftë sa më shumë. Kjo do të arrihet si me shfrytëzimin e vendburimeve ekzistuese, ashtu edhe duke zbuluar fusha të reja naftë. Njëkohësisht ne duhet të bëjmë vazhdimisht përpjekje që nafta të na vijë gjithnjë e më e lirë ekonomikisht. Ju jeni në

dijeni për ngritjen e rafinerisë së ardhshme moderne të naftës dhe për veprat e tjera të industrisë sonë. Të gjitha këto kanë nevoja të mëdha për karburant, për energji elektrike dhe për gaz. Kjo duhet të na bëjë të mobilizohemi akoma më shumë për realizimin e detyrave që na janë ngarkuar.

Diskutimet tuaja ishin të nivelit të lartë, konkrete dhe jo të njëanshme. Sot ju analizuat dobësitë që ekzistojnë në punën e shokëve drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimeve dhe të Institutit të Naftës e të Gazit, bëtë kritika të hapëta që mua më pëlqyen shumë, sepse prekët e trajtuat thelbin e problemit, kritikuat të metat, por njëkohësisht treguat edhe rrugët për arritjen e objektivave. Ky është një diskutim shembullor, prandaj kam bindjen se ai do të shërbejë shumë për t'ua arritur qëllimeve tona.

Nuk e kam lexuar mirë projektvendimin që keni përgatitur, por, sigurisht, aty ju duhet t'i keni radhitur edhe kritikën, edhe anët e mira, si dhe objektivat që synon kjo mbledhje e byrosë. Kështu projektvendimi edhe me vërejtjet konstruktive që bënë shokët, si Tefik Rama, Petro Olldashi e të tjerë, do të ndihmojë jo vetëm organizatën e Partisë dhe gjithë punonjësit e tjerë të sektorit të naftës, por edhe vetë Ministria e Industrisë dhe të Minierave.

Problemin e naftës ne e kemi shqyrtuar shumë herë në Byronë Politike, kemi diskutuar gjerësisht për të dhe kemi marrë vendimet përkatëse. Natyrisht, në qendër, nuk i dimë çështjet kaq shkoqur si ju, po vetëm në vija të përgjithshme. T'i dish çështjet në vija të përgjithshme është një gjë e mirë, po, sigurisht, jo e

mjaftueshme, mbasi problemet, për t'i zgjidhur mirë, duhen njohur thellë. Mundet që gabohem, por mendoj se Ministria e Industrisë dhe e Minerave dhe drejtoria e naftës e kësaj ministrie duhet t'i njohin më nga afër problemet që diskutuat ju, pse kam përshtypjen që nuk i dinë në atë nivel siç folët ju këtu. Shokët që punojnë në qendër dhe merren me naftën duhet jo vetëm t'i dinë e t'i studiojnë këto probleme një nga një, por edhe të marrin masa që t'ju ndihmojnë ju, t'ju inkurajojnë në punë dhe t'ju kontrollojnë për zbatimin e plotë të vendimeve të Partisë dhe të Qeverisë për sektorin e naftës. Është e vërtetë që te ju ka shumë gjëra të mira, por ka dhe mjaft probleme, për zgjidhjen e të cilave kërkohet një ndihmë më e kualifikuar nga lart.

Mendoj, gjithashtu, që megjithëse s'kemi arritur akoma të kemi sasinë që nevojitet për kuadro të lartë të të gjitha profileve ose për kuadro të mesëm për këtë sektor, prapë tani kemi mjaft kuadro të lartë dhe një numër të madh kuadrosh të mesëm, teknikë dhe punëtorë të thjeshtë, të cilët janë shumë mirë në gjendje ta çojnë punën gjithnjë e më përpara. Këtë ju e dini më mirë e më konkretisht nga unë, që problemin e naftës e të gazit e njoh vetëm nga raportet, nga leximet dhe diskutimet si këto të sotmet që trajtojnë probleme të këtij sektori. Kjo, natyrisht, nuk është një punë kaq e lehtë, përkundrazi, mjaft delikate, prandaj po nuk u zgjeruan njohuritë e punonjësve të sektorit të naftës, duke filluar që nga punëtorët e gjer tek inxhinieri dhe, në rast se të gjithë këta së bashku nuk zbatojnë rregullat teknike me një disiplinë

punëtores, mund të na ndodhin mosrealizime, gjëra të papritura, dëmtime, avari etj.

Pikëpamjet që ekzistojnë, qoftë edhe te një pjesë e vogël e shokëve, se «nuk mund të bëhet pa avari», nuk janë të shëndosha. Në realitet, kur i futesh një punë kaq të madhe, siç janë shpimet e puseve, mund të ngjasë edhe ndonjë avari. Kjo nuk diskutohet, por nuk duhet të lejohet që, pas pikëpamjeve të tilla të fshihen mungesa e disiplinës, e kontrollit, e marrjes së masave për realizimin e çdo detyre, për caktimin dhe studimin e drejtë të pikave, mungesa në drejtim të edukimit të punonjësve të këtij sektori etj. Çdo lëshim në këtë drejtim, është i dënueshëm. Prandaj, duke analizuar problemin në frymën e autokritikës dhe të kritikës së drejtë, objektive e parimore, ju veproni drejt edhe kur kritikoni shokët përgjegjës për të gjitha të metat e dobësitë që janë vërtetuar në punën e tyre.

Siç doli gjatë shqyrtimit të problemit që u analizua, ka të meta në dëgjimin e zërit të masave, në kontrollin punëtor e në bashkëpunimin e kuadrove të lartë me ata të ulët. Këto probleme janë jetike. Partisë i duhet të bëjë një punë të madhe për t'i edukuar të gjithë me frymën e klasës, sepse jo të gjithë e kanë të zhvilluar këtë frymë. Ta kuptojmë drejt se në jetë ka edhe ndonjë punëtor që nuk e ka të fortë ndjenjën e klasës, ashtu siç mund të ketë kuadro teknikë, të mesëm dhe të lartë, që e kanë të fortë ndjenjën e klasës punëtore.

Është fakt se punëtorët ndiejnë nevojën dhe e kërkojnë më tepër bashkëpunimin dhe ndihmën e drejtuesve dhe të kuadrove të lartë. Është gjendur ndonjë-



herë ndonjë punëtor pusesh që të thotë: «Ç'do që na vjen këtu ti shoku inxhinier ose shoku gjeolog?». Asnjë! Përkundrazi, ata ankohen se këta nuk shkojnë sa duhet atje ku punohet. Dhe fajin e kanë ata që nuk shkojnë për të bashkëpunuar me punëtorët dhe jo këta të fundit. Klasa punëtore nuk e kërkon këtë lidhje për sytë e bukur të inxhinierit, por sepse ndien nevojën e ndihmës dhe të diturisë së kuadrove të lartë. Këto kërkesa ne duhet t'ua plotësojmë punëtorëve në frymë revolucionare, jo me kryelartësi, jo me kuptimin që «ti je vartës dhe unë epror» dhe në asnjë mënyrë me frymën e komandimit. Në qoftë se shkojmë me këto pikëpamje, do të thotë se atë zotësi që na ka dhënë Partia, nëpërmjet shkollave e përpjekjeve tona individuale, ne nuk e përdorim në rrugën marksiste-leniniste ndaj klasës punëtore, punonjësve të bujqësisë etj. Prandaj ta shfrytëzojmë mirë këtë mundësi bashkëpunimi, pse kështu do të bëjmë me siguri gjëra të mrekullueshme.

Kur lexon literaturë të disa autorëve që jetojnë e punojnë në vendet kapitaliste, ku ekziston një teknikë shumë e zhvilluar, eksperiencë më e madhe, agroteknikë e lartë etj., na duket çudi që në sajë të trajtimit shkencor që u bëjnë atje, ta zëmë, bimëve bujqësore, arrijnë të marrin deri në 50 kuintalë grurë për hektar. Por, kur dëgjon se si një kooperativiste e thjeshtë shqiptare në një sipërfaqe toke prej disa hektarësh ka arritur të marrë 120 kuintalë misër për hektar, me të drejtë të shkon në mendje për atë zotësi të madhe që fshihet te njerëzit tanë, të cilët në shumë raste ua kalojnë atyre të vendeve të tjera me eks-

periençë të madhe dhe me teknikë të përsosur. Kjo kooperativiste ka arritur këto rezultate se u ka vënë veshin mësimeve të Partisë për zbatimin e agroteknikës, e cila të mëson si ta punosh tokën, sa pleh t'i hedhësh, cilën farë duhet të zgjedhësh e pastaj ta mbjellësh. Vetëm duke zbatuar këto porosi, kjo kooperativiste e thjeshtë me ato nocione të pakta që ka fituar, arriti të marrë një rendiment kaq të lartë në misër. Dhe duhet pasur parasysh që këto rezultate kaq të mira janë arritur nga njerëzit tanë të thjeshtë që nuk janë specialistë të mëdhenj të bujqësisë.

Duke gjykuar nga kjo situatë, mund të merret me mend ç'suksese do të kemi në sektorin e naftës në rast se teknikët, inxhinierët, instituti i studimeve, drejtoria, drejtuesit dhe të gjithë të tjerët do të jenë të lidhur me bazën, në qoftë se ata nuk do ta konsiderojnë punëtorin e sondës si punonjës të thjeshtë që ka mësuar të përdorë manivelën sa për të vënë në lëvizje sondën. Punëtori ynë i naftës duhet të kuptojë mirë ku shpon e përse shpon. Prandaj kuadrot e lartë është e domosdoshme që studimet e tyre t'i bëjnë afër punëtorëve që nxjerrin kampionet, pse këta janë në gjendje të japin hollësira dhe shenja, të cilat do t'u vlejné atyre pa masë për studimin e strukturave të tokës. Kështu, për shembull, sondatori, në bazë të përvojës shumëvjeçare, njih strukturën e tokës, që është baza me të cilën punon makina. Është pikërisht si në bujqësi, ku baza është toka. Aty traktoristi mund të dijë mirë përdorimin e traktorit, por në qoftë se nuk njih strukturën e tokës e shumë rregulla agroteknike, që i ka mësuar në shkollë, nuk mund të bëhet një

plugues i mirë, ashtu siç nuk mund të jetë sondator i vërtetë ai që njeh vetëm veglat e sondës.

Në shkollë njeriu merr mjaft dijeni, por një shkollë e mirë dhe e domosdoshme është edhe praktika e madhe e jetës. Në rast se në institut e mësojmë sondatorin për strukturat, i bëjmë të qarta atij si e ku gjendet nafta, pse ka ose pse s'ka ujë, si janë shtrirjet e thyerjet e shtresave etj., studimi është akoma i cekët dhe i mbyllur. Në qoftë se pa e nënvleftësuar do të dimë të shfrytëzojmë ndihmën e madhe që na sigurohet nga përvoja e punës së të tjerëve, studimi do të bëhet më i thellë, kuadrove do t'u hapen horizonte të tjera të reja, për arsye se ata që observojnë janë me qindra dhe vënë re çdo hollësi të punës. Kjo ka rëndësi të madhe për përgjithësimin shkencor. Nga rastet e veçanta bëhen përgjithësimet, prandaj shokët e institutit këtë nuk duhet ta harrojnë, pavarësisht se atje ka njerëz të zotë, me kapacitet e me njohuri të shumta, me eksperiencë dhe të aftë për punën e tyre.

Shokut Petro Oldashi ia mora diskutimin që e kishte të shkruar, por unë dëshiroj që po të ketë mundësi t'ua marr edhe shokëve të tjerë që folën, për t'i lexuar më qetë kur të vete në Tiranë, me qëllim që, në ndonjë mbledhje të Byrosë Politike, këto probleme t'ua bëj të ditur shokëve të Ministrisë së Industrisë e të Minerave që mund të ftojmë atje.

Ekzistojnë te ju një sërë problemesh me rëndësi parimore, organizative e politike, të cilat në këtë mbledhje u shtruan drejt. Ato duhet t'i kenë mirë parasysh edhe shokët e ministrisë, jo se nuk i kanë marrë seriozisht gjer më sot, por mendoj se ata duhet t'u

futen akoma më në thellësi atyre për t'ju ndihmuar ju më mirë se gjer tani.

Nesër a pasnesër do të bëhet një mbledhje në Patos, ku do të marrë pjesë edhe shoku Adil [Çarçani]. Atje, përveç problemeve tuaja mund të shtroni edhe disa nga çështjet që ngritët këtu.

Ju shokët e bazës mos lejoni që të shkelen vendimet që janë marrë për naftën nga Qeveria dhe nga Byroja Politike. Traktorët ose buldozerët që kanë ardhur për nevojat e sektorit të naftës duhet të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe nuk është e drejtë që ata të përdoren për punë të tjera. Ata kanë ardhur që të shfrytëzohen këtu dhe jo për hapjen e ndonjë hauzi, i cili le të bëhet kur të vijnë traktorët e mjetet që janë parashikuar për të. Këto mjete, që akoma janë të pakta, të domosdoshme e të llogaritura me krëk, janë vetëm për sektorin e naftës. Kurdoherë të jeni ekzigjentë në kërkesat, sidomos për ato që janë vendosur dhe duhet t'ju vijnë. Nuk përjashtohet që nga lart të bëhet ndonjë ndryshim, por kjo do të bëhet vetëm kur të jetë e nevojshme dhe pa u sjellë pengesa punëve në sektorin e naftës.

Ju ngritët këtu disa probleme, për të cilat unë s'kam ç'të them. Të gjithave u gjetët zgjidhje të drejta. Diskutimet dhe kritikrat që bëtë më kanë lënë përshtypje të mirë, ato ishin me karakter vërtet shoqëror, ideologjik dhe marksist-leninist, me to ju u vutë gishtin plagëve, me qëllim që të përmirësoni punën, të arrini të gjeni vendburime të reja nafte dhe gazi, që është edhe ky aq shumë i nevojshëm për ekonominë tonë.

Që të kryhen mirë të gjitha detyrat, që të zhduken avaritë etj., duhet punuar me njerëzit, në radhë të parë, politikisht, pastaj ata duhen mësuar dhe edukuar edhe teknikisht. Ka disa pika shumë delikate në sektorin e naftës, që kërkojnë një kujdes të jashtëzakonshëm nga të gjithë, pse në qoftë se na ndodh avari në një pus, humbasim miliona lekë. Prandaj të organizojmë kurset dhe shkollat e veçanta teknike me mësues e me mjeshtër të mirë, për të mësuar në mënyrë të sforcuar; të gjithë ata që janë rreth sondave, të bëhen me të vërtetë njerëz të zotë. Punëtorët e sondave nuk duhet të mbeten pas, sepse prej tyre varet shumë nëse do të gjejmë ose jo naftë, do të vemi në tri mijë metra thellësi apo më thellë, do të na ndodhë avari në pus apo do të kryhet procesi i punës normalisht etj. Në punë e sipër do të ndeshemi edhe me pengesa të tjera, por të kemi besim se me vullnet të gjitha do t'i kapërcejmë me sukses.

Një shok kur diskutoi vuri në dukje se 33 ish-sondatorë janë larguar nga kjo punë, mbasi janë bërë oficerë. Në qoftë se ata kanë 10-15 vjet që janë larguar, tani s'kemi ç'bëjmë, s'i kthejmë dot këtu, po në qoftë se kanë dy vjet mund edhe t'i kthejmë përsëri. Ata që janë bërë mësues, gjithashtu, mund t'i tërheqim, pse na vlejnë vërtet jo vetëm si të tillë, por edhe si sondatorë. Mund të tërhiqen e të zëvendësohen atje ku janë edhe shokë të tjerë që kanë qenë më parë me punë në sektorin e naftës dhe tani punojnë në sektorë të tjerë. Të gjithë këta që bëhen rreth 90-100 veta ne mund t'i tërheqim. Megjithatë, si kurdoherë, të kemi parasysh se vetëm këta nuk na e zgjidhin problemin.

Çështja është të kapemi pas filizave të rinj që janë këtu, t'i mësojmë ata sa më shpejt e t'i kualifikojmë në mënyrë të organizuar.

Që çdo gjë të shkojë në rregull, në radhë të parë, duhet disiplinë partie e shtetërore. Mua më duket se në këtë drejtim jemi ca dorëlëshuar. Një njeri që na shkaktonte një avari dhe na dëmton me miliona lekë, goftë edhe nga pakujdesia, mendoj se duhet dënuar rreptë. Prandaj t'i forcojmë kërkesën dhe vënien para përgjegjësisë në rrugë shtetërore të të gjithë atyre që dëmtojnë pasurinë socialiste, sepse klasa punëtore, masat punonjëse nuk mund të lejojnë që për pakujdesi të njërit apo të tjetrit t'i humbasin shtetit disa miliona lekë. Nuk është i drejtë një qëndrim i tillë! Natyrisht, ne nuk e shtrojmë zgjidhjen e kësaj çështjeje vetëm me masa administrative apo vetëm me dhunë, siç e shtron kapitalisti që kërcënon punëtorin se po bëri një dëm, medoemos do ta çojë në burg. Për ne kryesore është bindja, që realizohet me sukses duke punuar, në radhë të parë, politikisht për të mos qenë i pakujdes-shëm në detyrë. Çdo punëtor të mendojë mirë dhe të bëhet i ndërgjegjshëm se dëmi rrezikon ekonominë popullore. Në këtë drejtim ne duhet të bëjmë shumë përpjekje.

Jam i bindur se shokët e institutit do t'i ndreqin gabimet dhe do t'i kuptojnë reciprokisht drejt kritikën që u bëhen nga shokët e tjerë. Jam, gjithashtu, i bindur se shokët e tjerë për kritikën që bënë, nuk janë udhëhequr nga ndonjë ndjenjë personale, po nga interesi i punës. Të gjithë njerëzit nganjëherë, në punë e sipër, nxehen, lëshojnë nga një fjalë, po pas-

taj u vjen keq për atë që bënë. Puna i ka këto. Edhe vetë Petraq Xhaçka që e kritikoi Paskalin [Sinani] s'ka dyshim se ka raste që nxehet në punë e sipër. Por rëndësi ka çështja që kritika duhet bërë e hapët, ashtu sikurse vepruan shokët e byrosë së komitetit të Partisë në këtë mbledhje. Shoku Pirro Bozo tha që s'ishte dakord me ngritjen e shkollës në formën e arsimit shëtitës, pasi në kushtet tuaja, argumentoi ai, ajo nuk jep rezultate. Është jashtëzakonisht mirë kur mendimet thuhen hapur. Qëndrimi parimor dhe kritika e hapët revolucionare, siç bëtë ju këtu, inkurajohen nga Partia. Nga sa pashë, asnjëri s'mbajti këtu rezerva se mos i vijë keq njërit apo tjetrit. Dhe shumë mirë që nuk mbajtët gjë të fshehtë.

Tani shtrohet detyra që këto kritika t'i reflektoni mirë dhe t'i korrigjoni të metat. Mund të ketë ndonjë shok që akoma nuk e ka kuptuar e nuk e ka realizuar plotësisht kritikën. Veproni në këtë rast siç u tha këtu, kur njëri sheh se shoku s'e ka kuptuar kritikën, të shkojë tek ai, të bisedojë shtruar e ta kuptojë më mirë. Në qoftë se zgjidhet puna në mirëkuptim me njëri-tjetrin, s'është nevoja të shtrohet në mbledhje. Megjithatë është shumë mirë kur shoku që ka gabuar ngrihet vetë në mbledhje, bën autokritikë dhe i thotë organizatës se tani është plotësisht i qartë për gabimin që në fillim nuk e kuptonte, të tregojë se si shokët e ndihmuan gjersa u sqarua dhe atje të zotohet se gabimin nuk do ta përsëritë më. Shikoni sa mirë do të jetë po të veprohet kështu.

Ne, intelektualët, kur na kritikojnë, na vjen një çikë thartë në fillim, por si komunistë që jemi, reflek-

tojmë dhe, kur dalim nga mbledhja themi: mirë bëri organizata që na qortoi. Ne e kuptojmë drejt se shokët në organizatë nuk na kritikojnë për të na dënuar, ose për të na ulur autoritetin, përkundrazi, që të bëhemi më të mirë dhe të zhdukim të metat e dobësitë, të cilat na pengojnë për arritjen e rezultateve më të mira. Duke i njohur të metat kur i kemi dhe, duke pasur një thesar të tillë kuadrosh e punëtorësh, në rast se i forcojmë mirë lidhjet me ta, do të kemi pa dyshim rezultate shumë më të mira në punë dhe do të bëjmë një hop edhe më të madh përpara.

Mendoj se të gjitha mbledhjet duhet t'i përgatitim mirë, që të jenë sa më efektive. E them sinqerisht se përfitova shumë nga mbledhja juaj. Me këtë rast ju uroj suksese në kryerjen e detyrave ashtu siç dëshiron Partia. Të jeni kurdoherë revolucionarë e të guximshëm në zbatimin e direktivave, në mbrojtjen e vijës së Partisë, të jeni të çiltër, të flitni pa druajtje, me cilindo që të jetë. Mirë apo gabim, secili mendimet duhet t'ia thotë hapur Partisë, sepse edhe po të ketë diçka gabim, Partia e ndreq. Një luftë e një jetë e tillë në gjirin e Partisë e bën këtë të fortë si çeliku.

Ju shokët që jeni zgjedhur anëtarë të rinj të byrosë së komitetit të Partisë në rreth, do ta keni një çikë të vështirë tani në fillim sa të organizoni mirë lidhjet, të njihni format e metodat e punës së udhëheqjes. Mos u kufizoni vetëm në ato që do të mësoni nga shokët, po mendoni edhe vetë për të gjetur forma më të mira të punës, për të dhënë rendiment edhe në punën tuaj si udhëheqës. Pastaj organizoni punën në një mënyrë të tillë që jo vetëm të keni suksese por



edhe të mos dëmtoheni ekonomikisht. Partia ju zgjodhi në udhëheqje, duke kërkuar njëkohësisht që të jeni punëtorë. Dhe pikërisht pse jeni punëtorë ka vlerë ardhja juaj në udhëheqje. Partia do që energjitë, mendimet, shkathtësitë dhe shpirtin tuaj të sakrificës t'i sillni këtu në udhëheqje. Nuk e kam fjalën vetëm për kohën që harxhoni në mbledhje të byrosë, pse fundi i fundit këto mund të bëhen edhe pasdrekeve, por juve ju duhet të veni edhe në bazë. Po të shkosh në bazë si era dhe sa për t'u dukur, nuk do të bësh asnjë punë dhe masat me të drejtë do të të thonë: «Dale një herë, se s'të pamë kush je». Partia i kritikon me rreptësi të tilla qëndrime formale; drejtuesi duhet të shkojë në bazë jo një herë, po disa herë dhe në shumë vende. Prandaj të gjitha këto vajtje të shokëve të udhëheqjes në bazë duhet t'i shohim me kujdes që më parë, me qëllim që puna e Partisë të ecë si duhet, por edhe ekonomia personale apo familjare e shokut punëtor që është zgjedhur në drejtim të mos dëmtohet.

Shikoni shokë sa shumë kuadro dhe kaq të mirë ka Partia në bazë! Këta ne duhet t'i ngarkojmë me përgjegjësi të mëdha, pse kështu Partia do të jetë në gjendje të ecë vazhdimisht përpara, në çdo sektor.

Ju, punëtorët dhe fshatarët, që jeni zgjedhur në udhëheqje, jeni një forcë e madhe për Partinë dhe jam i bindur se me punën që do të bëni, do ta forconi më tej organizatën. Nga gjiri i Partisë kanë dalë kurdoherë kuadro të tillë të thjeshtë, si ju, shumë të vlefshëm. Disa nga ju tani jeni sekretarë organizatash, por kam bindjen se jeni të aftë dhe keni mundësi të

drejtoni më shumë. Ju duhet të bëni që masa e komunistëve dhe gjithë punonjësit t'i kuptojnë mirë politikisht dhe ideologjikisht vendimet e Partisë dhe të Qeverisë. Sqarimi dhe bindja si duhet për zbatimin e rregullave, të vendimeve dhe organizimi i mirë i masave që do të sigurojnë realizimin e tyre, të cilat nuk bëhen aq lehtë dhe aq shpejt, varet pikërisht nga kuptimi i drejtë politik e ideologjik i problemit.

*Pasi foli për disa çështje që kanë të bëjnë me demokracinë kooperativiste, për gjallërimin e punës në brigada, në sektorë, në përfaqësi e në asamble, shoku Enver Hoxha tha:*

Edhe me klasën punëtore ne kemi, gjithashtu, shumë për të bërë, duhet të punojmë vazhdimisht për edukimin e saj, sepse ka nga ata punëtorë që nuk e kuptojnë si duhet politikisht problemin teknik, nuk zbatojnë me rreptësi rregullat e ndërmarrjes dhe të disiplinës së punës. Në këto kushte ne duhet të bëjmë një punë konkrete politike dhe ideologjike, jo me slogane, po kurdoherë lidhur ngushtë me problemin. Kur flasim për disiplinën e punës në sondë duhet të zbatojmë me rreptësi çdo normë dhe rregull që ka të bëjë me funksionimin dhe mirëmbajtjen e saj. Po t'ia shpjegojmë ato si duhet punëtorit që t'i zbatojë me doemos gjatë punës së tij në sondë, ku duhet të kërkohet me rreptësi një disiplinë tekniko-shkencore e rreptë dhe njëkohësisht një disiplinë politike, ai do të bëhet i disiplinuar dhe do të punojë kudo me ndërgjegje jo vetëm në sondë, por edhe në jetë, në shtëpi, në shoqëri e në familje. Prandaj të punojmë që t'ua futim të gjithëve në shpirt ndjenjën e rregullit e të di-

siplinës. Veçse nuk mjafton të japim këshilla e porosi, por edhe të kontrollojmë zbatimin deri në fund të tyre. Punëtorit të cilin e porositim të lajë duart para se të fillojë punën në sondë dhe ia shpjegojmë edhe përse duhet të veprojë kështu, t'ia kërkojmë që ta zbatojë këtë. Kjo e bën atë të ndërgjegjshëm, e bën jo vetëm të mbahet i pastër në punë, por edhe në shtëpi, ku pastaj do t'i bëhet shprehi dhe do të vërë rregull e disiplinë edhe te fëmijët.

Pra, na mbetet të bëjmë akoma shumë në këto drejtime, por rëndësi ka çështja që jemi në rrugë të drejtë. Kudo ka një hov të madh mobilizues në punë dhe në realizimin e detyrave. Të metat nuk na bëjnë pesimistë, nga ato nuk kemi frikë. Njerëzit që punojnë, është e qartë, se edhe mund të gabojnë, po Partia duhet të përpiqet që t'i ndihmojë të ndreqen, të korrigjohen. Pozitivja te njerëzit tanë është shumë e madhe dhe kjo duket nga fakti që vija jonë ideologjike, politike dhe organizative vlerësohet lart dhe respektohet nga opinioni i komunistëve dhe i revolucionarëve kudo në botë. Edhe armiqtë, megjithëse nuk e duan, kanë respekt për Shqipërinë. Ata na luftojnë, por në të njëjtën kohë janë të detyruar të njohin se Shqipëria dhe vija që ndjek ajo janë të palëvizshme. Armiqtë e socializmit janë kundër nesh dhe kundër marksizmit, por nuk mund të mos e shikojnë të vërtetën dhe drejtësinë e vijës sonë në të gjitha drejtimet.

Armiqtë nuk janë dakord me demaskimin që ne i bëjmë revizionistit Dubçek, tek i cili ata shpresonin shumë. Partia jonë kishte deklaruar me kohë se ai është një revizionist dhe këtë parashikim tonin e provuan

ngjarjet e zhvilluara në Çekosllovakë. U vërtetua se Dubçeku është një satelit i revizionistëve sovjetikë, gjersa ai nuk u rezistoi pushtuesve revizionistë. Megjithëkëtë, sovjetikët e kanë shumë të vështirë situatën në Çekosllovakë. Edhe vetë Dubçeku me shokë po i binden me zor pushtimit sovjetik, prandaj revizionistët sovjetikë përpiqen t'i likuidojnë udhëheqësit aktualë çekosllovakë, me qëllim që të vënë në Çekosllovakë njerëz më besnikë.

Qëndrimi i Shqipërisë ka bërë përshtypje të madhe në Çekosllovakë. Të shumtë janë njerëzit e thjeshtë çekosllovakë që e kanë pëlqyer qëndrimin tonë. Elementët që qëndrojnë në pozita të avancuara revolucionare jo vetëm e aprovuan që në fillim qëndrimin e Partisë sonë, por edhe e propagandonin atë. Edhe ata që megjithëse në fillim, ishin dakord me qëndrimin tonë vetëm se u dukej si ca i tepruar kundër Dubçekut e Svobodës, tashti e pranojnë plotësisht këtë qëndrim dhe pohojnë se ne kemi pasur qysh në fillim të drejtë. Këtë e thonë jo vetëm elementët revolucionarë dhe miqtë e Shqipërisë, por edhe masat.

Shokë të përfaqësisë sonë në Pragë, kur u takon të hanë në ndonjë restorant, vënë re se duke mos u njohur nuk u jepet për të ngrënë, sepse kujtojnë se janë sovjetikë. Por, kur marrin vesh se janë shqiptarë, u kërkojnë të falur dhe u shërbejnë shpejt. Në një rast, lajmi se ata ishin shqiptarë e jo «rusë» u hap në gjithë restorantin dhe njerëz të thjeshtë, civilë dhe ushtarakë çekosllovakë, u ulën pranë tyre dhe u thanë: «S'ka si ju shqiptarët, ne dëgjojmë përnatë Radio Tiranën, e cila na frymëzon, na jep gjallëri dhe na arma-

tos për rezistencë. Rroftë Shqipëria! Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë!». Pastaj vazhdojnë të flasin për «rusët», duke i cilësuar hapur armiq, pse u kanë pushuar atdheun. Njëri prej tyre u tha se kur pat biseduar një ditë me një ushtar sovjetik, ai nuk dinte asgjë për arsyet që e kishin çuar në Çekosllovakë. Një tjetër tregoi se kishte biseduar me një oficer sovjetik dhe ky i kishte thënë se donte të dezertonte. Të tilla thënie fliten në masë dhe tregojnë pakënaqësinë edhe të ushtarëve sovjetikë. Në Çekosllovakë është një situatë mjaft e turbullt për revizionistët sovjetikë, që e kanë të vështirë ta ndreqin.

Atë që revizionistët sovjetikë bënë në Çekosllovakë kërkojnë ta bëjnë edhe me Rumaninë, por hezitojnë. Do ta bëjnë apo jo, kjo nuk dihet akoma, vetëm një gjë dihet me siguri: Rumanisë po i bëjnë presione të mëdha. Rumunët, hiqen sikur çoç janë, por s'kanë asnjë ndryshim nga revizionistët e tjerë. Ata bashkëpunojnë ngushtë me Titon, nëpërmjet të cilit dëshirojnë të lidhen me Shtetet e Bashkuara të Amerikës; kanë marrëdhënie të shumta me sovjetikët, por kanë shumë frikë prej tyre. Duke e ditur që udhëheqësit rumunë janë të frikshëm, revizionistët sovjetikë u bëjnë presione të mëdha. Tashti udhëheqësit sovjetikë u kanë kërkuar rumunëve të bëjnë manovra në tokën e tyre dhe me këtë rast përpiqen të futin ushtritë brenda në Rumani. Rumunët e dinë mirë se po u futën sovjetikët në territorin e tyre, edhe sikur t'i ndjekin, nuk do të dalin më. Prandaj nuk guxojnë ta pranojnë këtë kërkesë. Revizionistët sovjetikë u thonë rumunëve se gjersa jeni pjesëtarë të Traktatit të Varshavës, të pak-

tën ejani të merrni pjesë në manovrat që do të bëjmë së shpejti në Gjermani. Po rumunët as në Gjermani nuk dëshirojnë të shkojnë, duke u përpjekur të gjejnë gjithfarë justifikimesh para sovjetikëve. Ata po luajnë me njëri-tjetrin si macja me miun. Për arsye të refuzimit nga ana e rumunëve, revizionistët sovjetikë në Gjermani, në vend të manovrave të Traktatit të Varshavës, që gjoja kishin ndër mend të bënin, do të bëjnë vetëm manovra shtabi. Me këtë ata synojnë të ndalojnë mbledhjen që do të bëjnë revanshistët e Bonit në Berlinin Perëndimor, lidhur me zgjedhjen e presidentit të Republikës Federale. Por ky është vetëm një bluf, pse sovjetikët po bëjnë përpjekje të mëdha nga ana e tyre që të rregullohen vetë me Bonin. Rumunët refuzuan të çojnë forca në Gjermani, duke menduar se më vonë do të vijë radha që të tilla manovra të bëhen edhe në vendin e tyre, që është anëtar i Traktatit të Varshavës. Mirëpo edhe të dalin nga ky Traktat, udhëheqësit rumunë kanë frikë. Rumunët për vështirësitë që kanë me sovjetikët na kanë folur haptazi se nuk veprojnë dot si ne. Megjithëse rumunët pretendojnë se janë trima, udhëheqësit e tyre nuk kanë guximin ta denoncojnë këtë Traktat, siç bëjnë ne.

Udhëheqjen bullgare, Zhivkovin me shokë, revizionistët sovjetikë e kanë qind për qind satelit të tyre, por jo popullin bullgar, i cili është kundër. Haptazi flitet në Bullgari që Zhivkovi është shumë i diskredituar në popull, por atë, natyrisht, e mbajnë në fuqi sovjetikët, që kanë futur ushtrinë e tyre në Bullgari. Deklarata demaskuese që bëjnë ne, duke i sulmuar

zyrtarisht dhe botërisht revizionistët sovjetikë dhe bullgarë, ishte plotësisht e bazuar dhe e drejtë. Ushtarë sovjetikë tani ka në të katër anët e Bullgarisë.

Në Jugosllavi situata e brendshme është e turbullt, ndjenjat nacionaliste në të tëra republikat po ziejnë si në një kazan, prandaj gjendja në këtë vend është bërë çorbë. Vetëm prania e Titos dhe gjoja frika e një sulmi sovjetik kundër Jugosllavisë, i bën këto nacionalitete të kenë hëpërhë njëfarë uniteti sa për sy e faqe.

Frikën më të madhe Titoja e ka nga shqiptarët e Kosovës, sepse ata kanë qenë më të shtypur jo vetëm në kohët e para, por edhe gjatë regjimit titist. Por titistët tashti së fundi u detyruan t'u japin shqiptarëve disa të drejta. E drejta e flamurit nuk është diçka e vogël. Tani kosovarët kanë fituar të drejtën të mbajnë flamurin shqiptar me shkabë e me yll si tonin, luftojnë me guxim të hapin shkolla më shumë etj., kritikojnë regjimin titist që e ka lënë Kosovën të pazhvilluar ekonomikisht etj. Këto pak të drejta që kanë filluar t'u jepen shqiptarëve, titistët i bënë nga halli dhe jo nga malli dhe luftojnë në mos t'u hiqen, të paktën të mos u zgjerohen më tej. Rezistenca e shqiptarëve të Kosovës duket edhe në demonstratat e tyre në Prishtinë dhe në disa qytete të tjera të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit. Këto demonstrata i kanë trembur shumë jugosllavët. Indirekt gazetat e tyre mundohen të nxjerrin sikur këto demonstrata i kemi nxitur ne këtej nga Shqipëria. Për këtë titistët nuk na akuzojnë dot direkt, për shkak të frikës që kanë nga kosovarët. Nga ana tjetër, titistët e dinë që, po të na

ngacmojnë, atëherë ne do t'u japim përgjigjen e merituar.

Demonstratat e zhvilluara me sukses në Kosovë kanë nxitur për aksion edhe shqiptarët e Maqedonisë. Këtu shtypja e demonstratave ishte më e rreptë, megjithatë të arrestuarit nuk i kanë dënuar akoma. Shtypja e demonstruesve në Maqedoni ishte më e rreptë sepse situata për titistët atje është akoma më e vështirë, sepse Bullgaria ushqen rivendikime të hapëta ndaj Republikës Maqedonase, duke pretenduar se «Maqedonia është bullgare». Për ta argumentuar këtë, mbahen simpoziume, mbledhje akademike, shkruhen artikuj, botohen libra etj. Në këtë situatë ndodhën demonstratat e shqiptarëve në Kosovë, prandaj kjo çështje atje u ndërlikua shumë. Në Maqedoni, pra, titistët demaskojnë propagandën bullgare, sulmojnë udhëheqjen bullgare dhe rivendikimet nacional-shoviniste bullgare (shovinistët atakojnë shovinistët!). Nga ana tjetër, ndaj shqiptarëve e shtuan më tej shtypjen, duke gjetur si pretekst demonstratat që u zhvilluan në Kosovë. Megjithatë, as në Maqedoni titistët nuk do të mund të japin dot dënime të rënda, mbasi çështja e shqiptarëve përbën një gangrenë të madhe për ta. Trazira lindën edhe në Mal të Zi ku ka shumë shqiptarë. siç janë ata të Gucisë, Plavës, Ulqinit etj.

Revizionistët jugosllavë kanë kërkuar të dërgojnë delegacione studentësh kosovarë në Shqipëri për të treguar se gjoja po bëjnë përpjekje që të përmirësojnë marrëdhëniet me Shqipërinë. por në të vërtetë ata kanë frikë nga këto marrëdhënie. Ne kishim disa marrëdhënie tregtare me një numër firmash të Kosovës, të



cilat blinin mallrat tona, por, kur u bënë demonstratat, Beogradi u dha urdhër atyre që t'i presin këto marrëdhënie dhe kanë kërkuar që, po të duam, këtë tregti ne ta bëjmë me Malin e Zi. Është krejt e qartë për ne përse tremben kaq shumë udhëheqësit revizionistë jugosllavë, ata shikonin se kosovarët blinin mallra shqiptare. Kur kosovarët blejnë një vazo me reçel ose një paketë cigaresh që kanë markë nga Shqipëria, u marrin erë, u heqin etiketat dhe i mbajnë si kujtim të çmuar. Një patriotizëm i zjarhtë ekziston në Kosovë, prandaj, siç thashë, udhëheqësit revizionistë jugosllavë kanë shumë frikë nga lëvizja e shqiptarëve kosovarë.

Udhëheqësit jugosllavë, sido që janë revizionistë, kanë edhe mosmarrëveshje me revizionistët sovjetikë. Në këtë qëndrim ndikon shumë politika që ndjekin ndaj Jugosllavisë Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sovjetikët kanë planet e tyre në drejtim të Jugosllavisë, veçse i bëjnë mirë llogaritë, pse po ta sulmojnë, jugosllavët do të luftojnë. Ne e dimë se popujt e Jugosllavisë nuk pranojnë të pushtohen dhe të sundohen nga jashtë.

Revizionistët sovjetikë kanë shumë armatime, po brenda nuk e kanë të shëndoshë gjendjen politike. Imperializmi amerikan dhe borgjezia e madhe botërore po bëjnë shumë bujë, duke vënë në dukje sikur revizionistët sovjetikë gjoja po rehabilitojnë Stalinin, megjithëse vetë e dinë se ky është një bluf. Por, meqenëse në Bashkimin Sovjetik, si duket, situata e brendshme është shumë e vështirë dhe figura e Stalinit luan rol, për ta zbutur ca rezistencën kundër udhëheqjes aktuale tradhtare, revizionistët po bëjnë disa manovra,

me të cilat përpiqen të tregojnë sikur duan ta rehabilitojnë Stalinin, prandaj kanë nxitur disa mareshalë që të shkruajnë për të hedhur poshtë një pjesë të poshtërsive të Hrushovit kundër Stalinit. Këta mareshalë si Zhukovi, Konjevi e të tjerë kanë botuar libra të tyre, në të cilët thonë se Stalini ka qenë një udhëheqës i shquar, që dëgjonte me vëmendje të gjitha raportet, kritikën e sugjerimet e udhëheqësve ushtarakë. Borgjezia e di që këta libra janë sa të parrezikshëm, aq edhe të pafuqishëm, megjithatë ata janë si thika me dy presa, prandaj ka frikë edhe bërtet sikur tani gjoja «po rehabilitohet Stalini» në Bashkimin Sovjetik. Në fakt, Stalini atje nuk po rehabilitohet, por me këtë revizionistët sovjetikë synojnë, nga njëra anë, të shmangin rezistencën e revolucionarëve, për të cilët Stalini është shumë i dashur dhe, nga ana tjetër, të fshehin degjenerimin e partisë dhe të diktaturës së tyre fashiste ushtarake duke treguar sikur gjoja janë në rrugën e Stalinit. Tradhtarët revizionistë sovjetikë, me këto masa, përpiqen të gënjejnë njerëzit sikur gjoja po kthehen në rrugën e Stalinit.

Revizionistët sovjetikë janë tani një grup tradhtarësh e kapitalistësh të rinj, politika e të cilëve është lidhur ngushtë me atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste. Por kjo s'do të thotë që ata janë dakord në të gjitha çështjet me njëri-tjetrin, pse kanë edhe shumë kontradikta midis tyre, siç ka edhe në gjirin e imperialistëve e të kapitalistëve me njëri-tjetrin, sidomos midis Francës, nga njëra anë, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Anglisë, nga ana tjetër...

Ju e dini se Dë Goli është vetë një kapitalist i madh dhe përfaqësues i borgjezisë së madhe franceze, që ndjek politikën e rritjes së madhësisë së Francës. Synimi i tij është ta godasë imperializmin amerikan për të mos sunduar dot jo vetëm mbi Francën, por mundësisht as mbi Anglinë. Ai dëshiron ta drejtojë vetë kapitalin evropian, në forma «demokratike», qoftë edhe në aleancë me Gjermaninë Perëndimore, por me kusht që kapitali francez të dominojë në Gjermani, në Angli, në Itali, në vendet e Beneluksit<sup>1</sup> etj. Në realitet, mosmarrëveshjet dhe kontradiktat në mes Dë Golit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë të mëdha dhe të vjetra. Ato fillojnë qysh në kohën e luftës kur kapitali amerikan është sjellë shumë brutalisht ndaj klasës kapitaliste që përfaqëson Dë Goli, duke preferuar në vend të tij deri në fund Vishinë, Petenin, Darlanin e të tjerë.

Pra, situata që po zhvillohet në vendet revizioniste dhe kapitaliste tregon se të gjithë armiqtë e socializmit janë në krizë të madhe të përgjithshme politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake, në të gjitha drejtimet. Aleancat e tyre, të formuluarat e të përfunduara në hava, nuk janë të shëndosha. Për shembull, Franca me Gjermaninë kanë lidhje miqësie dhe marrëveshje, çdo vit krerët shtetërorë të niveleve të larta venë e vijnë te njëri-tjetri, por, në të njëjtën kohë, ata kanë midis tyre mosmarrëveshje të theksuara, pse interesa të kundërt i ndajnë. Republika Federale e Gjermanisë hiqet si aleate e Francës, po çfarë aleate

---

1 Belgjika, Holanda, Luksemburgu.

mund të jetë ajo gjersa dëshiron të sundojë mbi Francën? Një nga gazetarët e gazetës «Lë Mond» të Francës i thoshte ambasadorit tonë një ditë se «Gjermania e Bonit na është bërë si një kaposh i madh dhe dëshiron të sundojë mbi Francën, po kjo kohë nuk do të vijë kurrë».

Lindja e Mesme është një pikë nevralgjike në duart e revizionistëve sovjetikë dhe të imperialistëve amerikanë. Të dyja palët shikojnë vetëm interesat e tyre në këtë zonë, prandaj nuk kanë ndër mend që të zgjidhet drejt asgjë. E vetmja gjë pozitive në ngjarjet e Lindjes së Mesme është rezistenca me armë e luftëtarëve palestinezë. Megjithatë këta nuk janë shumë të pavarur në veprimtarinë e tyre luftarake...

*Botohet për herë të parë me shkurtime sipas tekstit të procesverbalit të mbledhjes së byrosë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit që gjendet në AQP*

# SI DUHET T'I KUPTOJMË DHE T'I ZGJIDHIM DREJT DISA ÇËSHTJE TË EKONOMISË SONË SOCIALISTE

*Fjala në mbledhjen me punëtorë, kooperativistë  
dhe kuadro të rrethit të Beratit*

26 shkurt 1969

E gjithë jeta, zhvillimi dhe përparimi material e shpirtëror i shoqërisë sonë socialiste kanë në themel punën, mendjen dhe zemrën e punonjësve. Ata janë zotër të vetvetes, punojnë, krijojnë e drejtojnë në mënyrë të vetëdijshme të udhëhequr nga Partia, duke u mbështetur në njohjen e në përdorimin e ligjeve të socializmit. Qëllimi i gjithë veprimtarisë së tyre është ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit.

Punonjësit, duke vepruar mbi natyrën, e njohin atë gjithnjë e më shumë, zbulojnë ligjet e zhvillimit e të transformimit të saj të pandërprerë dhe i përdorin ato për të përvetësuar pasuritë e saj të pakufishme, prodhojnë të mirat materiale, me të cilat plotësojnë si nevojat e konsumit vetjak, ashtu edhe ato të riprodhimit të zgjeruar. Ky është një proces i natyrshëm, i pandërprerë dhe i pafund prodhimi e konsumi.

Kur prodhimet janë me sasi të mjaftueshme dhe me cilësi të mirë, punonjësit ndiejnë kënaqësi të madhe, sepse u plotësohen si duhet nevojat dhe ngrihet vazhdimisht niveli i jetesës. Këtu synojnë edhe planet tona të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës. Ky është qëllimi më i lartë, nga i cili udhëhiqen në gjithë veprimtarinë e tyre Partia e shteti ynë.

Por ka edhe raste, kur disa nga prodhimet mungojnë, ose nuk janë me cilësi të mirë. Atëherë masat punonjëse ndiejnë njëfarë pakënaqësie dhe, me të drejtë, bëjnë e duhet të bëjnë edhe kritikë. Kjo është plotësisht e arsyeshme dhe e domosdoshme, përndryshe të metat dhe gabimet në realizimin e planeve tona ekonomike, si në sasi dhe në cilësi, nuk do të luftohehin dhe nuk do të ndreqeshin.

Po të analizojmë këtë çështje më me hollësi, do të dalim në këtë konkluzion të përgjithshëm: kur masat punonjëse kritikojnë dhe ankohen për mungesën e ndonjë prodhimi apo për cilësinë e tij, duhet ta kuptojnë se janë ato vetë përgjegjëse për këtë, se fajtorët janë ndërmjet tyre, sepse në regjimin tonë socialist janë pikërisht masat që prodhojnë e drejtojnë. Kësaj së vërtete askush nuk mund t'i shpëtojë ose t'i bëjë bisht. Të gjithë, kur jemi si konsumatorë, kur blejmë diçka për vete apo për fëmijët, kërkojmë të gjejmë çdo gjë dhe të cilësisë së mirë e sa më të lirë. Pa dyshim që këto janë kërkesa të drejta. Por përse jemi kaq ekzigjentë si konsumatorë, ndërsa kur jemi prodhues, kur punojmë në fabrikë apo në arë, nuk e kërkojmë këtë gjë të gjithë edhe nga vetja, duke u përpjekur me këmbëngulje që çdo mall, që del nga duart tona, ta

nxjerrim shpejt, me cilësi të mirë dhe me kosto sa më të ulët? Natyrisht, ka mjaft punonjës të cilët punojnë mirë dhe i realizojnë planet, por shumë herë edhe këta kanë dobësitë e tyre, sidomos për sa i përket cilësisë. Ka të tjerë që çalojnë nga të dy këmbët, si për sasinë, ashtu edhe për cilësinë.

Në këto të meta e dobësi kanë pjesën e vet, kush më shumë e kush më pak, të gjitha degët e ekonomisë: industria, bujqësia, transporti, tregtia etj. Të mos kujtojnë se mbeten pa pjesën e tyre të fajit, bile edhe më të madhe, administrata, drejtuesit, qofshin këta të qendrës ose të bazës, sepse edhe këta kanë përgjegjësi të madhe që punët të venë mbarë në planifikim, në drejtim, në shpërndarje, në furnizim etj.

Kur mungon ndonjë prodhim bujqësor, qytetari qahet dhe e ka në majën e gjuhës kritikën, «nuk punon mirë fshatari», thotë. Edhe kur punëtori nuk prodhon sa duhet dhe si duhet, qytetari qahet përsëri, sepse nuk i plotësohen disa nevoja as si sasi, as si cilësi. Edhe në këtë rast fajin ai ia hedh më pak vetes, sesa tregtisë ose administratës, që nuk i parashikojnë dhe nuk i shpërndajnë drejt mallrat. Tregtia dhe administrata, s'ka asnjë dyshim, kanë fajin e tyre, por populli thotë një fjalë: «Faji u bë qyrk dhe nuk e vesh njeri». Megjithatë, te ne nuk ngjet plotësisht kështu, sepse masat punonjëse edukohen nga gabimet dhe të metat e tyre, i njohin këto në përgjithësi dhe bëjnë autokritikë.

Është me vend dhe e drejtë që të kritikohet fshatari, kur ai i ka mundësitë dhe nuk prodhon atë që

duhet dhe sa duhet. Por kjo lypset ta bëjë edhe qytetarin të mendojë thellë për të punuar e për të prodhuar sa më shumë dhe me cilësi të mirë. Secili qytetar duhet t'i bëjë pyetje vetes: «Unë vetë dhe kolektivi ku punoj jemi vallë në rregull?». Të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe fshatari. Analizën e ndërgegjes së vet duhet ta bëjë gjithashtu edhe çdo nëpunës i pushtetit, i administratës, ose punëtor partie.

Kështu duhet të gjykojmë e të veprojmë të gjithë, përndryshe anomalitë, të metat e dobësitë e pjesshme e të përkohshme të ekonomisë sonë, nuk do t'i kuptojmë drejt dhe nuk do të mund të nxjerrim konkluzionet e duhura për të përmirësuar më tej punën tonë.

Le të marrim një rast nga jeta e përditshme. Ndodh që blerësit bëjnë vërejtje, kur në ndonjë rast këpucët s'janë as të mjaftueshme as të forta. Kjo është një vërejtje plotësisht e drejtë. Por, kur ato nuk dalin të mira nga fabrika, kjo nuk ndodh kurdoherë dhe vetëm për faj të saj, sepse shpesh edhe fshatari nuk tregon kujdesin e duhur për cilësinë e lëkurës, ose nuk realizon planin e përmirësimit e të shtimit të lopëve, të derrave, të bagëtive të imëta etj. Faj kanë, gjithashtu, edhe punonjësit e fabrikave tona të lëkurëve, që shpesh nuk i regjin këto as në kohën e duhur, as edhe me cilësinë që kërkohet e kështu me radhë. Është për këto arsye që tregtia importon lëkurë, por kjo natyrisht, sillet me sasi të paktë, sepse aq është vendosur. Nganjëherë bile sillet edhe me cilësi më të dobët.

Le të marrim edhe një rast tjetër. Disa herë ndodh,



për shembull, që vajzat e Myzeqesë bëjnë kritika për disa nga tekstilet tona të pambukta që nuk janë të cilësisë së mirë. Edhe kjo është një kritikë e drejtë. Por le ta shohim pak më nga afër këtë çështje. Përse ngjet kështu?

Të marrim, së pari, atë që duhet të bëjnë punonjësit e bujqësisë. Dihet se pambuku është një bimë shumë delikate. Po të mos zbatohen me përpikëri kodi agroteknik dhe gjeneracioni, nuk ka si të merret cilësia që kërkohet. Pas gjeneracionit të pestë në farën «108 F», për shembull, gjatësia e fijos bie nga 32 mm në 30 mm. Mirëpo çdo milimetër ulje e gjatësisë është barazi me 3 për qind të uljes së rendimentit në kombinatet e tekstileve, gjë që çon në dobësimin e cilësisë së tekstileve. Cilësia e pambukut keqësohet edhe kur punonjësit e bujqësisë punojnë sipas praktikës «ç'është e bardhë duhet vjelur», pa e ndarë prodhimin gjatë vjeljes sipas cilësisë dhe shkallës së pjekurisë. Vitin që kaloi nuk iu dol me kohë përpara edhe luftës kundër krimbit të pambukut (kloridea opsoleta), i cili e dëmtoi shumë prodhimin dhe, si pasojë edhe e faktorëve të tjerë, u krijua një deficit prej rreth 5 500 tonë pambuk të pastruar. Kjo e detyron shtetin të importojë pambuk, në vend që me këtë fond të importonte bojëra më të mira për ngjyrosje ose mallra të tjera të nevojshme për popullin dhe për ekonominë. Dhe puna pastaj shkon zinxhir në uzinat e zhveshjes së pambukut. Edhe në këto, kur nuk respektohet me rreptësi procesi teknologjik, dëmtohet më tej cilësia e pambukut. Ky bie pastaj në duart e punonjësve të tekstileve. Në goftë se edhe këta bëjnë lëshime në punë, lejojnë të

meta etj., si përfundim pëlhura do të dalë me fije të këputura, me dendësi e rezistencë të pamjaftueshme, me njolla në ngjyrosje etj., etj. Të gjitha këto ndikojnë për keq në cilësinë e tekstileve tona.

Po kështu mund të ndikojë për keq edhe puna jo e mirë e punonjësve të transportit e të tregtisë. Dhe ky është një rreth i mbyllur. Kështu ngjet, ku më shumë e ku më pak, edhe me prodhimin e mallrave të tjera të industrisë ose të bujqësisë.

Pra, nuk është e drejtë prirja për të kritikuar më shumë të tjerët sesa veten, për t'i lidhur jo si duhet problemet e secilit me problemet e përgjithshme dhe të harrojmë se të gjitha këto çështje janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe, më së fundi, kur vjen puna te interesi personal, ta vëmë këtë mbi interesin e përgjithshëm. Kjo nuk pajtohet me karakterin shoqëror të prodhimit socialist, por mbi të gjitha me marrëdhëniet e reja midis punonjësve dhe me ligjet ekonomike të socializmit, sipas të cilave, në shoqërinë tonë, secili duhet ta shohë punën e vet jo të shkëputur, por si pjesë të së tërës.

Me këtë sy duhet t'i gjykojnë veprimet e tyre edhe ata drejtues e kolektiva punonjësish që nuk tregojnë kujdesin e mjaftueshëm për të plotësuar realizimin e planit të disa mallrave të ashtuquajtura «të vogla», të decentralizuara e me vlerë të paktë, por që për popullin dhe për ekonominë janë shumë të nevojshme. Të dëmshme e të gabuara janë edhe ato raste kur luftohet për realizimin e planit në global (vetëm në vlerë) dhe nuk punohet me këmbëngulje e disiplinë të rreptë për të realizuar të gjitha asortimentet e planifikuara, të

gjitha mallrat e parashikuara për t'iu dhënë popullit, ekonomisë.

Gjithashtu, duhet të bëhet e qartë për të gjithë se kur dikush kërkon nga shoqëria, nga shteti, më parë duhet të japë, sepse nuk kanë nga të dalin të ardhurat për t'i siguruar ato që kërkohen jashtë parashikimeve, kur plani dhe zotimet nuk realizohen si duhet e sa duhet. E njëjta gjë duhet thënë edhe për ato raste, kur fondi i pagave tejkalohet ose kërkohet të bëhen shtesa në të, ndërsa rendimenti nuk rritet. Qëndrime të tilla burokratike janë shfaqje të hapëta të vënies së interesit të ngushtë të ndërmarjes, të rrethit apo të dikasterit, mbi interesat e përgjithshëm të popullit, të socializmit, janë shfaqje të mungesës së përgjegjësisë ndaj shoqërisë, të shkeljes së disiplinës së planit.

Në këtë kuadër neve na dalin edhe shumë probleme të metodologjisë e të formave të planifikimit që duhen studiuar e rishikuar me vëmendje të madhe, me qëllim që të vihen në rrugë të drejtë, në përshtatje me fazat e zhvillimit dinamik të ekonomisë sonë dhe të braktisen format që nuk u përshtaten situatave të reja që krijon ky zhvillim.

Prandaj të gjithë duhet të ndiejmë thellë e të forcojmë përgjegjësinë kolektive për çdo gjë. Po ashtu, bile edhe ca më tepër, ne duhet të ndiejmë e të rritim te çdo punonjës edhe përgjegjësinë personale, sepse kështu rritim njëkohësisht përgjegjësinë kolektive. Pra, duhet të mësohemi të kontrollojmë medoemos punën e të tjerëve, por njëkohësisht dhe më përpara të vendosim një «vetëkontroll» në punët tona, gjë që do të thotë autokritikë, korrigjim, kalitje e ndërjegjes so-

cialiste. Kjo çështje duhet të kthehet në një lëvizje të madhe revolucionare.

Në kokën e ndonjërit, i cili nuk ka haber nga zhvillimi i ekonomisë dhe nga ligjet socialiste që e drejtojnë këtë zhvillim, nganjëherë lindin mendime të mykura. Në rast se ai nuk gjen sa i duhet dhe kur i duhet në dyqan diçka që i nevojitet, thotë: «Përpara në dyqane gjeje ç'të doje, lloj-lloj basmash, këpucësh etj.». Por vetëm ai harron, kurse të rinjtë nuk e dinë fare se përpara kishte shumë pak dyqane, vetëm në disa qytete dhe shumë të paktë ishin ata që kishin para të blinin. Shitësit vrisnin miza dhe po të hyje në dyqan «rrëzonin raftet» për të të shitur diçka. Dhe kjo ngjiste jo sepse kishte bollëk, ose sepse punonjësit i kishin plotësuar nevojat, përkundrazi, ai që një bollëk i rremë, krizë nga fukarallëku i masave. Të varfrit i shikonin me dylbi këto dyqane e mallrat e tyre; atyre mezi u dilte të blinin edhe bukën, kripën, vajgurin, a një palë opinga, që i kishin të domosdoshme.

Kështu ndodh edhe sot në vendet ku në fuqi është kapitali, ku, pavarësisht nga koniunkturat e përkohshme që krijohen dhe nga të cilat krijohen iluzione për gjoja një ngritje të nivelit të disa shtresave të punonjësve, si ligj i përgjithshëm, atje krizat dhe papunësia, ku më shumë e ku më pak, prekin masa të gjera të proletariatit të qytetit dhe të fshatit. Kështu, hendeuku që ndan të pasurit nga të varfrit thellohet çdo ditë e më shumë dhe masat e gjera të punonjësve vazhdimisht vuajnë edhe për kafshatën e gojës.

Krejt ndryshe ndodh sot te ne, ku të gjithë punojnë, është siguruar një nivel mesatar jetese për tërë

popullin dhe secili, sipas të ardhurave që merr në bazë të punës, ka mundësi të blejë, të konsumojë dhe kështu të plotësojë në mënyrë të kënaqshme e të pandërpre-rë nevojat e tij të përditshme. Një rrjet i gjerë i treg-tisë socialiste është shtrirë në çdo fshat, edhe në skajet më të largëta të vendit tonë, ku gjen nga të tëra mall-rat që tregtohen edhe në qytet. Prandaj, ta vlerësosh realitetin tonë me kutin e së kaluarës, do të thotë të rrosh jashtë çdo realiteti.

Nuk qëndron aspak edhe ndonjë «mendim» i ço-roditur si ky: «Përpara, mor vëlla, gjeje mallra me cilësi të mirë, sepse ekzistonte konkurrenca, e cila s'e lejonte kapitalistin të prodhonte gjëra të këqija, mbasi i mbeteshin pa shitur». Ai që mendon kështu, meritat e sasisë së prodhimit të të mirave materiale dhe të cilësisë së tyre pa asnjë bazë ia vesh sistemit kapita-list, kapitalistit dhe konkurrencës.

Së pari, kapitalistët kurrë nuk kanë punuar vetë e s'kanë prodhuar asgjë, sepse vetëm punëtorët e fsha-tarët punojnë e prodhojnë. Duke i parë me këtë sy, kapitalistët janë parazitë, jetojnë në kurriz të të tjerë-ve, shfrytëzojnë e përvetësojnë punën e punëtorit e të fshatarit punonjës, talentet e tyre.

Së dyti, konkurrenca për të cilën flasim njerëz të kësaj kategorie, siç do të theksoj më poshtë, nuk ishte e nuk është gjë tjetër veçse një metodë shtypëse dhe përcisioni, karakteristikë e shoqërisë kapitaliste. Men-dimi i atyre të cilët lavdërojnë konkurrencën, nisët nga pozita nihiliste, për të përçmuar mallrat tona dhe për të mbivlerësuar ato që prodhohen në vendet kapi-taliste.

Është e vërtetë që disa mallra të jashtme janë me cilësi më të mirë se ndonjë mall yni, por midis tyre ka edhe shumë surrogato. Nga ana tjetër, gjërat duhen parë realisht, në zhvillimin e tyre dialektik. Sa për mirësim janë bërë në mjaft nga mallrat tona në krahasim, jo shumë larg të themi, por edhe me disa vjet më parë! Me një pjesë të tyre, ne kemi çarë e po çajmë me sukses edhe në tregjet e jashtme, me gjithë konkurrencën e egër imperialisto-revizioniste. Pastaj në këtë drejtim, duhet mbajtur parasysh edhe një çështje tjetër: ne luftojmë me të vërtetë për cilësinë, por në të njëjtën kohë edhe në atë masë duhet të vazhdojmë të luftojmë edhe për sasinë, sepse prodhimi ynë duhet të plotësojë jo vetëm nevojat e një grupi njerëzish, siç kërkohej në rendin çifligaro-borgjez, por të të gjitha masave të popullit, si në qytet dhe në fshat, si në lushë ashtu dhe në malësi. Prandaj punonjësit tanë duhet të mbajnë kurdoherë parasysh parullën: «Të kthejmë fytyrën nga cilësia, pa i kthyer shpinën sasisë». Kurse kapitalisti, në qoftë se qëllimin e tij kryesor, sigurimin e fitimit maksimal, e arrin edhe duke prodhuar më pak, por me cilësi më të mirë e me një çmim më të lartë, aq i bën që masat e popullit vuajnë dhe mbeten pa sendet më të nevojshme të jetesës.

Në këtë çështje nuk mund të mos mbahen parasysh pastaj edhe traditat. Zhvillimi industrial i mjaft vendeve kapitaliste ka një histori shekullore, kurse ne e kemi filluar çdo gjë nga hiçi, vetëm përpara 25 vjetëve, pas Çlirimit të atdheut. Megjithatë, punonjësit tanë të talentuar nuk flenë mbi sukseset e arritura, se ata janë të ndërgjegjshëm që neve na mbetet akoma

shumë e shumë për të bërë lidhur me cilësinë. Këtij qëllimi i shërben edhe revolucioni tekniko-shkencor që po thellohet pandërprerë në vendin tonë.

Partia jonë, duke vënë kurdoherë në themel të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës sonë socialiste parimin marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta, e vlerëson këtë si një parim të madh revolucionarizues, që shërben për të mobilizuar të gjitha burimet e brendshme materiale, financiare e njerëzore, që frymëzon e nxit mendimin krijues të masave, që rrit besimin e tyre në vetvete, që i përgatit ato të zgjidhin çdo problem e të kapërcejnë çdo vështirësi që del në rrugën e ndërtimit tonë socialist. Por ky parim nuk përjashton përpjekjet që duhet të bëhen edhe në të ardhmen për të përfituar sa më shumë edhe nga realizimet në fushën e shkencës e të teknikës që arrijnë popujt e tjerë.

Mendimet e gabuara që përmenda më lart e që ekzistojnë në kokën e disave janë mbeturinë e botëkuptimit të vjetër të zhvillimit kapitalist të ekonomisë, të metodave të tij shfrytëzuese, të marrëdhënieve kapitaliste në prodhim. Duke iu qepur këtyre mbeturinave, mbeturinat e interesit personal dhe të pronës private i bëjnë këta njerëz të harrojnë, ose të mos shikojnë në dritën e vërtetë zhvillimin e mrekullueshëm e të harmonishëm të ekonomisë sonë socialiste, ligjet e saj, marrëdhëniet e reja në prodhim dhe, si rrjedhim, të drejtat dhe detyrat e secilit në zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë sonë socialiste.

Prandaj, po t'i kuptojmë çështjet drejt, ashtu siç na porosit Partia, atëherë do të kemi rezultate edhe më të mëdha gjatë zhvillimit tonë të pandalshëm. Si-

gurisht, ne në këtë frymë po ecim, po duhet ta përmirësojmë më tej punën, se jo vetëm kemi akoma shumë për të bërë, por edhe sepse e mira nuk ka kurrë fund.

Lufta Nacionalçlirimtare, revolucioni popullor, të udhëhequr nga Partia jonë, zhdukën përgjithmonë te ne kapitalistin dhe kapitalizmin shfrytëzues, tok me ideologjinë dhe me metodat e tyre, por nuk kanë zhdukur dot akoma mbeturinat e ideologjisë së tyre në ndërgjegjen e njerëzve dhe pikërisht në këtë drejtim Partia jonë po zhvillon një luftë frontale. Populli ynë mori në dorë fuqinë dhe tani është ai që bën ligjin, që drejton, administron, prodhon e konsumon. Pra, tani te ne ekziston prodhimi i zgjeruar për një konsum shumë të zgjeruar. I gjithë ky proces zhvillohet pa shfrytëzues dhe pa të shfrytëzuar. Por duhet kuptuar drejt se ky zhvillim, megjithëse shumë i vrullshëm dhe që çdo ditë e më shumë ecën përpara, nuk do të thotë se ka arritur stadin që nevojitet për një konsum të mjaftueshëm si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Jo, ne kemi shumë e shumë për të bërë në këtë drejtim, prandaj janë tendosur të gjitha energjitë fizike dhe mendore të një populli të tërë, punëtor dhe të talentuar, siç është populli ynë.

Sistemi ynë socialist është sistemi shoqëror më i përparuar, domethënë sistem që hap rrugën më të gjërë për përparimin më të madh material, mendor, shpirtëror, kulturor dhe të teknikës moderne; kurse sistemi borgjez kapitalist është në kalbëzim, i destinuar të vdesë, të zhduket. Nga pikëpamja strategjike kapitalizmi është mundur nga socializmi. Duke filluar që me fitoren e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit,



të udhëhequr nga Lenini dhe gjatë periudhës së ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini, u vërtetua në jetë, në praktikë, se ka ardhur koha që kapitalizmi t'ia lëshojë vendin socializmit. Aktualisht socializmi, i bazuar në parimet revolucionare marksiste-leniniste, po ndërtohet në Republikën Popullore të Shqipërisë dhe idetë e tij kanë pushtuar dhe po pushtojnë sot mendjet dhe zemrat e masave punonjëse kudo në botë.

Populli ynë, nën udhëheqjen largpamëse të Partisë, me punë vetëmohuese dhe frymë të lartë revolucionare, po ndërton një botë të re, socialiste, me parullën e vet luftarake: «Të mbajmë në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën».

Më konkretisht. Në fushën e ekonomisë ne po luftojmë, dhe me sukses, për ngritjen e një bujqësie krejt të re socialiste me një të ardhme të madhe. Dhe provat dalin të gjalla e shumë bindëse, po të bëjmë krahasim me të kaluarën. Por a ia kemi arritur ne asaj që do Partia? Jo, kemi akoma shumë për të bërë që bujqësia jonë të prodhojë sa duhet dhe si duhet.

Dikush mund të thotë se në vendet kapitaliste bujqësia është më e përparuar dhe jep rendimente të larta. Kjo nuk është e vërtetë për të gjitha këto vende. Edhe atje ku ekziston ky fakt, ai nuk i detyrohet sistemit kapitalist, por shfrytëzimit të egër të njerëzve nga ky sistem.

Shkenca, dituritë për bujqësinë, eksperiencia e përparuar e njerëzve në këtë fushë dhe mjetet e përparuara të punës, krijohen dhe përvetësohen. Kjo te ne është vetëm çështje kohe. Sistemi socialist dhe

mundësitë kolosale që ai ka krijuar, njerëzit e çliruar përgjithmonë nga shtypja e shfrytëzimi kapitalist, do t'i djegin etapat, do ta arrijnë dhe do ta tejkalojnë kohën e humbur, do ta errësojnë zhvillimin e bujqësisë kapitaliste dhe do të shkatërrojnë njëkohësisht edhe vetë sistemin kapitalist.

I njëjti fenomen ngjet e do të ngjasë edhe në lëmin e industrisë. Ç'ndryshime të mëdha kanë ngjarë në vendin tonë në këtë fushë! Çdo gjë filloi nga zeroja. Ku ishim dhe ku jemi! Perspektiva e së ardhmes së vendit tonë është e shkëlqyer. Atë që ka bërë regjimi ynë socialist brenda një kohe kaq të shkurtër, një regjimi kapitalist do t'i duheshin me qindra vjet...

Të njëjtin hop të madh bëri industria edhe në Bashkimin Sovjetik sa kohë që ekzistonte atje diktatura e proletariatit, ndërsa sot mjerisht këtu sundojnë kapitalistët e rinj revizionistë, të cilët bazat e shkencës, të teknikës e të industrisë së përparuar sovjetike, përpiqen t'ia atribuojnë vetes dhe të gjitha këto i shfrytëzojnë për interesat e qëllimet e tyre tradhtarë.

Dikush mund të thotë se në vendet kapitaliste industria është shumë përpara. As kjo nuk është e vërtetë për të gjitha këto vende. Bota kapitaliste nuk përbëhet vetëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anglia dhe disa vende të tjera industriale, por edhe nga Afrika, Amerika Latine, Indonezia, Spanja, Portugalia dhe sa e sa vende të tjera, të cilat përbëjnë shumicën e kësaj bote dhe duke qenë nën regjimin kapitalist, kanë mbetur shumë prapa. Ky është pikërisht edhe shkaku kryesor që masat e gjera qindramilionë-

she të popujve të këtyre vendeve jetojnë në varfëri, papunësi e skamje të madhe, të përhershme e nën thundrën e regjimeve reaksionare fashiste. Pastaj edhe kapitalistët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë dhe të disa vendeve të tjera kapitaliste më të zhvilluara për arritjen e këtij zhvillimi kanë shfrytëzuar jo vetëm punëtorët e fshatarët e vendeve të tyre, por, gjatë disa qindra vjetëve, kanë shtrydhur në mënyrën më barbare djersën e gjakun e qindra miliona njerëzve dhe kanë grabitur pasuritë e mëdha natyrore të vendeve të tjera. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë sot shfrytëzuesi më i madh ndërkombëtar, kështjella kryesore e kolonializmit dhe e reaksionit botëror, armiku më i egër i popujve të të gjithë botës. Të shtytur nga lakmia e papërmbajtur për fitime ata nuk ndalen përpara asnjë mjeti, as agresioneve dhe luftërave. Megjithatë edhe brenda vetë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, polarizimi i popullsisë është aq i madh, sa ndërsa Mōrganët e Rokfelerët me shokë bëhen gjithnjë më të pasur dhe zotërojnë miliarda dollarë e pasuri të tjera përrallore, miliona punëtorë amerikanë dhe popullsia zezake vuajnë çdo ditë për bukën e gojës, nga skamja, papunësia, injoranca e sëmundjet. Bile edhe ata punëtorë që janë në punë, rrojnë vazhdimisht me frikën se mos mbeten pa punë dhe nën kërcënimin se kapitalistët mund t'i hedhin në rrugë të madhe. Prandaj, edhe në ato vende ku ka ndonjë zhvillim, ai nuk i detyrohet sistemit kapitalist, por shfrytëzimit barbar fizik dhe shpirtëror të njerëzve nga ana e këtij sistemi çnjerëzor.

Kështu, përparimi në fushën e prodhimit bujqësor

apo industrial në disa vende kapitaliste, nuk është meritë e kapitalizmit, por pikërisht rezultat i mendjes, i mundit dhe i punës krijuese të të shfrytëzuarve, kurse kapitalistët, duke përdorur sundimin e tyre barbar, vetëm përvetësojnë frytet e këtij përparimi.

## II

Në sistemin kapitalist frika e papunësisë dhe e urisë i detyron punëtorët, të cilët shfrytëzohen egërsisht, të prodhojnë mallra me cilësi të mirë, që kapitalisti të mund të nxjerrë sa më shumë fitime dhe t'i bëjë ballë konkurrencës. Në socializëm punëtori dhe fshatari punojnë dhe prodhojnë për veten e tyre, për lumturinë e tyre dhe të fëmijëve të tyre. Për këtë arsye, këtu është në radhë të parë ndërgjegjja ajo që i shtyn ata të plotësojnë detyrat dhe të prodhojnë mallra me cilësi të mirë. Në shoqërinë socialiste, në këtë drejtim luan dhe duhet të luajë një rol gjithnjë e më të madh emulacioni socialist.

Për të përmirësuar më tej punën në kryerjen e detyrave që na vë Partia për realizimin e planeve ekonomike dëshiroj të theksoj, qoftë edhe shkurtimisht, si duhet t'i kuptojnë dhe t'i zbatojnë në jetë punonjësit tanë mësimet e mëdha të Leninit për emulacionin e garat socialiste.

Në sistemin socialist lind një emulacion i madh në gjirin e punonjësve. Po ç'do të thotë emulacion në socializëm? Emulacioni socialist është metodë vetëveprimi, initiative të guximshme e krijimtarië të masave të

gjera punonjëse për ndërtimin e socializmit e të komunizmit, për kalitjen e ndërgjegjes së tyre revolucionare.

*«Emulacioni socialist, na mëson Stalini, është shprehja e autokritikës revolucionare konstruktive të masave, që mbështetet në iniciativën krijuese të miliona punonjësve»<sup>1</sup>.*

Vendosja e diktaturës së proletariatit dhe e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit, rritja e pareshtur e vetëdijes revolucionare, puna për shoqërinë, për vete, janë burimi vendimtar për lindjen e këtij emulacioni në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore.

Në kundërshtim me atë çka ndodh në shoqërinë socialiste, në kapitalizëm vepron konkurrenca e egër dhe e verbër. Ç'do të thotë konkurrencë në kapitalizëm? Konkurrenca është lufta për jetë a vdekje midis kapitalistëve për të siguruar fitime sa më të mëdha në kurriz të popullit punonjës. Parimi i konkurrencës është shkatërrim dhe vdekje e disave, fitore e sundim i disa të tjerëve. E tërë kjo përleshje zhvillohet me thikë ndër dhëmbë, sipas ligjit të xhunglës «peshku i madh e ha të voglin». Në stadin e sotëm të imperializmit konkurrenca është ndezur, ashpërsuar e zgjeruar jashtë çdo mase midis degëve të ekonomisë, midis monopoleve kombëtare e ndërkombëtare kundër njëri-tjetrit, midis monopoleve e ndërmarrjeve të pamonopolizuara, brenda bashkimeve monopoliste dhe deri mi-

1 J. V. Stalin, Veprat, vëll. 12, f. 108.

dis vetë shteteve imperialiste, për të ndarë tregjet e sferat e influencës, për të grabitur popujt e pasuritë e kolonive e të vendeve të varura. Konkurrenca është ligj objektiv dhe bashkudhëtar i pashmangshëm i mënyrës kapitaliste të prodhimit, që rrjedh nga prona private dhe anarkia në prodhim.

Në luftën e konkurrencës kapitalistët s'tërhiqen përpara asnjë mjeti. Ata shtojnë shtypjen e shfrytëzimin e punonjësve, nxjerrin në rrugë të madhe miliona punëtorë të papunë, ngrenë çmimet, falsifikojnë mallrat, organizojnë një reklamë të shfrenuar çoroditëse e mashtruese, praktikojnë gjerësisht me qëllime shfrytëzimi eksportimin e mallrave e të kapitalit, duke shkatërruar e duke vënë nën sundimin e vet ekonominë e vendeve të tjera, militarizojnë ekonominë, praktikojnë spekulimet monetare e financiare, «shpikjet» amerikane të gangsterizmit, të martesave me qëllime tregtare e të hedhjes në erë të pronës së kundërshtarit me anë të dinamitit dhe deri në agresione të hapëta kundër popujve. Në këtë luftë, ata kanë në anën e vet e shfrytëzojnë gjithë makinën politike, propagandistike, ekonomike dhe militariste të shtetit që është në duart e tyre.

E gjithë kjo përleshje e egër dhe e pamëshirshme konkurrence rrit në përpjesëtime të pashembullta fitimet maksimale të borgjezisë monopoliste dhe shton varfërinë, skamjen e mjerimin e masave të gjera punonjëse. nga të cilat kapitalistët shtrydhin çdo ditë e më shumë gjak e djersë. Për të fshehur nga masat punonjëse fitimet e veprimet e tyre antipopullore, monopolet përdorin mënyra të ndryshme mashtruese, që

nga përfshirja në shpenzimet e prodhimit të normave të rreme shumë të mëdha të amortizimit të mjeteve të prodhimit, zbatimi i të ashtuquajturit sistem të pagës me pjesëmarrjen e punëtorëve në fitim, që aq shumë trumbetohet nga lakenjtë e borgjezisë, e deri te falsifikimi i dokumentacionit kontabël etj.

Ndërsa emulacioni socialist është katërcipërisht i kundërt me konkurrencën kapitaliste.

Emulacioni socialist nxit iniciativën e guximshme; të kundërtën bën konkurrenca të krijuesit e vlerave materiale, të cilët e dinë se iniciativa e tyre në kapitalizëm u sjell fitime vetëm padronëve.

Emulacioni socialist nxit dhe zhvillon mendimin krijues të masave, kurse konkurrenca kapitaliste nxit spekulimet financiare.

Emulacioni socialist e bën njeriun të guximshëm dhe të lirë të mendojë e të veprojë, kurse konkurrenca kapitaliste nxit despotizmin, e bën njeriun frikacak dhe servil përpara padronit.

Emulacioni socialist mobilizon dhe fut në lëvizje masat e gjera të punëtorëve, lejon shkëmbimin e lirë dhe të frytshëm të eksperiencës së gjithsecilit në interesin e përgjithshëm, gjë që ndihmon në ngritjen tekniko-profesionale të të gjithëve, zbulon talente të reja. Të kundërtën e këtyre bën konkurrenca kapitaliste. Ajo e përdor talentin për spekulim individual e monopolizëm. Konkurrenca kapitaliste nxit ndjenjën individualiste dhe automatizmin shabllon në punë për masat e punëtorëve.

Emulacioni socialist i krijon dhe i kalit njeriut ndjenjën e lartë se ai punon për gjithë shoqërinë, pra

me njerëzit për rritjen e vazhdueshme të ndërgjegjes e të frymës së tyre revolucionare.

Pjesë e pandarë dhe e gjallë e organizimit të emulacionit socialist është publiciteti në mënyrën e në format më të mira, të thjeshta, të qarta e të kuptueshme, për të përhapur shembullin e më të mirëve në prodhim, në organizim, në disiplinë dhe në të gjitha çështjet e tjera që përmban emulacioni. Mendimi krijues po çan përpara edhe në këtë fushë, po gjen mënyra e forma të reja, duke organizuar ekspozita, konsulta, këmbim delegacionesh; shtypi, radioja dhe të gjitha mjetet e tjera të propagandës po përhapin të rejat e prodhimit, shembullin pozitiv dhe motivet e larta revolucionare që nxitin punonjësit tanë në emulacion.

Gjithnjë, lidhur me këtë çështje, duhet t'u jepet fund shfaqjeve të formalizmit e të shabllonizmit, punës me hope e me fushata si në qytet, por veçanërisht në fshat. Të mos lejohet që për garat socialiste dhe përhapjen e shembullit pozitiv të interesohen vetëm disa komisione që ngarkohen me këtë detyrë. Bërthamë, ku duhet të ziejë emulacioni, të bëhet ndërmarrja, kooperativa bujqësore, reparti, brigada e skuadra. Garat socialiste, zotimet që merren, duke u mbështetur në direktivat e Partisë, duhet të dalin nga gjiri i masës, në konsultim me të dhe të jenë me të vërtetë iniciativë krijuese e tyre. Në organizimin e zhvillimin e garave të përdoren më gjerësisht dhe të përsösen më tej format e stimulit moral.

Në tërë këtë kompleks problemesh të emulacionit socialist, organizatat e bashkimeve profesionale dhe organizatat e tjera të masave, nën drejtimin e Partisë,



të kërkojnë e të gjejnë format më të përshtatshme e më efektive të punës së tyre. Sivjet sidomos, në kuadrin e 25-vjetorit të Çlirimit e të fitores së revolucionit popullor dhe për nder të tij, në çdo qendër pune e kooperativë, me forma nga më të ndryshmet, duhet të shpërthejë një emulacion i paparë.

Natyrisht, kur themi emulacion socialist ne kuptojmë njëkohësisht cilësi e jo vetëm sasi, kuptojmë organizim sa më të përsosur, disiplinë shembullore dhe jo shthurje, anarki e lëshime të tjera të këtij lloji. Të tilla të këqija duhen thyer kudo ku shfaqen, pa ngurrim e në çdo rast.

Duke e kuptuar drejt emulacionin socialist, duhet t'u bëhet një luftë e vazhdueshme parazitëve, spekulatorëve të shpërdorimit të vlerës së kohës së punës, shkelësve të disiplinës në punë e të zbatimit drejt e me sukses të teknikës. Të luftohen, gjithashtu, pikëpamjet idealiste dhe mikroborgjeze në kuptimin e interesit e të përfitimit personal, iluzionet sentimentale individualiste.

Punëtorët tanë të rinj, të cilët nuk e kanë njohur shtypjen kapitaliste, duhet të bëhen vazhdimisht të ndërgjegjshëm nëpërmjet edukimit ideopolitik. Ata duhet të kuptojnë se vetëm tani, në socializëm, njerëzit ngritën kokën dhe drejtuan shpinën, se në socializëm njeriu ka mundësi të punojë për shoqërinë, pra edhe për veten e tij, ka mundësi t'i ketë plotësisht të tijat mjetet e punës dhe të mbështetet lirisht dhe me guxim krijues në teknikën e përparuar, në shpikjet e reja, në shkencën dhe kulturën moderne.

Klasa jonë punëtore, e edukuar brenda kaq vje-

tëve nga Partia me një punë këmbëngulëse, duke thyer e përbuzur shtypësit e djeshëm, ka fituar një eksperiencë të madhe në problemet organizative. E njëjta gjë ka ngjarë edhe me fshatarësinë kooperativiste, e cila tani është në gjendje të organizojë punën në prodhimin e madh, të organizojë kooperativat dhe punën brenda tyre. Punëtorët dhe fshatarët jo vetëm e kanë fituar këtë eksperiencë për organizim, por me iniciativë po e zgjerojnë atë gjithnjë dhe po e bëjnë më të përsosur. Iniciativa ka shumë rëndësi dhe, kur asaj i shtohen dituria dhe eksperiencia, kthehet në një forcë të madhe vepruese, që nuk njihet kufi në rezultate; ajo rrëzon male.

Në këtë ndryshim të madh të kuptimit të çështjeve do ta gjejmë ne arsyen përse punëtorët dhe fshatarët tanë janë të etur për mësim, për dituri, përse ata po mësojnë dhe po përparojnë në mënyrë të vrullshme.

Lufta i bëri ata të ndërgjegjshëm se janë të zotë të drejtojnë, të ndërtojnë e të prodhojnë. Njerëzit e të ashtuquajturave klasa të ditura, të destinuara të drejtonin, s'ishin veçse xhahilë, shtypës dhe gjakpirës injorantë, «zero me xhufkë», siç thotë populli. Bejlerët, agallarët e «njerëzit e mësuar» në shërbim të tyre, s'mungonin që tok me kërbaçin dhe me rrjepjen e lëkurës, t'u jepnin punëtorëve dhe fshatarëve edhe këshilla. Por ç'vlerë kishin këshillat e tyre? Ç'rezultate jepnin në praktikë këto këshilla? Asgjë! Zhvillimi ekonomik, arsimor e kulturor i vendit, nën sundimin e borgjezisë dhe të feudalëve, e vërteton këtë gjë katërcipërisht. Gjithçka që bëhej në atë kohë ishte vetëm

fryt i djersës, i mundit dhe i punës praktike të fshatarit, të punëtorit e të zanatçiu. Po ta vëmë afër e afër këtë kohë me kohën tonë të ndërtimit socialist, s'ka asnjë krahasim. Nga ky ballafaqim dalin dy gjëra: se bejlerët, agallarët, gjakpirësit e gjithë parazitët duheshin likuiduar nga rrënjët, siç u likuiduan, dhe se punëtorët, fshatarët ishin çdo gjë, ishin një forcë e madhe krijuese, vendimtare, forcë që, kur mori fuqinë, nën udhëheqjen e Partisë, bëri dhe po bën mrekullira.

Nga zhvillimi i vrullshëm i vendit tonë drejt socializmit, ne duhet të nxjerrim edhe një konkluzion tjetër. Punëtorët dhe fshatarët tanë, që iu përveshën punës për ndërtimin e socializmit, a ishin të mësuar, a ishin ata të ditur, a e zotëronin shkencën e teknikën moderne dhe a kishin ata në duart e tyre mjete moderne? Jo! Po atëherë si bënë? Praktika i mësoi, ajo u hapi atyre horizonte për të studiuar dhe zgjeruar dijet e tyre, ajo i ndihmoi t'i verifikojnë ato në jetë. Kjo, edhe në realitetin tonë, vërteton tezën marksiste-leniniste se praktika qëndron në bazë të çdo diturie, në bazë të teorisë. Praktika i mësoi punëtorët dhe fshatarët tanë të kërkonin dhe të gjenin format dhe metodat më të mira të organizimit të punës dhe të luftës. Ata fituan kështu eksperiencë, iu hapën horizonte dhe iu lindën dëshira të zjarrta t'i zgjeronin dituritë, të pasuroheshin me eksperiencën e tyre dhe të të tjerëve. Kështu ata filluan të mësojnë dhe të përvetësojnë diturinë, ta lidhin atë me jetën dhe ta kthejnë në praktikë.

Por, duke i dhënë vendin e vet të madh dhe që i përket me të drejtë praktikës, kjo te ne nuk duhet të çojë asnjëri në pikëpamjen e gabuar dhe të huaj për mark-

sizëm-leninizmin, në nënvleftësimin e rolit të madh të teorisë. Armatosja e njerëzve tanë me botëkuptimin marksist-leninist dhe me dijeni të thella shkencore, si edhe mritja e aftësive të tyre profesionale mund të realizohen vetëm në unitetin dialektik midis praktikës dhe teorisë. Ky proces është i vazhdueshëm dhe i pafund. As punëtori, as fshatari i mësuar në socializëm dhe ca më pak intelektual, nuk duhet ta harrojnë këtë unitet dhe veçanërisht rolin vendimtar të praktikës. Pa praktikën, pa zbatimin në jetë në mënyrë të plotë dhe të organizuar, dituria, këshillat e bukura akademike nuk vlejné asgjë, ato janë si një stoli pa vlerë. «Këshillat dhe metodat e urta» të atij intelektual që i rritet mendja, që shkëputet nga jeta, nga praktika, janë shterpë; ato nuk të japin asgjë, as bukë, as këpucë, as gjalpë, as mish dhe as shtëpi. Një intelektual i tillë nuk tregon gjë tjetër, veçse intelektualizmin e tij të sëmurë, boshllëkun e tij, në radhë të parë e mbi të gjitha, në formimin ideologjik me botëkuptimin tonë marksist-leninist, gjë që e bën atë të mos dijë përse punon dhe kujt duhet t'i shërbejë. Prandaj është e udhës dhe e drejtë që klasa punëtore dhe kooperativistët, në rast se ia duan të mirën një intelektual të tillë, vetëkuptohet për ta ndrequr dhe edukuar, duhet ta vënë atë të punojë së bashku me ta, që të futë duart deri në llërë në vajra e në baltë. Intelektualët, të rinjtë, nuk duhet të ruhen se mos u ndoten duart e rrobat nga puna, sepse ato mund të lahen e të ndërrohen brenda ditës e disa herë në ditë. Rëndësi ka fakti që pikërisht kjo lloj «ndotjeje» spastron nga ndërgjegjja njollat e së kaluarës, nuk lejon të mbijnë, në të, ba-

rëra të egra e të helmuara të ideologjisë borgjeze revizioniste. Në rast se do të ketë ndonjë intelektual që nuk i pëlqen kjo rrugë, që nuk do të korrigjojë veten, atëherë klasa punëtore dhe kooperativistët me të drejtë duhet të mos i japin atij as bukë, as këpucë dhe as dhomë ku të futë kokën për të ëndërruar dhe «filozofuar» në kuptimin e keq të kësaj fjale.

Përse t'i zbutet zemra klasës punëtore dhe fshatarësisë sonë nga të tillë njerëz, qofshin këta të dalë edhe nga gjiri i tyre? Përse duhet të preken ato nga butësia dhe sentimentalizmi i sëmurë për t'i nxjerrë sytë vetvetes, për të penguar ecjen tonë përpara? Apo për të lënë që të lindë e të krijohet në mes nesh një shtresë intrigantësh e sabotatorësh të socializmit? Në asnjë mënyrë nuk duhet të mbylлим sytë dhe ta lejojmë një gjë të tillë! «Mëshira» në këto raste është shprehje e sentimentalizmit mikroborgjez dhe shumë e dëmshme. Klasa punëtore dhe fshatarësia kooperativiste duan punë, duan ndershmëri, duan kontroll dhe llogari nga të gjithë.

Në dritën e këtij kompleksi të madh problemesh, të këtyre zgjidhjeve të thella dhe të drejta parimore marksiste-leniniste që po u jep atyre vendosmërisht Partia, të këtij botëkuptimi kaq të drejtë të popullit për to, të këtij entuziazmi revolucionar dhe mobilizimit total të masave punonjëse, problemet për emulacionin socialist marrin një kuptim të madh dhe të qartë. Emulacioni socialist dhe garat socialiste, të kuptuara thellë në këtë kuadër të madh e të ndritur të realitetit tonë socialist, të kuptuara në mënyrë të gjithanshme politikisht e ideologjikisht dhe të vëna organiza-

tivisht si duhet në zbatim, kthehen në një forcë kolosale që zhvillojnë e i perfeksionojnë më tej forcat prodhuese e marrëdhëniet shoqërore në prodhim, zhdukin e luftojnë të metat, luftojnë të ligjtë e parazitët, shtojnë diturinë dhe perfeksionojnë praktikën, rritin mirëgenien e masave punonjëse.

Duke marrë parasysh rëndësinë e emulacionit socialist, që është njëkohësisht një problem politik, ideologjik dhe organizativ, dëshiroj të theksoj se në këtë drejtim asgjë nuk duhet lejuar për t'i dhënë atij një zhvillim shkel e shko të një pune rutinë e shabllone, duke u udhëhequr gjoja nga pozita që të veprohet njëlloj kudo. Ky farë uniteti në shabllonizëm, siç e thekson Lenini, nuk ka të bëjë aspak me centralizmin demokratik. Shabllonizmi në këtë fushë, si edhe në çdo fushë tjetër, është pjella e dështuar e atyre që u kanë rrjedhur trutë, që s'vrasin mendjen, që s'lodhen e s'punojnë, që nuk janë të lidhur me masën, e cila punon, lodhet, krijon e prodhon.

Punonjësit tanë, të edukuar nga Partia, janë plotësisht në gjendje të kuptojnë thellë se ku duhet uniteti, bile i çeliktë, por për gjërat themelore, për gjërat parimore. Ata e kuptojnë drejt se pa centralizmin demokratik marksist-leninist nuk mund të ecet, por ata kuptojnë gjithashtu thellë çështjen, që, për të zhvilluar si duhet emulacionin, nuk hyn fare në punë formalizmi dhe shabllonizmi, por duhet varietet në çdo gjë, në veçoritë e natyrës së punës, të vendit, të metodave, sepse e tillë është në realitet edhe vetë përmbajtja e problemeve të emulacionit.

Si konkluzion i gjithë këtyre që u thanë më lart,

ne, njerëzit që jetojmë dhe luftojmë në socializëm, duke punuar e ndërtuar, duhet të mësojmë dhe të kuptojmë me rrënjë ekonominë politike të socializmit, e cila jo vetëm do të na sqarojë fenomenet e përkohshme negative të rritjes, që duken aty-këtu gjatë punës sonë ndërtimore, por edhe do të na çlirojë nga mbeturinat e nocioneve e të kategorive të ekonomisë kapitaliste, do të na hapë horizonte të gjera dhe do të na armatosë për detyrat e mëdha që kemi për të kryer në të ardhmen. Ne duhet t'i përvishemi pandërprerë studimit, përvetësimit dhe zbatimit, në të gjitha fushat e jetës, të shkencës dhe të teknikës moderne të përparuar.

Në këtë drejtim detyra të mëdha për t'i bërë njerëzit të ndërgjegjshëm dalin përpara propagandës. Qëllimi i propagandës sonë marksiste-leniniste është i lartë. Duke ditur se njeriu socialist nuk lind në mënyrë spontane me të ndërruar kushtet ekonomike, Partisë i vihet si detyrë që këtë njeri ta formojë dhe ta edukojë me pikëpamje të reja revolucionare, me botëkuptimin e ri materialist, ta bëjë atë të aftë të kuptojë ligjet e zhvillimit të shoqërisë, t'i bëjë të tijat ligjet e shoqërisë sonë, duke përfshirë këtu edhe ligjet ekonomike të socializmit. Pajisja e njerëzve tanë me mendimin marksist-leninist, me virtytet revolucionare, do t'i bëjë ata që të veprojnë aktivisht, të luftojnë me sukses ideologjinë idealiste-borgjeze, mbeturinat mikroborgjeze në veten e tyre dhe te të tjerët, të demaskojnë dhe të luftojnë pikëpamjet metafizike mbi filozofinë, mbi ekonominë dhe mbi teorinë e së vërtetës materialiste.

Njohja e thellë nga punonjësit tanë e ligjeve ekonomike objektive të socializmit do t'i bëjë ata që të

depërtojnë në esencën e fenomeneve të ndryshme ekonomike dhe të nxjerrin prej tyre konkluzione të drejta për një drejtim shkencor të ekonomisë sonë popullore, për të zbatuar me përpikëri vijën e drejtë revolucionare të Partisë.

Në këtë drejtim ka ardhur koha që edhe në propagandimin e problemeve e të çështjeve të ndryshme ekonomike t'u bëhet një luftë e vendosur skemave shabllone, qëndrimeve në sipërfaqe dhe të trajtohen ato sa më thellë, qartë, thjesht e me përmbytje të lartë jo vetëm në plan ekonomik e politik, por edhe në planin ideologjik e teoriko-shoqëror. Propagandimi i problemeve të ndryshme ekonomike duhet të lidhet sa më ngushtë me praktikën, me ndërtimin tonë socialist, me revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit dhe të ndihmojë që punonjësit të kuptojnë e të zbatojnë sa më mirë vijën e Partisë në këtë fushë, që ata të zgjidhin sa më mirë e më shpejt çështjet e ndryshme që u nxjerr përpara zhvillimi dinamik i ekonomisë sonë.

Asgjë nuk mund të jetë e vështirë dhe e parealizueshme për njerëzit tanë të lirë, të guximshëm dhe politikisht të ngritur, që rrojnë dhe luftojnë në shoqërinë tonë socialiste dhe që udhëhiqen me aq kujdes nga Partia jonë revolucionare marksiste-leniniste.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Si duhet t'i kuptojmë dhe t'i zgjidhim drejt disa çështje të ekonomisë sonë socialiste». Tiranë, 1969*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## TE GDHENDURIT E GURIT ESHTË NJË NGA MJESHTËRITË ME TË BUKURA

*Bisedë me pionierët e shkollës «7 Nëntori»  
të qytetit të Beratit<sup>1</sup>*

26 shkurt 1969

Të dashur pionierë,

Jam shumë i gëzuar që po takohem sot me ju, se jeni pionierët e parë të vendit tonë që morët iniciativën për të ndërtuar sërishmi kalldrëmet e qytetit të lashtë e të bukur të Beratit. Në shembullin tuaj kanë filluar tani të bëjnë kalldrëme edhe shumë pionierë të tjerë në vendin tonë.

Punimi i gurit, siç ju kam shkruar në letrën që ju kam dërguar<sup>2</sup>, ka rëndësi të madhe, se me gurë bëhen

---

1 Në këtë bisedë, që u zhvillua me pionierët iniciatorë të punës për shtrimin e rrugëve të qytetit me kalldrëm, merrnin pjesë dhe arsimtarët e kësaj shkolle dhe gurgdhendës pensionistë.

2 Më 27 janar 1967 shoku Enver Hoxha u dërgoi një letër pionierëve të qytetit të Beratit, me të cilën i përgëzon për

shtëpi banimi, ngrihen institucione shoqërore, kulturore dhe ekonomike, ndërtohen rrugë e ura, bëhen statuja të mëdha e sa e sa vepra të tjera që jetojnë për qindra e mijëra vjet dhe që janë të vlefshme për njerëzimin. Edhe në gur mund të pasqyrohen mendimet më përparimtare dhe shijet estetike të popullit, të shprehen frymëzimi më i pastër dhe dëshirat më të zjarrrta të atyre që dinë të punojnë me ta. Të gdhendurit e gurit është një nga mjeshtëritë më të vjetra e më të bukura.

Ju jeni të rinj e do të keni rastin të shikoni ndërtimin e veprave shumë më të bukura e më madhështore jo vetëm nga ato që kanë parë e ndërtuar këta që ju mësuan, por edhe nga ato që po ndërtohen sot. Tani është koha e Partisë, e cila udhëheq ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Te ne ngrihen uzina e fabrika, ndërtohen vepra ujitëse e kulluese që i bëjnë gjithnjë e më pjellore dhe i lulëzojnë fushat tona, ndërtohen pallate, shkolla e spitale, shtëpi kulture, kinema etj., etj. Të gjitha këto ngrihen me sukses çdo vit e më mirë nën udhëheqjen e Partisë, që ka në dorën e saj një armë shumë të fortë, teorinë e klasës punëtore, teorinë e Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit, me të cilën udhëheq klasën punëtore, fshatësinë, inteligjencien tonë, ku bëjnë pjesë edhe mësueset e mësuesit, të cilët ju mësojnë dhe ju edukojnë ju që të bëheni njerëz shumë më të mirë nga ne, kur ishim të vegjël si ju. Në të kaluarën, ne nuk na mësonte njeri gjithë këto gjëra kaq të dobishme për po-

---

iniciativën për ndërtimin e kalldrëmeve të qytetit. (Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 34, f. 413.)

pullin dhe për atdheun, siç ju mësojnë ju sot. Ne u rritëm në kushte të tjera, më të vështira, sidoqoftë, punuam me ndërgegje e ndershmëri, luftuam, sakrifikuam dhe vuajtëm shumë, pikërisht që populli ynë të dilte në dritë dhe të arrinte në këto ditë kaq të bukura e revolucionare që po jetojmë.

Muratorët e vjetër, të cilët po ju mësojnë ju të gdhendni gurë e të bëni kalldrëme, janë nga ata proletarë të vërtetë, për të cilët ju kanë folur shpesh mësuesit në orët e mësimit. Proletarët, si këta, në të kaluarën s'kishin gjë tjetër veç mistrisë dhe rrobave të grisura në trup. Ata ishin të paushqyer mirë dhe jetonin në mëshirën e beut, të agait, të tregtarit, apo të fajdexhiut të pamëshirshëm. Punonin e roboheshin dhe kur mbaronin së ndërtuari shtëpitë e zotërinjve, merrnin si shpërblim vetëm një krodhë bukë dhe disa lekë, që nuk u mjaftonin as për të ushqyer veten, pa lëre për fëmijët që vuanin për bukën e gojës, se për t'i dërguar ata në shkollë, në ato kohë të vështira as që mendohej fare. Përveç kësaj, punëtorët muratorë atëherë i përbuznin dhe i shanin, megjithëse ishin pikërisht këta që ndërtonin me duart e tyre të shkathëta pallatet e pasanikëve e të bejlerëve, të Vrionasve me shokë. Shumë herë këta punëtorë nuk paguheshin për punën e madhe që bënin dhe, në vend të shpërblimit, bejlerët u jepnin dru kokës, ua hanin të drejtën, se atëherë nuk kishte drejtësi për popullin, kurse klasat e pasura i mbronin ligji. Kur erdhi Partia në udhëheqje dhe populli e mori fuqinë në dorë, bejlerët morën dënimin e merituar. Ne u shkatërruam atyre dhe gjithë armiqve të tjerë të popullit, pushtetin e tyre shtypës e mizor dhe po-

pulli i udhëhequr nga Partia erdhi në fuqi dhe vendosi pushtetin e vet.

Në sajë të luftës së popullit, të klasës punëtore, të fshatarësisë e të inteligjencies, të udhëhequra nga Partia, lindi Shqipëria e re socialiste, ku janë ndërtuar dhe ndërtohen tani vepra kaq të bukura. Për ngritjen e tyre po kontribuoni edhe ju, djem e vajza kaq të reja e të gjalla, me ndjenja kaq të pastra. Ju ndiqni si duhet rrugën që ju tregon Partia dhe mësoni si ju porosit ajo. Mësimi ka rëndësi të madhe për ju dhe për shoqërinë tonë, pionierë të dashur. Këtë ju e kuptoni mirë, prandaj duhet të mësoni sa më shumë dhe njëkohësisht edhe të punoni mirë. Kur mësuesja ose mësuesi ju porositin t'i përgatitni vazhdimisht mirë mësimet, të mos bëni gabime në hartime, t'i zgjidhni drejt dhe shpejt problemet e aritmetikës apo ushtrimet e gjuhës, të mbani mend këto ose ato gjëra, duhet t'i kuptoni drejt se sa punë të madhe bëjnë ata dhe sa shumë jua duan të mirën. Prandaj i doni dhe i dëgjoni me respekt duke u përpjekur të përfitonit sa më shumë prej tyre, se janë më të rritur dhe e njohin jetën më mirë, kanë përvojë të madhe në jetë dhe në punë, kanë dituri më shumë dhe dinë ç'nevoja keni ju. Të gjitha këto ata i kanë mësuar në procesin e madh të jetës, pra, që kur kanë qenë të vegjël, kështu si ju, e gjer tani. Partia sot dhe njerëzit përparimtarë e patriotë të së kaluarës i kanë mësuar ata vazhdimisht, ndaj dhe e kuptojnë se pa dituri s'ka jetë, po errësi, siç ndodhte në regjimet e kaluara.

Kur mësuesit dhe edukatorët tuaj ju shpjegojnë mësimin, ju duhet të jeni të vëmendshëm dhe t'i thith-

ni mirë të gjitha dijet që ju japin ata. Shokët më kanë thënë se ju kështu keni bërë dhe kështu po vazhdoni të bëni. Mësimet e Partisë, që jua zbërthejnë mësuesit, i keni kuptuar dhe i kuptoni mirë. Këtë e provon edhe fakti se ju, tok me rëndësinë që i jepni mësimit, ishit të parët që vlerësuat lart rëndësinë e punës dhe dolët me iniciativë për të ndërtuar kalldrëmet e prishura të rrugëve, për të ndërtuar kalldrëme të reja atje ku ndihet nevoja e tyre.

Rruga ka rëndësi të madhe për të gjithë. Në rrugë ju luani me top, me pingël e lojëra të tjera të reja që ne, kur ishim të rinj si ju, nuk i kishim. Rruga është shumë e dashur për cilindo, sepse atje kalon përditë, sepse ajo të lidh me njerëzit, me jetën. Në rrugë kalojnë njerëzit kur venë e vijnë nga puna, në rrugë kalojnë edhe fëmijët kur venë e kthehen nga shkolla. Në rrugë njeriu duke ecur edhe mendon, edhe ëndërron për të ardhmen, domethënë, bën plane me bukë e jo ëndrra të kota. Prandaj rrugët duhet t'i mbajmë kurdoherë të pastra, që të mos kenë gurë të hedhur andej-kënde, as pellgje me ujë që njerëzit të pengohen e të ndoten. Po të ketë gurë, ai që kalon bie e vritet, po të ketë pellgje me ujë, bëhet helaq. Po të ngjasë kështu edhe me ju, kur të veni në shtëpi me siguri nëna do t'ju qortojë e do të thotë: «Po ku u bërë kështu more ditëshkurtër?». Akoma më keq është kur ndonjë i kaluar nga mosha pengohet, nga këto gjëra në rrugë, bie dhe thyen dorën ose këmbën. E shihni, pra, ç'rëndësi të madhe ka rruga? Pastaj, pas pune, në rrugët e mira njerëzit bëjnë edhe shëtitje, se të ecurit forcon shëndetin e njeriut, njëkohësisht edhe e

qetëson shumë atë, prandaj mësuesit e mësueset ju këshillojnë që, pasi të mbaroni mësimin në klasë dhe të bëni detyrat në shtëpi, të dilni edhe jashtë për të luajtur e për të shëtitur me njëri-tjetrin. Shëtitja, si çdo lëvizje tjetër, është me të vërtetë një nevojë e domosdoshme për trupin e njeriut, është një gjë shumë e mirë, por, natyrisht, duhet bërë vetëm pasi të keni kryer detyrën. E them këtë se ka edhe ndonjë pionier jo të rregullt dhe ndonjë të kaluar në moshë, që nuk i kryejnë mirë detyrat, por sillen lart e poshtë gjithë ditën. Kjo do të thotë ta kalosh kohën kot, pa i sjellë dobi si shoqërisë, edhe vetes tënde.

Kur morëm vesh se ju filluat të bënit kalldrëmet, këtë e vlerësuam si një iniciativë shumë të mirë. Unë dhe shokë të tjerë udhëheqës thamë atëherë për ju: «Këto vajzat e djemtë e Beratit qenkan jo vetëm shumë të zgjuar, por edhe shumë të lidhur me popullin, me shkollën, me mësuesit dhe me punën. Kjo do të thotë se ata e kanë kuptuar mirë orientimin e Partisë se njerëzit duhet të mësohen me punë që në vegjëli». Për këtë ju bëni shumë mirë dhe veproni shumë drejt, sipas mësimëve të Partisë. Ju lumtë!

Gjithashtu, unë jam i bindur që ju nuk ia bëni kurrë fjalën dy as mamasë e as babait, se ata për lumturinë tuaj punojnë në fabrikë dhe në arë, ju ushqejnë, ju lajnë kokën e trupin, ju lajnë e ju hekurosin teshat. Por edhe ju nuk mungoni t'i ndihmoni ata për të mbushur ujë e për punë të tjera. Edhe unë kur isha i vogël bëja ca punë në shtëpi. Mëma më kishte bërë atëherë një kokore me leckë dhe, para se të veja në

shkollë e vija atë në kokë, mbi të vija tepsinë me bukë për ta çuar në furrë. Kokoren e lija te furrxhiu se kur kthehesha nga shkolla duhet ta merrja medoemos tepsinë prapë në kokë.

Mbaj mend, gjithashtu, se kur isha i vogël, në Gjirokastrë nuk kishte ujë të mjaftueshëm për të pirë, siç ka kudo tani në kohën e Partisë, prandaj detyroheshim të pinim ujët e ndenjtur të sterave e të muslluqeve. Stera nganjëherë zinte papastërtira, prandaj para se të mbushnim ujë në muslluk në grykën e gjymit vinim një copë të hollë për ta kulluar ujët që do të pinim. Atëherë nëna ime ishte e re, por edhe sot që kanë kaluar shumë vite i mban mend mirë ç'hiqnim. Prandaj nganjëherë më flet për ato kohë dhe më thotë: «E djalo i mban mend këto gjëra?». «I mbaj mend, si jo» i them unë. Po fjalën e kam këtu që shpesh ajo më porosiste të mbushja gjymat, mirëpo unë në atë kohë nuk e kuptoja se e kisha detyrë ta bëja këtë punë dhe nganjëherë nuk e zbatoja porosinë e saj. Vetëm dëgjonim, këtë e themi në mes nesh, se unë atëherë nuk mendoja si tani, ose, më mirë të themi, siç mendoni ju, që jetoni sot në një kohë tjetër, në kohën e Partisë, dhe jeni të zhvilluar nga çdo pikëpamje.

Kur ju filluat të ndërtoni kalldrëmet, ishte një gëzim i madh për ne në Tiranë. Juve nuk ju shkon në mendje e nuk e përfytyroni dot që me shembullin tuaj të bukur ndihmuat për të forcuar idenë që në shkollat tona, krahas mësimit edhe të punohet. Kështu ju kontribuuat shumë për revolucionarizimin e shkollës. Shembulli juaj është një gur i rëndësishëm në themelin e shkollës sonë të re.

*Pastaj shoku Enver Hoxha i drejtohet një gurdhendësi të vjetër.*

Edhe ti që i ke mësuar këta pionierë të gdhendin gurë e të bëjnë kalldrëme, je mësuesi i gjithë këtyre, je njeri i dalë nga klasa jonë punëtore, pa të cilën s'bëheshin dot gjithë këto mrekulli e të arriheshin gjithë këto suksese në vendin tonë. Prandaj, të dashur pionierë, duhet të keni respekt të madh për këtë xhaxhon këtu dhe për të gjithë punëtorët. Si gjithë punëtorët, edhe shokët muratorë janë njerëzit më të nderuar në shoqërinë tonë socialiste, dhe këta, që ju kanë mësuar ju, kanë bërë një punë shumë të dobishme.

Duke biseduar me ju, mund të rrimë këtu me orë të tëra, se s'ka minutë, orë dhe ditë më të bukura për njerëzit e moshës sonë sesa kur rrimë e bisedojmë me fëmijët. Në raste të tilla kujtdo i kujtohen shumë gjëra të bukura nga jeta e rinisë, prandaj më të lumturit në botë janë mësueset e mësuesit, që merren vazhdimisht, gjatë gjithë jetës me edukimin e brezit të ri.

Edhe një herë dëshiroj t'ju këshilloj që t'i doni e t'i respektoni shumë mësueset dhe mësuesit tuaj, të dëgjoni me vëmendje këshillat dhe mësimet e tyre, se ata punojnë sipas mësimeve të Partisë.

Tani të vemi t'i shohim konkretisht rrugët që ju i keni shtruar me kalldrëm dhe ju siguroj se kur të kthehem në Tiranë, do t'u tregoj të gjithë shokëve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, për takimin që pata sot këtu me ju, sa e përzemërt dhe e paharrueshme është për mua kjo pritje që m'u bë këtu në Berat, ku kemi pionierë të zgjuar, të zjarrtë, patriotë dhe trima, të cilët mësojnë dhe punojnë mirë,



bëjnë edhe kalldrëme të mira. Jam i bindur se tani që do të vete t'i shoh, do t'i gjej të forta dhe të bukura dhe, po të jetë vërtet kështu, atëherë do t'ju vë një notë të mirë.

Rroftë Partia që na solli këto ditë dhe na edukon!

Rroftë rinia!

Rrofshin pionierët!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## DEMOKRACIA KOOPERATIVISTE ÇON PUNËN PËRPARA

*Nga fjala në drekën e shtruar në kooperativën  
e bashkuar «8 Nëntori» të Kutallisë  
në rrethin e Beratit*

27 shkurt 1969

Të dashur shokë dhe shoqe,

Jam shumë i gëzuar që erdha sot këtu, për t'u njohur nga afër me kooperativistët e mrekullueshëm të kooperativës së bashkuar të Kutallisë dhe me rezultatet e punës së tyre. Kryetari i kooperativës më paraqiti qartë dhe në mënyrë të hollësishme rezultatet e mira që keni arritur, si dhe të metat që janë vërtetuar gjatë punës në kooperativën tuaj. Siç e thashë edhe në aktivin e Partisë në Berat<sup>1</sup>, njerëzit mësojnë si nga rezultatet, ashtu edhe nga të metat. Rezultatet e mira janë një mbështetje dhe nevojë e domosdoshme për të ngritur nivelin e jetesës të kooperativistëve që, çdo ditë e çdo vit, ata të jetojnë më mirë. Pikërisht për

---

1 Shih në këtë vëllim f. 175.

këtë qëllim punon dhe lufton Partia. Por ne nxjerrim mësim edhe nga të metat në punë, të cilat i luftojmë vazhdimisht, mbasi ato nuk zhduken dot menjëherë. Sidoqoftë shembujt e mirë dhe sukseset te ne janë më të mëdha, ne frymëzohemi prej tyre dhe mësojmë për ta çuar më tej këtë zhvillim të madh që ka përfshirë tërë vendin tonë.

Vuajtjet e papërkrahura, që ka pësuar nën shtypjen e bejlerëve, të feudalëve dhe të pushtuesve italianë e gjermanë, e mësuan popullin tonë të rrokë armët, të luftojë me heroizëm, t'i thyejë më së fundi armiqtë dhe të dalë në dritë. Ajo kohë perëndoi dhe e kaluara e hidhur është bërë mësim për popullin tonë. Brenda këtyre 25 vjetëve të pushtetit popullor në kooperativën tuaj janë arritur rezultate të shkëlqyera ashtu si në të gjithë vendin tonë.

Faktori vendimtar për arritjen e këtyre rezultateve është Partia jonë, e cila, duke u mbështetur në eksperiencën shumëvjeçare të popullit, me anët e shumta e të mira, por edhe me të metat e saj, diti të ndërtojë një vijë të drejtë politike dhe organizative dhe ta transformojë Shqipërinë nga një vend i prapambetur në një vend të përparuar. Populli e ndoqi me besim vijën e drejtë të Partisë, se ajo shprehte dëshirat dhe ëndrrat e tij. Pa Partinë në krye, të përbërë nga djemtë dhe vajzat e tij më të mira, populli nuk mund të luftonte me sukses, të asgjësonte armiqtë e të ndërtonte këtë jetë që gëzon sot. Por ju e dini që vija e drejtë e Partisë ka hasur në vështirësi se nuk ishte e mundur të realizoheshin përnjëherë të gjitha ato që na dëshironte zemra.

Partia, si organizata që kishte bërë të vetën eksperiencën e madhe kolektive të popullit, ishte e ndër-gjegjshme për vështirësitë që do të haseshin. Realizimet e mëdha që shohim sot nuk u arritën menjëherë. Për këtë duhet të kalonin disa etapa. Në fshat, për shembull, duheshin kapërcyer disa vështirësi që kishin lidhje me mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e fshatarëve tanë. Partisë i duhej të përpiquej të arrinte që të gjithë ta kuptonin se e vetmja rrugë për të ardhmen e popullit tonë në përgjithësi dhe për fshatarësinë në veçanti, që përbënte dhe përbën shumicën e popullsisë të ne, ishte kolektivizimi i bujqësisë, bashkimi i mjeteve të prodhimit, i tokës, i kafshëve të punës dhe i çdo pasurie tjetër. Me shekuj, brez pas brezi, në kushte të tjera krejt të ndryshme nga këto, në kushtet e pronës individuale, ishte formuar ndërgjegjja e fshatarëve tanë. Përpara kolektivizimit çdo fshatar luftonte vetëm për interesat e ngushtë të familjes së vet. Pikërisht dhe për këto arsye ishte ca e zorshme në fillim të kuptohej se «bashkimi bën fuqinë», se bashkimi i tokës, i kafshëve, i mjeteve të punës etj., do t'ia ndryshonte shpejt dhe për më mirë faqen bujqësisë sonë. Prandaj Partia eci me kujdes të madh në këtë drejtim, me qëllim që populli ta kuptonte mirë dhe të bindej për çdo masë që merrte ajo, se vetëm kështu do të arrihej sukcesi. Në rast se populli nuk arrin të kuptojë menjëherë një direktivë të Partisë, kësaj i del për detyrë të punojë me durim, me këmbëngulje e me kujdes të madh, kurdoherë me rrugën e bindjes, që t'i shpjegojë se kjo është në të mirën e tij. Kur masat e popullit e kuptojnë direktivën ato e zbatojnë atë me suk-

ses, qoftë edhe shumë e vështirë apo e ndërlikuar.

Kolektivizimi në vendin tonë tashmë ka përfunduar kudo, pikërisht se i gjithë populli i kuptoi të mirat që sjell ai. Sot nuk jemi në atë fazë që të pyeten fshatarët duhet apo s'duhet kooperativa, nëse duhen bashkuar tri, katër a më shumë fshatra në një kooperativë të vetme apo jo. Tashti është kuptuar nga kushdo që me bashkimin e forcave dhe të mjeteve të prodhimit, organizimi bëhet më i mirë, arrihet më shpejt bollëku dhe ngrihet niveli kulturor i njerëzve.

Tashti te ne ngrihet problemi që të gjitha fushat, kodrat e malet tona t'i bëjmë akoma më pjellore e më të lulëzuara. Për këtë punon fshatarësia jonë kooperativiste, e cila dëshiron që me forcat e bashkuara të njerëzve, të merren sa më shumë prodhime nga toka jonë. Tani fshatarësia nën udhëheqjen e Partisë i është futur punës për realizimin e kësaj detyre.

Të mirat nuk kanë fund. Nga e njëjta tokë mund të marrësh pak prodhime por mund të marrësh edhe prodhime të bollshme. Kjo varet kryesisht nga puna. Prodhimet e bollshme arrihen vetëm me vullnetin e papërkulur, me diturinë dhe me zotësinë e njerëzve tanë. Çdo gjë e kemi ne vetë në dorë. Në qoftë se mendojnë të gjithë, burra e gra, pleq e të rinj, pionierë e pioniere, si t'ia dalin me sukses kësaj detyre, atëherë do t'i zbulojnë dhe do t'i njohin të gjitha të fshehtat e punës dhe të tokës. Këtë bindje tani e kemi të tërë. Partia ka krijuar një situatë të tillë sa që sot në vendin tonë s'ka njeri që të mos mendojë çfarë duhet bërë për të prodhuar sa më shumë drithëra, mish, qumësht, fruta, perime, veshmbathje etj. Partia mendon

për shtimin e prodhimeve, por, për t'ia arritur këtij objektivi, duhet medoemos të punojmë të gjithë.

Puna është faktori kryesor për sigurimin e të mirave materiale. Kush është dembel, edhe sikur të jetë i ditur, nuk nxjerr gjë në dritë. Ai njeri që e bën mësimin qëllim në vetvete, jashtë nevojave aktuale të ekonomisë dhe të jetës së vendit dhe që vetë i lidh duart dhe fillon t'u shesë mend të tjerëve, nuk ka asnjë vlerë dhe nuk i sjell asgjë të mirë shoqërisë sonë socialiste. Prandaj Partia, duke vënë në bazë të çdo gjëje punën, lufton me sukses që të gjithë njerëzit tanë të punës të bëhen njëkohësisht të mësuar; me punë edhe me mësim transformohet jeta, bujqësia, ekonomia, i gjithë vendi e, bashkë me to, ç'është më e rëndësishmja, zhvillohet e pasurohet botëkuptimi i drejtë i njerëzve tanë. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme për ne, sepse janë njerëzit ata që mendojnë, shpikin, krijojnë dhe bëjnë gjithçka me punën e tyre të palodhur.

Mbrujtjen e njerëzve me ndërgegje të lartë për punën dhe me dëshirë të madhe për të mësuar Partia e bën vazhdimisht dhe në mënyrë të zgjuar. Për të pasur sukses në përhapjen e mësimin të masat, Partisë i duhej të luftonte me koncepte të tilla si: «Shkolla nuk i duhet fshatarit, po djalit të beut», «Gruaja nuk duhet nxjerrë nga shtëpia, por të merret vetëm me kuzhinën e me rritjen e fëmijëve» etj. Të tilla koncepte ia kishin ngulitur popullit tonë ish-klasat shfrytëzuese, ato që kishin pasur pushtetin në dorë, bejlerët, agallarët, klerikët e të tjerë. Që të zhdukeshin këto koncepte reaksionare nga mendjet e njerëzve tanë duhej punuar me kujdes. Dhe Partia ka punuar shumë

me masat e gjera të popullit dhe ka arritur suksese në këtë drejtim. Një nga rezultatet e mëdha në këtë fushë janë edhe shkollat e shumta, që janë ngritur në çdo fshat, deri në skajet më të largëta. Jo vetëm kaq, por në vendin tonë sot kooperativisti, punëtori, qytetari mendojnë për ta dërguar fëmijën e vet në shkollë, mbasi kushdo e ka kuptuar se mësimi është i domosdoshëm si buka dhe si ujët. Gjithnjë e më shumë nga masat tona punonjëse po ndihet nevoja jo vetëm për shkollën fillore, por secili tash e sheh se i duhet arsimi tetëvjeçar, se detyrat dhe punët e mëdha që na presin, veç vullnetit, kërkojnë edhe dituri. Në nivelin ekonomiko-shoqëror që ka arritur sot vendi ynë, bile edhe vetëm arsimi tetëvjeçar nuk është i mjaftueshëm për masën.

Dëgjova me vëmendje të madhe kur foli agronomi juaj, shoku Lufter [Xhuveli] dhe më bëri përshtypje përgatitja e tij profesionale. Ai solli këtu eksperiencën e kooperativistëve. Dje në aktivin e Partisë dëgjova edhe shoqen Zymbyle Bega, e cila foli atje shumë mirë dhe solli, gjithashtu, eksperiencën dhe zotimet që keni marrë ju për realizimin e planit. Këta janë kuadrot tuaj. Për ju që keni krijuar një kooperativë kaq të bukur, të madhe dhe të lulëzuar, tani ndihet nevoja të keni jo vetëm një agronom por edhe dy e më shumë po të jetë e mundur, të keni edhe veterinerë e zooveterinerë. Ju tani për tani keni vetëm një mjek. gjithashtu edhe një mami, por, po të keni nga dy, do të jetë akoma më mirë. Për mësues s'kam ç'them se paskeni mjaft dhe jeni të kënaqur prej tyre.

Udhëheqja e drejtë e Partisë, zhvillimi i vrullshëm

ekonomik e kulturor i vendit tonë, ia kanë hapur sytë popullit, i cili tani e ka kuptuar se, që të ecim përpara, duhet të punojmë e njëkohësisht të mësojmë, punën dhe mësimin t'i kryejmë tok, se pa punë, mësimi nuk vlen asgjë, ashtu sikurse pa mësim punët tona nuk mund të ecin përpara me ritmet që dëshirojmë.

Këto janë dy çështje me rëndësi të madhe që Partia, gjatë këtyre 25 vjetëve, duke luftuar e duke jetuar gju më gju me popullin, i vuri në rrugë të drejtë, në baza të shëndosha. Asnjë armik, sado i fortë e i armatosur qoftë edhe me armët më moderne, këto fitore të mëdha historike të popullit shqiptar nuk i cenon dot, nuk mund t'i zhdukë, sepse ato janë rrënjosur në zemrën e në ndërgjegjen e tij.

Armiqtë imperialistë e revizionistë e kanë halë në sy ndërtimin e socializmit në Shqipëri, ideologjinë tonë marksiste-leniniste, filozofinë e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse kooperativiste. Ata janë kundër kësaj ideologjie, se kjo do të sjellë përmbysjen e tyre dhe fitoren e socializmit kudo në botë. Këta armiq mund edhe të na sulmojnë, sepse nuk duan që vendi ynë të lulëzojë dhe të bëhet shembull edhe për popuj të tjerë të botës, në mënyrë që edhe ata të shkojnë në rrugën e socializmit. Por para se të na sulmojnë, ata duhet të mendohen mirë, sepse nuk kanë për të dalë dot nga aventura që mund të fillojnë. Armiqtë, cilëtdo qofshin ata, po të na sulmojnë, do të pësojnë disfatë. Për këtë populli shqiptar ka bindje të plotë, bindje që atij i është formuar në shekuj, se kurdoherë ka luftuar dhe ka fituar. Megjithëse kemi qenë një popull i vogël. që jemi sulmuar vazhdimisht nga ar-



miq të shumtë, kemi luftuar e jetuar, dhe këtë tokë të trashëguar brez pas brezi, që na ka rritur e ushqyer, e kemi mbrojtur me të gjitha forcat. Prandaj nën asnjë pushtues populli shqiptar nuk ka qëndruar duar-lidhur, por me ato forca që ka pasur është hedhur në luftë për të ruajtur jetën e vet, pavarësinë dhe kurdoherë ka dalë faqebardhë.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, megjithëse armiq-të ishin shumë më të mëdhenj, të fortë dhe të cgër, populli ynë, i udhëhequr nga Partia, luftoi me heroizëm të pashembullt, i mundi ata, fitoi eksperiencë, prandaj sot është në gjendje të përballojë armiq akoma më të mëdhenj. Ne fituam mbi armiqtë fashistë dhe tradhtarët e popullit në kohët e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, kur s'kishim as dyfek, as bukë dhe asgjë tjetër e jo më tash që populli është në fuqi, në një kohë që kemi një ekonomi të fortë socialiste, kur fuqia mbrojtëse e atdheut është shumëfishuar, e mbi të gjitha, është rritur ndërgjegjja patriotike e njerëzve tanë të kalitur nga Partia dhe uniteti Parti-popull është bërë i pathyeshëm. Prandaj ne do të dërrmojmë çdo armik, po të na godasë, se, në radhë të parë, kemi njerëzit tanë të përgatitur e të edukuar.

S'ka sot njeri në Shqipëri të cilit t'i dridhet dora kur është çështja për mbrojtjen e atdheut. Kjo ndodh edhe me ata, që, për një arsye ose për një tjetër, nuk morën dot pjesë me armë në dorë në Luftën Nacionalçlirimtare. Ata tani janë të lidhur ngushtë me popullin dhe me Partinë ndaj e kuptojnë dhe e ndiejnë më shumë se kurrë sa u detyrohen atyre për çka nuk bënë në atë kohë. Lufta e popullit. heroizmi i tij dhe vija e

drejtë e Partisë kanë bërë që sot të tërë, të bashkuar si një trup i vetëm, të jemi shumë herë më të fuqishëm, si nga ana shpirtërore, ashtu edhe nga ana materiale. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ne mbronim kasollet tona të varfra të mbuluara me kashtë, siç e përmendi kryetari i kooperativës suaj, dhe këtë e bënim se ato ishin shumë të shtrenjta dhe të dashura për ne, mbasi ne në to jetonim. Atëherë mbronim kodrat e malet me gurë e shkëmbinj dhe fushat plot kënetë e moçale, gjithë këtë truall ku kalonte jeta jonë e mjeruar e në errësirë, sepse kjo ishte toka jonë dhe sepse mendonim që do të vinte një ditë që do ta bënim më të mirë. Tani të gjitha këto i kemi transformuar e po i kthejmë çdo vit e më mirë në kopshte të bukura. Me zërin plot ne u themi armiqve të mos na prekin se këto toka që i kemi skuqur me gjakun dhe me djersën tonë do të dimë edhe t'i mbrojmë.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare ne kishim miq dhe aleatë Bashkimin Sovjetik të udhëhequr nga Stalini dhe gjithë popujt përparimtarë të botës, të cilët si në ditë të mira, ashtu edhe në ditë të vështira janë kurdoherë përkrah njëri-tjetrit. Edhe popujt amerikanë, francez, anglez e të tjerë ushqenin simpati për luftën e popullit tonë. Sot në këto vende sundojnë kapitalistët dhe revizionistët. Të gjitha pasuritë atje janë vërtet në duart e shfrytëzuesve, si dhe ekonomia e ushtria, por popujt, megjithëse jetojnë të shtypur, ashtu siç ishim edhe ne në kohën e Zogut dhe të pushtuesve fashistë, nuk janë në duart e tyre.

Udhëheqja e partisë dhe e shtetit në Bashkimin Sovjetik prej kohësh është futur në rrugë të gabuar,

ka tradhtuar çështjen e socializmit dhe është bërë armike e popullit. Ajo, në fakt, nga një anë bashkëpunon me armiqtë më të tërbuar të socializmit dhe të komunizmit, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me të gjitha vendet e tjera kapitaliste, kurse nga ana tjetër bën propagandë duke gënjyer popullin sovjetik dhe të gjithë popujt e tjerë, duke u munduar t'i bindë ata se po ndërton komunizmin. Në fakt, Bashkimi Sovjetik nuk shkon në komunizëm, krerët tradhtarë revizionistë, pas vdekjes së Stalinit, e ndryshuan rrugën dhe kështu popullin sovjetik, të dehur nga sukseset, e zuri gjumi, humbi vigjilencën. Dhe dihet se po të zuri gjumi, kur rreth e përqark ke armiq, mbarove, të hëngri gjarpri. Kështu ndodhi në Bashkimin Sovjetik.

Me gjithë tradhtinë e udhëheqjes sovjetike, Shqipëria nuk mbeti e vetme, përkundrazi, pozitativisht e saj në arenën ndërkombëtare nga dita në ditë janë forcuar edhe më shumë. Ne kemi miq e dashamirë në gjithë botën.

Imperializmi duket i madh, i fortë e i tërbuar në pamjen e jashtme, por përbrenda është i kalbur, sepse vazhdimisht e brejnë kontradikta të shumta. Megjithatë ai është akoma në gjendje t'i shkaktojë mjerime e fatkeqësi popujve me anën e sulmeve grabitqare. Në këto situata populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia, e kupton se sa më të fortë të jemi ushtarakisht, ekonomikisht, ideologjikisht e politikisht, aq më i paprekshëm nga cilido armik do të jetë atdheu ynë. Këtë e ka të qartë populli ynë dhe Partia punon çdo ditë që ai ta kuptojë edhe më mirë.

Partia na këshillon t'i kuptojmë të gjitha çështjet,

në radhë të parë, politikisht. Të marrim orientimin që ka dhënë ajo për prodhimin e bukës në vend. Zbatimi i kësaj direktive do të thotë që në të ardhmen ne të mos importojmë drithë. Kur populli e siguron bukën në vend ai është i sigurt dhe nuk varet nga të tjerët. Ne do të importojmë vetëm gjëra të domosdoshme, që hëpërhë s'kemi mundësi t'i prodhojmë në vend. Ne kemi nevojë për makina e traktorë që akoma nuk i prodhojmë dot vetë dhe prandaj jemi të detyruar t'i importojmë. Në vend ne duhet të prodhojmë më shumë bukë, mish, gjalpë e çdo gjë tjetër jo vetëm për të kënaqur nevojat e përditshme të popullit, por edhe për të pasur rezerva të mjaftueshme në kohë rreziku edhe për industrinë, edhe për të shitur që të mund të këmbejmë prodhimet tona me mallrat që na duhen të importojmë. Ky është kuptimi politik i kësaj direktive të Partisë.

Partia ka vënë disa rregulla, të cilat anëtarët më parë duhet t'i njohin e t'i kuptojnë drejt, pastaj t'i zbatojnë. Kështu puna në kooperativë do të mund të ecë mirë dhe çështjet do të kuptohen drejt politikisht e ideologjikisht.

Le të marrim, për shembull, kooperativën tuaj. Kjo është një kooperativë e madhe, në të cilën janë bashkuar 7 fshatra. Nga një vit në tjetrin ju keni arritur që nga 15 kuinalë drithë për hektar që realizonit përpara, sot, në shumë nga parcelat tuaja, të merrni 40, 50 e 60 kuinalë misër për hektar, si dhe 30 e 35 kuinalë grurë për hektar, ndërsa mesatarisht, duke llogaritur gjithë sipërfaqen e mbjellë, 15 e 16 kuinalë për hektar.

Kjo ekonomi e madhe e përbërë nga mijëra frymë e mijëra hektarë tokë, siç është kooperativa juaj, duhet drejtuar mirë, se në këtë rast nuk është fjala për një ekonomi të vogël si ajo e familjes individuale që ekzistonte përpara, po për një tjetër shumë më të madhe. Këtë ekonomi kaq të gjerë e të shumanshme nuk mund ta drejtojë dot si duhet vetëm kryetari, sado i zoti që të jetë ai. Parimi bazë për mbarëvajtjen e kooperativës është se atë duhet ta drejtojë vetë masa e anëtarëve që punon për forcimin e për lulëzimin e saj. Vërtet ka një kryesi që ju drejton, por kryesinë e zgjidhni ju vetë dhe, kur s'punon mirë, e hiqni përsëri ju. Partia ju ka mësuar dhe kjo te ju zbatohet që për çështjet themelore duhet të vendosë asambleja, domethënë të gjithë anëtarët e kooperativës. Ndonjëri mund të shtrojë çështjen se populli nuk mund të mblidhet vazhdimisht për të marrë vendime, ndryshe njerëzit do të mbeteshin në mbledhje, arat do të mbeteshin pa punuar, misri e pambuku pa prashitur, bagëtia pa kujdesin tonë etj. Partia, me rregullat që ka caktuar, ka parashikuar që asnjë punë të mos mbetet pa kryer. Kryesorja është që populli të thotë fjalën dhe mendimin e tij, të ushtrojë kontrollin e tij të fortë mbi çdo gjë, të drejtojë ai vetë, ndryshe nuk do të bëhet as gruri, as lulja e diellit, as orizi etj. Dhe Partia i ka gjetur format se si të drejtojë populli në kooperativë, me zbatimin e demokracisë kooperativiste.

Demokracinë në kooperativë duhet ta kuptojnë të gjithë drejt. Ajo nuk duhet kufizuar vetëm kur bëhet mbledhja e përgjithshme në fund të vitit, ku kooperativistët kanë të drejtë të thonë mendimin e tyre për

çdo problem të ekonomisë kolektive. Këtë anëtarët e kooperativës mund dhe duhet ta bëjnë në çdo kohë. Ata kanë të drejtën të shprehin në çdo rast mendimet për punën e për njerëzit, ashtu si i gjykojnë, qofshin edhe të gabuara.

Siç e dini, njësia bazë me rëndësi të madhe në kooperativë është brigada, e cila ka sektorët e saj të punës, planin se cilat bimë duhet të kultivojë secili sektor, mjetet dhe rregullat e veta etj. Në brigadë punojnë anëtarët e kooperativës, të cilët sa herë që e ndiejnë të nevojshme diskutojnë për punën, për zgjidhjen e problemeve që kanë përpara. Ata kanë të drejtë të kritikojnë jo vetëm njëri-tjetrin dhe brigadierin, por edhe kryetarin e kooperativës, sekretarin e organizatës-bazë të Partisë, kryetarin e pushtetit, kur këta nuk e kanë organizuar mirë punën, kur nuk i ndjekin mirë e si duhet problemet, kur bëjnë gabime. Po nuk u veprua kështu, atëherë fishket demokracia kooperativiste, punët nuk do të shkojnë mbarë, prodhimet do të dëmtohen, jeta e anëtarëve nuk do të përmirësohet. Prandaj në brigadë duhet të ziejnë mendimet dhe çdo problem të zgjidhet drejt e në rregull, me partishmëri. Por nuk është e mjaftueshme që zëri i brigadës të mbetet vetëm brenda radhëve të kooperativës ku bën pjesë kjo brigadë, sidomos kur është rasti që kritikohet ndonjë kryetar, i cili vepron sipas kokës së tij, pa përfillur mendimet e anëtarëve, duke nënvleftësuar kështu demokracinë në kooperativë. Në raste të tilla ka shokë kooperativistë të cilët mendojnë se çështja i duhet raportuar sekretarit të komitetit të Partisë të rrethit. Natyrisht, edhe sekretarit të komitetit të Partisë mund

t'i kërkohet ndihmë, por Partia na mëson që punën, në radhë të parë, e keni në dorë ju prandaj ju vetë duhet ta zgjidhni.

Në brigadë ju keni përfaqësuesit, të deleguarit tuaj që janë anëtarë të kryesisë. Kur në brigadë zic diskutimi për një çështje dhe anëtarët vënë në dukje se kryesia nuk ka marrë këto ose ato masa që janë vendosur, se kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të kooperativës së bashkuar nuk u interesua që të bëhej, për shembull, kjo çezmë, ose sekretari i organizatës-bazë të Partisë nuk ndërrhyri për një problem të ngutshëm etj., shokët e përfaqësuesit duhet ta transmetojnë më lart zërin e brigadës, duke shtruar para kryesisë, kryetarit dhe sekretarit të organizatës-bazë të Partisë çështjet që kanë dalë në brigadë, vërejtjet, propozimet dhe kritikën e tyre dhe të kërkojnë që këta të japin mendim për çështjet që ngrihen, të pranojnë të metat për të cilat gjykojnë se janë me vend, sepse ata shikojnë interesin e përgjithshëm të kooperativës. Përfaqësuesit kthehen pastaj në brigadë, së cilës i raportojnë për rezultatet e diskutimit të zhvilluar me kryesinë dhe organizatën-bazë të Partisë. Në qoftë se brigada është dakord me këto rezultate të diskutimit, atëherë problemet e ngritura konsiderohen të zgjidhura. Por mund të ndodhë që anëtarët e brigadës, për një ose disa çështje, të mos jenë dakord me kryesinë, atëherë këto çështje të sqarohen edhe një herë në mbledhjen më të afërt që bën kryesia me përfaqësuesit. Këto mbledhje bëhen në disa momente kyç, si për shembull: për mbjelljet, për korrjet etj. Në këto mbledhje ku marrin pjesë përfaqësues nga

brigada, anëtarët e kryesisë së kooperativës, sekretari e zëvendëssekretari i organizatës-bazë të Partisë dhe kryetari i këshillit popullor, pasi i bëhet një analizë e përgjithshme problemit në shqyrtim, pasi diskutohet dhe vendoset për zgjidhjen e tij, anëtarët e brigadës, që marrin pjesë në këtë mbledhje, ngrenë edhe ato çështje që brigada gjykon se nuk janë zgjidhur drejt nga ana e kryesisë. Mbledhja diskuton edhe për këto dhe u jep zgjidhjen që gjykon të arsyeshme, e cila i raportohet edhe brigadës. Në qoftë se përsëri brigada nuk është e bindur për zgjidhjen e çështjes, atëherë vendos ta shtrojë për të fundit herë, në fund të vitit, kur bëhet mbledhja e përgjithshme e asamblesë së kooperativës. Këtu çështja diskutohet e zgjidhet përfundimisht dhe, në qoftë se asambleja nuk e merr parasysh, do të thotë se kjo brigadë nuk e ka parë problemin në prizmin e interesit të përgjithshëm të kooperativës, por në një prizëm më të ngushtë. Në të kundërtën, në rast se asambleja i jep të drejtë brigadës, kjo do të thotë se kryesia ka vepruar gabim dhe në këtë rast është e detyruar të marrë masa për zgjidhjen e çështjes.

Fjalën e tyre, pra, anëtarët kanë të drejtë ta shfaqin në çdo kohë në brigadë, pastaj në mbledhjen që bën përfaqësia me kryesinë deri edhe në mbledhjen e asamblesë së kooperativës, para së cilës kryesia jep raportin përfundimtar.

Si duhet përgatitur raporti përfundimtar? Që ky raport të jetë në lartësinë e duhur, është e domosdoshme, edhe në këtë rast, të zbatohet mirë demokracia kooperativiste. Nuk është aspak e mjaftueshme që kryetari i kooperativës të përmendë para asamblesë disa



nga problemet kryesore që ka menduar ai vetë. Për këtë qëllim, kryesia, bashkë me shokët e Partisë e të pushtetit në kooperativë, duhet të mbledhin përfaqësinë, e cila, pasi dëgjon mendimin e kryetarit për situatën në kooperativë e probleme të tjera, së bashku me shokët, të cilët marrin pjesë në mbledhje, i bëjnë pyetje atij dhe shokëve të kryesisë për ato gjëra që nuk i kanë të qarta. Pastaj diskutojnë për çështjet që duhet të ngrihen në raport, duke u përpjekur që aty të shprehen mendimet e masës së kooperativistëve. Një përfaqësues shtron ç'mendohet në brigadën e tij për një problem të caktuar dhe i kërkon mbledhjes të thotë nëse është ose jo e drejtë, një tjetër raporton pikëpamjen e brigadës së tij për vlerën e ditës së punës, dikush ngre çështjen se shtëpia e lindjes ose një objekt tjetër, të ngrihet vitin e ardhshëm etj. Të gjitha këto mendime qoftë edhe të kundërta diskutohen gjerësisht, duke i rrahur mirë dhe kështu arrihet në përfundime më të pjekura e më të studiara. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe që tregon qartë se kooperativistët nuk flasin një herë në brigadë dhe pastaj vetëm në fund të vitit, në mbledhjen e përgjithshme të kooperativës.

Por s'janë veç këto raste e forma pune që tregojnë se udhëheqja e kooperativës ndihmohet e kontrollohet nga kooperativistët. Ndihma, po të kërkohet e duhet të kërkohet, mund të merret çdo ditë nga masa e anëtarëve. Asgjë nuk u shpëton syve të kooperativistëve, të cilët për ato që vënë re kanë të drejtë çdo ditë t'u bëjnë vërejtje kryetarit, kryesisë, organizatës-bazë të Partisë ose këshillit popullor. Duke u zbatuar drejt

demokracia kooperativiste, s'ka dyshim që ndihma për të gjitha këto organe do të jetë e madhe, e përditshme dhe e vazhdueshme. Çdo anëtar ka të drejtë ta përgëzojë kryetarin kur merr një masë me vend, ose t'i bëjë një vërejtje apo kritikë personale për një masë tjetër, që, sipas mendimit të tij, nuk i duket e drejtë. Dhe në qoftë se sheh se ai nuk ia vë veshin, në qoftë se sheh se vazhdon të dëmtohet interesi i kooperativës, ai ka të drejtë që kritikën ta bëjë edhe më të fortë duke mos pritur mbledhjen. Kështu qoftë kritika, qoftë përgëzimi që iu bëhet drejtuesve çdo ditë nga masa e anëtarëve, është një ndihmë e inkurajim i madh për udhëheqjen, prandaj këto forma që ka krijuar Partia, duhet të shfrytëzohen plotësisht dhe të mos nënvlefëtohen, përkundrazi të inkurajohen me çdo mënyrë e të gjallërohen. Në të gjithë këtë ekonomi të madhe «pa çati» që është edhe nën ndikimin e kushteve atmosferike, punët nuk mund të ecin mirë në qoftë se nuk i shfrytëzojmë të gjitha këto forma e mjete që nga përfaqësuesit deri te komisionet, që ndihmojnë për të vënë në jetë demokracinë e vërtetë kooperativiste.

Komisionet luajnë, gjithashtu, një rol të madh. Partia e ka shpjeguar punën që duhet të bëjnë këtc, vetëm ka rëndësi çështja që të vihen më shumë në lëvizje, të punojnë si duhet.

Shikoni, pra, shokë, gjithë këta organizma: brigadat, sektorët, përfaqësuesit, komisionet, kryesia dhe, mbi të gjitha, Partia që i udhëheq e i edukon. Prandaj të gjitha këto duhet të funksionojnë mirë, se janë format më të përshtatshme të demokracisë kooperativiste, që e ndihmojnë kooperativën të çojë punën për-

para, se pa to ajo nuk mund të arrijë rezultatet që presim. Në fabrika puna është më e lehtë, se atje ne kemi jo një, por disa inxhinierë e drejtues të tjerë të zotë nga ana teknike, pastaj gjithçka atje është nën çati, normat maten me mjete speciale etj. Në kooperativat bujqësore puna është shumë më e vështirë, prandaj, në qoftë se nuk i vëmë në zbatim mirë këto rregulla e norma demokratike, në qoftë se kontrolli i masës kooperativiste mbi të gjithë veprimtarinë ekonomike dhe mbi njerëzit nuk do të jetë në lartësinë e duhur që kërkon Partia, puna do të vështirësohet. Partia na mëson që të gjithë kooperativistët të mendojnë dhe të gjykojnë për çdo problem. Askujt të mos i shkojë në mend e të thotë: «Këtë punë e di kryetari, brigadieri apo dikush tjetër, unë s'kam përse ta vras mendjen», kur sheh se një punë shkon keq. Kryetari dhe kryesia le t'i dinë mirë punët, por pa masën e anëtarëve ata nuk bëjnë dot asgjë dhe kur nuk ccin drejt, kooperativistët duhet t'i sinjalizojnë, t'i këshillojnë e t'i kritikojnë jo vetëm në mbledhje, por edhe aty për aty.

Duke vepruar në këtë mënyrë do të na zhvillohen më shpejt kooperativat. Prandaj Partia e shtron problemin politikisht, me qëllim që të zhduken nga ndërgjegjja e disa anëtarëve koncepte të dëmshme, sidomos mendime të tilla se mos i mbetet hatëri kryetarit po t'i vihet në dukje një e metë. Nuk është në rrugë të drejtë ai kryetar ose brigadier që zemërohet nga një kritikë e drejtë që i bën një anëtar i kooperativës, ose një shok i tij dhe nuk merr masa për të ndrequr gabimin. Por, mund të ndodhë që kooperativisti ose shoku të mos e ketë të bazuar kritikën, atëherë kryetari

a brigadieri duhet të shtrohet, të bisedojë miqësisht me të dhe ta bindë si qëndrojnë çështjet. Kurrë nuk duhet pasur frikë dhe ngurrim që secili ta thotë ashtu si e ndien atë që mendon. Duhet të jemi të hapët, siç është i hapët vetë populli. I hapët e i sinqertë duhet të jetë ai që i thotë tjetrit diçka, por edhe ai të cilit i drejtohet vërejtja ose kritika. Duke qenë i hapët të jetë edhe i dashur me atë që e kritikon, të mos mbajë kurrë mëri dhe ca më tepër të mendojë t'i bëjë keq. Atyre që hidhen në hakmarrje, masa dhe organizata-bazë e Partisë që e udhëheq, duhet t'u tregojnë vendin. Por duhet të kemi, gjithashtu, parasysh se atë që kemi zgjedhur ta konsiderojmë si njeriun tonë e ta duam, por kur ndodh që na duhet t'i vëmë në dukje të metat, edhe ai nga ana e tij duhet të jetë i thjeshtë, kokulur, i dashur, ashtu sikurse duhet të jetë i rreptë në kërkimin e llogarisë me njerëzit që heqin këmbët zvarrë e bëjnë hilera, sepse ka edhe nga ata të cilët, nën maskën e demokracisë, përpiqen të mbulojnë dobësitë e tyre.

Në kërkesën e llogarisë duhet të jesh i rreptë, po njëkohësisht i drejtë. Rreptësia në drejtësi është e rekomandueshme, kurse rreptësia për kapadaillëk dhe arrogancë, pra në kuptimin e keq të fjalës, duhet luftuar. Kur vendosim të bëjmë një punë, që gjykohet se është e nevojshme, kërkohet edhe mobilizim për ta realizuar. Kjo vë detyra përpara atyre që zgjidhen për të drejtuar këtë punë. Të jenë në vijë të parë dhe të japin shembullin e mirë personal. Kështu ata do të kenë edhe forcën morale që po të jetë se ndonjëri i shmanget vendimit, pra kryerjes së detyrës, ta sinjalizojnë e ta këshillojnë që të kryejë detyrën, po ta përsëritë qën-

drimin e pandërgjegjshëm të merren masa më të rrepta. Herën e tretë në rast se ai dëmton interesat e popullit, duke shkelur ligjin, atëherë, pa një pa dy, t'ia japë edhe organeve të drejtësisë, cilido qoftë ai që gabon. Është, pra, absolutisht e domosdoshme që demokracia dhe format e punës e të drejtimit në kooperativë të forcohen.

Prandaj, shokë kooperativistë, të gjitha këto forma pune që përmenda për drejtimin e për kontrollin në kooperativat bujqësore t'i kuptoni deri në fund dhe t'i zbatoni se vetëm kështu do ta bëni kooperativën më të fortë e më të lulëzuar.

Mendoj se mënyra me të cilën ju po i zgjidhni problemet në kooperativën tuaj, është shumë e drejtë, është inkurajuese dhe shembullore. Nga sa po shoh unë, Partia, kryesia dhe të gjithë ju, keni kapur disa probleme kyç, zgjidhja e drejtë dhe e shpejtë e të cilave do t'ju ndihmojë për të marrë rendimente të larta në të gjitha kulturat. Ato që më thatë për eksperimentimin shkencor, për zhvillimin agroteknik të të gjithë sektorëve dhe të vetë kooperativistëve janë probleme aktuale. Të gjithë ju, kooperativistë e kooperativiste, duhet ta zotëroni mirë agroteknikën dhe kurrë të mos i bëni qejfin vetes duke menduar se dini gjithçka nga përvoja. Me këtë unë nuk dua të them që ju nuk i njihni punët e bujqësisë, po dituria kurrë s'ka fund, prandaj duhen bërë përpjekje për të mësuar vazhdimisht. Unë që nuk merrem direkt me bujqësinë, duke lexuar edhe për probleme të saj, shoh se ç'fushë e gjerë dhe sa shumë ka akoma për të mësuar për zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm.

Në këtë drejtim ne duhet të mësojmë jo vetëm

nga përvoja jonë e përparuar, por edhe nga ajo e vendeve më të përparuara, shumë nga të cilat kanë arritur rezultate të mëdha në bujqësi. Natyrisht, këto rezultate nuk i kanë arritur vetë kapitalistët, por fshatarët që punojnë e shfrytëzohen prej tyre, punëtorët që me mendjen dhe me duart e tyre prodhojnë makina dhe vegla moderne bujqësore. Duke shtypur dhe shfrytëzuar egërsisht punëtorët dhe fshatarët punonjës, kapitalistët s'bëjnë gjë tjetër veçse realizojnë fitime të mëdha. Eksperiencën e përparuar të vendeve kapitaliste, natyrisht, ta marrim por ta zbatojmë duke ia përshtatur kushteve të vendit tonë. Për të arritur rezultate të mira në të gjithë sektorët, por edhe në bujqësi, ne kemi hapur shkolla të kulturës së përgjithshme, shkolla e kurse teknike industriale, shkolla e kurse bujqësore, bëjmë eksperimente tekniko-shkencore etj. E tërë Shqipëria është ngritur në këmbë për të përvetësuar teknikën moderne.

Fshatari ynë edhe në të kaluarën ka pasur përvojë në sektorin e bujqësisë, po kjo ishte e fituar vetëm nga praktika. Tani Partia po e zhvillon këtë përvojë praktike edhe me anën e përhapjes së diturive shkencore, nëpërmjet kurseve e shkollave që janë ngritur. Ajo që kemi arritur gjer tani në këtë fushë me të vërtetë është akoma e paktë, por shumë inkurajuese. Ne qysh tani po shohim që, duke u bazuar vetëm në porositë e agronomit ose të teknikut të mesëm se si duhet mbjellë, si duhet prashitur, plehëruar e ujitur misri, vajzat tona të zgjuara e të zellshme fshatare kanë arritur të marrin deri 100 e 120 kuintalë misër për hektar, rendimente këto që nuk janë arritur as në vende të

zhvilluara kapitaliste që kanë mjete nga më modernet dhe çdo masë agroteknike që marrin e studiojnë shumë, se kanë edhe një numër të madh agronomësh, të cilët i shfrytëzojnë në kulm dhe po të mos punojnë siç kërkojnë ata, i flakin tej. Dhe në realitet, në vendet kapitaliste shumë agronomë, inxhinierë e kuadro të tjerë të lartë i hedhin në rrugë të madhe, se s'kanë ku t'i çojnë, prandaj ka në masë nga këta që kryejnë edhe punë nga më të thjeshtat.

Është, pra, shumë inkurajuese, kur shikon që vajzat tona të arrijnë suksese të tilla. Do të vijë pastaj koha që këtyre vajzave, pasi të kalojnë në kurse e shkolla agroteknike, që ka hapur e do të hapë vazhdimisht Partia në të katër anët e vendit tonë, t'u futen thellë në mendje njohuritë shkencore për tokën, bimët, kafshët etj. Atëherë me siguri, brenda disa vjetëve, vetë ne do të habitemi me ndryshimet e mëdha ekonomiko-kulturore e teknike që do të arrihen në kooperativat nga kooperativistët tanë. Për t'ia arritur kësaj shtate, Partia dhe Qeveria kanë menduar që shkollat dhe kurset të shtohen akoma.

Mësuesit, pedagogët e specialistët e bujqësisë, të cilët japin mësim në këto shkolla e kurse kanë mjaft punë, por njëkohësisht ky është edhe një nder i madh, sepse ata kryejnë një detyrë shumë të lartë. Kooperativistët që i ndjekin këto shkolla, jo vetëm që duhet të dalin të mësuar duke përvetësuar thellë njohuritë shkencore, por njëkohësisht të dalin edhe të edukuar në brigadë, t'u mësojnë edhe shoqeve e shokëve të tyre ato që kanë mësuar për vete, duke shfrytëzuar për këtë qëllim si kohën e pushimit, edhe atë pas orarit

të punës. Partia me punë të vazhdueshme do të bëjë që problemi të kuptohet politikisht nga të gjithë dhe brenda një kohe të shkurtër brigadat, ku do të bëjnë pjesë këta njerëz të mësuar, do të bëhen të zonjat ta çojnë gjithnjë e më përpara prodhimin. Kooperativistët do të fitojnë më shumë dituri dhe kjo është një punë me vlerë të madhe se i bën ata t'i futen edhe më mirë mësimit dhe shkollës. Kështu ne do të kemi në kooperativat tona në masë jo më fshatarë të paditur, por punonjës aktivë të bujqësisë me përvojë dhe me njohuri të gjera shkencore.

Kryetari i kooperativës më vuri në dijeni se ju po e ndiqni mirë rrugën e eksperimentimit shkencor, jeni duke eksperimentuar sidomos disa varietete gruri. Ju bëni shumë mirë që i kryeni këto eksperimente, të cilat do t'ju ndihmojnë për të përcaktuar shkencërisht cili grurë është më i përshtatshëm në kushtet e tokës e të klimës së kooperativës suaj, cili kalli reziston më fort kur fryn erë ose kur bie shi, dhe cili thyhet. Përcaktimi cila është koha optimale kur duhet korrur, nëse duhet mbjellë gruri i unjtë apo i gjatë. Provoni se cilat lloje japin më shumë rendiment, pra i kanë kokrrat të mbushura me më tepër amidon se llojet e tjera, bëni llogari me specialistët e kooperativës ç'fitime do të ketë, cilat farë duhen mbjellë. Të gjitha këto probleme, që kanë lidhje me grurin, kalojnë një herë në fushën e eksperimentimit dhe pastaj vendoset cili lloj duhet mbjellë në shkallë të gjerë. Këto llogari nuk bëhen për të ngatërruar mendjen, po për të mbushur hambarët, se pikërisht këtu është e drejtuar gjithë lufta jonë. Ka shumë rëndësi çështja e eksperimentimit



shkencor. Prandaj në parcelat eksperimentale duhet të vihen vajzat dhe djemtë më të kujdesshëm, punëtorë të palodhur e të mësuar.

Farët që mbjellim ne, i kanë provuar edhe të tjerët. Në Francë, siç kam lexuar në një libër, në stinë të ndryshme, përdoren farë të ndryshme që për grurin arrijnë deri në 30 lloje. Mbasi i kultivojnë më së miri, i mbyllin në thasë dhe i vulosin, duke u vënë etiketa me shpjegimet përkatëse: çfarë lloj gruri është, në ç'lloj toke e kushte klimatike duhet mbjellë, ç'rendimente për hektar mund të sigurohen për secilën etj., etj. Kur e shpërndajnë, ai që është i interesuar për një lloj fare të caktuar, mjafton të shikojë etiketën e thesit për të gjetur llojin që kërkon. Edhe ne duhet të bëjmë përpjekje për të arritur në këto se nuk kërkohet ndonjë gjë e veçantë. Prandaj eksperimentet që keni filluar t'i vazhdoni dhe t'i bëni akoma më mirë, sepse kanë rëndësi të madhe për rritjen e rendimenteve.

Le të marrim tani çështjen e plehut kimik. Përpara, kur fshatarët tanë nuk ia dinin dobinë kishin frikë e mosbesim ta përdornin gjer në atë shkallë, sa shumë prej tyre që e morën, e groposën ose e flakën. Tani që e dinë dobinë e tij të madhe të gjithë kërkojnë pleh. Mirëpo edhe plehu ka të fshehtat e tij dhe duhet përdorur me karar. Është e domosdoshme të dish masën e plehut që duhet t'i hedhësh tokës për çdo hektar, kohën kur duhet t'ia hedhësh, cilës tokë t'ia hedhësh etj. Këto çështje duhen përcaktuar mirë, që të mund të marrim rendimente të larta. Dhe kjo arrihet, përveç të tjerave, edhe duke krijuar laboratorë, nëpër të cilët do të studiohen tokat, sipas parcelave, për të parë e për të

analizuar përbërjen kimike të secilës. Djemtë dhe vajzat e kooperativave tona janë tani në gjendje t'i mësojnë këto të fshehta të tokës e të bimëve nëpër shkolla e kurse dhe, kur të kthehen, të jenë në gjendje të studiojnë përbërjen e tokave të kooperativës së tyre, kohën e sasinë e plehut që do secila tokë etj. Nevoja e kësaj praktike ndihet, por vënia e saj në jetë do të bëjë që të mos ecet symbyllur në punët e bujqësisë. Kryesia e kooperativës dhe teknikët e bujqësisë, në bazë të studimeve që do të bëjnë, do të zgjedhin për të mbjellë atë farë gruri që i përshtatet parçelës së cilës do t'i hidhet edhe sasia e duhur e plehut organik, e nitratis ose e fosfatit që ka nevojë toka.

Edhe sasia e ujit që i duhet lëshuar çdo bime kërkohet të jetë e studiuar në mënyrë shkencore, me qëllim që bima të marrë aq sa i nevojitet. Duke vepruar në këtë mënyrë do të luftohen kritikrat pa vend, deri edhe pikëpamjet e shtrembra e konceptet fetare të njerëzve, të cilët nuk i njohin këto çështje të rëndësishme.

Të gjitha këto që thashë, shoqe dhe shokë, do të arrihen duke punuar e duke mësuar, duke i bashkuar të dyja këto anë në një të vetme, sepse bimët, toka e kafshët kanë secila karakteristikat e veta që duhen njohur thellë.

Çobani kur kullot dhentë, i bie fyellit jo vetëm se ka qejf të merret me muzikë dhe të kënaqë veten, por edhe sepse e di që delja është një kafshë jashtëzakonisht e ndjeshme dhe kur shkon për kullotë ose për të pirë ujë, ka nevojë të jetë e qetë. Muzika është një mjet i fuqishëm qetësues për të. Ja përse bariu i bie

fyellit me lloj-lloj mënyrash. Bariu me eksperiencë as qenin nuk e lë kurrë të futet në mes të deleve me qëllim që të mos i shqetësojë, por i mëson qentë që kurdoherë t'i vijnë rrotull kopesë. Deri edhe kur milen, ndaj deleve duhet pasur kujdes e dashuri, sepse, po të veprohet ndryshe, ato mund të mos e japin të gjithë qumështin që kanë në gji. Ju e dini mirë se ka lopë që, po t'i egërsosh, nuk të japin qumësht. Këtë veti të kafshëve çobanët tanë e dinë vetëm nga praktika, por blegtorët tanë duhet të njohin edhe anatominë, përbërjen e trupit të kafshës, e bashkë me të edhe veçoritë e saj. Kafshët kanë instinkte që duhen njohur, gjë që arrihet duke mësuar për to.

Dashuria e njerëzve tanë për bagëtitë është e madhe. Te ne, gjatë shekujve, brez pas brezi, është bërë traditë rritja dhe dashuria për delen, për dhinë, për lopën etj. Por ne tani duhet t'u shpjegojmë dhe t'u mësojmë të rejave dhe të rinjve tanë, si në praktikë ashtu dhe në shkollë, çdo gjë që ka të bëjë me mbarëshkrimin e tyre. Disa gjëra për kafshët shtëpiake unë i njoh nga jeta, disa i kam mësuar nëpër libra. Një ditë pyeta një mjelëse nëse gjatë mjeljes i binte me dorë gjirit të lopës. Ajo m'u përgjigj negativisht. Kur pyeta një plak ai më tha se i binte, po nuk ishte në gjendje të shpjegonte arsyen përse bëhej kjo gjë, porse ai e bënte se kështu e kishte gjetur nga të parët. Mirëpo, shkenca i shpjegon arsyet, pse i bihet dhe pse duhet t'i bihet me dorë gjirit të lopës.

Sa shumë gjëra të tilla, që duken si të vogla, kemi për të mësuar. Këto janë me rëndësi të madhe për blegtorinë, për trajtimin e mirë të kafshëve, për buj-

qësinë, për tokën, për bimën etj. Prandaj çështja e eksperimentimit të farëve, të plehrave, të ujërave, kujdesi i gjithanshëm për bagëtitë e shumë probleme të tjera kanë rëndësi të madhe. Çdonjëra nga këto ka të fshehtat e saj, të cilat duhet t'i mësojmë e t'i vëmë në shërbimin tonë, në kushtet e tanishme që te ne janë në ndryshim të vazhdueshëm. Duke u përpjekur të zbatojmë mësimet që marrim, në kushtet e tokës ku punojmë do të kemi rezultate, ndryshe do të mbështetemi vetëm në ato që lexojmë dhe, po t'i zbatojmë pa i pasur parasysh kushtet, mund të gabohemi. Po kështu, një njeri që nuk njeh klimën dhe natyrën e tokës suaj, por di vetëm sasinë e plehrave kimike që ju është dërguar, mund t'ju bëjë vërejtjen, që sipas kësaj sasive, ju nuk keni marrë rendimentin e duhur. Mirëpo kjo nuk mund të merret shabllon, vetëm sipas librave, se mund të ndodhë që një tokë të varfër, e cila për vite të tëra s'ka parë kurrë pleh, t'i duhet një periudhë kohe prej një, dy ose më shumë vjetësh gjersa të ngopet, të pasurohet dhe të arrijë të japë atë rendiment që pritet. Prandaj duhet bërë diferencimi se nga toka me kushte të ndryshme nuk mund të kërkohet i njëjti rendiment brenda së njëjtës periudhë kohe.

Të gjitha këto, ju, shoqe dhe shokë, i dini edhe më mirë nga unë, që shumë gjëra i mësoj prej jush. Kur shkoj vizitë në kooperativa, dëgjoj kooperativistë me përvojë, kryetarë e shokë të tjerë. Kjo është për mua një ndihmë më e mirë sesa leximi i ndonjë libri të agronomisë. Specialistët i dinë shumë më mirë të gjitha këto çështje. Duke bashkuar dituritë e tyre me praktikën tuaj, ju do të arrini rezultate të mëdha.

Ju i keni të qarta perspektivat e zhvillimit të bujqësisë dhe të blegtorisë në kooperativën tuaj. Përparimi i blegtorisë, pa të cilën s'ka as bujqësi, është çështje që duhet studiuar me kujdes, me llogari dhe pastaj të vendoset drejt se cilat lloje bagëtish duhen rritur në kooperativë. Derisa të zënë ullinjtë që keni mbjellë në kodrat e tarracuara bukur, këto vende mund t'i shfrytëzoni për kullotën e bagëtive të imëta. I vini, pra, rëndësi edhe zhvillimit të lopës në vendet fushore, sepse ajo ka leverdi më të madhe. Ka ardhur koha të kemi lopë të racës së mirë. Për këtë arsye kemi sjellë nga jashtë dhe do të sjellim akoma një sasi të konsiderueshme mëshqerrash, që do t'i rritim nëpër ferma, gjersa të fillojnë të na japin viçat, të cilët do t'ua shpërndajmë pastaj me radhë kooperativave bujqësore. Gjithë këto mëshqerra na nevojiten për t'i dhënë një shtytje zhvillimit të lopës në vendin tonë. Pasi të kemi arritur këtë sukses, të luftojmë për të marrë 2 000, 2 500 deri 3 000 litra qumësht e lart. Pra ndaj ju këshilloj që edhe ju t'i kushtoni rëndësi kësaj çështjeje sepse kështu do të krijohet mundësia t'i japim popullit më shumë qumësht të freskët, më shumë gjalpë e mish, kurse me tepricën të zhvillojmë industrinë e lehtë për t'i përpunuar djathin e nënproduktet e tjera të qumështit jo si deri tani, por në mënyrë moderne, me cilësi të lartë, me kosto më të ulët dhe me shumicë.

Edhe në drejtim të mekanizimit ne nuk do të qëndrojmë në nivelin e tanishëm, por, çdo vit e më shumë, do ta shtojmë atë. Këtë vit do të importojmë traktorë e kombajna të tjera. Vitin e kaluar humbëm një

sasi të madhe të prodhimit të grurit, të llojit «Myzeqeja», për arsye se ai piqet aq shpejt sa nuk arrin ta korrësh me mënyrat e zakonshme. Ky varietet vërtet jep shumë, por kërkon një mekanizim dhe mobilizim të plotë. Ai duhet korrur qysh në fazën e dyllit, ndryshe, po u vonove, siç na ndodhi vjet që kjo punë na zuri në befasi, ai shkoqet dhe bën firo të madhe. Prandaj këtë vit jemi duke sjellë makina korrëse-lidhëse, me qëllim që brenda 10 ditëve të korret e të lidhet gjithë gruri i këtij lloji dhe të sigurojmë kështu rendimente të mira.

Por ka edhe makina të tjera të shumëllojta që përdoren në gjithfarë procesesh pune në bujqësi e në blegtori për njohjen dhe sigurimin e të cilave ne do të dërgojmë jashtë specialistë, të cilët do të përpiqen të gjejnë ato që përdoren në kushtet tona, si për shebull, traktorë të vegjël për zonat kodrinore e malore. Për të plotësuar nevojat, disa do t'i blejmë, po disa do të përpiqemi t'i prodhojmë vetë në vend, sepse tashti kemi krijuar një bazë mekanike mjaft të mirë. Këto pastaj do t'i shpërndajmë nëpër kooperativat. Kështu mendojmë se do ta përmirësojmë mekanizimin, që ka gjithashtu një rëndësi të madhe në shtimin e prodhimit dhe në ekonomizimin e forcave të punës për të cilat kemi, dhe në të ardhmen e afërt do të kemi, nevoja akoma më të mëdha.

Në Shqipëri, në të katër anët po ngrihen e do të ngrihen shumë objekte të mëdha e të vogla, që kërkojnë edhe mjaft forca pune. Megjithëse po i mekanizojmë e do t'i mekanizojmë çdo vit e më mirë ndërtimet tona, prapë do të na duhen më shumë punëtorë të

rinj të mësuar e të kualifikuar. Këta do t'i marrim kryesisht nga qyteti, por një pjesë edhe nga fshati.

Për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të jetesës së kooperativistëve duhen bërë akoma përpjekje. Në rrugë të mirë jeni me ngritjen e çerdheve e të kopshteve, por dëshiroj t'ju them se të ndërtohet çerdhe e kopshte do të thotë t'i mbushësh me kalamane dhe nuk është aspak mirë që të mos i çoni atje. Kjo tregon se politikisht nuk e keni kuptuar problemin si duhet. Ne po luftojmë që gratë të aktivizohen sa më shumë në punë, po për këtë duhet që ato të lehtësohen në disa drejtime. Këtij qëllimi i shërben edhe ngritja e çerdheve dhe e kopshteve. Kështu gruaja do të shkojë e qetë në punë, në çdo front, e sigurt dhe e bindur se fëmija që ka lënë në çerdhe apo në kopësht i mbahet mirë dhe për të tregohet kujdes. Kur na mungonin çerdhet s'kishim ç'bënim, kurse tani që i kemi dhe po ngremë të tjera, duhet t'i çojmë medoemos fëmijët në to, pa hezitim.

Edhe një këshillë tjetër. Gratë shtatzëna nuk duhet të lindin në shtëpi, se kjo lidhet me shëndetin e tyre dhe të fëmijëve që do të vijnë në jetë. Për shëndetin e njerëzve tanë, të nënës dhe të fëmijës ne duhet të tregojmë kujdesin më të madh, të mos bëjmë asnjë lëshim dhe të zhdukim mentalitetin e mykur që ekziston te ndonjë, sipas të cilit fëmijët edhe sot mund të rriten ashtu sikurse jemi rritur ne dikur. Por s'duhet harruar se atëherë nënat tona lindnin nga tetë, nëntë e dhjetë fëmijë, po për fat të keq shumica e tyre u vdisnin, kurse sot Partia lufton që të gjithë ata që lindin të rrojnë dhe të rriten të shëndetshëm. Kjo

është arsyeja që ne ndërtojmë gjithë këto institucione.

Shtëpitë e lindjes, çerdhet, kopshtet, furrat e bukës, mensat, banjat, lavanderitë etj., i ndërtojmë dhe për mbajtjen e tyre bëjmë gjithë këto shpenzime, vetëm e vetëm për të mirën e njerëzve, për të mirën e kooperativistëve, se edhe Partia atë do që ju të jeni sa më mirë. Kur ju prodhoni për vete, keni prodhuar për vendin, se ai është juaji. Në qoftë se ju jeni me shëndet të mirë, Shqipëria është e fortë, në qoftë se fëmijët janë me shëndet të mirë, Shqipëria nuk do të ketë kurrë pleqëri, ajo do të përtërihet vazhdimisht.

Këshillat që jep Partia për higjienën dhe për pastërtinë janë për të mirën tonë dhe të njerëzve tanë. Para çdo gjëje ne duhet të vëmë kujdesin për njeriun dhe në këtë rrugë kemi pasur rezultate, por kemi akoma shumë për të bërë. Prandaj të gjitha këto institucione që keni ngritur i organizoni mirë. Nga ana tjetër, hapni edhe mensa, se kanë rëndësi të madhe për kooperativistët, vetëm kini kujdes që gjellët atje jo vetëm të gatohen të shijshme e në kushte sa më të pastra, por edhe të kostojnë sa më lirë e të ketë me bollëk.

Ju, në kooperativën tuaj, mbase jeni në rregull me këtë që do të them, por kur Partia këshilloi të shkurtohen oborret, disave ndoshta u erdhi keq, por edhe këta më vonë e kuptuan rëndësinë e kësaj mase. Megjithatë në disa kooperativa nuk është zbatuar akoma si duhet porosia e Partisë, sipas së cilës të gjitha tokat që u përfituan nga shkurtimi i oborreve të mbillen me zarzavate, me fruta, me bimë të tjera, në radhë të parë, për të plotësuar me prodhime nevojat e anëtarëve si dhe për ushqimin e bagëtive të



tyre. Gjithashtu u dhanë udhëzime që anëtarët të furnizohen me mish e me bulmet prej bagëtie që u morën nga oborret kooperativiste. Mirëpo në disa kooperative asgjë nuk po u jepet anëtarëve dhe këta kanë të drejtë të ankohen ndaj kryesive, që nuk po punojnë për zbatimin e këtyre direktivave të Partisë.

Oborret u shkurtuan me qëllim që të shfrytlëzohen më mirë se sa kur ishin në duart e anëtarëve. Bagëtitë e përfituara do të japin më shumë mish, bulmet, kurse tokat më shumë zarzavate, më shumë bar për bagëtitë që u kanë mbetur oborreve. Pas kësaj kooperativistët duke e parë gjendjen konkretisht do të binden për drejtësinë e kësaj mase. Kur prej këtyre tokave ju të merrni nga 40 e 50 kuintalë misër dhe nga 25 kuintalë grurë<sup>1</sup>, ose nga 8 tonë oriz për hektar dhe prodhimet t'u shpërndahen anëtarëve në sasi të mjaftueshme dhe në natyrë, ju vetë do të kërkonit që t'ju hiqen edhe ato që ju kanë mbetur akoma, se në dyqanin e kooperativës do të gjeni kur të doni e sa të doni fruta, perime, mish e bulmet. Kur të gjitha këto do t'i keni të siguruara, atëherë do të kërkonit radio, stofra e basma të mira, krevate e karrige, që nuk i keni akoma në masën e duhur.

Hëpërhë Partia gjykon se anëtari i kooperativës duhet ta mbajë akoma lopën dhe parcelën e tokës, derisa të krijojmë atë bollëk për të cilin po luftojmë. Duhet të përpiqemi të gjithë që ta krijojmë sa më parë këtë bollëk. Tani, anëtari e mban oborrin që të

---

1 Në vitin 1983 kjo kooperativë mori mesatarisht 35,5 kuintalë grurë për ha dhe 60 kuintalë misër për ha.

sigurojë ca perime, fasule e bulmet. Në të ardhmen, kur t'i sigurojë këto në dyqanet dhe në mënyrë të qëndrueshme, kur në mensat që hapen anëtari do të vejë të hajë një pjatë gjellë fare lirë, kooperativistit nuk do t'i duhen më as fasulja, as lopa. Duke hapur një dyqan, na duket sikur diç bëmë dhe kënaqemi se kemi bërë mjaft, po Partia mendon se kjo nuk është e mjaftueshme. Edhe fshati duhet të bëhet si qyteti. Prandaj kudo, në çdo fshat, sipas rastit, duhet të ketë furrë, se nuk kushton shumë, me qëllim që çdo anëtar të bëjë atje jo vetëm bukën, por t'u vijë në ndihmë edhe për të pjekur gjëra të tjera.

Ju po bëni gjithë këto shtëpi, po për t'u larë s'keni menduar. Prandaj, edhe për këtë duhet vrarë mendja se si të bëhet për të larë rroba, si dhe për të bërë banjë. Për njeriun kjo është e domosdoshme pasi banja bën mirë edhe për shëndetin. Këto çështje kanë rëndësi të madhe për zbukurimin e jetës sonë, prandaj ndërtimi i objekteve që thamë nuk është para e humbur, siç mund të thotë ndonjë, përkundrazi, ruan shëndetin, shton edhe kënaqësinë e kooperativistëve. Që jeta e njerëzve të bëhet më e mirë, duhen marrë edhe këto masa, pa harruar, natyrisht, kujdesin për prodhimet, për rendimentet etj. Të gjitha këto sjellin begatinë, mirëqenien dhe shtojnë mundësitë për ndërtimin e veprave të tjera më të mira social-kulturore në kooperativat tona.

Për rritjen e pulave dhe të zogjve nuk duhet të mbetemi në ritmet e gjertanishme. Kooperativa juaj kaq e përparuar, që jep prodhime të mëdha duhet të rritë shumë zogj. Natyrisht kjo nuk mund të arrihet

me kllaçka, po me inkubatorë, që tani kemi filluar t'i prodhojmë edhe vetë si në Durrës, në Vlorë etj. Këto makina, që punojnë me korrent, brenda 21 ditëve nxjerrin nga 2 000-3 000 zogj përnjëherësh, të cilët ushqehen me sistem, u jepet të hanë rregullisht çdo ditë një sasi të caktuar ushqimi, nuk lëshohen në natyrë. Pas një kohe, një pjesë e zogjve mund të theren për mish, kurse pjesa tjetër rritet për vezë. Tërë këtë sasi zogjsh, po të rritet brenda një vendi të vogël dhe me kujdes, asnjë sëmundje nuk e zë. Ashtu si veprojmë tani që zogjtë transportohen nga ndërmarrjet në kooperativa, kur gjysmat ngordhin rrugës, një pjesë nga sëmundjet etj., nuk duhet ta vazhdojmë në të ardhmen.

Vitin që vjen, do të importojmë edhe një inkubator të madh, me anën e të cilit do të nxjerrim miliona zogj në vit. Kjo do të jetë në duart e shtetit. Përveç atyre që do të bëjmë vetë, do të importojmë edhe disa inkubatorë modernë më të vegjël dhe sipas tyre do të prodhojmë në vend inkubatorët për nevojat e kooperativave. Pra edhe sektorin e shpendëve duhet ta zhvillojmë, prandaj as ju mos e lini pas dore, se ka leverdi dhe na është shumë i nevojshëm.

Është një gjë shumë e mirë që në kooperativën tuaj keni vendosur të mbillni edhe pemë frutore. Për frutat më duket se ju po punoni, por dëshiroj të theksoj se te ne akoma nuk janë të njohura aq sa duhet. Sidomos te fshatarët ekzistojnë koncepte të tilla që përdorimin e frutave e konsiderojnë si diçka të tepërt, sepse mendojnë që mund të bëhet edhe pa to. Prandaj del detyrë t'i bindim ata se frutat kanë rëndësi të madhe për shëndetin. Trupi i njeriut ka nevojë për

shumë lloj ushqimesh. Kur nuk kemi mundësi të sigurojmë nga të gjitha, s'kemi ç'bëjmë, por ku janë mundësitë të mbjellim e të kemi, duhet medoemos të punojmë që të ketë fruta gjatë gjithë vitit dhe përdorimin e tyre ta bëjmë masiv. Kjo jo vetëm për frutat, por edhe për perimet. Për shembull, ne duhet të mbjellim sa më shumë majdanoz. Po të lexosh librat mjekësorë mëson se majdanozi është një nga barishtet ushqyese më të rëndësishme për trupin e njeriut. Prandaj përdoren sa të jetë e mundur në çdo gjellë atë, se ai ka disa lloj lëndësh që janë mjaft të nevojshme për organizmin. Për njeriun është e nevojshme të marrë të gjitha llojet e ushqimeve. Prandaj që të mos sëmuret, që të jetë i shëndoshë dhe energjik, ai duhet të hajë gjithfarëlloj ushqimesh. Mishi i derrit është i ushqyeshëm, megjithëse pleqtë tanë, ashtu siç ishin mësuar, jo vetëm mishin e derrit, po as atë të lopës nuk e hanin. Myslimanët i pengonte feja ta hanin mishin e derrit, gjë shumë e gabuar. Mjekësia tani na mëson se çdo ushqim i ngrënë në rregull dhe në masën e duhur bën mirë, ashtu si çdo gjë e ngrënë pa rregull e me shumicë bën dëm. Çështjen e shëndetit duhet ta mendojmë ndryshe e jo siç mendohej përpara.

Në vendin tonë tani bëhet luftë për më shumë prodhime dhe mundësi në këtë drejtim kemi, se jemi në rrugë të drejtë. Ne jemi të bindur se kooperativat tona nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, me ndihmën e shtetit, me punën e palodhur e me forcën e bashkuar të kooperativistëve, me zgjuarsinë dhe me diturinë që ata kanë, të cilën e vënë në zbatim, do të arrijnë të marrin më tepër prodhime. Këta faktorë pozitivë janë

ata që do t'i krijojnë mundësitë dhe jemi të bindur se përpimet do të jenë të mëdha.

Unë jam gëzuar shumë për përpimet që keni arritur. Shokë nga udhëheqja e Partisë, të cilët ju kanë vizituar herë pas here, më kanë folur mirë dhe me respekt të veçantë për kooperativën tuaj. Ata u rekomandojnë shpesh shokëve të rretheve të tjera që të vijnë në kooperativën tuaj për të marrë eksperiencë për shumë çështje; sidomos për të parë e për të mësuar se si ju i keni transformuar kodrat dhe i keni kthyer në vende të lulëzuara, se si kujdeseni për zbatimin e agroteknikës, për çerdhet, për kopshtet, për kurset e për gjithçka tjetër pozitive që keni arritur. Unë jam i bindur se nuk ju rritet mendja nga fjalët e mira që thuhet për kooperativën tuaj. Ato, përkundrazi, duhet t'ju nxitin për të ecur akoma më përpara, për të mos u kënaqur me çka keni arritur dhe për t'u bërë kështu shembull për shumë kooperativa të fushës dhe të malësisë.

Është shprehje e lartë e solidaritetit socialist vendimi që keni marrë ju për të ndihmuar shokët e malësisë. Kështu na mëson Partia, që të mobilizohemi të gjithë krah për krah në punë dhe në luftë për rritjen e mirëqenies së përgjithshme. Kushdo në vendin tonë mendon se derisa të gjithë janë mirë, edhe individ i veçantë do të jetë mirë. Neve ndërtuesve të shoqërisë socialiste ndërgjegjja nuk na lejon të pranojmë që disa të jetojnë mirë, kurse disa të tjerë të vuajnë. Kjo s'pajtohet me natyrën e shoqërisë sonë socialiste, kurse në shoqërinë kapitaliste kjo është një nga aspektet e neveritshme të realitetit të atjeshëm. Ne frymëzohemi

nga një ideal i lartë, nga ndjenja fisnike shumë humane, prandaj ndihma që i japim njëri-tjetrit nuk na duket një barrë, përkundrazi, ajo sjell kënaqësi të madhe shpirtërore. Kështu shpjegohet edhe sakrifica që bëni ju për të ndihmuar shokët e malësisë dhe që tregojnë sa mirë e keni kuptuar solidaritetin komunist. Pra, kooperativa juaj po shkon përpara edhe në drejtim të edukimit të ndërgjegjes së njerëzve. Ju po arrini suksese edhe në këtë drejtim, ashtu siç keni arritur edhe në prodhimin bujqësor e blegtoral.

Për sukseset dëgjon në të katër anët e vendit tonë, si në industri, ashtu edhe në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë. Sidomos këto dy vitet e fundit është bërë një hop i madh përpara. Edhe ju përmendët këtu, me të drejtë, shembullin e lartë komunist në punë të brigadierit Alo Qose. Me letrën që i dërgova<sup>1</sup> e mora si shembull këtë brigadier të pararojës, po si ai ka edhe shumë të tjerë në vendin tonë dhe jam i bindur se të tillë ka edhe në mes jush. Ju, në kooperativë, keni njerëz të mrekullueshëm, gra e burra, vajza dhe djem, të cilët punojnë dhe mësojnë në mënyrë shembullore ashtu si edhe Alo Qosja, por puna dhe qëndrimi i tyre komunist nuk vihen në dukje. Një mbledhje, si ajo që bëtë për zbatimin e eksperiencës së Alo Qoses, nuk e keni bërë edhe për përhapjen e eksperiencës së anëtarëve të dalluar të kooperativës suaj që i keni këtu para syve çdo ditë e çdo orë. Kjo nuk është e mirë. Ne duhet ta luftojmë kudo këtë qëndrim jo të drejtë ndaj njerëzve të mirë, të cilët i

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim f. 78.

kemi pranë, se është refleksi i pikëpamjeve të gabuara idealiste. Përhapja e eksperiencës së përparuar të fillojë së pari qysh këtu, në kooperativën tuaj, me shembullin e njerëzve të përparuar, që i kemi pranë, por që shpesh nuk i shikojmë, duhet të kujdesemi dhe ta vëmë mirë në dukje punën e tyre, të mësojmë edhe gjithë të tjerët që të punojnë si ata. Kur shohim që një brigadë merr rendimente të larta, e gjithë kooperativa duhet të marrë shembull dhe të punojë në atë mënyrë. Ajo duhet të bëhet pishtar i përhapjes së të resë në kooperativë. Po ta bëjmë një gjë të tillë në të gjitha kooperativat, në fabrikat e në ndërmarrjet e vendit tonë, atëherë kemi për të parë se si do të ngrihen rendimentet dhe prodhimet do të jenë më të shumta e më të lira. Prandaj të mos presim gjersa udhëheqja të vërë në dukje ndonjë shembull dhe pas-taj ta ndjekim atë. Shembujt t'i gjejmë në mes jush. Po të veproni në këtë mënyrë keni për të parë se ç'përparime të mëdha do të arrini.

Partia vazhdimisht porositi që të ndiqet në çdo vend shembulli i më të mirëve. Këtë porosi ajo e thekson edhe tani. Natyrisht, në fillim, kjo direktivë u zbatua në një kuadër të ngushtë, më vonë filloi të zërë vend më mirë, kurse tani po zbatohet në një shkallë gjithnjë e më të gjerë. S'ka dyshim se duke ecur në këtë rrugë, në vitet e ardhshme, vala e vrullit të punonjëseve tanë s'do të përmbahet. Përpara në një hektar tokë merrej vetëm 10 kuintalë misër, kurse tani po merren nga 25 e 30 kuintalë, bile ka parcela ku merren 50, 60, 70 e më shumë kuintalë për hektar. Kjo provon se shembulli i më të mirëve, që Partia ka poro-

situr të ndiqet nga të tërë, po vjen vazhdimisht duke u zgjeruar dhe çdo vit do të zgjerohet. Tani po luftojmë me të gjitha forcat dhe mjetet që, në sipërfaqe të mëdha, të marrim mesatarisht 20 e 25 kuintalë grurë për hektar dhe 30 e 40 kuintalë misër etj. Për ta bërë realitet këtë pikësynim, shembujt e Alo Qoses dhe të tjerëve si ai, kudo që janë, duhet të bëhen të njohur dhe të ndiqen në masë. Të gjithë e kuptojmë drejt këtë çështje prandaj është e nevojshme të vëmë në dukje shembullin e kooperativistëve të palodhur si Alo Qosja, që janë në kooperativën tuaj, se kështu do të ngrihet më shpejt e do të përparojë më tej kooperativa në çdo pikëpamje.

Keni bërë shumë mirë që keni zgjedhur nënkryetare një vajzë, sepse shoqet tona janë shumë të zonjat, njëlloj si edhe shokët dhe këtë zotësi ato e tregojnë çdo ditë me fakte, me punë. Këtu afër ju keni Kombinatit e Tekstileve. Kush e viziton atë shikon se atje mbizotëron gruaja punëtore, e cila ka në dorë makinat moderne. Gratë kanë mësuar t'i përdorin ato më së miri. Kudo në Shqipëri, në industrinë tonë, sidomos në arsim, në shëndetësi, në tregti e në fronte të tjera pune shumica janë vajza e gra. Edhe në bujqësi gati gjysma e punonjësve janë shoqe. Kjo vjen jo se humbën burrat po se Partia këshillon që gruaja të dalë e të punojë njëlloj si dhe burri. Në të kaluarën ç'nuk thuhej për dobësinë e gruas, por këto sot nuk pinë ujë. Sesa të zonjat janë gratë këtë e ka treguar lufta, e tregon puna dhe zotësia e tyre. Kjo çështje duhet parë drejt. Gjysma e njerëzimit, ashtu si dhe e popullsisë së Shqipërisë, përbëhet nga femra. Prandaj në



goftë se ndihmojmë që këto të edukohen, të mësojnë dhe të bëhen të afta njëlloj si burrat, atëherë përparimi i vendit tonë do të jetë dyfish më i madh.

Gratë kanë edhe një funksion tjetër të natyrshëm dhe të respektuar, ato ripërtërijnë jetën. Pikërisht vetëm për këtë duhet të ushqehet respekti më i madh për gratë, respekt dhe dashuri për ato që krijojnë jetën. Nuk ka më të dashur se nëna. Ai që nuk e do e nuk respekton nënën, nuk mund të jetë njeri me ndjenja të pastra. Kush respekton nënën, ka respekt edhe ndaj gruas, të cilën e kemi për detyrë ta ndihmojmë në jetë që ajo të punojë e të jetojë me nder, t'i dëgjohen fjala e mendimi dhe të ecë përpara. Kjo është vijë e drejtë e Partisë sonë për qëndrimin ndaj gruas.

Vajzat tona, tashti kudo po çajnë përpara, ato akoma kanë pak druajtje, por Partia u jep forcë t'i thonë pa druajtje mendimet e tyre, ca më tepër të mos kenë frikë nga kurrkush. Kjo nuk do të thotë që atyre t'u mungojë respekti për njerëzit, sepse edhe ato duhet të kenë po atë respekt për të tjerët, siç duhet të kemi edhe ne për to. Vetëm se ne burrat po t'i bëjmë më mirë llogaritë, do të na dalë që kemi akoma shumë për të bërë në favor të grave. Po të hedhim një sy atje ku punojnë gra e burra, del se gratë jo vetëm janë më të ndershme e më të ndërgjegjshme në punë, por edhe shumë më të ngarkuara. Vërtet burrat në kooperativën tuaj bëjnë nga 320 e më tepër ditë-punë, kurse gratë vetëm nga 220-230 ditë-punë, por së pari puna që bëjnë gratë në arë është e një cilësie më të mirë, nga çdo pikëpamje; këtë besoj s'ka njeri ta

kundërshtojë dhe kjo vjen se gruaja është më e ndër-gjegjshme. Nuk duhet të harrojmë se tërë barra e punëve të shtëpisë i bie gruas dhe këto punë nuk janë të pakta, bile disa janë mjaft të rënda. Një punë tjetër me shumë rëndësi për gruan është edhe kujdesi për rritjen e fëmijëve. Pra duke llogaritur se gruan përveç punës që bën në kooperativë, në shtëpi e presin edhe mjaft punë të tjera, del se ajo punon shumë më tepër nga burri. Prandaj ne burrat e kemi për detyrë të mendojmë dhe të luftojmë që grave t'ua lehtësojmë punët në shtëpi, se vetëm kështu ato do të jenë në gjendje që edhe jashtë shtëpisë, të bëjnë po aq ditë-punë sa edhe burrat.

Ka raste që koha e punës në kooperativë nuk shfrytëzohet si duhet. Merreni një herë në shqyrtim këtë çështje, mateni mirë punën që bëni dhe do t'ua dalë se si numër ditësh me të vërtetë bëhen nga shumë kooperativistë edhe 350 ditë-punë në vit, por në të njëjtën kohë do të rezultojë se nuk punohet më shumë se 5-6 orë në ditë. Kjo nuk është e drejtë. Në Kushtetutën e Republikës sonë Popullore thuhet që çdo shtetas duhet të punojë 8 orë në ditë. Kaq punojnë edhe punëtorët. Prandaj duhen bërë përpjekje që koha e punës të shfrytëzohet si duhet. Në qoftë se shkohet me mendimin për të bërë shumë ditë-punë si numër, por punë faktike pak, të jemi të sigurt që paga e ditës së punës do të ulct. Në qoftë se përpiqemi që gjatë ditës së punës të punojmë 8 ose 9 orë, të jemi të sigurt që edhe sikur 200 ose 220 ditë-punë të bëjmë, prodhimet do të jenë më të shumta, prandaj edhe paga do të ngrihet. Duke punuar si duhet, duke e shfrytë-

zuar mirë kohën e punës, rendimentet e prodhimeve do të ngrihen. Përkundrazi, kur puna bëhet shkel e shko dhe vetëm gjatë 4 e 5 orëve, nuk mund të marrim 40 apo 50 quintalë misër për hektar siç parashikojmë. Në raste të tilla mund të bësh edhe 400 ditë-punë si numër, po paga që do të marrësh do të jetë e vogël, se pa punuar në rregull, pa rritur rendimentin nuk rritet prodhimi. Prandaj këtë çështje e shikoni me kujdesin më të madh, shoqe dhe shokë kooperativistë, se koha është flori.

Pa u larguar nga ky problem është mirë të mbahehet parasysh edhe çështja e normave. Në asnjë mënyrë nuk duhet luftuar për të vendosur norma të vogla, por të mëdha. Kjo nuk do të thotë që njerëzit të dërrmohen në punë. Jo, përkundrazi, Partia porosit vazhdimisht, që kudo të tregohet kujdes për të ruajtur shëndetin e njerëzve tanë, se këta janë pasuria jonë më e madhe. Vetëm se normat duhet të jenë të përshtatshme, të atilla që, pa dëmtuar shëndetin e njerëzve, të bëhet nga secili ajo që duhet, prandaj në këtë drejtim të luftoni edhe ju.

Ka kooperativistë, të cilët ankohen se kryetari merr rrogë të majme. Rroga e kryetarit nuk është e madhe, ajo është caktuar në atë masë që të mos ketë një diferencim të theksuar me të ardhurat e një kooperativisti që punon në mënyrë normale. Por kryetarit shpërblimi i është caktuar në bazë të ditëve të punës. Në qoftë se kooperativistët si numër bëjnë shumë ditë-punë, po punojnë nga tre orë efektive në ditë, sigurisht që do të marrin më pak të ardhura. Fajin në këtë rast e kanë anëtarët e kooperativës, sepse ata bëjnë

ditë-punë të shumta por të zbrazëta. Këtu e ka buri-min diferenca midis pagës së kryetarit, i cili paguhet me rrogë bazë, dhe pagës së kooperativistit që punon pak. Prandaj në raste të tilla kooperativistët duhet të kritikojnë, në radhë të parë, veten e tyre. Ata le të bëjnë ditë-punë më pak, por këto ditë po të jenë me të vërtetë të ngjeshura dhe me rendiment, atëherë të ardhurat do të jenë më të shumta dhe paga do të jetë më e madhe.

Këto kisha për t'ju thënë, shoqe dhe shokë kooperativistë. Me besim të patundur te Partia përvishjuni punës që në vitin jubilar të 25-vjetorit të Çlirimit të arrini suksese më të mëdha se kurrë ndonjëherë.

Rroftë Partia!

Rroftë klasa jonë punëtore!

Rroftë fshatarësia jonë kooperativiste!

*Botohet për herë të parë, me  
ndonjë shkurtim, sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

# INTEGRIMI ME BORGJEZINË — KURS I RI I KONGRESIT TË 12-TË TË REVIZIONISTËVE ITALIANË

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

2 mars 1969

Revizionistët italianë mbajtën para pak ditësh në Bolonjë, Kongresin e tyre të 12-të. Në qoftë se do të përpiqeshim t'i karakterizojmë vetëm me një fjalë rezultatet e këtij kongresi revizionist, mund të thoshim se ai ishte kongresi i integritit të plotë të revizionistëve italianë me borgjezinë e tyre kombëtare nëpërmjet vijës ideologjike dhe praktikës së vjetër politike të socialdemokracisë evropiane. Njëkohësisht ai ishte kongresi që shënoi një çarje tjetër më të thellë dhe zgjeroi hendekun midis revizionistëve italianë e atyre sovjetikë.

I vetmi qëllim që i vuri vetes udhëheqja toliatiste në kongresin që organizoi në Bolonjë ishte adaptimi i një kompleksi masash praktike të përshtatshme për koniunkturën e jetës politike aktuale të Italisë për integrimin e partisë revizioniste në strukturat e qeverisjes së vendit nga klasat sunduese. Në qoftë se disa

vjet më parë, revizionistët italianë flitnin akoma për «marrjen» e pushtetit, tani edhe këtë fjalë e hoqën përfundimisht nga fjalori i tyre. Në kongresin e ri ata deklaruan se dëshirojnë vetëm «pjesëmarrjen» e tyre në pushtetin ekzistues borgjez, në marrëveshje me partitë sunduese borgjeze.

Kongresi i Bolonjës tregoi se objektivi kryesor i udhëheqjes revizioniste është rendja e çmendur për t'ua përshtatur politikën dhe qëndrimin e saj koniunkturave kalimtare që krijohen në vend nga manovrimet e shumta të forcave politike borgjeze. Tezat e kongresit ishin në fakt një grumbull kërkesash reformiste që nuk dalin asnjë grimë jashtë kuadrit të lejueshëm të demokracisë borgjeze. Ato ishin vërejtje e kritika për legjislacionin në fuqi, gjë që përfaqësuesit revizionistë e bëjnë prej vitesh në parlamentin borgjez, por deri më sot nuk ua ka vënë veshin njeri. Longoja u betua e u stërbetua njëqind herë se kërkesat dhe synimet e partisë nuk do të prekin në asnjë mënyrë rendin borgjez ekzistues. «Pikënisje dhe referim i gjithë luftës sonë, deklaroi ai, mbetet kushtetuta republikane».

Nuk mund të themi se s'ka të drejtë «Korriere dela sera», gazeta e madhe e patronatit italian, kur shkruan se tezat e Kongresit të 12-të të PKI mund t'i quajnë si të tyre dhe t'i brohorasin të gjitha korrentet politike borgjeze të Italisë. Duke karakterizuar raportin e Longos në kongres gazeta shkruan se nga ai «del një lloj amalgami i përgjithshëm, në të cilin çdo njeri, duke filluar nga papa Pavli VI, te demokristiani Moro, nga Lombardi, te De Martino, socialistë të së majtës, nga studenti, te njeriu i thjeshtë mund të gjejë diçka

që i përshtatet. Mbishtresat e vijës e të perspektivës janë aq të shumta sa përfundojnë të paralizohen dhe të shlyhen njëra nga tjetra. I vetmi fakt që rezulton është se nuk ekziston më një, por vija të ndryshme italiane drejt socializmit, domethënë asnjë».

Kur revizionistët italianë e reduktojnë gjithë luftën për socializëm në luftë për zbatimin e kushtetutës, ose më mirë të themi të asaj që lejon borgjezia, ata ndjekin dy qëllime të përcaktuara mjaft qartë. Në radhë të parë, ata garantojnë borgjezinë se nuk do të prishin rendin kapitalist ekzistues dhe rregullin që ajo ka vendosur, dhe në radhë të dytë, çka është më e rëndësishmja, duke përhapur iluzionin se socializmi është kushtetuta dhe revolucioni është lufta për mbrojtjen e saj, ata i largojnë klasën punëtore dhe masat punonjëse nga revolucioni e nga lufta e vërtetë për socializëm, i shtyjnë ato të mbeten të robëruara brenda kuadrit të rendit kapitalist.

Nuk është e rastit që gjatë gjithë punimeve të kongresit nuk u dëgjua asnjëherë, goftë edhe rastësisht, fjala revolucion ose diktaturë e proletariatit. Këtë ata e shikojnë si një provë të devotshmërisë së tyre ndaj demokracisë borgjeze, si një demonstrim të integritit të plotë të tyre në këtë demokraci. Në praktikën e përditshme ky qëndrim shprehet në një betejë tragjikomike midis eksponentëve të borgjezisë dhe atyre të revizionistëve. Të parët u bëjnë vazhdimisht presion se nuk janë akoma plotësisht demokratë, në kuptimin borgjez, se nuk janë tërhequr akoma plotësisht nga «pozitat dogmatike», dhe të dytët bëjnë sa më shumë lëshime për t'u treguar demokratë e për t'u mby-

llur gojën atyre që ua mohojnë këtë cilësi. Me sa duket puna, nuk do të vonojë shumë që të ndërrohen rolet dhe revizionistët të thonë se borgjezët nuk janë aq borgjezë sa pretendojnë.

Të ftuarit e partive dhe të korrenteve borgjeze folën dhe paraqitën në kongres, pa kurrfarë druajtje dhe në mënyrë sistematike, programet e tyre politike, duke u përmendur pjesëmarrësve se ku dhe sa duhet të lëshojnë akoma. Por, nga ana tjetër, në kongres nuk foli asnjë përfaqësues dhe nuk u dëgjua fare zëri i 20 milionë punonjësve italianë që ato ditë, ndërsa zhvillonte punimet kongresi, kishin shpërthyer në grevë për të drejtat e tyre, që ua mohojnë borgjezia dhe ata përfaqësues të saj që u duartrokitën aq frenetikusht nga revizionistët në kongresin e tyre.

Revizionistët, gjithashtu, nuk harruan të adoptonin si dokument të parë të kongresit një telegram dërguar presidentit të republikës, ruajtësit të rendit kapitalist, rend ndaj të cilit grevistët ishin revoltuar, por «harruan» të adoptonin ndonjë rezolutë solidarizimi, qoftë edhe formale, në shenjë vëmendjeje e përkrahjeje për këta miliona punonjës.

Në kongres nuk «u harrua» vetëm çështja e solidarizimit me këtë grevë, kjo do të ishte e keqja më e vogël, por aty, sidomos në raportin e Komitetit Qendror, nuk u trajtua pothuajse fare, problemi i luftërave klasore që këto dy vitet e fundit kanë marrë proporcione të gjera në Itali. Revizionistët u munduan ta mbulonin këtë çështje tronditëse duke u orvatur që të krijonin gjatë punimeve të kongresit, nëpërmjet pompoziteteve, siç ishte, për shembull, numri i madh



i të ftuarve, mbi 5000 veta, pjesëmarrja e gjerë e përfaqësuesve të shtypit borgjez, midis të cilëve edhe ai i Vatikanit, një eufori false politike, e cila do ta largonte vëmendjen e publikut nga ballafaqimi midis temave që diskutonin revizionistët në kongres dhe realitetit të ditës.

Por me gjithë përpjekjet e udhëheqjes për të fshehur të vërtetën, Kongresi i 12-të revizionist zbuloi se në Itali, ashtu si dhe në mjaft vende të tjera të Perëndimit, tanimë ka filluar procesi i ndarjes së masave nga partia revizioniste. Kjo shprehet në faktin se shtresat popullore, të cilat kanë qenë deri më sot nën influencën e partive revizioniste, kanë filluar të mos u binden më predikimeve të tyre për paqen sociale dhe në kundërshtim me vullnetin e revizionistëve shpërthejnë në aksione të fuqishme të luftës klasore kundër borgjezisë dhe pushtetit të saj. Në këtë luftë, punonjësit dhe revizionistët ndodhen në kampe të ndryshme dhe hendeku midis tyre po bëhet gjithnjë më i gjerë e më i thellë.

«Rreth nesh, — ishte i detyruar të pranonte plot preokupim, dhjetorin e kaluar, organi qendror i partisë revizioniste italiane, gazeta «Unita», — po krijohet një boshllëk i madh besimi. Ne nuk përfaqësojmë më një forcë revolucionare në një kohë kur problemi i revolucionit është bërë tema kryesore e Perëndimit dhe e shoqërisë kapitaliste». Shqetësimet e mëdha të bazës i tregon edhe fakti që jo shumë kohë para se të mblidhej kongresi shumica e 109 krahinave të partisë revizioniste italiane i kishin kërkuar udhëheqjes të rishqyrtonte qëndrimin e vet ndaj revoltës së studentëve,

Megjithëse jo e hapët, por mjaft e qartë ishte edhe kritika që bëri në kongres Borgini, anëtar ekzekutiv i Federatës së Rinisë Komuniste, i cili e qortoi partinë për pasiguri dhe pse kishte treguar «ngadalësi në analizën e kontradiktave të reja të kapitalizmit», të cilat kishin çuar në revoltat e studentëve.

Rritja e shpejtë e luftës klasore të masave popullore i ka vënë revizionistët në pozitë mjaft të vështirë. Ata duan të shkëputen nga punonjësit dhe të bashkohen me borgjezinë kundër tyre dhe njëkohësisht me pamje të lënë përshtypjen se janë më punëtorët. Kjo taktikë oportuniste prej renegatësh tipikë doli fare qartë edhe në Kongresin e 12-të të partisë revizioniste italiane. Ndërsa nga njëra anë u përpoqën t'i drejtojnë klasën punëtore, fshatarësinë e varfër, studentët dhe inteligjencien antikapitaliste në rrugën e reformizmit e të nënshtrimit, nga ana tjetër, i kërkuan borgjezisë të bashkohet me revizionistët për t'i bërë ballë rrezikut të ri që kërcënon të dyja palët. «Të gjesh një rrugëdalje politike nga kriza e tanishme, — deklaroi Longoja në raportin e tij, — nuk është një detyrë që mund të kryhet vetëm nga pararojat e aq më pak nga një parti e vetme. Ne ripohojmë se ta bësh Italinë të dalë nga kriza dhe ta bësh të përparojë në rrugën e demokracisë së socializmit, do të jenë forca të ndryshme që veprojnë në të njëjtin drejtim me përkrahjen e të gjithë popullit».

Nëse do të bashkohen «pararojat» borgjeze me revizionistët për të shkuar tok në socializëm kjo lë mjaft për të dyshuar, por që ata shpejt a vonë do të bashkohen për të shtypur punonjësit dhe për të mbytur në

gjak lëvizjet e tyre revolucionare, kjo është e sigurt. Paraardhësit e tyre, socialdemokratët, në tradhtinë ndaj revolucionit dhe kauzës së klasës punëtore, kanë dhënë mjaft shembuj të tillë. Nuk është pa kuptim fakti që sot në Itali ekziston një grup i fuqishëm në parti të demokristiane dhe në qarqet e larta sunduese, të kryesuar nga ish-kryetari i qeverisë, Moro, të cilit, meqë ra fjala, Longoja i bëri elozhe të mëdha në kongres, që kërkon të shikohet eventualiteti praktik i krijimit të një koalicioni qeveritar me pjesëmarrjen e revizionistëve.

Një nga çështjet, që tërhoqi vëmendjen e përgjithshme në kongresin e Bolonjës, ishte edhe problemi i marrëdhënieve midis revizionistëve sovjetikë e atyre italianë, e në mënyrë të veçantë, qëndrimi i këtyre të fundit ndaj pushtimit të Çekoslovakisë. Siç pritej, krerët revizionistë italianë, me gjithë afinitetin e madh shpirtëror që kanë me ata të Bashkimit Sovjetik dhe me gjithë peshën e madhe që kanë subvencionet sovjetike në aktivitetin e tyre, mbetën këmbëngulës në qëndrimin e vet kundër hegjemonisë së Moskës dhe agresionit në Çekoslovaki. Ata janë kundër sepse revizionistët çekoslovakë i përkasin së njëjtës rrymë revizioniste si edhe italianët. Në mënyrë të veçantë në trajtimin e çështjes çekoslllovakë ata duan të jenë në një kor me borgjezinë italiane dhe nuk dëshirojnë në asnjë mënyrë të ndahen nga ajo.

Longoja dhe krerët e tjerë të partisë së tij polemizuan haptazi me miqtë sovjetikë duke u kundërvënë përsëri teoritë e tyre të mirënjohura të policentrizmit toliatist pretendimeve hegjemoniste e shoviniste të udhëheqësve hrushovianë të Bashkimit Sovjetik për

dominim e nënshtrim të frontit revizionist e të shteteve revizioniste. Ata folën për «respektimin e plotë të autonomisë dhe të sovranitetit të çdo partie komuniste dhe të çdo shteti socialist», shfaqën «kundërshtimin ndaj çdo teorie të shtetit ose të partisë udhëheqëse», kundër çdo «ndërhyrjeje e presioni» në punët e brendshme të partive të tjera. Në mënyrë të veçantë ata përkrahën klikën e Dubçekut dhe vijën çekosllovake, duke i këshilluar sovjetikët «të mos bëjnë asgjë që do të dëmtonte autoritetin e udhëheqësve çekoslllovakë, as në Çekoslovakë as jashtë saj».

Më kot u mundua Ponomarjovi, «specialist» i marrëdhënieve ndërrevizioniste, të cilin Brezhnjevi e pat dërguar në Bolonjë, t'i bindte revizionistët italianë se padronët e sotëm të Kremlinit gjoja janë «për barazinë e të drejtave dhe pavarësinë e të gjitha vendeve e të partive», se, sipas tyre, «në lëvizjen komuniste nuk duhet të ketë parti udhëheqëse». Ai e demaskoi vetveten kur, më poshtë, u mundua të justifikojë agresionin barbar në Çekoslovakë dhe ta quajë atë «detyrë internacionaliste». Heshtja me të cilën të pranishmit dëgjuan fjalimin e tij ishte më afër përbuzjes se sa vëmendjes.

Edhe ndërhyrjet e satelitëve të revizionistëve sovjetikë, përfaqësues të Gomulkës, Zhivkovit e të tjerë nuk mundën ta shpëtonin izolimin dhe pozitën e papërshtatshme në të cilën u gjendën revizionistët sovjetikë në kongresin që u zhvillua në Bolonjë. Mjaft lehtë, nga ana tjetër, mundën të notojnë titistët, të cilët gjetën te revizionistët italianë përkrahës jo të këqij në grindjen e re të përkohshme që kanë me udhëheqësit e Moskës. Dalja e delegacionit sovjetik nga

salla në kohën kur po fliste Kardeli nuk mund të ishte ndonjë masë efikase për të vënë në vend nderin nga akuzat diskredituese të titistëve në një vend ku ishte mbledhur ajka e revizionizmit.

Kongresi i revizionistëve italianë ishte një dëshmi tjetër e degjenerimit të mëtejshëm të frontit revizionist, e shtimit të grindjeve dhe kontradiktave midis grupimeve të ndryshme revizioniste. Këtu u provua përsëri se përpjekjet e udhëheqësve revizionistë sovjetikë, për të vendosur autoritetin monopolist të Bashkimit Sovjetik në frontin revizionist, kanë pësuar tanimë një dështim të plotë. Agresioni në Çekoslovaki dhe vazhdimi i rezistencës së popullit çekoslovak, përveç faktorëve të tjerë, i kanë bërë pothuajse të pamundura marrëveshjet, qoftë edhe sa për sy e faqe, midis revizionistëve. Politika hegjemoniste e imperialiste e krerëve të Bashkimit Sovjetik, siç e tregoi edhe kongresi italian, i nxiti dhe shërben si pretekst për grupet revizioniste të Perëndimit të intensifikojnë kursin e tyre për t'u shkëputur nga presioni i Moskës dhe integrimin e tyre me borgjezinë e vet kombëtare. Revizionistët italianë, për shembull, faktin e grindjeve të tyre me udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik dhe kundërshtimin e vijës hegjemoniste sovjetike i kanë shndërruar në një flamur të kthesës drejt bashkimit me borgjezinë, si provë të besnikërisë së tyre ndaj rendit borgjez. Po në këtë aspekt duhet parë edhe rritja e tendencave nacionaliste brenda këtyre grupimeve, gjë që në fushën praktike shprehet në mungesën e përkrahjeve të iniciativave që Bashkimi Sovjetik ndërmerr tani në arenën ndërkombëtare dhe në solidari-

zimin e heshtur e shpeshherë të hapët me politikën e jashtme të qeverive përkatëse borgjeze edhe në ato çështje që drejtohen kundër sovjetikëve. Qëndrimet e reja të udhëheqjeve të partive revizioniste ndaj Tregut të Përbashkët, NATO-s, ose problemit të Berlinit, janë mjaft kuptimplote në këtë drejtim.

Qëndrimet që mbajtën dhe pikëpamjet që shprehën delegatët e huaj në kongresin italian e japin të qartë edhe atmosferën që do të sundojë në mbledhjen revizioniste të majit në Moskë dhe cilat mund të jenë rezultatet e saj. Revizionistët sovjetikë, të cilët kërkojnë të thyejnë izolimin brenda frontit revizionist dhe të vënë disi në vend prestigjin dhe autoritetin e tyre të rënë përtokë, mundohen që në Moskë të diskutohen «problemet aktuale në luftën kundër imperializmit dhe veprimet e përbashkëta në këtë luftë» me qëllim që të bëhet «shtrëngimi i radhëve» të revizionistëve, siç u shpreh Ponomarjovi në Bolonjë. Por, siç doli edhe nga fjalimet e përfaqësuesve të pjesës më të madhe të partive të huaja, të cilët morën pjesë në Kongresin e 12-të të revizionistëve italianë, të tjerët nuk kanë aspak ndër mend t'u japin kënaqësinë krerëve sovjetikë që, nëpërmjet spekulimeve rreth «veprimeve të përbashkëta», t'u imponojnë detyrime që janë vetëm në interes të politikës së jashtme të Bashkimit Sovjetik. Revizionistët e tjerë e kuptojnë se në situatën e sotme marrja e çfarëdo detyrimi do t'i vinte ata jo vetëm nën njëfarë varësie nga hegjemonia sovjetike, do t'u hapte jo vetëm shteg presioneve të udhëheqësve të Kremlinit, por do të kufizonte shumë edhe terrenin e veprimit të tyre në fushën e marrëdhënieve kombëtare e ndërkombë-

tare. Ata nuk duan të venë tek amerikanët nën drejtimin e revizionistëve sovjetikë, por në unitet të plotë me borgjezinë e tyre kombëtare. Berlingueri, zëvendëssekretari i përgjithshëm i partisë revizioniste italiane, duke ditur se shpreh edhe mendimin e mjaft partive të tjera, në fjalën e mbylljes së kongresit u tha sovjetikëve se në mbledhjen e Moskës duhet bërë «një ballafaqim i hapët dhe me përgjegjësi i pikëpamjeve, bile edhe lidhur me problemet më të vështira» dhe jo siç duan udhëheqësit sovjetikë që atje të diskutohet vetëm çështja e «luftës kundër imperializmit» që është një manovër për t'u shtrënguar vidhat të tjerëve.

Por a do të pranojnë revizionistët sovjetikë që në mbledhjen e Moskës të vihen në bankën e të akuzuarve dhe të dëgjojnë kundërshtimet e italianëve, të francezëve, të anglezëve etj. për agresionin e tyre në Çekoslovaki, t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me teorinë e Brezhnjevut për «sovrانيتetin e kufizuar të vendeve socialiste», ose për «pavarësinë e kondicionuar» të partive etj.? Vështirë është të pranohet. Sovjetikët duan që në Moskë të vendosin dhe të justifikojnë hegjemoninë e tyre mbi partitë pjesëmarrëse, kurse italianët, ose francezët do të shkojnë atje, para së gjithash, për ta kundërshtuar këtë hegjemoni dhe për të marrë kështu një certifikatë «mirësjelljeje» që do t'u shërbente për integrimin e mëtejshëm me borgjezinë e tyre. Prandaj konferenca e majit në Moskë ka dështuar përpara se të mbahet. Edhe në qoftë se do të mblidhet ndonjëherë, ajo nuk do të bëjë gjë tjetër veçse do t'i shtojë edhe më tepër grindjet e përçarjet në frontin revizionist, do t'i diskreditojë dhe më tepër organi-

zatorët e saj, e në radhë të parë, krerët e revizionizmit sovjetik, të cilët kanë mbështetur aq shpresa të mëdha në të.

Sado përpjekje që të bëjnë revizionistët unitet midis tyre nuk mund të ketë. Kurrë ndonjëherë deri më sot nuk është vendosur ndonjë unitet mbi bazën e tradhtisë ndaj revolucionit e marksizëm-leninizmit dhe të luftës kundër tyre. Kjo ndodh jo vetëm për sa u përket partive të ndryshme revizioniste, por edhe unitetit brenda secilës parti. Këtë e tregoi fare mirë edhe kongresi i fundit i partisë revizioniste italiane. Në shembullin e partive borgjeze e sidomos të atyre socialdemokrate, partia është ndarë tani në fraksione nga më të ndryshmet, që kanë platforma ideologjike e politike të caktuara, që kanë pasuesit e përkrahësit e tyre, brenda e jashtë radhëve të partisë, dhe që grinden e përleshën me njëra-tjetrën për epërsi e pozita të veçanta. Në këtë situatë vija dhe qëndrimet e partisë do të marrin gjithnjë e më pak në konsideratë opinionin e masave e të anëtarëve të thjeshtë dhe do t'u përshtaten më shumë raportit të forcës, kompromiseve dhe lëshimeve reciproke të këtyre fraksioneve. Kontradiktat që vihen re në raportin e KQ, të paraqitur në kongres nga Longoja, rrjedhin, sigurisht, në pjesën më të madhe, nga vetë vija e përgjithshme oportuniste antimarksiste e kundërrevolucionare e partisë revizioniste italiane, por në një shkallë të konsiderueshme ato janë edhe shprehje e luftës midis vijave të ndryshme fraksioniste që ekzistojnë në parti.

Është e vërtetë se Italia po kalon një krizë të rëndë që prek si ekonominë, ashtu edhe politikën. Lëvizja e fuqishme e studentëve, grevat e mëdha të punëtorëve



që kanë prekur gati të gjithë sektorët e prodhimit, protestat e nëpunësve shtetërorë e privatë, duke mos përmendur luftën e paprerë të fshatarësisë së shfrytëzuar, tregojnë se borgjezia italiane qëndron mbi një vullkan, shpërthimi i të cilit mund të ndodhë në çdo kohë. Masat punonjëse luftojnë dhe kërkojnë rrugëdalje nga gjendja e rëndë, kërkojnë ndryshime revolucionare për gjendjen e tyre dhe të vendit, janë të gatshme të luftojnë me vendosmëri për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Por dëmet që i kanë sjellë dhe i sjellin revizionistët italianë lëvizjes revolucionare të klasës punëtore dhe të masave të tjera të shfrytëzuara janë të mëdha. Ata mundohen ta futin klasën punëtore në rrugën e reformizmit, të ngjallin në të frymën e pasivitetit, të pritjes e të nënshtimit kristian. Është detyrë e forcave pararojë dhe më të shëndosha të klasës punëtore italiane, e revolucionarëve të vendosur marksistë-leninistë që të vihen në ballë të luftës së klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse, rinisë punëtore dhe shtresave të tjera të popullsisë që kundërshtojnë borgjezinë, dhe të luftojnë për thellimin gjithnjë e më të madh të luftës klasore në vijën e drejtë të marksizëm-leninizmit për revolucionin proletar dhe për diktaturën e proletariatit. Është detyra e tyre që t'u tregojnë masave rrugën e drejtë revolucionare, që t'i ndriçojnë ato me ideologjinë e vërtetë të klasës punëtore, të përpunojnë dhe të zbatojnë strategjinë dhe taktikën e drejtë për kryerjen e revolucionit.

E gjithë kjo punë nuk është e lehtë. Një pjesë e konsiderueshme e masave punonjëse e deziluzionuar nga oportunizmi dhe vija tradhtarë e revizionistëve mo-

dernë, nën influencën e të cilëve ka qenë deri më sot, tani është hedhur në luftë kundër shtypjes e rendit borgjez. Por kësaj lufte i mungon orientimi, organizimi e drejtimi, kështu që borgjezia dhe oportunistët nuk e kanë të vështirë të mbrohen nga sulmi i saj dhe ta kundërgodasin me ashpërsi të madhe. Prandaj revolucionarëve u takon detyra e vështirë, por fisnike, të futin përsëri te punonjësit ndërgjegjen klasore, frymën e disiplinës e të organizimit e mbi të gjitha t'i udhëheqin ata në rrugën e revolucionit, ashtu siç mëson marksizëm-leninizmi.

Revizionistët italianë mburren se ata janë një parti e madhe, se për ata votojnë kaq e aq veta. Në të vërtetë ata janë mjaft të dobët ashtu siç është e dobët edhe borgjezia me të cilën ata bashkëpunojnë. Ata i përkasin së vjetrës, asaj që po shembet e po vdes. Falimentimi i revizionistëve duket në degjenerimin e tyre, duket në rrokullisjen që ata kanë marrë drejt integritetit të plotë me borgjezinë. Fundi i palavdishëm i revizionistëve nuk është i largët, ai po duket qartë në horizontin e zhvillimit historik të kohës sonë. Revizionizmi ka filluar tanimë të ecë në të tatëpjetë dhe brezi ynë do të jetë patjetër dëshmitar i rrokullisjes së tij në greminën e historisë, atje ku kanë përfunduar të gjitha forcat reaksionare që i janë kundërvënë përparimit revolucionar të popullit punonjës.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 52 (6404), 2 mars 1969*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 323*

# **TË BËJMË NJË PUNË MË TË MIRË PËRGATITORE PËR LËVIZJEN E KOOPERATIVISTËVE NGA VERIU NË JUG DHE ANASJELLTAS**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 mars 1969**

*Para se të fillonte mbledhja dhe gjatë diskutimeve rreth kësaj pike të rendit të ditës, shoku Enver Hoxha bëri disa pyetje e ndërhyrje për të qartësuar sa më mirë efektet e lëvizjes së fshatarësisë nga Veriu në Jug e anasjelltas. Në fillim, diskutimi i këtij problemi mori karakterin e një bisede të lirë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Ju, shokët e rretheve, keni ndonjë gjë të re për të na treguar, se ato që thuhën në materialin që është paraqitur i dimë që para 5 muajsh, bile dimë gjëra të tjera edhe më të freskëta. Le të na

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi lëvizjen e kooperativistëve nga Veriu në Jug e anasjelltas dhe detyrat për thellimin e mëtejshëm të saj», paraqitur nga Kryesia e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

flasë për shembull, shoku Sevo Tarifa<sup>1</sup>, të cilin nuk e kemi dëgjuar ndonjëherë në mbledhjet tona qëkurse ka shkuar me punë në Gjirokastrë.

*SHOKU SEVO TARIFA:* Në Gjirokastrë, vitin e kaluar, erdhën nga zonat e Veriut 166 veta, kurse nga rrethi ynë shkuan në ato zona, ndër të tjera, edhe 64 të reja aktiviste. Përveç këtyre, në rrethet e Veriut u dërguan edhe 30 mësuesë për një vit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nga ishin këto mësuesë që shkuan në rrethet e Veriut? A kishte prej tyre nga Dropulli apo ishin gjirokastrite që punojnë si mësuesë në Dropull?

*SHOKU SEVO TARIFA:* Shumica e tyre ishin nga qyteti por që punojnë në fshat, kurse arsimtare nga Dropulli ishin vetëm tri.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po në Dropull çuat malësorë dhe në ç'fshat?

*SHOKU SEVO TARIFA:* Këtë radhë, në Dropull nuk çuam malësorë, por kemi marrë masa që nga turni i dytë që do të vijnë së shpejti, të çojmë dhe në Dropull. Jemi konsultuar me shokë të Dropullit dhe ata e mirëpresin një gjë të tillë, pavarësisht nga disa vështirësi për çështjen e gjuhës shqipe.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kudo në Dropull tani ka familje që flasin shqip, prandaj u kam thënë shokëve të Gjirokastrës që edhe në këto fshatra të dërgohen malësorë të Veriut.

*SHOKU SEVO TARIFA:* Për sa u përket efekteve

---

<sup>1</sup> Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Gjirokastrës.

edukative të kësaj lëvizjeje, nuk do të them këtu përshtypjet tona, por në qoftë se më lejohet, po citoj ndonjë shprehje nga letrat e malësorëve, të cilat kanë më shumë kuptim se fjalët tona si kuadro. Një fshatar nga rrethi i Shkodrës, në letrën që i drejton një kooperativisti të Mashkullorës, në familjen e të cilit ai kishte ndenjtur, shkruan: «Të fala shumë anesë. Nuk e harroj kurrë dashurinë e saj dhe tuajën për mua», ndërsa gruaja e tij, që nuk kishte qenë në Mashkullorë, shkruan: «Mua më duket si me të pasur vëlla në gjak dhe po të më takojë rasti me ardhë në atë krahinë, unë do ta kërkoj shtëpinë tuaj».

Gjithashtu, një kooperativiste nga Shkodra shkruan: «Po i erdhi mbarë bashkëshortit tim, ka me ardhë aty se i ka mbetë mendja për gjithçka që unë i kam tregue për ju. Në qoftë se do të vini edhe ju, të na bëni telegram se kemi me ju dalë në Shkodër me ju pritë»... Kështu ndodh edhe me mësueset e rrethit tonë që kanë shkuar në Veri...

**SHOKU ENVER HOXHA:** Çfarë përshtypje kanë këto mësuese për zonat e Veriut? Natyrisht, na thuaj jo vetëm përshtypje të mira. Ç'thonë ato për përparimet në Veri dhe a ka gjëra që duhen zgjidhur më mirë?

**SHOKU SEVO TARIFA:** Ato na kanë treguar se në fshatrat e Veriut, përveç përparimeve, që janë të mëdha, ka akoma prapambetje, sidomos në mënyrën e jetesës. Mendimi i tyre është se shokët e komiteteve të Partisë dhe punonjësit e shëndetësisë nuk bëjnë një punë të mjaftueshme politike dhe bindëse për futjen e kulturës në fshat...

*SHOKU XHEMAL DINI*<sup>1</sup>: Kontaktet që u morën me kooperativistët e Jugut kanë bërë që te malësorët e rrethit tonë të rrënjoset ideja se duhet patjetër të ndryshohen mënyra e jetesës dhe konceptet e vjetra që ekzistojnë akoma në ndërgjegjen dhe në veprimet e tyre...

Eksperiencën që fshatarët tanë kanë fituar nga kooperativat e Jugut për mbajtjen e pastërtisë dhe të rregullit në shtëpi, për pajisjen e banesës me orëndi të përshtatshme, si minderë, perde etj., janë munduar t'i vënë në jetë në ambientin familjar të tyre...

*SHOKU ENVER HOXHA*: Gjejnë fshatarët në dyqan dyshekë, jorganë dhe oriendi shtëpijake që u nevojiten?

*SHOKU XHEMAL DINI*: Ne kemi marrë masa që në fshat të plotësohen kërkesat e fshatarësisë dhe për këtë periudhë, që është koha e ndarjes së të ardhurave në kooperativat bujqësore, organet e tregtisë janë kujdesur në mënyrë të veçantë për të furnizuar dyqanet me mallra.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Dyshekët dhe sendet e tjera i keni në sasi të mjaftueshme sa të përballoni të gjitha nevojat e fshatarësisë?

*SHOKU XHEMAL DINI*: Në bazë të llogarive që kemi bërë ne i plotësojmë kërkesat e fshatarëve për Kelmendin dhe Dukagjinin. Për këtë qëllim u kemi hequr disa mallra zonave të tjera dhe qytetit.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Po kjo nuk do të thotë

---

<sup>1</sup> Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës.

të lini pa gjë lokalitetet e tjera, si fjala vjen atë të Shllakut.

*SHOKU XHEMAL DINI:* Në Shllak ka mallra në dyqan, por ka më pak kërkesa nga ana e fshatarësisë, sepse janë furnizuar më parë, kurse në lokalitetin e Kelmendit e të Dukagjinit akoma nuk e ndiejnë sa duhet domosdoshmërinë për t'i blerë këto sende, por edhe puna jonë këtu ka qenë më e dobët.

Një problem tjetër që na del neve në rreth është ai i higjienës personale. Në përgjithësi fshatarët e Gjirokastrës dhe të Vlorës kanë dhënë një shembull të mirë në këtë drejtim...

*SHOKU ENVER HOXHA:* A bëhen nga populli kërkesa për sapun?

*SHOKU XHEMAL DINI:* Kërkesa për sapun ka pasur, por jo në atë shkallë sa ç'bëhen për jorganë dhe për dyshekë...

*SHOKU KOÇO LAKO<sup>1</sup>:* Çështja e përfitimit nga lëvizja Veri-Jug ishte e dyanshme, si nga ana e malësorëve që erdhën nga Veriu, ashtu edhe nga vetë kooperativistët tanë.

Në Tragjas, gjatë kësaj kohe, kooperativistët bënë gjëra të tilla, të cilat nuk ishin bërë as për vite të tëra. Vetë lëvizja ndikoi për vetedukimin e kooperativistëve tanë. Ne patëm parasysh t'u bënim të qartë kooperativistëve problemet, sepse në fillim pati disa keqkuptime dhe shpenzime të tepërta për pritjen e miqve...

*SHOKU ENVER HOXHA:* Cilat probleme shoqëro-

---

<sup>1</sup> Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës.

re preokupojnë Partinë për ta shfrytëzuar si duhet këtë lëvizje? Çdo ditë po flasim për këto çështje, por këtu s' duam gjëra të përgjithshme. Ç'mendojnë, për shembull, kooperativistët për dashurinë midis të rinjve, për takimet midis tyre etj.? Ç'mendojnë për kishën, për xhaminë, për pashkën e bajramin, për veshjet etj.? Pra na flitni për gjëra konkrete.

Çfarë thonë për këto probleme malësorët e ardhur nga Veriu, këto na interesojnë shumë. Në qoftë se fshatari që pret mikun ther një qengj, fundja mirë bëri, kishte pa e theri, e tillë është edhe mikpritja jonë. Partinë nuk e preokupon kjo, po çështjet shoqërore.

**SHOKU KOÇO LAKO:** Midis kooperativistëve është biseduar edhe për çështjen e martesave, për probleme të familjes dhe për organizimin e punës. Duke folur për problemet e fesë, ata mësuan për këto gjëra, po bënë edhe vërejtje. Për shembull, në Novoselë u bënë vërejtje përse në varrezat kishte akoma kryqe?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Dua t'ju bëj edhe një pyetje, shoku Koço: I përgatitët shokët që dërguat në Veri? Bëtë mbledhje të veçanta me ta për problemet shoqërore? I mblodhët tri -katër herë, ta zëmë, dhe t'i instruktonit për problemin e gruas, të fesë, për problemin e veshjes, të kuzhinës, duke i vënë në dijeni se atje do të gjejnë një situatë të tillë apo të atillë dhe t'i porositnit si t'i trajtojnë këto probleme? E bëtë një punë të tillë?

**SHOKU KOÇO LAKO:** Jo, këtë gjë nuk e kemi bërë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sekretari i organizatës-



-bazë fare lehtë mund të caktojë 60 veta që të shkojnë në Veri, po çfarë duhet të çojnë këta atje, për këtë nuk është menduar. Kështu këta njerëz shkojnë jo të përgatitur dhe, po vajtën kështu, s'kanë për të bërë gjë. Jeni interesuar të mësoni prej tyre çfarë mendimesh kanë sjellë dhe në çfarë konkluzionesh kanë arritur?

Ju vetë nuk keni bërë ndonjë punë me ta para se t'i çoni në Veri, kurse duhet të punoni me kujdes që t'i përgatitni mirë, se ata do të jenë agjitorë të vijës së Partisë dhe nuk do të venë atje formalisht. Nga sa shoh në këtë çështje më duket nuk jeni në rregull. Prandaj kini parasysh që në të ardhmen të punoni më mirë në këtë drejtim, si punëtorë partie të thelloheni, të përgatiteni mirë, me qëllim që nga gjithë eksperiencia e këtij viti të nxjerrim konkluzione dhe që vitin e ardhshëm të jemi më të përgatitur për këtë lëvizje.

Shokët e Komitetit Qendror të Rinisë të mos jenë si të huaj në këtë lëvizje, të mos mendojnë se është e mjaftueshme ajo që interesohen shokët e Partisë të rretheve. Në këtë lëvizje marrin pjesë edhe të rinj, ka vërtet të moshuar, por gjithë lufta bëhet për të përkrahur të renë, rininë. Kjo punë bëhet që i moshuari ta kuptojë të renë dhe ta mbështetë. Prandaj kjo nuk është një punë që s'ju takon shokëve të Komitetit Qendror të Rinisë. Le të jenë pleq ata që shkojnë nga Veriu në Jug dhe nga Jugu në Veri, këta shkojnë që të shikojnë të renë, të binden se duhet përkrahur e reja dhe të mos sjellin pengesa.

Në lidhje me problemin që po analizojmë, unë insistoj, sidomos për punën që duhet bërë për përgatitjen ideopolitike të kooperativistëve që dërgohen nga Veriu

në Jug dhe anasjelltas, se kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Përgatitja nuk duhet bërë me një punë të përciptë shkel e shko, duke u mjaftuar vetëm me caktimin e njerëzve që do të dërgohen nga Veriu në Jug dhe me marrjen e tyre rastësisht e pa kriter, sa andej-këtej, nga një fshat ose nga një tjetër. Në përbërjen e këtyre grupeve të kemi parasysh që të caktojmë persona nga ato fshatra dhe sidomos nga ato familje ku janë më të theksuara shfaqjet e konceptet e vjetra konservatore e prapanike në politikë, në ideologji, në moral, apo edhe në ekonomi qoftë, kur ekzistojnë në të tilla në mendjet e tyre, me qëllim që këta t'i ndihmojmë për t'i zhdukur këto njolla të shoqërisë së vjetër e të krijojmë koncepte e qëndrime të reja socialiste.

Prandaj, si rrethet që i dërgojnë, ashtu dhe ata që i presin duhet të punojnë me kujdes të madh me këta njerëz dhe shumë kohë përpara se t'i nisin. Për shembull, në qoftë se mendohet të dërgohet një grup kooperativistësh nga Shkodra në Vlorë, nuk është e mjaftueshme që komitetet e Partisë të këtyre dy rretheve të merren vesh vetëm për personat që do t'i shoqërojnë, për datën e nisjes, për sigurimin e autobusëve etj., se nuk janë këto kryesoret. Me shokët e Vlorës duhet të bisedohet konkretisht që nga Shkodra do të dërgohen, fjala vjen, tre kooperativistë nga Vukli, pesë nga Kopliku etj., duke i vënë në dukje rrethit pritës karakteristikat e secilit grup, bile të çdo individ, sidomos për pikëpamjet prapanike, që kanë lidhje me formimin e tyre ideopolitik etj. T'i sinjalizohet, gjithashtu, rrethit që i pret, mendimi i organizatës së Partisë që i dërgon

se çfarë problemesh duhet të trajtohen me këta njerëz gjatë kohës që do të qëndrojnë atje, në mënyrë që të vendosen në ato familje që janë të përgatitura dhe të çliruara nga të tilla pikëpamje dhe që janë në gjendje t'u flasin me takt e me kujdes miqve që do t'u shkojnë për të metat e tyre dhe t'i bindin për dëmet që na sjellin ato dhe jo të dërgohen ku të mundet ose t'i marrë kush të dojë. Ata malësorë shkodranë që kanë, ta zëmë, pikëpamje të prapambetura për fejesat e martesat, të dërgohen të banojnë si miq në familje ku çështja e martesës jo më sot, po vite të tëra është kuptuar drejt dhe vetë të zotët e shtëpisë kanë krijuar lidhje martesë në mënyrë të çiltër. Kjo duhet pasur parasysh edhe kur një grup tjetër njerëzish ose ndonjë individ është fanatik, beson akoma te zoti dhe, megjithëse është i lidhur me Partinë, mban akoma kreshmë në familje, por jo haptazi, dhe e ka të zorshme të pranojë me ndërgjegje ato çka thuhet kundër fesë. Të tillë njerëz duhen dërguar në ato familje pjesëtarët e të cilave nuk kanë besuar kurrë, s'kanë festuar as bajram, s'kanë mbajtur as ramazan, apo kreshmë, kanë qenë kundër tyrbeve, ikonave etj., etj., se këta janë në gjendje dhe dinë si të punojnë me ata që do t'u shkojnë. Duke u dërguar në ambiente të atilla, miqtë do të marrin një valë që do t'i shërbejë qëllimit të lëvizjes që ka filluar.

Prandaj midis dy rretheve nuk duhet të bisedohet vetëm në vija të përgjithshme për këtë problem të rëndësishëm, po të punohet nga palët me kujdes të madh për përgatitjen sa më të mirë të punës.

Mirë duhet përgatitur gjithashtu edhe kur dërgo-

hen njerëz nga Jugu në Veri për të ndihmuar organizatat e Partisë atje ku do të venë. Komiteti i Partisë i rrethit që i dërgon dhe ai që i pret duhet të mendojnë së pari, ku do të venë këta, natyrisht, jo ku të mundet, apo sa për të gjetur një qoshe ku të futen. Jo! Kështu do të jetë më mirë të mos dërgohen fare. Së dyti, duhet menduar që në Veri të çojmë njerëz të zgjedhur, për të punuar në ato kooperativa ku ekziston një situatë jo e mirë që duhet ndrequr, ku duhet zgjidhur ky ose ai problem shoqëror, ideologjik, politik etj. Ata që do të caktohen të venë, në radhë të parë duhet të jenë, pra, në gjendje dhe në atë nivel që këto probleme politike, ideologjike, shoqërore etj., që preokupojnë Partinë në kooperativa, t'i trajtojnë drejt me njerëzit që i presin, të dinë të prekin me takt e me ngrohësi zemrat e tyre dhe, me punën që do të bëjnë, ta thyejnë këtë situatë jo të mirë. Pastaj, para se të nisen, dhe jo vetëm një herë, atyre u duhet bërë e qartë, sipas nevojës dhe gjendjes që ekziston në kooperativën që do t'i presë, ç'qëndrim mbajnë atje njerëzit ndaj problemit të gruas, në luftën kundër fesë, për problemin e higjienës e të pastërtisë, në luftën kundër zakoneve prapanike, për rritjen e kujdesin për fëmijët, për dashurinë, fejesat e martesat sipas normave socialiste etj., etj. Kur të jenë mirë të informuar dhe si të jenë instruktuar si duhet, atëherë ata do të dinë edhe të punojnë me kujdes të madh me miqtë që i presin.

Këtë qëllim duhet të ketë për objektiv puna përgatitore me ata që do të dërgohen, ndryshe kjo nuk ka për të na sjellë dobitë që dëshirojmë. Nuk shtrohet, pra, çështja sa për t'i ndihmuar ca materialisht koope-

rativat që i presin, për shembull, për të hapur toka të reja, për të korrur, apo për t'u dhënë eksperiencë në këtë apo në atë sektor të zhvillimit kooperativist. Natyrisht, edhe këtë ndihmë duhet ta japin ata që do të shkojnë, se në sajë të punës që do të bëjnë gjatë kohës që do të qëndrojnë atje si miq, do të sigurojnë edhe ushqimin e tyre, por me këtë lëvizje ne ndjekim qëllime të tjera më të mëdha, t'i ndihmojmë pritësit në radhë të parë për problemet që ata i preokupojnë, të luftohen tek ata disa mbeturina e pikëpamje të vjetra që i pengojnë në punë dhe në jetë, në mënyrë që vendësit të lehtësohen prej tyre e të punojnë më mirë vetë në të gjitha drejtimet.

Jo vetëm kaq, po kujdes duhet pasur gjatë përgatitjes edhe për ndihmën që do të jepet edhe në fushën ekonomike, në dhënien e eksperiencës së përparuar etj. Ç'rëndësi do të kishte në qoftë se në Veri dërgohen nga Jugu njerëz nga një kooperativë që vetë është e mbytur në prodhimin e domateve, për t'u folur për kultivimin e kësaj perimeje shokëve të tyre në Veri, kur në fshatin që i pret domatet nuk bëhen fare? Kooperativa mikpritëse mund të jetë në një terren të tillë ku, si thotë populli, «ha pula strall», klima është e atillë që domatja nuk arrin të piqet fare. Prandaj ata që do të venë, duhet ta dinë që më parë se atje nuk mund të bëhet domatja, pra as që duhet të flasin për këtë çështje, se nuk sjell asnjë përfitim. Këtë gjendje më parë duhet ta dijë komiteti i Partisë që i dërgon, i cili, akoma pa i nisur këta aktivistë, duhet t'u bëjë të ditur edhe gjendjen politike, nivelin ideologjik e problemet shoqërore që ekzistojnë atje, por edhe gjendjen

ekonomike deri kushtet tokësore e klimatike të kooperativeve ku do të shkojnë, t'u flasë për bimët që rriten atje dhe për të tjerat që mund të mbijnë dhe si t'i mësojnë shokët e tyre të malësisë që t'i mbjellin.

Në Jug, ka fshatra, trualli i të cilave i përngjet atij të fshatit që pret miqtë, që kanë, pra, kushte pak a shumë të barabarta ose të përafërta klime, toke etj., por që kanë grumbulluar një eksperiencë të mirë, të vlefshme për t'ua dhënë edhe të tjerëve. Duke punuar konkretisht dhe në kushte reale të mundshme për të zënë vend eksperiencia e tyre, puna që do të bëjnë do të japë rezultate, ndihma do të jetë efektive dhe mikpritësit do të përfitojnë.

Këtë qëllim ka përgatitja dhe jo t'u flitet njerëzve kuturu.

Rrethi që pret, ta zëmë Shkodra, e di se në cilat kooperativa ka rezistencë për këtë ose për atë problem, prandaj mund t'u kërkojë rrethëve të tjera që gjatë këtij viti t'i dërgohen njerëz aq sa e ndien ai vetë nevojën, vetëm për 2-3 kooperativa e jo për të gjitha. Atëherë komitetet e Partisë që do të dërgojnë njerëzit e tyre në Shkodër, si, bie fjala, ata të Vlorës, Beratit, ose Gjirokastrës duhet të bëjnë përpjekje për të njohur me hollësi situatën ekonomike, politike, ideologjike, morale etj., të këtyre tri kooperativeve, për të njohur pra problemet që preokupojnë konkretisht organizatën e Partisë të rrethit të Shkodrës në këto tri kooperativa që të dinë të caktojnë elementë të përshtatshëm nga kooperativat korresponduese të tyre, të aftë për të çarë në një situatë jo të mirë që ekziston dhe që kërkon një punë të menduar mirë.

Kështu duhet të veprohet edhe me ata që do të dërgohen nga Veriu në Jug që edhe kooperativistët e kësaj zone të përfitojnë nga virtytet e larta të malësorëve tanë. Edhe kooperativat e rretheve të Jugut kanë problemet e veta për zgjidhjen e të cilave mund të ndihmohen duke u dërguar njerëz nga Veriu. Ta zëmë se në një kooperativë bujqësore të Gjirokastrës mungon pastërtia, kurse në Shkodër ka plot njerëz të pastër që mund ta ndihmojnë këtë kooperativë me shembullin e tyre. Për t'i dhënë një shtytje përpara zgjidhjes së kësaj situatë në këtë kooperativë, Komiteti i Partisë i Rrethit të Gjirokastrës e informon atë të Shkodrës për këtë situatë, me qëllim që t'i dërgohen andej disa njerëz nga familje që pastërtinë e kanë traditë, për t'u mësuar, në këtë rast, atyre të kooperativës së Gjirokastrës, ç'është pastërtia dhe ç'duhet të bëjnë që të jenë të pastër. Ka, gjithashtu, në ndonjë rreth fshatra ku jetojnë njerëz që ndoshta bëjnë hile në punë e në shumë drejtime, që vjedhin, mashtrojnë, bëjnë matrapazllëqe e të tjera. Në fshatra ku ka të tilla shfaqje duhet të dërgohen njerëz nga ato krahina dhe familje që kurdoherë janë shquar për cilësitë e tyre burrërore, që i kanë urryer vjedhjet, grabitjet, hiletë, mashtrimet etj. Këta, para se të nisen, duhet të instruktohen nga Partia, t'u tregohet qëllimi përse po dërgohen, që ta dinë se do të venë të qëndrojnë për ca kohë në një fshat ku ekzistojnë situata të tilla, prandaj të porositen që virtytet e tyre të larta t'ua komunikojnë njerëzve të kooperativës në të cilën do të shkojnë.

Rëndësia e përgatitjes është e madhe, se tani janë

me qindra njerëzit që po venë e vijnë nga Veriu në Jug dhe nga Jugu në Veri, ku, përveç të tjerave, duhet të çojnë atje ku venë cilësitë e tyre të mira, gjithashtu, të marrin andej për në vendet e tyre gjithçka pozitive që do të shërbejë për ta çuar edhe më përpara gjendjen. Prandaj në rast se kjo punë do të bëhet me mend dhe e përgatitur, do të na japë me siguri rezultate të mëdha.

Por as kjo nuk është e mjaftueshme. Edhe kur të kthehen në rrethin dhe kooperativat e tyre njerëzit e dërguar, komitetet përkatëse të Partisë duhet të marrin përsëri takim me ta, t'i dëgjojnë me vëmendje si kaluan dhe si punuan, vështirësitë që ndeshën, përvojën që çuan dhe atë që fituan, të marrin mendimin e tyre ç'thonë ata vetë që të bëhet akoma më shumë në të ardhmen, në mënyrë që komitetet e Partisë nga ana e tyre të thellohen, të nxjerrin nga kjo punë mësimet e konkluzione të reja për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Duke vepruar kështu, s'ka dyshim që çdo vit do të bëhet një punë edhe më e kualifikuar në këtë fushë dhe lëvizja që ka filluar do t'ia arrijë qëllimit që synon Partia.

Edhe organizatat e rinisë nuk duhet të qëndrojnë si të huaja në këtë lëvizje dhe, pavarësisht se në grupet e njerëzve që dërgohen nga një rreth në tjetrin mund të bëjnë pjesë në shumicë të moshuar, duhet të marrin pjesë aktive edhe këto organizata në punën përgatitore që duhet të bëhet para dërgimit të këtyre njerëzve. Kjo ka për qëllim që vetë të moshuarit që dërgohen nga një rreth në tjetrin të binden, ta kuptojnë dhe ta



përkrasin pa pengesa të renë që po lind e po rritet, ta mbështetin rininë në çdo ndërmarrje përparimtare të saj.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha. «Raporte e  
fjalime 1969-1970», f. 76*

*Botohet i plotë sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverbali  
i mbledhjes së Sekretariatit të  
KQ të PPSH që gjendet  
në AQP*

## **TË RRITET MË TEJ CILËSIA E PUNËS IDEOSHKENCORE ME STUDENTËT DHE PEDAGOGËT**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 mars 1969**

Jam dakord me të gjitha sa u thanë, por lidhur me çështjen që shqyrtojmë, dëshiroj të vë në dukje se, për shumë probleme që u shtruan, kërkohet të kalojmë nga faza e diskutimeve në veprim, të mos kënaqemi vetëm me një «duhet...» dhe të vazhdojmë të ecim me ngadalë përpara.

Që duhen kuadro më shumë, jam dakord; që duhen lehtësuar këta kuadro, edhe me këtë, gjithashtu, jam dakord, po kjo nuk na e zgjidh problemin. Ne në asnjë vend nuk kemi kuadro të lartë disponibël, të tepërt. Këtu nuk e kam çështjen për t'ju dhënë dy ose tre kuadro, se kjo është një gjë e vogël që mund të

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua për punën e bërë për edukimin e studentëve dhe të pedagogëve në Universitetin e Tiranës.

bëhet, puna është për shumë kuadro. Me këta që kemi, mund t'i zgjidhim problemet që na dalin përpara. Për shembull, shoku Stefanaq Pollo është në gjendje të përgatitë disa tema problemore të historisë së Shqipërisë, pse edhe vetë është hartues i tekstit të saj, po kështu mund të veprojnë edhe specialistë të tjerë përkatësisht në fushën e veprimtarisë së tyre.

Botimi i tekstit të Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë është një lehtësi e madhe për gjithë pedagogët të cilët japin filozofinë, apo historinë e Partisë, për faktin se, ndërsa më parë atyre u duhej të bazohehin në tekste dhe copëza të shkëputura, t'i mblidhnin e t'i plotësonin ato, të përpunonin leksionet etj., tani u është dhënë në dorë një material shumë i mirë, i koncentruar. Këta, sipas mendimit tim, janë njerëz të aftë, që e zotërojnë lëndën, kanë kapacitet konkludiv dhe janë në gjendje të hartojnë, pra u ecën pena. Natyrisht, po të jenë ca më të lirë, s'ka dyshim, mund ta bëjnë edhe më mirë punën, po në këtë drejtim duhet të mendojnë e të punojnë dhe ata vetë për ekonomizimin e kohës, për përmirësimin e stilit dhe të metodës së punës. Vazhdimisht po flitet e po diskutohet se, si kudo, edhe në dhënien e mësimit duhen ndryshuar stili, format e metodat e punës. Pikërisht në këtë çështje të insistojmë shumë, pse në qoftë se nuk përmirësohen metoda e stili, s'ka si gjendet koha e nevojshme për ngritjen e nivelit dhe të punës shkencore të kuadrove të shkollave tona të larta.

Për sa i përket praktikës së mësimdhënies, mendoj se, derisa një pedagog i ka të përgatitura dhe të shtypura leksionet në dispensë, nuk ka arsye përse

të humbasë kohën për të përsëritur në auditor edhe një herë fjalë për fjalë të njëjtat gjëra. Një formë e tillë pune më duket se është kohë e humbur që duhet përfitur. Përse ta humbasim atëherë këtë kohë të pedagogut? Pedagogu mund t'i bëjë të ndërgegjegjshëm studentët, dhe këtu duhet të ndihmojë edhe puna konkrete e organizatës së rinisë, që secili student leksionin e shtypur ta studiojë vetë, kurse në mësim s'ka pse të vihen në lëvizje studentët për të mbajtur shënime e për të kopjuar të njëjtat gjëra që ata i kanë në dispensa. Në të tilla raste do të ishte mirë që pedagogu të përgatitet për t'u dhënë studentëve diçka më tepër, plotësuese dhe të re, pse kështu edhe studentët i ndihmon, fiton kohë edhe për vete, ndërsa mësimi bëhet më interesant.

Këtë kohë pedagogu le ta shfrytëzojë më mirë për të mësuar, për të konceptuar vetë disa forma të tjera pune, për ta pasuruar leksionin me gjëra të reja. Kjo, mendoj unë, është një formë që mund të praktikohet, megjithatë ju, që merreni pikërisht me këtë punë, mund të gjeni forma të tjera më të frytshme dhe më ekonomike nga pikëpamja e kohës.

Një pedagog i cili që prej 10 vjetësh jep lëndën e historisë, në qoftë se vazhdon të japë të njëjtat leksione, pa u bërë këtyre asnjë ndryshim, mendoj se ndjek një metodë pune të gabuar. Nuk duhet vepruar kështu. Një mënyrë e tillë në dhënien e mësimit tregon se nuk bëhen përpjekje as për kualifikim të mëtejshëm, as për të lehtësuar studentët. Kërkohet që pedagogu i historisë të lexojë, herë pas here, disa libra, të zgjerojë gjithnjë horizontin, të kualifikohet e të rritë cilësinë e

dhënies së mësimi. Po të bëhet sistematikisht një punë e tillë, pedagogu do të jetë fare mirë në gjendje që brenda një kohe shumë të shkurtër t'u bëjë një transformim të konsiderueshëm leksioneve, të mos i përsëritë ato, përkundrazi, t'i bëjë shumë më interesante se më parë.

Nuk e kam fjalën nëse janë apo jo mundësitë nga ana teknike për t'i shtypur leksionet, ky është një problem tjetër, por për përmirësimin e stilit dhe të metodës së punës të pedagogëve tanë. Në qoftë se pedagogu e ka bërë një punë qysh në auditor, përse ta përsëritë të njëjtën punë edhe në seminar? Seminari të shërbejë për të dhënë sqarime të mëtejshme për leksionet, për të plotësuar ato që nuk ka pasur mundësi të thuhet gjatë orës së mësimi. Po të jetë problemi shumë i koklavitur, pra, kur është nevoja, seminari mund të zgjasë në kohë, po seminare për seminare s'ka përse të bëhen. Seminari jep mundësi që pedagogu të zhvillojë disa çështje që nuk i përmban leksioni. Pikërisht këtu do të duket zotësia e pedagogut, i cili duhet të gjykojë se ç'është e nevojshme t'u japë studentëve në një seminar a konferencë plotësuese. Kjo punë, duke dalë nga kuadri i teksteve të hartuara, do të ndihmojë për zgjerimin e mëtejshëm të horizontit të studentëve, për të nxitur tek ata kuriozitetin, për të mësuar e për t'u thelluar më shumë.

Pedagogu në leksion apo në seminar, sigurisht, e ka për detyrë t'ua bëjë më të lehtë punën studentëve, po edhe këta duhet të mendojnë e të punojnë që t'ua lehtësojnë detyrën pedagogëve, duke bërë të gjitha përpjekjet. Kjo punë, pra, kryhet mirë e në kompleks

kur studentët venë në seminar të përgatitur. Pedagogu nga ana e vet s'duhet të ketë frikë se në seminar do t'i drejtohen pyetje të vështira. Përkundrazi, kur studentët bëjnë pyetje, kjo do të thotë se ata e kanë studiuar materialin para se të vijnë në seminar. Kur veprohet kësisoj, pedagogu, që di ku janë dobësitë e tekstit, mund të parashikojë edhe pyetjet që mund t'i drejtohen dhe do të jetë kështu në gjendje t'u përgjigjet. Pra, në qoftë se pedagogu e zhvillon punën në platformën që thamë, në mënyrë më racionale, atëherë ai do të jetë në gjendje t'u dalë përpara edhe pyetjeve që mund t'i drejtohen. Në auditor ndonjë pedagog ndien në vetvete se leksioni që do të mbajë mund të mos jetë i plotë dhe kjo e shqetëson, pse mendon për pyetjet që mund t'i bëjnë studentët me aftësi të mira konkludive. Ky shqetësim duhet t'i nxitë të punojnë më me kujdes, që t'u dalin përpara të papriturave, domethënë, para se të venë të flasin, problemin ta njohin konkretisht, të shfletojnë në bibliotekë tekste e manuale të ndryshme për t'i freskuar njohuritë, të thellohen nga të gjitha anët, të reflektojnë dhe të parashikojnë çfarë pyetjesh mund t'u bëhen nga studentët.

Megjithatë mund t'u japësh përgjigje edhe pyetjeve dhe të krijosh përshtypjen se çështjet u kuptuan mirë, mirëpo këto pyetje të shumta mund të jenë edhe për shkak se tema nuk është kuptuar si duhet. Prandaj, duke u orientuar nga pyetjet që drejtuan studentët, veç leksionit, me qëllim plotësues, mund të bëhet edhe diçka tjetër, një seminar a konferencë. Gjersa drejtohen shumë pyetje kuptohet se ka probleme të ngritura në leksion që nuk janë sqaruar. Shqetësimi

që lind është i drejtë, por puna plotësuese që duhet bërë të jetë e tillë që ta nxitë tjetrin të interesohet të vijë në konferencë a seminar, se atje do të dëgjojë gjëra të reja që nuk i ka mësuar më parë.

Kam parasysh se kuadrot e universitetit janë shokë me dijeni të gjëra. Megjithatë, edhe sikur të supozohet se një leksion është i përgatitur më së miri, prapë në të nuk jepen të gjitha dituritë e pedagogut për problemin që trajtohet. Veç kësaj, as format që përdoren në dhënien e leksioneve nuk janë të vetmet dhe më të mirat, pse ka dhe duhet të ketë forma të tjera të përshtatshme që, të njëjtën lëndë, me po ato njohuri, studentët t'i përvetësojnë edhe më thellë. Kur vetë pedagogu përpiqet dhe i rifreskon e i zgjeron më tej dituritë e veta, ai gradualisht e me kohë i pasuron temat me fakte të reja, me shembuj të tjerë.

Për sa u përket pyetjeve që bëjnë disa studentë, për çështjet ndërkombëtare, përgjigjja, në një formë ose në një tjetër, jepet çdo ditë në gazetatat tona, bile ato japin shumë materiale. Përse t'u përgjigjen pedagogët në mësim këtyre pyetjeve, kur studentët kanë mundësi të sqarohen çdo ditë nga shtypi, apo për të humbur kohën? Ku është këtu puna politike e organizatës së rinisë me studentët? Nuk dua të them me këtë që të mos sqarohen studentët, medoemos duhen sqaruar, por nuk duhet të ketë student që të mbetet pa lexuar shtypin. Në qoftë se ka të tillë, ky boshllëk zë fill te puna e pamjaftueshme politike e organizatës së rinisë për të ngjallur në gjithë këtë masë të madhe djemsh e vajzash pasionin e tyre edhe për lexim, për punë politike e kulturore jashtë mësimin e jashtë mble-

dhjeve. Studentët të bëhen të ndërgjegjshëm se janë njerëz politikë, prandaj, si të tillë, ngjarjet e vendit dhe ato ndërkombëtare kanë për detyrë t'i ndjekin përditë, t'i njohin, të marrin pjesë aktive në mbledhjet e organizatës së rinisë, të lexojnë rregullisht gazetatat, të diskutojnë me shokët, të bëjnë edhe pyetje, në mënyrë që të nxjerrin diçka për veten, por edhe për të tjerët.

Pedagogët tanë janë njerëz punëtorë, të ndërgjegjshëm, që e duan universitetin dhe bëjnë përpjekje të lavdërueshme në punë. Megjithatë, duhet të ecim edhe më përpara nga niveli i arritur, sidomos për ngritjen e cilësisë së dhënies së mësimin, duke u vënë pedagogëve më tepër kohë në dispozicion për ngritjen e nivelit të tyre ideoshkencor. Nga ana tjetër, krahas përmirësimit të stilit dhe të metodës së tyre për mësimdhënien, rëndësi ka të shtohen përpjekjet për të ngritur ndërgjegjen e studentëve në një nivel më të lartë, gjë që është plotësisht e mundur, se edhe këta i kemi njerëz të mirë e patriotë. A i keni parasysh, për shembull, dëshirat e studentëve kur bëhen planet e pranimit të tyre në degë të ndryshme në universitet? Sigurisht, do të gjykohet, në radhë të parë, në bazë të nevojave të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së vendit, por edhe dëshirat e të rinjve e të rejave, ku kemi mundësi, t'i plotësojmë. Ka ndonjë, dëshirat e të cilit janë të prira «për degë të zgjedhura» nga mungesa e formimit, po te ndonjëri ka edhe mungesë aftësie për të ndjekur një profil të caktuar. Një student, për shembull, që nuk është i zoti për matematikë, caktohet të ndjekë inxhinierinë. Mirëpo ai, jo se e nënvleftëson këtë profesion, por nuk e bën dot. Natyrisht, këto gjëra nuk



kemi si i zgjidhim plotësisht, veç ekzistojnë, prandaj duhet të përpiqemi t'i zgjidhim sa të mundim. Aftësitë dhe prirjet e studentëve ndryshojnë, njëri është më i zoti në matematikë, dikush në një lëndë tjetër e kështu me radhë, prandaj, kur ka mundësi, secili të dërgohet në ato profile ku mund të dalë me rezultate sa më të mira, sepse aty edhe do të japë më shumë.

Për sa u përket marrëdhënieve të studentëve me pedagogët mendojmë se këtu ka vend për më tepër punë. Nëse ka ndonjë rast, siç u tha këtu, që studentët nuk e kuptojnë leksionin dhe bëjnë vërejtje për këtë, pedagogu s'duhet të fyhet. Përndryshe, nëse ai reagon negativisht, ndonjë student, si edhe ka ndodhur, s'do të ketë dëshirë të frekuentojë leksionet e tij, gjë që, sigurisht, është gabim. Do të ishte më mirë sikur pedagogu, në vend të masave administrative në raste mungesash të tij, t'u kërkonte studentëve të flitnin nëse e jep qartë apo jo lëndën dhe vetë të vinte në dukje se nuk e bën të qartë atë, ndryshe nuk ka si shpjegohet mosardhja e ndonjërit në leksion. «Pikërisht këtu është përgjegjësia ime, — të theksonte ai. — Por ju si njerëz politikisht të qartë e patriotë, pavarësisht nga të metat që kam unë në dhënien e lëndës, do t'ju lutem shumë të më ndihmoni në ç'drejtim të korrigjohem». Atëherë studentët do të shfaqnin mendime për sa u kërkohet dhe nuk do të kapeshin pas gjërave të vogla, sikur munguan se njëri gjoja kishte nënën sëmurë, tjetri një pretekst afërsisht si ky e kështu me radhë; do të thoshin, pra, arsyet e vërteta të mungesës, se mënyra si e jep pedagogu mësimin është e rëndë, dhe do të propozonin konkretisht si të përmirësohet puna.

Edhe sikur pedagogu të jetë shumë i aftë në lëndën që jep, nuk do t'i binte nderi po ta bënte një gjë të tillë, përkundrazi, pasi të bënte autokritikë, duke vepruar në këtë rrugë, do t'i tërhiqte më shumë studentët në diskutime. Që t'u bëhet leksioni më i qartë dhe më i lehtë, studentët kanë të drejtë ta kërkojnë këtë dhe pedagogu duhet të përpiqet të gjejë metodën për ta bërë leksionin sa më të kuptueshëm. Brumi i studentëve tanë është shumë i mirë, por, siç thashë, Partia dhe sidomos organizata e rinisë duhet të luftojnë e të punojnë më tepër për edukimin e gjithanshëm të tyre. I kemi mundësitë ta çojmë akoma më tej cilësinë e punës ideoshkencore me studentët dhe me pedagogët.

Vërejtjet që u bënë në adresë të Ndërmarrjes së Botimeve janë të drejta. Ja, për shembull, përse është botuar manuali për kultivimin e krapit? Punëtorët e peshkimit vërtet janë me mijëra, po ky manual mund të shtypej me shaptilograf, jo në formë libri. Duhet vënë rregull në këto çështje, shokë, se nuk kemi me bollëk as libra të dorës së parë. Kur t'i kemi këto me shumicë, atëherë mund të nxjerrim edhe të dorës së dytë. Në zyrë më vijnë broshura për gjëra të vogla, në vend që të botohen libra të tjerë më të nevojshëm. Tani e kemi lehtë të kuptojmë përse punëtorët e shtypshkronjave janë, siç na thonë, kaq shumë të mbytur në punë, se janë të zënë edhe me manuale të tilla jo me shumë rëndësi që mbulojnë kapacitetin e shtypshkronjave. T'u japim mundësi pedagogëve të universitetit, t'u vëmë detyrë që brenda një kohe sa më të shkurtër t'u bëjnë ndryshime cilësore teksteve, të cilat, gradualisht, t'ua botojmë, në vend që të shtypim gjëra pa

ndonjë vlerë të madhe. Kështu nxënësit dhe studentët do të marrin në dorë tekste dhe leksione të reja, të përgatitura mirë. Vazhdimisht po flitet për problemin e botimeve, po çështjet nuk po zgjidhen si duhet.

Këto vërejtje kisha. Edhe një herë dëshiroj të theksoj se jam dakord me diskutimet që bënë shokët. Jemi të kënaqur, gjithashtu, nga shokët e universitetit, në radhë të parë nga organizata e Partisë dhe nga pedagogët. Raporti që na u paraqit prej tyre është mjaft i mirë, larg shablloneve të njohura. Vërejtjet dhe kritikrat që u bënë për të metat që ekzistojnë të shërbejnë për të organizuar më mirë punën, që gjithçka të na ecë sa më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## KRAHAS INDUSTRISE TË ZHVILLOJMË EDHE BUJQËSINË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 mars 1969

Orientimi i Kongresit të 5-të të Partisë për t'u mbështetur fort në të dyja këmbët, edhe në industri, edhe në bujqësi, është plotësisht i drejtë. Përpjesëtimet e zhvillimit të këtyre dy degëve kryesore të ekonomisë sonë të vazhdojmë t'i përcaktojmë kurdoherë me kujdes të madh, duke peshuar mirë çdo gjë, deri, kur i thonë, edhe në qimet e kokës; të studiojmë me vëmendje të gjitha mundësitë dhe burimet ekzistuese në vend, mungesat e përkohshme, nevojat reale e më të ngutshme të zhvillimit tonë socialist dhe pastaj të vendosim sa e në ç'drejtim do të ecë industrializimi. Studimet do të na japin mundësi të caktojmë drejt dhe në mënyrë të bazuar rrugën dhe deri në ç'masë do të shkojmë.

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa probleme të zhvillimit perspektiv të bujqësisë (1971-1980).

Për zhvillimin ekonomik të vendit tonë, të ruajmë dhe të zbatojmë, kurdoherë drejt, parimin marksist-leninist që industria të ecë më përpara. Natyrisht, ne nuk tërhiqemi, nuk entuziazmohemi, dhe as gënjehemi nga përqindjet e zhvillimit dhe orientimet që hidhen për demagogji si në vendet kapitaliste, ashtu edhe në vendet ku sundojnë revizionistët modernë. Me këtë dua të them që ndonjëri të mos mendojë se ne, duke u nisur nga teza që industria është faktor vendimtar për përpërimin e përgjithshëm të vendit në rrugën e socializmit, po kalojmë në superindustrializim.

Pikëpamja e superindustrializimit, për vendin dhe kushtet tona, është e gabuar dhe shumë e dëmshme. Kur flitet për superindustrializim, me këtë formulë nuk kuptohet ngritja e një uzine për përpunimin e ferrokromit me kapacitet qoftë edhe 800 000 tonë në vit. Kjo formulë do të thotë të ngresh një industri shumë të madhe e komplekse të prodhimit të makinave, të ngresh ndërmarrje që transformojnë metalet, të cilat, kuptohet, duhet t'i kesh në sasi shumë të mëdha. Superindustrializimi parashikon rezerva kolosale mineralesh. Ne kemi bërë dhe do të vazhdojmë të bëjmë edhe në të ardhmen studime dhe kërkime për të siguruar rezerva të reja të tjera mineralesh, por, sipas parashikimeve, këto rezerva, në kushtet e sipërfaqes së vogël të vendit tonë, nuk mund të jenë të asaj natyre sa të mendojmë për superindustrializimin e Shqipërisë, duke ndërtuar një industri të fuqishme për prodhim makinash jo vetëm për të plotësuar tërësisht nevojat tona, por edhe për të konkurruar tregjet e jashtme kapitaliste apo revizioniste. Prandaj të jemi realistë.

Superindustrializim do të thotë që në fshat, në bujqësi, të jetojë dhe të punojë një përqindje fare e vogël e popullsisë së vendit. Vendet revizioniste kanë një industrializim të çalë, mirëpo, meqenëse atje 40 përqind e popullsisë jeton e punon në fshat, revizionistët rendin pas formulimeve të tilla, siç është ai i superindustrializimit, apo i pakësimit të popullsisë e të krahut të punës në fshat e në bujqësi, për të treguar se janë gjoja të përparuar, në një kohë kur armata të tëra punonjësish largohen nga këto vende për të punuar si skllëvër në shtetet kapitaliste, sepse kjo rrugë u ka krijuar papunësi. Bujqësia në vendet revizioniste, tashmë është kthyer përfundimisht në baza kapitaliste; punonjësit e fshatit dhe të qytetit në këto vende varfërohen dhe vuajnë për bukë, për mish, për zarzavate, për vezë etj. Nga eksportues, vendet revizioniste janë kthyer në importues të drithërave e të produkteve të tjera bujqësore e blegtorale. Partia jonë nuk e ka futur dhe nuk do ta futë kurrë vendin në një rrugëkryq të tillë, sepse, për çdo gjë që bëjmë, jemi shumë të matur.

Të mos harrojmë shokë, se ne, duke u bazuar si kurdoherë në parimet marksiste-leniniste, ndërtojmë socializmin me një eksperiencë që në mjaft drejtime nuk e kanë të tjerët, në një vend me territor të kufizuar dhe me popullsi të vogël, në kushte të vështira nga çdo pikëpamje dhe me mundësi të pakta. Këto kushte t'i kemi kurdoherë parasysh.

Zhvillimi i gjendjes ndërkombëtare, pozita gjeografike e vendit tonë dhe interesat e ndërtimit të socializmit në Shqipëri, e lypin që në çdo rrethanë të përpiqemi për të siguruar vetë gjithçka të domosdo-

shme për ushqimin e popullit. Të gjithë e kemi të qartë se, po të shpërthejë një luftë, do të detyrohemi të hamë pak, pse lufta imponon restriksione të mëdha. Prandaj, në zhvillimin aktual të gjendjes ndërkombëtare duhet të importojmë sa më pak që të jetë e mundur mallra ushqimore, duke vënë të gjitha forcat që këto t'i prodhojmë çdo vit e më shumë në vend. Për këto arsye, mendoj, është e domosdoshme t'i japim një rëndësi të jashtëzakonshme zhvillimit të bujqësisë, pa lënë pas dore zhvillimin e industrisë, por kurdoherë në përpjesëtimet që kemi vendosur në Kongresin e 5-të të Partisë.

Ne duhet të bëjmë kujdes të veçantë që zhvillimi i bujqësisë të ecë me hapa më të shpejtë se deri tani, kurse në industri, duke shfrytëzuar me etapa pasuritë tona të nëntokës, duke kaluar gradualisht në përpunimin e tyre, të plotësojmë nevojat e vendit, si edhe të eksportojmë. Industria jonë duhet të orientohet, gjithashtu, edhe në përpunimin e artikujve bujqësorë për nevojat e popullit, duke filluar që nga sheqeri, perimet, frutat, bulmeti, mishi e deri te vaji. Por do të bënim gabim të madh po të ktheheshim në tifoze të zhvillimit të industrisë jashtë masës dhe jashtë mundësive tona. Është e gabuar pikëpamja, sipas së cilës, duke u nisur nga dëshira e superindustrializimit të vendit, artikujt bujqësorë e blegtoralë, që duhen për ushqimin e popullit, të blihen jashtë.

Për sa i përket intensifikimit të bujqësisë, jam dakord, se intensifikimi është rruga kryesore për ta çuar kurdoherë përpara bujqësinë tonë. Por të bëjmë kujdes që intensifikimi dhe zhvillimi i fushave të sho-

qërohen medoemos edhe me zhvillimin dhe me përparimin e gjithanshëm të zonave kodrinore e malore. Këtyre t'u vëmë rëndësi të madhe, siç ka vendosur Kongresi i Partisë. Me këtë nuk duhet kuptuar që të hapim toka pa kriter, ose të bëjmë punë të tjera jashtë mundësive tona, por të koordinojmë me kujdes çdo punë. Të bëjmë shumë kujdes, shokë, që me formulimet që pasqyrojnë pikëpamje të caktuara, të jemi, siç kemi qenë kurdoherë, shumë të matur. Orientimet që ka caktuar Kongresi i 5-të i Partisë për tokat e reja janë shumë të drejta, prandaj të mbështetemi fort në to dhe të mos nxitohemi me formulime superlative.

Orientimet për këtë ose atë problem duhet të bazohen mirë në realitetin objektiv të brendshëm, por edhe në atë të jashtëm, nga i cili nuk jemi aspak të shkëputur. Të mbajmë, gjithashtu, mirë parasysh perspektivat e ecjes sonë përpara në rrugën e socializmit.

Ne po e ndërtojmë socializmin jo sipas modelit të të tjerëve, por duke zbatuar marksizëm-leninizmin në përputhje me kushtet tona konkrete. Prandaj të matim me kujdes çdo hap që bëjmë për zhvillimin e degëve të ekonomisë dhe të zonave të vendit. Lidhur me këtë shoku Hysni [Kapo] dha disa mendime të mira, të cilat mendoj se duhen thelluar akoma më shumë.

Në qoftë se te dikush ekziston mendimi se ka më shumë leverdi të intensifikohen fushat, duke mekanizuar më tej ato në kurriz të zonave të thella, jashtë përpjesëtimeve të caktuara, të kihet parasysh se ky mendim nuk është i drejtë, pasi kjo do të shkaktojë anomali. Duke i dhënë fushës më shumë ndihmë



nga sa kemi eaktuar, do të krijohej një shpërpjesëtim në të ardhura dhe në drejtime të tjera në krahasim me kooperativat bujqësore të malësisë, të cilat aktualisht akoma janë më të dobëta. Ndryshimet ekonomike dhe shoqërore që do të krijonte ky intensifikim jo proporcional do të lindnin situata të ndërlikuara, të cilat duhet të parashikohen. Ka një sërë problemesh të tilla, shokë, që na detyrojnë të ndjekim vazhdimisht e me kujdes zhvillimin politik, ekonomik e demografik të të gjithë vendit. Prandaj të bëjmë kujdes e të mos kalojmë sa nga një anë në tjetrën pa u menduar thellë. Fushat do t'i intensifikojmë më shpejt kur të kemi mundësi më të mëdha për investime në to, por do të mendojmë edhe për kodrat e malësitë.

Na vihet për detyrë që toka, si mjeti kryesor në bujqësi, të shfrytëzohet kudo sa më shumë. Në sajë të kujdesit të treguar nga Partia e pushteti popullor dhe me hovin e përpjekjet e mëdha të punonjësve, këto vitet e fundit, edhe në zonat kodrinore dhe në një pjesë të atyre malore po merren rendimente të mira në një sërë prodhimesh bujqësore e blegtorale. Megjithatë, nuk mjafton që këto zona të sigurojnë vetëm bukën, por në një të ardhme të afërt, me një mobilizim më të madh e me një punë më të mirë organizative, ato duhet të sigurojnë më tepër edhe produkte të tjera, edhe të ardhura. Ndihma që ka dhënë gjer më sot shteti për zonat kodrinore e malore, në krahasim me atë që parashikohet të jepet në të ardhmen, s'ka krahasim, prandaj janë të gjitha mundësitë që edhe këto zona të ecin më shpejt përpara.

Na vihet, pra, për detyrë ta balancojmë si duhet

zhvillimin e bujqësisë me industrinë, zhvillimin e zonave me bujqësi të përparuar me ato në thellësi të vendit; të kujdesemi që intensifikimi i fushave të mos bëhet në dëm të zonave kodrinore e malore.

Intensifikimi, mekanizimi dhe elektrifikimi më shpejt i bujqësisë, s'do ta pengojë industrializimin e vendit. Të mos mendohet se energjia elektrike na duhet vetëm për nevojat e industrisë. Jo. Në qoftë se duam që ujërat e lumenjve, të liqeneve e të rezervuarëve që ndërtojmë të shfrytëzohen në maksimum për ujitje, do të përdoret edhe energjia elektrike për t'i ngritur këto ujëra me elektropompa. Përdorimi gjerësisht i energjisë elektrike në bujqësi, elektrifikimi i saj, do të thotë intensifikim i bujqësisë. Duke elektrifikuar fshatin dhe duke intensifikuar prodhimin, veç përfitimeve të tjera të mëdha, ecet përpara edhe për industrializimin e vendit por edhe për forcimin e karakterit industrial të punës e të prodhimit në bujqësi.

Industria në të ardhmen do të zgjerohet shumë në drejtim të prodhimit të makinave për plotësimin e nevojave tona, si dhe për ripërtëritjen dhe prodhimin e pjesëve të ndërrimit për të gjitha llojet e makinerive që kemi e që po shtohen pareshtur. Kjo s'do të thotë se po superindustrializohemi. Ne do ta zhvillojmë industrinë brenda mundësive dhe kushteve të vendit tonë për të përballuar kryesisht nevojat e brendshme, pa lënë pas dore në asnjë rast zhvillimin dhe intensifikimin e mëtejshëm të bujqësisë. Ky është një orientim i drejtë që ruan parimin e zhvillimit të ekonomisë mbështetur në të dyja këmbët si dhe qëllimet e këtij parimi.

Materiali i paraqitur për zhvillimin perspektiv të bujqësisë është i mirë dhe do të na shërbejë si bazë për orientimet që do të japë Kongresi i 6-të i Partisë. Mund ta shtrijmë studimin edhe për periudhën e mëvonshme, po mendoj që më parë të përcaktojmë mirë orientimet për projektplanin e pesëvjeçarit të ardhshëm, të cilat do të na shërbejnë si bazë për të përcaktuar pastaj drejt edhe orientimet e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë për më tutje.

Jam dakord me mendimet që shprehën shokët. Si konkluzion, intensifikimi i bujqësisë, mekanizimi i saj, zgjerimi gjithnjë e më shumë i rrjetit për ujitjen e tokave të mbjella etj., të bëhen duke e parë çështjen në kompleksitetin e saj, në aspektin ekonomik dhe shoqëror, si për fushën, ashtu edhe për malësinë. Prandaj të mos mendohet vetëm për intensifikimin e disa zonave, si për shembull në Myzeqe, duke lënë pas dore zhvillimin e zonave kodrinore e malore. Nga ana tjetër, të kemi parasysh se arritja e rendimenteve të larta nuk është një punë kaq e lehtë, që bëhet menjëherë. Përparimet e arritura në shumë kooperativa bujqësore janë vërtet të mira, megjithatë, te ne rendimenti për hektar në drithëra është akoma i ulët. Rendimentet në disa rrethe e kooperativa malore, janë akoma larg mesatares së Republikës. Prandaj është e nevojshme të bëjmë kujdes e t'i vëmë rëndësi të madhe punës për shtimin e pjellorisë edhe të tokave të zonave kodrinore e malore, duke rritur aftësinë ujitëse, mekanizimin, plehërimin, përdorimin e farnave të zgjedhura etj., ndryshe ato do të mbeten prapa, prodhimet që do të japin do të jenë të pakta, kooperativistët e këtyre zo-

nave nuk do të plotësojnë nevojat për drithë e për produkte të tjera të domosdoshme dhe, si rrjedhim, do të detyrohemi të importojmë jo vetëm vaj, po edhe drithëra e mish.

Po me se dhe nga t'i importojmë këto? Të jemi realistë. Gjendja ndërkombëtare, siç e shikojmë, është mjaft e turbullt. Në këto situata, si duhet ta shtrojmë problemin? Të prodhojmë në vend në radhë të parë sendet më të domosdoshme për jetën e popullit: bukën, mishin, qumështin etj. Në këtë rrugë, mendoj, duhet të ecim.

Bashkë me disa probleme të tjera të mëdha për zhvillimin e ekonomisë sonë që i kemi shqyrtuar më parë, edhe këto orientime të na shërbejnë për të përgatitur një plan të ri pesëvjeçar real e konkret, një plan që të jetë mbështetje e fuqishme edhe për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e shoqëror të vendit në një perspektivë më të largët.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# TË MËSOJMË NGA SHOKËT PUNËTORË TË ZGJEDHUR NË UDHËHEQJE TË ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE T'I NDIHMOJMË ATA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 mars 1969

Rezultatet janë të mira. Ne kemi asistuar në konferencat e Partisë dhe kemi parë vetë sa mirë e në ç'nivel të lartë i zhvilluan ato punimet. Ditët e fundit mora pjesë në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit, ku më bëri përshtypje shumë të mirë pjekuria e shokëve të rinj të zgjedhur, të cilët e kanë marrë punën me seriozitet të madh. Në këtë mbledhje, që u bë në Qytetin Stalin, përveç atyre që janë specialistë të naftës, diskutuan edhe shokë të tjerë me gjendje punëtorë, të cilët i kishin studiuar me kujdes të madh materialet që u ishin dërguar nga

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi realizimin e orientimeve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH për përmirësimin e mëtejshëm të përbërjes shoqërore të organeve të Partisë në rrethe e në bazë».

aparati i komitetit të Partisë, disa kishin vajtur edhe në puse për të parë në vend punën politike dhe organizative që bëhet në bazë. Diskutimet e tyre ishin në nivel të lartë, me një frymë serioze kritike dhe autokritike, gjë e cila tregon se ata janë njerëz të përgatitur.

Më ra, gjithashtu, në sy se anëtarët e byrosë nuk folën me fraza të përgjithshme, por ngritën probleme dhe bënë edhe kritika direkte; folën, pra, krejt ndryshe nga sekretarët e komiteteve të Partisë kur i thërresim në raport në qendër, të cilët na mbushin me fraza.

Në këtë mënyrë diskutuan edhe shokët e organizatave-bazë të Partisë të ftuar për problemin që ishte në rendin e ditës. Përshtypja ime për një punëtor naftëtar që është zgjedhur së fundi sekretar në organizatën-bazë të një pusi, ku ka 10 komunistë dhe 20 punëtorë, është aq e mirë saqë mendoj se pa frikë mund ta bësh anëtar të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit. Ai diskutoi me seriozitetin më të madh, konkretisht, duke i rënë problemit drejt, në thelb. Nuk u entuziazmovava, pra, vetëm për faktin se ky ishte punëtor, apo pse tha vetëm tri fjalë, jo, ai diskutoi plot një çerek ore, dhe në një nivel me të vërtetë të lartë, bëri kritikë me emër në adresë të drejtuesve të ndërmarrjeve të naftës që kishin gabime në punë. «Ne jemi shpues, — tha ai, — prandaj përse nuk na vini atje të na bëni ndonjë konferencë për natyrën e shpimeve, të kampioneve, çfarë përfaqësojnë ato etj.? Ju lejohet juve, kuadrove të lartë të na lini të punojmë në mënyrë të verbër, vetëm të shpojme, pa u bërë me punëtorët një punë e mirë sqaruese dhe pa u hapur perspektiva për punën që bëjnë, që të mos ndodhin avari? Ne punojmë

pa ditur çfarë shtresash mund të takojmë dhe që mund t'i takojmë në këto ose ato thellësira etj., kurse, po të na e bëni ju të qartë gjendjen e shtresave, do të punojmë më mirë», përfundoi ai.

Kjo është një kritikë me shumë vend nga një komunist punëtor, i cili ngriti në mbledhje edhe probleme të tjera. Në rrethin e Beratit të tillë njerëz ka sjellë Partia në udhëheqje gjatë fushatës së fundit të zgjedhjeve në organizatat-bazë dhe në konferencat e Partisë.

Mendoj se kështu duhet të ketë ngjarë kudo, rasti i Beratit nuk duhet të jetë i veçantë, prandaj, siç thuhet edhe në material, nga këta shokë kaq të mirë, që ka sjellë Partia në udhëheqje, të mësojnë të gjithë; atyre të mos u pritët hovi e guximi për t'i shtruar kurdoherë drejt problemet. Është e nevojshme, pra, të bëjmë shumë kujdes, ndryshe, me dashje ose pa dashje, mund të ndrydhen. Orientimin e drejtë të Komitetit Qendror për të sjellë në udhëheqje elementë punëtorë do ta vëmë plotësisht në jetë nëse bëjmë përpjekje më të mëdha për të përmirësuar stilin dhe metodën tonë të punës.

Për sa i përket çështjes së shkollave mendoj se një punëtor 40-vjeçar që është zgjedhur në byro dhe që ka një eksperiencë shumë të madhe në punë dhe në jetë do të jetë më mirë ta nxitim të mbarojë një ose dy kurse ideologjike partie, ndërsa kuptohet, një punëtor me moshë të re, 20-22 vjeç ose fundja 30 vjeç duhet nxitur të bëjë përpjekje për të mbaruar shkollën; s'duhet trajtuar njëlloj çështja e tij si me një të thyer nga mosha. Sekretarët e organizatave-bazë, që tani zako-

nisht i kemi me moshë të re dhe shumë të mirë, mund t'i nxitim të mbarojnë shkollat. Të tillë pashë mjaft në aktivin e Partisë që u bë në Berat. Ata që folën ishin zjarr, sidomos disa prej tyre diskutuan shumë mirë. Këta po, mund të dërgohen në shkollë. Kurse me punëtorë të kaluar nga mosha, me një eksperiencë të madhe në punë, mund të bëhen më shumë kurse me karakter ideologjik dhe profesional.

Jam i mendimit që ky material me çështjet kryesore, duke i hequr ato të dorës së dytë që njihen në bazë mbasi andej kanë dalë të gjitha, pra, në mënyrë koncize, pa bërë agjitacion e propagandë, t'u dërgohet komiteteve të Partisë të rretheve.

Rëndësi ka përgjithësimi i problemeve. Shokët e rretheve me këtë material konciz duhet të marrin dijeni, si u zhvilluan konferencat e Partisë në të gjithë vendin dhe cilat janë problemet kryesore që dolën. Prandaj t'u thuhet se materiali nuk dërgohet vetëm për informacion, po të kenë parasysh se ka edhe detyra.

E kam fjalën t'i ndërrojmë ca format e punës, të mos u japim njerëzve të gjitha gjërat me hollësira, midis të cilave ka me dhjetëra që ata i dinë vetë, prandaj s'ka përse t'i mbushim me materiale të panevojshme dhe t'u hamë kohën.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## BASHKËPUNIMI SOVJETO-AMERIKAN SUNDOI MBLEDHJEN E BUDAPESTIT TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

22 mars 1969

Në fillim të kësaj jave, në Budapest, u mbajt një mbledhje e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit agresiv të Varshavës. Ky takim i krerëve të vendeve revizioniste ishte i pari pas pushtimit të Çekosllovakisë nga ana e trupave të revizionistëve sovjetikë dhe sate-litëve të tyre, që shkaktoi grindje e konfuzion në radhët e frontit revizionist. Një takim në nivel të lartë, ku të merrnin pjesë pa përjashtim të gjithë anëtarët e Traktatit të Varshavës, shikohej nga udhëheqësit revizionistë sovjetikë si një masë për të influencuar opinionin publik, që në sytë e botës do ta paraqiste familjen revizioniste të bashkuar, që do të tregonte se ajo i ka harruar grindjet dhe i ka kapërcyer kontradiktat.

Por e gjithë kjo farsë, edhe pse e montuar me mjaft kujdes, nuk i fshehu dot kalbëzimin dhe degjenerimin e mëtejshëm të organizatës së Traktatit të

Varshavës. Mbledhja u zhvillua në një atmosferë të rënduar nga kontradiktat e shumta politike, ekonomike e ushtarake dhe nga presionet e vazhdueshme të kre-rëve sovjetikë, të cilët kërkojnë t'u imponojnë partne-rëve të tjerë diktafēt e tyre hegjemoniste.

Sipas komunikatës zyrtare, që u botua pas mbledhjes rrufe, e cila zgjati vetëm dy orë, në Budapest u morën disa masa për organizimin e brendshëm të Traktatit të Varshavës dhe u bë një «Thirrje» drejtuar vendeve të Evropës «për diskutimin e çështjeve të sigurimit evropian dhe të bashkekzistencës paqësore». Vëmendjen në këto dokumente nuk e tërheqin ato që thuhën, por ato që nuk thuhën.

Kur analizon procedurën e mbledhjes dhe rezultatet e saj, nuk mund të mos lindë pyetja: Përse iu desh udhëheqësve sovjetikë të bëjnë gati një javë rrugë vajtje e ardhje me tren deri në Budapest për një takim vetëm prej dy orësh me partnerët e tyre, duke përfshirë këtu edhe ceremonitë e gjata të fotoreporterëve, nënshkrimet e pjesëmarrësve në dokumentet përfundimtare etj.?

«Thirrja» e re drejtuar Evropës është një nga dokumentet më bajate që ka nxjerrë ndonjëherë në dritë diplomacia revizioniste. Ajo përsërit në mënyrë mekanike, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, thirrjet që bënë krerët revizionistë në vitin 1966 në fund të konferencës së Traktatit të Varshavës dhe të asaj të partive revizioniste në Karlovi-Vari, me përjashtim të faktit që në «Thirrjen» e Budapestit pothuajse as që dënohet fare imperializmi dhe jo vetëm nuk mbahet qëndrim, por as që përmenden fare problemet e mëdha

aktuale ndërkombëtare. Nxjerrja me ngut nga dosjet e pluhurosura e kësaj kopjeje të vjetër dhe e një komunikate të errët për përfundimin e punimeve, vë në dukje me të drejtë i gjithë shtypi i huaj, është bërë me qëllim që të zëvendësojë ndonjë dokument tjetër të udhëheqësve sovjetikë që, për shkak të grindjeve e të kontradiktave me partnerët e tyre, nuk mundi ta shikojë dritën. Që mbledhja e Budapestit u thirr me iniciativën e sundimtarëve të Kremlinit për t'u shërbyer qëllimeve të politikës së tyre të jashtme, kjo nuk ka asnjë dyshim, ashtu siç nuk mund të vihet në diskutim fakti se ata kanë qenë padronët dhe dirigjentët e saj. Ata kanë kohë, që, pas pushtimit të Çekosllovakisë, përgatiten për këtë. Gati të gjithë udhëheqësit kryesorë të vendeve pjesëmarrëse në Traktatin e Varshavës kanë bërë udhëtime të shpeshta në Moskë, duke mos përmendur vizitat e pandërprera të Jakubovskit dhe të personaliteteve të tjera të Bashkimit Sovjetik në kryeqytetet e vendeve revizioniste. A mund të merret me mend se në këto takime të dendura dhe në këto bisedime mjaft të gjata është folur vetëm për të vënë përsëri në qarkullim planin e stërnjohur revizionist të të ashtuquajturit sigurim evropian dhe të jenë lënë mënjanë problemet e mëdha botërore, të cilat kanë zënë për fyti, në radhë të parë, vetë krerët e Kremlinit?

Në ditën e hapjes të mbledhjes së Budapestit më 17 mars, gazeta revizioniste çekosllovake «Rude pravo» shkruante në mënyrë të sigurt se «bisedimet do të prekin krizën e fundit të Berlinit, ashpërsimin e gjendjes në Lindjen e Mesme dhe, e fundit, por jo pa rëndësi,

incidentet e armatosura në kufirin kino-sovjetik». «Pasi do të jetë sesioni i parë i Komitetit Politik Konsultativ pas ndërhyrjes së trupave të Traktatit të Varshavës në Çekosllovakia, — vazhdonte gazeta, — është e pamundur të mos diskutohet edhe çështja çekosllovake».

Por «Thirrja» e Budapestit nuk përmend asnjë nga këto probleme. Në të nuk ka as «luftë kundër imperializmit», nuk përmendet as Vietnami, as Lindja e Mesme, bile edhe «rreziku i revanshizmit gjerman», temë shumë e dashur për propagandën revizioniste, këtë herë është paraqitur me ton shumë të butë. Kjo vërteton edhe një herë se revizionistët sovjetikë e të tjerë, që, me fjalë, hiqen si përkrahës të zjarrit të popullit vietnamez, Vietnamin e sakrifikojnë në altarin e bashkëpunimit sovjeto-amerikan, ashtu siç sakrifikojnë edhe interesat e popujve arabë etj.

A janë të rastit këto? Asnjëri nuk mund ta besojë. Nga vetë teksti i «Thirrjes» dhe komentet e informatat e ndryshme, del se qëllimi kryesor i mbledhjes së Traktatit të Varshavës ka qenë përgatitja e bisedimeve të krerëve sovjetikë me presidentin e ri të SHBA-së Riçard Niksonin. Ashtu si Niksoni, përpara se të ulej në tryezën e pazarllëqeve me sovjetikët, u takua me partnerët e tij evropianë të NATO-s për të siguruar solidaritetin dhe përkrahjen e tyre për allishverishet e ardhshme, edhe krerët e Kremlinit bënë po të njëjtën gjë në Budapest me partnerët e tyre të Traktatit të Varshavës.

«Thirrja» e Budapestit nuk përmend asnjë nga problemet e mëdha që preokupojnë botën, qoftë edhe

në formulat politike klasike revizioniste, pasi Brezhnjevi e Kosigini dëshirojnë ta sigurojnë Niksonin se për këto probleme ata nuk duan të marrin qëndrime të paracaktuara, të cilat mund të paragjykonin bisedimet e ardhshme sovjeto-amerikane në nivel të lartë. Ata duan t'i thonë presidentit amerikan se për të gjitha çështjet do të diskutojnë e do të vendosin bashkërisht, duke u nisur nga një terren i hapët, i lirë për çdo kompromis dhe për çdo zgjidhje dhe se për këtë kanë aprovimin e të gjithë partnerëve të Traktatit të Varshavës, siç e tregon nënshkrimi unanimitet i «Thirrjes» nga të gjithë pjesëmarrësit. Për më tepër, me këtë ata duan të lënë përshtypjen se sundimtarët e vendeve revizioniste i shikojnë këto bisedime me dashamirësi të madhe dhe janë të predispozuar të bëjnë çmos për të krijuar një atmosferë sa më të favorshme paraprake për zhvillimin e tyre.

Njëfarë disonance nga fryma e përgjithshme e qetësisë dhe e largimit nga temat e mëdha e të mprehta të politikës ndërkombëtare në pritje të takimit sovjeto-amerikan në nivel të lartë që vihet re në «Thirrjen» e Budapestit, mund të përbënte përmendja e problemit gjerman, që përsërit qëndrimet e njohura të revizionistëve sovjetikë e që nuk pëlqehen, as në Bon, as në Uashington. Por edhe kjo është vetëm në dukje. Çështja gjermane, aktualisht, nuk mund të mos përmendej në një dokument publik të Traktatit të Varshavës e për më tepër që ka të bëjë me Evropën dhe me të ashtuquajturin sigurim evropian. Ajo u duhej udhëheqësve sovjetikë për të mbuluar blifin e Berlinit dhe për të fshehur fiaskon e zhurmës boshe që ata bënë

në lidhje me zgjedhjen e presidentit të Republikës Federale të Gjermanisë në Berlinin Perëndimor. Ata mundohen tani të qetësojnë Ulbrihtin dhe shokët e tij, që në një moment mjaft delikat i lanë vetëm, i diskredituan dhe i vunë në një pozitë shumë të pahijshme përpara gjithë gjermanëve dhe gjithë botës, duke treguar se klika e Ulbrihtit nuk është gjë tjetër veçse një satelit i thjeshtë i revizionistëve sovjetikë dhe një lodër e tyre në manovrat e bashkëpunimit sovjeto-amerikan. Që përmendja e çështjes gjermane në dokumentin e Budapestit është formale e kuptojnë mirë si Niksoni ashtu edhe Kisingeri, pasi zhurma që bënë revizionistët sovjetikë në lidhje me zgjedhjet presidenciale në Berlin nuk pati asnjë konsekuencë tjetër përveç diskreditimit të mëtejshëm të klikës së Ulbrihtit. Nuk është e rastit që qeveria e Bonit që e para që e përshëndeti me zjarr «Thirrjen» e Budapestit me gojën e ministrit të saj të Jashtëm Vili Brandtit.

Pjesëmarrësit revizionistë të mbledhjes së Budapestit përpiqen ta paraqesin kohën e shkurtër të seancave zyrtare, vetëm dy orë, si shprehje gjoja të unanimitetit rreth problemeve të diskutuara. Dy orë ndoshta kanë mjaftuar për të arritur në përfundimin se nuk mund të merren vesh, por është e pamundur të diskutohet e të vendoset një vijë politike ose edhe vetëm disa veprime konkrete në lidhje me problemin e Berlinit dhe gjendjen në Lindjen e Mesme, të shqyrtohen fatet e Evropës dhe lufta në Lindjen e Largme, çështja gjermane dhe ndryshimet strukturore të një organizate ushtarake. Në të vërtetë s'ka pasur unanimitet, por dështime, dhe dështime të gjithanshme...

Politikën famëkeqe të revizionistëve sovjetikë «pa-  
qe në Evropë dhe luftë në Azi», mbledhja e Budapestit  
e nxjerr edhe një herë lakuriq përpara gjithë botës.  
Sado demagogji që të bëjnë autorët e saj për të mbu-  
luar karakterin kundërrevolucionar të kësaj mbledh-  
jeje, ata nuk mund t'ia dalin dot në krye. Vetë «Thirr-  
ja» e re drejtuar qeverive borgjeze të Evropës, hartuar  
me frazeologjinë pacifiste të kohëve më të mira të Ni-  
kita Hrushovit, është në të vërtetë një thirrje drejtuar  
imperializmit amerikan për të rënë në ujdi që të mbaj-  
në ekuilibrin e forcave në Evropë, të respektojnë zo-  
nat e influencës në këtë kontinent...

Në njoftimet që dhanë agjencitë e shtypit nga Bu-  
dapesti, mjaft nga ato e lidhnin kohën e mbledhjes së  
Traktatit të Varshavës me zhvillimin e punimeve të  
kongresit të 9-të të revizionistëve jugosllavë. Ato vi-  
nin në dukje se kjo nuk është një ko incidencë e rastit.  
Në fakt, dihen presionet e udhëheqësve sovjetikë ndaj  
Jugosllavisë, kohët e fundit, për ta detyruar këtë që  
të pranojë vijën sovjetike, sidomos për sa u përket  
marrëdhënieve me vendet e tjera revizioniste. Udhë-  
heqësit sovjetikë, veçanërisht pas agresionit të tyre fa-  
shist kundër Çekoslovakisë, nuk e tolerojnë me qejf  
në vendet satelite veprimtarinë jugosllave, të cilën e  
shikojnë si cenim të hegjemonisë së tyre. Po kështu,  
atyre nuk u pëlqen afrimi e bashkëpunimi i Beogradit  
me Bukureshtin, ashtu, sikurse, nga ana tjetër, titistët  
nuk i dëshirojnë presionet që Moskë ushtron ndaj Ru-  
manisë. Këto acarime të përkohshme midis revizionis-  
tëve sovjetikë e atyre jugosllavë shpeshherë, siç po  
ndodh edhe aktualisht, marrin një mprehtësi të ve-

çantë dhe sovjetikët, në pragun e kongresit të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe gjatë këtij, duke nxitur e duke inkurajuar grupin serbomadh dhe rankoviçianët kundër grupit kroato-slloven, i tregojnë Titos se ata kanë edhe karta të tjera presioni në duart e tyre.

Edhe në çështjen e qëndrimit ndaj Jugosllavisë, pra, udhëheqësit sovjetikë pësuan në Budapest një disfatë tjetër. Ata nuk mundën t'u impononin partnerëve të tjerë një vijë të përbashkët. Se sa të përçarë janë revizionistët në lidhje me Jugosllavinë e tregoi edhe mënyra se si e trajtuan këta çështjen e përfaqësimit të tyre në kongresin e fundit të titistëve. Rumunët, për shembull, shkuan në Beograd dhe zunë atje një nga vendet më të nderuara midis mysafirëve të huaj. Çekoslovakët nuk shkuan, pasi, me sa duket, nuk siguruan dot lejën nga Moska, por shtypi çek shkroi gjerësisht për të dhe me një ton mjaft të ngrohtë. Bullgarët e mongolët i kishin njoftuar zyrtarisht jugosllavët se do të dërgonin delegacione në kongresin e tyre, por pastaj e anuluan. Kuptohet se e gjithë kjo rrëmujë nuk mund të ketë qenë gjë tjetër veçse rezultat i diktatit sovjetik i minutës së fundit që u kërkonte satelitëve të zbatonin vullnetin e tij në këtë çështje.

Por të gjitha këto nuk e ndaluan Titon të mbajë kongresin dhe të ndjekë vijën e tij politike të njohur. Për më tepër, mbledhja e Budapestit dhe përçarjet që dolën atje midis pjesëmarrësve lidhur me Jugosllavinë, i krijojnë klikës titiste mundësi të reja për të vazhduar vijën e saj antimarksiste në shërbim të imperializmit në vendet e tjera revizioniste.



Një çështje tjetër që ka qenë e pranishme në punimet e mbledhjes së fundit të Traktatit të Varshavës është edhe çështja çekoslllovae. Në komunikatën përfundimtare nuk bëhet fjalë për këtë, por e gjithë vënia në skenë e kësaj mbledhjeje ishte bërë me një kujdes të tillë që opinionit publik t'i jepej përshtypja se gjendja në Çekoslllovakë gjoja qenka normalizuar në rrugën e kërkuar nga pushtuesit sovjetikë. Si dëshmi për këtë pretendim do të shërbente pamja e unitetit të plotë që gjoja ekziston për të gjitha çështjet e diskutuara e që nuk do të ishte e mundur të arrihej po të ekzistonin vlerësime të ndryshme ose divergjenca në lidhje me Çekoslllovakinë. Këtë synim kishte edhe caktimi i Dubčekut për të kryesuar mbledhjen, ashtu si dhe nderimet false e përgëzimet demagogjike që i bëri atij Brezhnjev për «drejtimin e shkëlqyer» të mbledhjes. Por sado të përpiqen t'i japin lustër revizionistët, çështja çekoslllovae mbetet një plagë e hapët dhe akuzë e rëndë për të gjithë revizionistët si për ata që dërguan tanket e tyre për të robëruar popullin çekoslllovak, ashtu dhe për klikën e Dubčekut, Svobodës e Çernikut, e cila, siç e tregoi dhe një herë me qëndrimin e saj në Budapest, është kthyer në një vegël të neveritshme të pushtuesve revizionistë sovjetikë dhe që nga populli çekoslllovak nuk mund të presë fund më të mirë nga ai që historia u ka rezervuar të gjithë re-negatëve e tradhtarëve.

Në planet politike të klikës Brezhnev-Kosigin, mbledhja e Budapestit zinte një vend të veçantë në lidhje edhe me mbledhjen e partive revizioniste, që thuhet se do të zhvillohet në maj në Moskë. Ajo e

shikonte takimin e Budapestit si një parapërgatitje dhe si një rast të përshtatshëm për të marrë disa koncesione të mundshme nga partnerët e tjerë për tezat që revizionistët sovjetikë do të shtrojnë në konferencën e Moskës. Por fakti që as në Komunikatë e as në «Thirrjen» e Budapestit nuk bëhet fjalë fare për këtë, si dhe informatat që dalin nga komisioni përgatitor që është mbledhur në Moskë, tregojnë se edhe në këtë pikë krerët revizionistë sovjetikë nuk kanë mundur të imponojnë tezat e tyre dhe divergjencat mbeten e zgjerohen.

Komunikata e mbledhjes së Budapestit përmend edhe disa vendime me karakter organizativ, si krijimi i Komitetit të ministrave të mbrojtjes etj. Këto janë disa thërrime që Kremlini u hedh satelitëve të tij, për të krijuar njëfarë iluzioni se edhe ata kanë pjesë në komandën e përbashkët. Në të vërtetë, imperialistët e Moskës nuk bëjnë asnjë lëshim nga kontrolli dhe dominimi absolut që ushtrojnë mbi këtë pakt hegjemonist e agresiv. Çdo masë që marrin ata, qoftë kjo politike apo organizative, ka për qëllim t'i shtrengojë më fort vidhat e mekanizmit të kontrollit për të konsoliduar më tej sundimin e tyre diktatorial mbi vendet satelite, mbi politikën, mbi ekonominë e mbi ushrinë e tyre.

Siç e treguan qartë ngjarjet e këtyre viteve të fundit dhe sidomos agresioni i tipit fashist kundër Çekosllovakisë, Traktati i Varshavës ka degjeneruar prej kohësh në një instrument shantazhi politik e agresioni ushtarak në duart e klikës revizioniste sovjetike për të imponuar politikën e saj shoviniste e imperialiste mbi shtetet pjesëmarrëse, për të shndërruar shtete të tëra

të Evropës Lindore në koloni të imperializmit revizionist sovjetik. Ai, siç u provua edhe tani së fundi në mbledhjen e Budapestit, përdoret nga klika e Kremlinit si një mjet pazarllëqesh me partnerët e saj — imperialistët amerikanë, në dëm të lirisë, të pavarësisë dhe të sigurimit të vërtetë të popujve të botës.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 69 (6421), 22 mars 1969*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje reprash) 1968-1970», f. 335*

# EDUKIMIT IDEOPOLITIK TË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE T'I JEPET RËNDËSI E DORËS SË PARË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

4 prill 1969

Raporti i paraqitur nga shokët e kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, sipas mendimit tim, është i bazuar, konkret dhe pasqyron gjendjen e vërtetë në fushën e krijimtarisë artistike dhe letrare. Gjithashtu, megjithëse në raport është shprehur mendimi juaj i drejtë, kolektiv, marksist-leninist për letërsinë dhe artet, shkëmbyem këtu drejtpërdrejt mendimet tona për këto probleme të rëndësishme që ishin të dobishme dhe na ndihmuan, sepse ju jeni specialistë e krijues në këtë fushë.

Dëshiroj të theksoj, siç u shpreh edhe shoku

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë për aktivitetin e këtij institucioni si dhe për disa probleme aktuale për revolucionarizimin e mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve.

Manush [Myftiu], që kritika për degjenerimin revizionist në fushën e letërsisë dhe të arteve të zgjerohet e të thellohet më tepër. Në raport flitet më shumë për degjenerimin e letërsisë e të arteve në letërsinë perëndimore e veçanërisht në atë franceze, kurse unë mendoj se kjo çështje duhet parë më gjerë, të flitet edhe për letërsinë dhe artet në vendet revizioniste, pse janë edhe më të rrezikshme, ngaqë në to ka një shtjellim pseudoideologjik dhe antimarksist të çështjeve që mund t'i dëmtojnë më shumë njerëzit tanë.

Ne në përgjithësi jemi të kënaqur nga shkrimtarët, artistët e kompozitorët tanë, mbasi ata në frymën e Partisë bëjnë përpjekje të mëdha e këmbëngulëse për t'i çuar përpara letërsinë dhe artet. Natyrisht, të meta e dobësi ka edhe në këta sektorë, prandaj vazhdimisht duhet t'i sqarojmë e t'i sheshojmë ato; për këtë rëndësi të veçantë ka bashkëpunimi i ngushtë i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve me Ministrinë e Arsimit e të Kulturës.

Mua më duket, shoku ministër<sup>1</sup> se dikasteri që drejtoni nuk ka qenë në krye të këtyre çështjeve, kurse gjatë diskutimit më ra në sy që përsëritët shumë herë në adresë të shokëve të Lidhjes shprehjen: «Ejani t'i shtrojmë këto çështje». Mendoj se shokët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, sigurisht, do t'ju kenë shtruar çështjet që i preokupojnë, por ju, drejtuesit e Ministrisë së Arsimit e të Kulturës, nuk jeni interesuar në masën e duhur dhe nuk keni qenë këmbëngulës për t'iu futur seriozisht dhe për t'i zgji-

---

1 Thoma Deliana.

dhur deri në fund problemet në të dy drejtimet, si në arsim, ashtu edhe në sektorët e kulturës, si për sa u përket problemeve teknike, materiale, sigurimit të fondeve për zhvillimin harmonik të letërsisë dhe të arteve, por sidomos në drejtim të ndihmës politiko-ideologjike, për arsye se Ministria e Arsimit dhe e Kulturës është organ kompetent që e kanë ngarkuar Partia dhe pushteti të merret me këto punë. Juve, pra, ju bie detyra ta ndërtoni punën në ministri në një mënyrë të tillë që të dy këtyre sektorëve të rëndësishëm, si të arsimit, ashtu edhe të kulturës, t'u kushtohet vëmendja e duhur, në masën dhe peshën që i përket secilit.

Kur është çështja për marrjen e masave për disa nevoja teknike materiale që nxjerr përpara koha dhe që kanë lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të kulturës dhe të arteve, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, ngurron, bile vetë ti, shoku ministër, personalisht, je mjaft i frikshëm, nuk ke guximin që këto çështje t'i shtrosh me forcën e nevojshme në Qeveri. E përsëris, nuk mjafton vetëm të thuash: «Ejani shokë t'i shtrojmë këto çështje», pse, nga sa jemi në dijeni, të gjitha këto që vunë në dukje këtu shokët e Lidhjes i kanë shtruar, prandaj t'i ndihmonit dhe t'i ndihmoni konkretisht; këtu nuk e kam fjalën vetëm për çështje të krijimtarisë ose për leje krijuese.

Kur konkludohet, ta zëmë, që, për ta çuar më shpejt përpara muzikën, duhet ngritur një shkollë tjetër ose duhen marrë masa të tjera që kërkojnë fonde, të sigurohen disa kuadro, apo të bëhen lëvizje kuadrosh, shtesa lokalesh etj., nuk shohim që të merrni

masa. Shoku Foto Stamo ka shtruar përpara ministrisë kërkesën se s'ka lokale të përshtatshme ku të ekspozohen veprat e artit. Atëherë, përse s'keni marrë masa për plotësimin e kësaj kërkesë, shoku ministër? Ndryshe është vepruar kur kanë dalë probleme për shkollat, ato janë zgjidhur, kurse për të ekspozuar në mënyrë të kulturuar tablotë e pikturës sonë, nuk jeni interesuar fare, bile këtë e keni quajtur krejt të panevojshme.

Të tilla probleme, shokët e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës duhet t'i shikojnë më mirë e më thellë. Po të gjykohen drejt problemet dhe kërkesat, që lindin nga nevojat e rritjes e të paraqiten këto në Qeveri në mënyrë të arsyeshme, siç po i shtrojnë shokët këtu, jam i bindur se do të merren parasysh. Tani ne mund t'i diskutojmë kërkesat që na u parashtruan dhe të shohim çfarë mund të bëjmë më shumë në të ardhmen.

Jam dakord që të jepen leje krijuese dhe disa shkrimtarë të dalin në profesion të lirë, me qëllim që të kenë më shumë kohë për prodhime letrare. Edhe ne vetë kur fillojmë të shkruajmë për një problem, qoftë edhe të vogël, duam kohë, prandaj lëmë punët e tjera, mbyllemi në zyrë dhe shkruajmë; megjithatë, s'do të ishte me vend që orientimi i mësipërm të zbatohet për të gjithë shkrimtarët dhe artistët në masë. Zhvillimi ynë çdo vit dhe bile çdo ditë që kalon, po bëhet vazhdimisht më i madh. Gjithmonë e më shumë njerëz të thjeshtë, duke u frymëzuar nga realiteti ynë, do të vazhdojnë të shkruajnë, kush një ose më shumë vjersha, të tjerë në prozë, bile do të ketë edhe ndonjë

mjek, apo specialist tjetër që do të vihet të shkruajë një novelë ose një roman. Megjithatë nuk mund të themi se të gjithë këta u bënë shkrimtarë. Gjatë rrugës sonë të zhvillimit do të dalin në masë njerëz që do të shkruajnë, disa nga të cilët në të ardhmen mund të bëhen shkrimtarë apo romancierë.

Më kanë rënë në dorë libra të shkruar nga njerëz të tillë që s'janë shkrimtarë. Kam lexuar, për shembull, një roman të shkruar nga një mjek për Prustin. Autori e trajton veprën e tij më shumë nga këndi i mjekësisë, se Prusti, siç dihet, ka qenë i sëmurë. Megjithëse nuk është shkrimtar i afirmuar, romani i mjekut që thashë, prapë është shumë i mirë. Nuk është e thënë, gjithashtu, që një agronom të mos bëhet shkrimtar. Një specialist i tillë, veç punës së tij si agronom, mund të jetë njëkohësisht edhe shkrimtar, sepse duke qenë i lidhur ngushtë me masën e popullit, frymëzohet dhe vihet të shkruajë jo vetëm tregime, poezi etj., por edhe një roman.

Nga ana jonë do të ishte gabim i madh po të mos e inkurajonim këtë zhvillim të vrullshëm masiv të lehtësisë në të tëra gjinitë. Partia, në radhë të parë, ka për detyrë të kujdeset për rritjen cilësore të të gjithë organizmave që ka krijuar, veçanërisht për Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve, që kjo t'u japë pastaj ndihmën e vet gjithë atyre që shkruajnë e do të shkruajnë, të cilët nesër nuk do të jenë sa sot, rreth 300-400 veta, po me mijëra. Megjithatë, mendoj që në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të pranohen si anëtarë elementë që afirmohen në lëmin e krijimtarisë; ndihma që duhet të japë Lidhja për gjithë këtë



masë njerëzish nuk është e domosdoshme të kushtëzohet me faktin që secili prej këtyre duhet të jetë anëtar i saj. Ai që shkruan e merret me veprimtari letraro-artistike, pa qenë anëtar i Lidhjes, me një punë të menduar mirë nga ana e këtij institucioni mund të marrë atë ndihmë për të cilën ka nevojë. Prandaj mendoj që në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve të pranohen ata elementë që shquhen në lëmin e krijimtarisë letraro-artistike dhe që ndihmojnë për ta organizuar më mirë këtë aktivitet të gjerë në gjithë vendin.

Siç thanë edhe shokët, nga artistët, përveç atyre që kemi sot, mund të bëheshin anëtarë të organizatës edhe interpretuesit, artistët e regjisorët e kinemasë apo të teatrit etj., të cilët janë të lidhur më ngushtë me shkrimtarët, kompozitorët e dirigjentët e orkestrave, duke pasur parasysh se artisti interpretues në vetvete është edhe ai një krijues. Por unë mendoj, kjo mund të diskutohet, të mos futen në Lidhje të gjithë artistët, duke përfshirë edhe amatorët, pse kështu nuk do të arrihej qëllimi që ka ajo për të ndihmuar për ngritjen e nivelit artistiko-kulturor dhe ideopolitik të të gjithë masës së atyre që merren me veprimtari krijuese letraro-artistike, numri i të cilëve do të vijë vazhdimisht duke u shtuar nga viti në vit.

Se si i ndihmon Lidhja krijuesit nuk e di me hollësi, por më duket se nuk po kuptohet drejt nga të gjithë pse duhet të shkojnë shkrimtarët në bazë. Për këtë çështje jemi të gjithë dakord, por duhen luftuar me kujdes të gjitha të metat që u vunë në dukje. Të mos harrojmë se ekzistojnë dhe do të ekzistojnë akoma vështirësi për të vajtur në bazë, veçanërisht për shkrim-

tarët dhe artistët. Pikërisht për të kapërcyer këtë vësh-  
tirësi, të punojmë ideologjikisht dhe politikisht që të  
mos krijohen iluzione të shtrembra te njerëzit.

Në rrethe ka njerëz që i kritikojnë disa nga  
shkrimtarët dhe artistët që janë ngarkuar, duke shfa-  
qur lehtë mendimin sikur nuk japin sa duhet, me ar-  
syetimin se ndonjëri nuk ka pranuar t'u rregullojë  
skenat. Shokët e rretheve nuk është e drejtë të shpej-  
tohen dhe të nxjerrin konkluzione jo të drejta për pu-  
nonjësit e artit dhe të letërsisë, të cilët nuk po i për-  
dorin si duhet, në një kohë që ata janë në gjendje të  
diskutojnë, të japin mendime të pjekura për problemet  
që shtrohen se janë njerëz me partishmëri.

Kam lexuar një pjesë<sup>1</sup> për qëndrimin e një in-  
xhinieri, i cili ishte dërguar të punonte në Qytetin  
Stalin dhe, mbasi kishte mbushur afatin, siç i kishin  
premtuar, u nis për në ministri, ku do të parashtronte  
një mijë e një arsyetime, se kishte kryer detyrën që  
i kishin caktuar, prandaj tani të kthehej në Tiranë,  
ku ishte më parë. Në autobusin që udhëtonte ndodhe-  
shin edhe disa punëtorë, që kishin lënë familjet dhe  
vendin e punës dhe po shkonin të punonin diku larg.  
Duke dëgjuar me vëmendje bisedat e tyre inxhinieri e  
kuptoi se me ç'ndërgjegje të lartë e hov revolucionar  
mendonin e punonin ata, reflektoi dhe i erdhi turp nga  
vetja që po kërkonte të kthehej në Tiranë, pra u pe-  
ndua, u kthye përsëri në punë dhe shkroi për sa ki-

---

<sup>1</sup> Është tregimi me titull «Rrugës midis njerëzve të thje-  
shtë» i shkrimtarit Anastas Kondo, botuar në gazetën «Drita»,  
5 janar 1969.

shte menduar. Duke përmendur këtë shembull, desha të t'heksoj që edhe edukimit ideopolitik të vetë shkrimtarëve dhe artistëve duhet t'i jepet rëndësi e dorës së parë.

Së dyti, të punohet gjithashtu edhe për forcimin e bashkëpunimit midis shkrimtarëve dhe artistëve me përvojë dhe më të rinjve duke i ndihmuar ata. Në vendin tonë sot kemi shkolla ku mësojnë dhe edukohen të reja dhe të rinj, që nesër do të bëhen artistë, muzikantë, piktorë, skulptorë etj. Por për shkrimtarët nuk kemi shkolla të posaçme. Puna dhe veprimtaria e tyre krijuese kufizohet më tepër në përpjekje individuale dhe jo kolektive. Punës kolektive, për disa arsye subjektive, i bëhet bisht sepse, nga një anë, të afirmuarit kanë frikë se mos të tjerët u marrin idetë dhe, nga ana tjetër, të rinjtë mendojnë se mos bëhen, si të thuash, shërbëtorët e një të talentuari. Ju e dini mirë se të gjithë artistët e mëdhenj, duke filluar nga Mikelanxhelo e pas tij të tjerë me radhë, në fillim kanë qenë çirakë të mjeshtërve të mëdhenj.

Dua t'ju pyes ju, shokë të Lidhjes, cili nga piktorët më të shquar të vendit tonë ka marrë ndonjëherë me vete 5-10 nxënës për të bashkëpunuar ngushtësisht me ta për ndonjë tablo që mendon të krijojë? As edhe një. Siç kam dëgjuar, piktori, për tablotë që komponon së pari mendon temën, pastaj merr veglat e bojërat, e fillon dhe e mbaron veprën vetë, pa i shkuar në mendje si ta konkretizojë në punën e vet vijën e masave, të bashkëpunojë me 5-6 nxënës, qofshin këta nxënës të shkollës së pikturës ose piktorë të tjerë të rinj apo të reja me talent, por pa shkollë fare (dhe, nga sa dimë, shumë nga ata që janë bërë artistë

dhe piktorë të njohur, fillimisht nuk kanë pasur shkollë). Secili ka praktikën e tij të punës, por mendoj se s'do të ishte keq sikur në fillim piktori të bënte skicën e tablosë, punë kjo që është një art më vete, një shkollë e madhe, pse para se të nisësh kompozimin, duhet të kesh të qartë idenë. Nga kjo punë studimore do të mësonin bashkëpunëtorët e rinj me të cilët rrihen mbarë e mbrapsht mendimet, duke krijuar kështu edhe bindje se ç'ndihmë japin ata me idetë e tyre. Në çdo tablo piktori përpigjet të konkretizojë një ide, ua hedh, pra, këtë ide bashkëpunëtorëve të rinj, i nxit ata të diskutojnë dhe nga rrahja e përbashkët e mendimeve fiksohet më së fundi sfondi i tablosë. Për përpunimin e veprës bashkëpunëtorët, gjithashtu, japin ndihmën e tyre, ndërsa mjeshtri u rri të gjithëve mbi kokë, i udhëzon, u bën vërejtje, i korrigjon, u jep udhëzime e mendime të mëtejshme, gjersa figura të arrijë në atë nivel sa duhet t'i jepen bojërat. Mjeshtri ndjek me kujdes tërë këtë proces, vë në diskutim cila pjesë është paraqitur më bukur dhe më e plotë, pastaj punës i jepet përfundimisht dora e fundit.

E njëjta rrugë mendoj se duhet ndjekur edhe për punimet në skulpturë, për veprat muzikore etj. Bile edhe shkrimtari para se ta shkruajë romanin, përse të mos thërresë një rreth kolegësh e të diskutojë për idenë e veprës që do të thurë, me qëllim që ta paraqesë atë sa më të plotë? Mirëpo në praktikë nuk veprohet kështu, midis shkrimtarëve nuk shkëmbehen mendime më parë se të fillohet puna, kjo bëhet në fund, pasi mbarohet vepra, por sa vështirë është atëherë për të realizuar vërejtjet e mundshme.

Në qoftë se nga një procedim i tillë ndonjëri nga bashkëbiseduesit mund të përvetësojë e shfrytëzojë mendimet e autorit, fundja le t'i shfrytëzojë, ai që përpigjet të kopjojë dhe të rrojë me «mend hua» nuk mund të shkojë gjatë, s'bën prokopi.

Puna e kryesisë së Lidhjes dhe e degëve të saj në rrethe, ose e degëve të tjera që mund të krijohen atje ku akoma nuk kemi, ka rëndësi të madhe për këto që u parashtruan. Duhet menduar si të organizohen këto mbledhje, si të sigurohet një bashkëpunim sa më i frytshëm dhe si të ndihmohen sa më mirë punonjësit tanë të letërsisë dhe të arteve që të zhvillohen më tej këta sektorë.

Për sa u përket disa shkrimtarëve dhe artistëve me aftësi të njohura, jam i mendimit se nuk është mirë të mbahen nëpër zyra, por të lihen në profesion të lirë. Kam biseduar për këtë çështje edhe me shokun Ramiz [Alia]. Shokë si Kristaq Rama, Odhise Paskali, Çesk Zadeja, Dhimitër Shuteriqi e të tjerë punonjës dhe krijues të vjetër, të aftë dhe të lidhur me Partinë, të cilët i kemi çuar në vende drejtuese në ministri apo në institucione të tjera qendrore të artit dhe të kulturës, për të dhënë më shumë në sferën e krijimtarisë së tyre do të ishte më mirë të liheshin në profesion të lirë. Mendoj se po të merret kjo masë, nuk do të ketë rrezik që ndonjëri prej tyre të heqë këmbët zvarrë.

S'kemi pse të jemi të kënaqur, për shembull, që Kristaq Ramën tani e kemi inspektor në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, kur që nga 50-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë nuk po na dorëzohet projektskica e Monumentit të Pavarësisë, apo kur për disa vjet të

tërë presim të na paraqitet skica e Varrezave të Dëshmorëve. Pseja theksohet, shoku ministër, ai s'ka kohë të merret me këto vepra kolosale, të cilat Byroja Politike, Qeveria dhe populli presin të realizohen. Pikërisht ky skulptor, nga i cili pritet kryerja e këtyre dy detyrave kaq të mëdha, është caktuar me punë në ministri. Për të bërë këto vepra nuk mjaftojnë disa muaj, për secilën nga ato do të duhej shumë më tepër kohë. Pastaj, këtu nuk është fjala vetëm për një e dy, por për 20 e ca skica të monumenteve dhe veprave të tjera që duhen përgatitur, për të cilat Kristaqi, fjala vjen, si përgjegjës i këtyre punëve duhet të vejë në vend, të shohë e të studiojë deri edhe natyrën e tokës ku do të ngrihen këto përmendore, të kujdeset për gurët, për bazamentin, mermerin etj., etj., që duhen për ndërtimin e tyre. Si mund të bëhen, pra, vepra të tilla monumentale që duan kohë, kur ai ngarkohet edhe me detyrën e inspektorit në dikaster me një mijë e një punë të përditshme administrative që e gozhdojnë në vend?

Njerëzve si ky duhet t'u caktohet vetëm një detyrë kryesore, ndryshe ai s'ka ç'të bëjë. Për ta zëvendësuar në ministri Kristaq Ramën, le të gjendet një kuadër tjetër, mjafton të jetë njeri me horizont, me nivel të mirë politik e ideologjik dhe, në përgjithësi, të dijë pak a shumë ç'janë arti e kultura. Njerëz të talentuar s'ka pse të vihen në krye të sektorëve administrativë, prandaj jam i mendimit ta rishikojmë këtë çështje.

Edhe në fushën e muzikës duhen liruar nga punët e tjera tre-katër shokë nga më kryesorët e më të mirët, sepse s'është normale që muzika të qëndrojë në

vend ose të ecë përpara ngadalë e me vështirësi. Cilët janë shokët që duhen nxjerrë në profesion të lirë, ky është një problem që duhet parë në mënyrë serioze e të planifikuar dhe jo në mënyrë liberale, as edhe sektare.

Sigurisht, duke i larguar të tillë kuadro nga këta sektorë, mungesa e tyre do të ndihet për ca kohë, derisa shokët e tjerë që do t'i zëvendësojnë të ngrihen në nivelin e të parëve. Duke ecur në këtë rrugë, mendoj se do të ndihmojë që krijimtaria letraro-artistike në vendin tonë të zhvillohet më shpejt. Sa janë kuadro të tillë që mund të lirohen, kjo duhet parë një për një, por asnjë nga këta të mos kujtojë se, duke e lënë në profesion të lirë, i lejohet vetëm të ëndërrojë. Me ata që kanë ëndërrime, në kuptimin e keq të kësaj fjale. të jemi më të shtrënguar. Për Monumentin e Pavarësisë në Vlorë, për shembull, s'ka përse të zvarritet puna, atyre që do ta marrin përsipër këtë vepër t'u vihet për detyrë që brenda afatit të caktuar ta përfundojnë.

Vërejtjet e shokëve që diskutuan t'i kemi parasysh se janë të drejta. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të jetë më këmbëngulëse në zgjidhjen e problemeve, por edhe shokët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve duhet të jenë më të matur në kërkesat e tyre, si edhe të insistojnë kur janë të bindur se kanë të drejtë për kërkesat që bëjnë.

Puna në fushën e letërsisë dhe të arteve po ecën mirë dhe jemi të bindur se akoma më mirë do të ecë në të ardhmen. Kongresi<sup>1</sup> që do të bëhet, do të japë

---

<sup>1</sup> Kongresi i 2-të i Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Shqipërisë i zhvilloi punimet më 24-26 prill 1969.

rezultate, rrjedhimet e tij do të jenë të mëdha në gjithë zhvillimin e kulturës e të arteve në vendin tonë.

Mendoj që me këtë rast, shtypi duhet të shkruajë më tepër për punën tuaj dhe për kongresin tuaj. Këto ditë vetë ju shkrimtarët dhe artistët sulmohet gazetat me artikuj e materiale të tjera, që edhe ato të ndihmojnë për përgatitjen e opinionit në vendin tonë, në mënyrë që kongresi të pritët nga të gjithë me entuziazëm të madh.

Ju urojmë suksese në punë dhe dalshi faqebardhë. Ne ju falënderojmë për punën e mirë që keni bërë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



# RIPËRTËRITJA E PARTISË DHE E ORGANEVE TË SAJ ME GJAK TË RI KA TË BEJË ME TË ARDHMEN E VETË PARTISË E TË VENDIT TONË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 prill 1969

Luftën për forcimin e Partisë, çështje jetike me rëndësi të dorës së parë, organizatat-bazë duhet ta kenë vazhdimisht në rendin e ditës, pse Partia është ajo që drejton, edukon e mobilizon masat e popullit dhe u qëndron punëve në krye. Për këtë qëllim, Partia ka dhënë udhëzime mjaft të qarta, por fjala është që të bëhen përpjekje të mëdha për t'i kuptuar e për t'i zbatuar ato si duhet. Çështja e pranimeve të reja asnjëherë nuk duhet kuptuar si një fushatë, ajo është detyrë e përhershme e të gjitha organizatave. Kur flasim për ripërtëritjen e Partisë, organizatat-bazë t'i bëjmë të ndërgjegjshme që të mos e shikojnë si diçka të

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e bërë për forcimin e përbërjes së Partisë gjatë vitit 1968 dhe mbi disa çështje për pranimet në Parti në rrethin e Tiranës.

thjeshtë, por të gjykojnë thellë, për shembull, për pranimet e reja, duke kuptuar mirë rëndësinë e madhe ideologjike të çështjes, sepse ka të bëjë me futjen e gjakut të ri në Parti, me ripërtëritjen e organeve të saj, prej nga varet e ardhmja e vetë Partisë dhe e vendit tonë.

Me kalimin e viteve, njerëzit nuk mund të kenë më gjallërinë që kishin kur qenë të rinj. Kjo kuptohet, energjitë e tyre vijnë gradualisht duke u pakësuar, fizikisht bien, se mosha bën të vetën, prandaj, duke punuar me devotshmëri për kryerjen e detyrave të përditshme një nga detyrat e tyre kryesore si komunistë është edhe përgatitja për në Parti e të rinjve. Është e domosdoshme, pra, që udhëzimet e dhëna për pranimet e reja, organizatat-bazë t'i kenë kurdoherë parasysh dhe të punojnë për t'i zbatuar ato në jetë, ndryshe, nëse kjo çështje nuk do të kuptohet thellë ideologjikisht, s'është vështirë të merret me mend ç'pasoja do të kishte për jetën e Partisë në përgjithësi, apo qoftë edhe për organizatat-bazë në kooperativat bujqësore, në ndërmarrjet ekonomike, në institucionet e ndryshme.

Në organizatat-bazë të Partisë, në fshatra sidomos, pengon konservatorizmi, që plekset me dobësi të ndryshme, si mungesa e ngritjes ideologjike, moskuptimi drejt, në mjaft raste, i vijës së Partisë, ekzistenca e mbeturinave mikroborgjeze dhe disa vese të tjera mjaft të këqija në karakterin e ndonjë komunisti, të cilat, të koncentruara të gjitha së bashku, ndikojnë negativisht edhe në çështjen e pranimeve në Parti. Mirëpo këto dobësi, që pengojnë përtëritjen e Partisë

me gjak të ri, organizatat-bazë shpesh i kalojnë lehtë, duke u justifikuar me lloj-lloj arsyesimesh pa bazë, kur shfaqjeve të tilla është e domosdoshme t'u qëndrohet vazhdimisht mbi kokë.

Problemi që po shqyrtojmë është i lidhur ngushtë me pjesëmarrjen e komunistëve në prodhim. Nga pranimet që janë bërë më parë, për të zgjidhur kërkesat e shumta që kemi pasur në situata të ndryshme për shokë drejtues, në ndërmarrjet ekonomike, të bujqësisë etj., një sërë komunistësh kanë marrë, si të thuash, profile jashtë prodhimit, duke punuar në drejtim dhe në prapavija. Për t'i futur gjithë këta shokë në prodhim, aktualisht në përgjithësi po ecet mirë; suksese ka, por akoma disa komunistë mezi lëvizin. Prandaj, sipas mendimit tim, këtej e tutje të kemi parasysh që në ndërgjegjen e komunistëve të rinj të mos lejohen prirje për të zënë punë në prapavijat e ndërmarrjeve apo të kooperativave bujqësore, larg prodhimit. Në punë të këtilla të preferohen për t'u vendosur më shumë se gjer tani njerëz të paorganizuar në Parti; s'duhet të jemi sektarë.

Në Parti nuk kemi tendenca sektarizmi, megjithatë, po të shohësh konkretisht gjendjen në ndonjë ndërmarrje, sektarizmi atje duket qartë; mendohet, për shembull, se në depo duhet vënë patjetër një komunist, kështu organizata e Partisë është e sigurt se administrohen më mirë vlerat materiale. Me fjalë thuhet përse të mos vihet në një detyrë si kjo një punëtor i mirë i paorganizuar në Parti, një e re apo një djalë i ri, por, kur vjen puna në praktikë, kjo harrohet, në vende ku administrohen vlera materiale, mone-

tare etj. nuk vihen njerëz të paorganizuar në Parti. Në qoftë se komunistët më të mirë dërgohen në prodhim, do të forcohet edhe vigjilenca për ruajtjen e pasurisë së përbashkët, ata vetë do të edukohen si udhëheqës të vërtetë revolucionarë, do të mësohen të drejtojnë e të edukojnë me frymën e Partisë masën e punonjësve që nuk janë anëtarë partie. Anëtar i Partisë, që futet në prodhim, bëhet shembull në çdo drejtim, në punë, në shoqëri e kudo, kalitet, bëhet, pra, më revolucionar. Në këtë mënyrë ai do të jetë në gjendje ta ndihmojë, ta kontrollojë më mirë dhe ta edukojë edhe magazinierin e paorganizuar në Parti, të caktuar për të punuar në depo, i cili akoma mund të mos i ketë të kristalizuara në ndërgjegjen e vet cilësitë e një komunisti. Komunistët duhet të punojnë me këmbëngulje për t'i ngritur punonjësit e paorganizuar në Parti, për t'i edukuar ata ideopolitikisht.

Po t'i lejohet komunistit të mendojë dhe t'i zhvillohet prirja për t'u futur diku në administratë e jo në prodhim, ai do të humbasë shumë nga cilësitë e veta; ndërsa në prodhim, ku është burimi i të ardhurave dhe i krijimit të të mirave materiale, kaliten vetitë më të mira të njerëzit si vullneti, vendosmëria, fryma e sakrificës, ndjenja e drejtësisë, e ndershmërisë etj., etj. Nga ana tjetër, duke punuar në prodhim, komunisti do të njohë punonjësit më të mirë e më të ndërgjegjshëm, të cilët do të synojë t'i përgatitë për në Parti. Në të ardhmen, duhet të insistojmë fort që njerëzit, të cilët do të mbushin radhët e Partisë, në përqindjen më të madhe të jenë nga baza, nga prodhimi, të edukuar me një frymë të tillë që, edhe si të bëhen komunistë, të

qëndrojnë në prodhim, sepse kështu do të forcohet akoma më shumë organizata e Partisë, por edhe vetë kooperativa, ndërmarrja etj. Pra, duke dërguar më shumë komunistë në prodhim, edhe pranimet në Parti këtu do të jenë më të mira si në sasi, ashtu edhe në cilësi.

Për këtë problem shumë të rëndësishëm orientime janë dhënë vazhdimisht, megjithatë në disa rrethe, si në Korçë etj., ka pasur të meta serioze, për eliminimin e të cilave kohët e fundit duket se është bërë kthesë.

Mendoj se punonjësit e aparatit të Komitetit Qendror, kur shkojnë me shërbim, nuk duhet ta flenë mendjen, të jenë më shumë ekzigjentë dhe ta ndjekin me shumë kujdes këtë çështje, se pikërisht në organizatën e Partisë të rrethit të Korçës, më tepër se në çdo organizatë tjetër për pranimet e reja përsëri vazhdon të ketë konservatorizëm, sidomos ndaj shoqeve. Shfaqje të tilla ka edhe në disa zona të rretheve të Jugut, prandaj, me aq sa është bërë, të mos mendohet se, për problemin në fjalë, janë zhdukur kudo pikëpamjet konservatore ose të tjera si këto.

Do të duhet akoma kohë e gjatë dhe punë këmbëngulëse nga ana e Partisë që të realizohen tërësisht dhe mirë orientimet e dhëna. Jo vetëm në rrethin e Korçës, po edhe në krahina të tjera, si në Mallakastër e në Vlorë, pranimet e reja s'ecin me ritmin e duhur, sepse mjaft komunistë të vjetër, bile edhe shokë të luftës, kur organizatat-bazë pranojnë ndonjë të ri, atë e nënvleftësojnë, duke i vënë përpara «për krahasim» meritat e veta të së kaluarës. Këto shfaqje negative të dëmshme i frenojnë shumë pranimet, prandaj nuk

mjafton të japin vetëm udhëzime apo të merret një masë ose të bëhet një kritikë në konferencën e Partisë; ky problem të ndiqet me këmbëngulje dhe konsekuencë nga e gjithë Partia.

Është krejtësisht normale dhe e domosdoshme që në organizatën-bazë, ta zëmë, të kooperativës bujqësore të Cakranit, të pranohen në Parti elementë të rinj të lindur pas Çlirimit, punonjës të devotshëm për ndërtimin e socializmit, djem e vajza, që, megjithëse nuk kanë marrë pjesë në luftë, se ishin të vegjël në moshë, për punën dhe cilësitë e tyre të mira e meritojnë të jenë anëtarë partie. Mirëpo atje ka shokë të vjetër që pengojnë dhe akoma s'u hyn në kokë se djali ose mbesa e tyre mund dhe duhet të pranohet në Parti; mbase me gojë ata nuk e thonë këtë, po qëndrimi që mbajnë tregon qartë pikëpamjet e tyre konservatore për këtë problem jetik për Partinë. Prandaj është e domosdoshme, pra, të tregojmë kurdoherë kujdes të madh e të pandërprerë për këtë çështje.

Duke e parë në një kënd tjetër problemin, është me interes të na thuhet si punojnë shokët e rinj që kanë ardhur në udhëheqje, sidomos ata të cilët janë zgjedhur në byrotë e komiteteve të Partisë dhe a është organizuar gjithçka si duhet, që puna e tyre në prodhim të koordinohet mirë me punën në drejtim, a gjejnë vështirësi, sidomos kur vijnë në mbledhjet e byrosë?

Ata janë njerëz të prodhimit, punëtorë, sjellin gjallërinë e klasës, prandaj në punët drejtuese të Partisë këtyre shokëve duhet t'u rekomandojmë të mos adaptojnë stilin e instruktorit, por instruktorët të adaptojnë stilin e këtyre si në diskutime për ngritjen

e problemeve ashtu dhe në kontaktet me punëtorët, ndryshe mund të bien në frazeologji. Të mos lejohet që raportet e tyre, kur caktohen në ekipe pune, t'i bëjnë ata që dinë të shkruajnë bukur, bile të mos lejohet as për t'u korigjuar prej këtyre. Ata të shkruajnë atë që dinë, ndryshe do t'u futen formulat. Në qoftë se instruktori, për shembull, ka ndonjë gjë për të shtuar, t'ua thotë atë dhe të mos e futë vetë në raport.

Kur këta shokë caktohen nga komiteti i Partisë në grupe pune për kontroll e ndihmë s'duhet të bien në praktikën e njohur të mbledhjeve të gjata e pa bukë. Për shembull, për të ndrequr komunistët që kanë dobësi a gabime në punë, s'ka pse pritet shumë derisa këta të pranojnë gabimet e fajet e tyre, por pasi grupi i punës e ka analizuar plotësisht gjendjen në vend, ka biseduar kokë më kokë me këta komunistë, ka nxjerrë konkluzione, u lë atyre që kanë gabuar vetëm disa orë kohë të mendohen e të bëjnë autokritikë. Po të vihet re se këta nuk reagojnë drejt dhe kërkojnë të fshehin fajet e tyre, atëherë u tërhiqet edhe një herë vëmendja për gjithçka që kanë bërë dhe pastaj çështja diskutohet në organizatën-bazë ose në kolektiv, ku merren dhe masat e duhura. Pra, edhe ata që gabojnë t'i mësojmë të kuptojnë drejt, se Partia nuk lejon të humbasë koha kot, se asaj nuk i kalojnë as oratoritë, as dredhitë, prandaj, në qoftë se komunisti do që të ndreqet dhe të jetë në rregull nuk duhet ta zgjatë me ditë dhe javë autokritikën, por të reflektojë menjëherë dhe kur reagon drejt e kupton thellë gabimin, Partia do t'i japë dorën. Një metodë e tillë e drejtë,

e studiuar mirë dhe e shpejtë, e bën atë të ndihmojë veten, por edhe të mos dëmtojë më tej punën.

Në praktikë ndodh që një çështje zvarritet nën pretekstin se duhet ndihmuar ai që gabon. Natyrisht, ai që gabon duhet ndihmuar dhe kjo është një nga metodat dhe kriteret më të shëndosha të punës së Partisë, por kjo nuk do të thotë që të biesh në pozitat e atij njeriu, i cili, edhe pse është i bindur se s'ka të drejtë, kërkon të fshehë gabimet e fajet e tij me dredhi, për të mashtruar. Pra, në këtë rast, s'duhet rënë në pozitat e atij që ka tendencë ta vërtitë çështjen dhe të na humbasë kohën kot. Në qoftë se në këto raste do të veprohet shpejt, kohë që të ndreqet ai ka. Dua të them që kuadrot kryesorë të mos humbasin tepër kohë, duke u munduar të bindin fajtorin që nuk do të pranojë fajin. Për këtë gjë s'ka pse të merret as organizata-bazë me mbledhje pa fund; shumëkush mund të dojë, le ta bindë jashtë mbledhjes, por kur je i sigurt se ai ka bërë këto faje dhe kërkon t'u shmanget, përse duhet të humbasësh kohën me të? Përse të lihet të bëjë dredhi? E kam fjalën që për çdo rast duhet përdorur një metodë dhe stil i përshtatshëm pune, për t'i zgjidhur drejt problemet dhe pa humbur kohë. Këtë shembull duhet ta japë Partia e para.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## **PËR PASOJAT E TËRMETIT MOS KINI ASNJË SHQETËSIM, DO T'I LIKUIDOJMË SHPEJT**

*Nga fjala para popullit të krahinës së Krahësit  
në rrethin e Tepelenës gjatë vizitës pas tërmetit  
të 3 prillit*

**6 prill 1969**

Të dashur shokë, motra dhe vëllezër,

Jemi dërguar nga Partia dhe Qeveria e, mund të themi, nga i gjithë populli shqiptar, nga Veriu në Jug, për të qenë pranë jush në këto çaste të vështira. Porsa morëm vesh për tërmetin e 3 prillit, që preku rrethet e Tepelenës, të Fierit, të Vlorës, të Beratit, të Përmetit e të Skraparit, si të gjithë, edhe ne shokët e udhëheqjes, si bijtë dhe gjaku juaj, u rrëqethëm, u prekëm shumë dhe s'na pritej të vinim këtu sa më shpejt për t'ju parë vetë me sy si jeni dhe për t'u takuar drejt-përdrejt me ju.

Populli thotë me të drejtë se në kohë të vështira hidhërimi dhe brengat kalohen më shpejt e bëhen më të lehta, kur kalohen së bashku me njerëz. Sot, në Shqipërinë tonë socialiste, i gjithë populli, i madh e i vo-

gël, komunistë e patriotë, janë me zemër e mendje me popullin e të gjitha krahinave heroike që u dëmtuan nga tërmeti.

Motra dhe vëllezër, ashtu siç kaloi shpejt tronditja e parë e lëkundjes nga tërmeti, po ashtu shpejt do të kalojnë e do të vihen në vend pasojat që shkaktoi ai. Këtë e garantojnë vullneti i mbarë popullit tonë dhe vendimi i Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>, që u mor menjëherë të nesërmen e ngjarjes. Ky vendim parashikon të rindërtohen në një kohë sa më të shkurtër të gjitha, ç'janë prishur e shkatërruar, në mënyrë që plagët e rënda të shkatuara të shërohen pa vonesë. Për këtë qëllim dhe që puna të organizohet sa më mirë janë marrë e do të merren masa financiare, materiale e teknike.

Të gjitha shpenzimet, që do të nevojiten për tërë këtë rindërtim, i merr përsipër shteti. Kjo provon edhe një herë se Partia dhe pushteti ynë janë të popullit, se gjithçka që drejton, administron dhe kontrollon Partia, shkon në dobi të tij, si në kohë të mira, ca më tepër në kohë të vështira. Çdo gjë që krijon populli, me Partinë në krye, te ne është vetëm e popullit.

Fatkeqësi të tilla të natyrës ose të çfarëdolloji tjetër qofshin, në vendin tonë, shërohen shpejt, se populli shqiptar i ka tradita shpirtgjerësinë, solidaritetin vëllazëror dhe luftarak, vendosmërinë e patriotizmin e flaktë që s'kanë shembull në botë. Këto virtyte të larta të popullit tonë për t'iu gjendur pranë vëllait në

---

<sup>1</sup> Ky vendim u botua në gazetën «Zëri i popullit», më 5 prill 1969.

kohë të vështira i ka ngritur në një shkallë shumë më të lartë dhe i kalit vazhdimisht Partia. Ajo i edukon njerëzit tanë çdo ditë me shpirtin e lartë të sakrificës, që me entuziazëm e me vendosmëri revolucionare të kapërcejnë çdo pengesë e çdo vështirësi, i frymëzojnë për t'u hedhur në sulm me të gjitha forcat e në çdo moment që do të jetë nevoja për mbrojtjen e atdheut, ashtu siç bëri gjatë luftës kundër pushtuesve, siç bën sot që na udhëheq në luftën për ndërtimin e socializmit, për jetën e lumtur. Prandaj ai që nuk frymëzohet, që nuk udhëhiqet dhe që nuk sakrifkohet për këtë popull, nuk ka vlerë. Edhe një mijë herë ta japësh jetën për popullin tonë trim, nuk mund të mendosh se ke bërë gjithçka. I tillë është populli ynë.

Komitetit Qendror i vijnë letra e telegrame të shumta në shenjë solidariteti, nga të katër anët e atdheut, me anën e të cilave vëllezërit e motrat tuaja nga e gjithë Shqipëria kërkojnë t'ju vijnë në ndihmë. Zemrat e të gjithë shqiptarëve, si në kohë gëzimi, edhe në kohë hidhërimi, rrahin si një e vetme, trupat e tyre janë të bashkuar si një i vetëm dhe mendjet e tyre janë përqendruar si një e vetme dhe e fuqishme për t'i çuar atdheun dhe popullin tonë gjithnjë përpara, për ndërtimin e socializmit dhe për lulëzimin e vendit, për të përballuar së bashku çdo vështirësi e rrezik. Me ju, që kaluat këto momente të rënda, janë të bashkuar më shumë se kurrë në një unitet të çeliktë dhe si një trup i vetëm gjithë shqiptarët dhe s'ka si të ndodhë ndryshe. Në sistemin tonë socialist fatkeqësi të tilla të rënda, që në të kaluarën sillnin mjerime të mëdha, tani mënjanohen pa shumë dhimbje.

Megjithëse disa mijëra shtëpi na u rrënuan dhe mjaft njerëz na u plagosën, ne s'jemi të dëshpëruar, bile jemi të lehtësuar që nuk patëm të vrrarë, kurse të plagosurit janë të gjithë mirë. Edhe ndonjë që u plagos më rëndë, tashmë e ka kaluar rrezikun. Me gjithë fatkeqësinë e rëndë, në fytyrat tuaja, të grave, të vajzave, të burrave dhe të luftëtarëve të vjetër njeriu nuk shikon asnjë shenjë pikëllimi, sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Kjo vjen se populli e ndien veten zot të fateve të veta në atdheun e lirë socialist.

Partia, me vijën e saj të drejtë, ka krijuar besimin në masat e popullit se forca e tij është e madhe. Kjo forcë e popullit, e udhëhequr nga Partia jonë, është në gjendje të çajë malet, zbukuron dhe kalit, në radhë të parë, njeriun tonë të ri të socializmit, transformon natyrën, i bën tokat të lulëzojnë. Këtë besim tani e ka dhe e ndien mbarë populli ynë, prandaj në çastet më të vështira, si këto që kaluat ju, nuk ka asnjë dëshpërim, përkundrazi, kudo punohet me entuziazëm. Pra, qoftë nga ana e tronditjes shpirtërore, ashtu edhe nga pikëpamja materiale, kjo që na ngjau është diçka e vogël, në krahasim me «tërmetet» shumë më të rënda që ka njohur dhe i ka provuar në kurriz populli shqiptar në të kaluarën.

Pikërisht si nesër, 30 vjet më parë, Shqipëria pësoi një «tërmet» të tmerrshëm të shkaktuar jo nga natyra, por nga hordhitë fashiste të Musolinit. Kjo qe një fatkeqësi e madhe dhe e rëndë për vendin tonë, por populli trim shqiptar, që ka përshkuar me shekuj një rrugë luftërash të pandërprera, nuk u përkul. Ai i priti me armë në dorë pushtuesit fashistë, mori pa-

rasysh se do t'i vriteshin qindra e mijëra bij e bija, se do t'i shfarosej bagëtia, do t'i digjeshin e do t'i shkatërroheshin me dhjetëra mijë shtëpi dhe krahina të tëra, por asnjëherë nuk hoqi dorë nga lufta për liri. Në sajë të kësaj vendosmërie, populli ynë i vogël në numër përpara këtyre armiqve të egër, dinakë dhe të armatosur gjer në dhëmbë, doli fitimtar.

Kush e ngriti popullin tonë në luftë dhe e udhëhoqi në fitore? Partia që lindi nga gjiri i tij, forca e tij e pamposhtur që nuk pyeti për asnjë vështirësi, uniteti i tij me Partinë. Çelësi i fitores së popullit mbi fashistët e tradhtarët ishte besimi i pakufishëm i popullit në udhëheqjen e drejtë të Partisë. Me atë në krye ne bëmë me sukses luftën e madhe Nacionalçlirimtare dhe transformuam vendin në atë nivel që s'është parë kurrë ndonjëherë. Kjo situatë që krijoi Partia na jep sot mundësi të rindërtojmë dhe të vëmë në vend gjithçka që na shkatërroi tërmeti.

Populli, me Partinë në krye, duke u hedhur në luftë jo vetëm përzuri pushtuesit fashistë, por përmbysi njëherë e përgjithmonë edhe pushtetin feudo-borqjez dhe në vend të tij ngriti pushtetin popullor, krijoi kështu kushtet për ndërtimin e socializmit. Prandaj sot jeta në vendin tonë është zbukuruar, Republika jonë është forcuar, autoriteti i Shqipërisë është rritur dhe rritet nga dita në ditë.

Armiqtë tani duhet të mendohen mirë para se të cenojnë interesat e Republikës sonë Popullore. Partia, me punën e saj, ka bërë që të shtohen miqtë e Shqipërisë në botë, të shtohet dashuria e tyre për këtë popull të vogël, por luftarak e të papërkulur. Gjith-

ashtu, shtohen vazhdimisht edhe respekti e mirënjohja e tyre ndaj popullit tonë, i cili mban lart flamurin e marksizëm-leninizmit, të lirisë dhe të demokracisë. Ja, pra, të dashur motra dhe vëllezër, ç'është bërë në vendin tonë në këta 25 vjet në sajë të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë e të trimërisë së popullit të saj, të vogël në numër, por të madh nga çdo pikëpamje tjetër.

Populli shqiptar është i thjeshtë, po edhe Partia, që lindi nga gjiri i popullit dhe ruan karakteristikat e tij, është e thjeshtë, e fortë dhe e çeliktë. Me këto karakteristika duhet të brumoset çdo anëtar partie. Në qoftë se komunisti dëshiron ta quajë veten të tillë dhe të mbetet kështu deri në fund të jetës së tij, duhet të mos dalë kurrë nga rruga, të ndjekë me besnikëri vijën e saj të drejtë, të dëgjojë këshillat dhe vërejtjet tuaja. Komunistët shqiptarë, të cilët karakterizohen nga thjeshtësia proletare, janë luftëtarë të paepur për çështjen e popullit dhe njëkohësisht punëtorë të palodhur e krijues. Por Partia na mëson të mos kënaqemi me fitoret që kemi arritur e aq më tepër të mos na rritet mendja, përkundrazi, të vëmë të gjitha forcat për të ecur kurdoherë përpara. Partisë dhe popullit, që kanë detyra të mëdha përpara, u hapen tani perspektiva të shkëlqyera, të cilat duhen shfrytëzuar për ta lulëzuar më tej vendin tonë. Duke u bazuar në çka kemi krijuar, në të ardhmen ne do t'i hedhim hapat akoma më të mëdhenj se gjer tani.

Kujtoni, vëllezër dhe motra të Tepelenës, se si në regjimet e së kaluarës për të ndërtuar një shtëpi një familjeje i duhej një kohë e gjatë, kurse tash ajo ngri-

het në një kohë shumë të shkurtër. Kjo vjen sepse te ne janë krijuar ajo forcë dhe ai bashkim që nuk njohin vështirësi, pengesa, apo mungesë mjetesh e specialistësh, sepse çdo veprim, çdo aksion shihet me syrin politik, i kombinuar ky me pjekurinë e popullit tonë dhe kryhet në rrugën që na mëson Partia.

Populli ynë e mbështet në çdo gjë Partinë, e cila është e fortë, sepse vetë populli, nga gjiri i të cilit ka dalë ajo, është i fortë; është e zgjuar, sepse i zgjuar është populli, dhe e urtë, sepse mbështetet në urtësinë e madhe të popullit. Populli duhet ta ndihmojë vazhdimisht Partinë, se ajo ka nevojë për këshillat e tij dhe i konsideron ato një thesar të madh e të paçmueshëm. Partia e mëson popullin të jetë vigjilent, të flasë hapët për çdo gjë që ka në zemër, të inkurajojë punët e mira që bëhen dhe të kritikojë kur vërtetohen gabime e të meta, kudo qoftë. Vetëm kështu uniteti Parti-popull nuk do të shuhet kurrë dhe asnjë armik nuk do të mund të përfitojë nga të metat e gabimet e individëve ose të komunistëve të veçantë; vetëm kështu planet e mëdha që kemi përpara do t'i realizojmë në një kohë sa më të shkurtër dhe do të krijojmë për vendin tonë një forcë akoma më të madhe ekonomike, politike e morale.

Tërmeti ra, shtëpitë na u prishën, por rëndësi ka çështja që njerëzit shpëtuan. Me gjithë fatkeqësinë e rëndë, tani të tërë i janë përveshur punës. Punëtorët e Minierës së Memaliajt asnjë minutë nuk e ndërprejnë punën për të nxjerrë qymyrin nga nëntoka, as kooperativistët nuk i lanë pas dore punët e bujqësisë. Kjo tregon për atë ndërgegjeje të lartë politike që ka kalitur

Partia te njerëzit tanë, për kuptimin e drejtë që kanë ata për të kryer detyrat ndaj vetes, ndaj Partisë, Republikës sonë Popullore dhe ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Kjo përbën forcën tonë të madhe.

Shokë, motra dhe vëllezër,

Siç e dini, tani jemi nga mesi i punës për realizimin e planit tonë të katërt pesëvjeçar, i cili edhe po tejkalohet. Veçanërisht në bujqësi kemi një përparim të madh. Vërtet jemi disi larg asaj që kërkojmë të arrijmë, por kemi besim në perspektivën e ndritur, se jemi në rrugë të drejtë. Populli shqiptar, që kurrë s'e ka prodhuar bukën në vend, tani do ta arrijë edhe këtë. Ka rëndësi të madhe të luftojmë për bukën, shoqe dhe shokë, por duhet të luftojmë që të arrijmë rezultate të mira edhe në sektorin e blegtorisë, në perimet, në vreshtat, në pemëtari etj.

Ju tepelenasit, ashtu siç ngjet edhe në krahina të tjera të vendit tonë, jeni shumë të dhënë pas blegtorisë, sidomos pas bagëtive të imëta. Vetë Partia i kush-ton vëmendje të madhe sektorit të blegtorisë. Në planet që keni hartuar dhe nga studimet që kanë bërë të gjitha rrethet, tash së fundi, rezulton se ju keni marrë vendime të rëndësishme. Tani mbetet ta organizoni mirë punën që këto vendime të realizohen. Në qoftë se keni harruar të parashikoni, ashtu si duhet, çështjen e sigurimit të bazës ushqimore të blegtorisë, më lejoni t'ju këshilloj t'i rishikoni edhe një herë vendimet që keni marrë, po jo në dëm të bukës. Në parcelat e dri-



thërave përpiguni të merrni rendimente sa më të larta, se kështu do të mundni të ekonomizoni disa toka për të mbjellë më shumë bimë që shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Blegtoria nuk zhvillohet e bagëtitë nuk të japin prodhim pa u ushqyer. Është një ndjenjë e bukur ajo e popullit tonë që i do shumë bagëtitë, por që ato të rriten e të japin prodhim të bollshëm, në radhë të parë, duhet t'u sigurohet ushqimi, pa lënë pas dore punën për përmirësimin racor të tyre etj.

Vëllezër, blegtorë tepelenas, unë e di mirë që ju i doni delet me shpirt, por ka rëndësi, dhe besoj që edhe ju jeni dakord me ne, që nga delja, lopa ose dhia të marrim sa më shumë qumësht, mish, lesh dhe pleh. Ne kemi dele, lopë e dhi të mira, të cilat, po t'u sigurojmë një ushqim të mjaftueshëm dhe t'u bëjmë një trajtim më të mirë në ato drejtime që kërkojnë, edhe prodhime do të na japin më shumë. Mirëpo konstatojmë se nuk tregohet kudo kujdes i mjaftueshëm për to. Akoma te disa ekziston dëshira për të pasur sa më shumë kokë bagëti, gjë që kërkon të sigurojmë më shumë bar e kullota. Ne duhet të punojmë që nga bagëtitë, si lopët, delet dhe dhitë, të marrim rendimente të larta në qumësht, mish dhe lesh me sa më pak shpenzime. Po t'ia caktojmë vetes këtë detyrë, do të na dalë se me kullotat dhe me bazën ushqimore që kemi mundësi të sigurojmë, duhet të mbajmë bagëtitë më të mira dhe jo me shumicë sa për të pasur shumë si numër. Në këtë mënyrë, brenda një kohe të shkurtër, duhet të arrijmë që, në krahasim me numrin më të madh të krerëve të deleve që keni ju tani, të marrim më tepër qumësht, mish dhe lesh nga më pak krerë.

Kur të arrini të merrni, ta zëmë, nga 20 dele, aq sa merrni sot nga 50, përse të detyroheni të mbani më shumë si numër e t'u jepni nga një grusht bar? Po të keni krerë më pak, barin dhe ushqimet e tjera do t'jua jepni më me shumicë, atëherë edhe delja qumështin do t'jua japë «jo me okare, po me matare».

Kjo punë nuk do të fillojë duke i përdorur për mish delet që nuk na japin qumësht sa duhet. Partia na këshillon që në planet tona të parashikojmë sa nga këto duhet të shkurtojmë çdo vit. Në qoftë se kemi, për shembull, një tufë prej 50 krerë delesh, por që japin pak prodhim, përse të mos i kufizojmë këto, ta zëmë deri në 30 krerë, me qëllim që, duke i ushqyer e duke u kujdesur më mirë për to, duke përmirësuar edhe racën e tyre, të marrim më tepër prodhime. Kjo do të arrihet dalgadalë, brenda disa vjetësh, duke punuar kryesisht për rritjen e rendimentit të qumështit, të mishit etj. Gjatë kësaj kohe duhet të punojmë intensivisht me një sistem të atillë që në të gjitha kooperativat të kemi lopë, dele e dhi të racave të zgjedhura. Kështu do të krijojmë një blegtori me rendiment të lartë e të qëndrueshëm, që do të na japë jo vetëm më shumë prodhim, por edhe gjenerata të racës së mirë, bij e bija të shëndosha. Atëherë do ta kuptojmë sa mirë kemi bërë që pakësuam krerët dhe krijuam një blegtori me të vërtetë të shëndetshme, do të shohim që me pak shpenzime do të marrim më shumë prodhime nga sa merrnim.

Partia kurdoherë na mëson të gjykojmë me mend në kokë, me zemër dhe me laps në dorë. Jam i mendimit që çdo gjë, shokë, ta shoshitni mirë. Asgjë s'duhet

bërë pa llogari, gjithçka, në drejtimet që thashë, të kryhet me pjekuri, me rrahje mendimesh me blegtorët me përvojë dhe me popullin.

Në rrugën që ka caktuar Partia, bujqësia jonë do të bëjë përparime gjithnjë e më të mëdha, se ajo do të mekanizohet më shumë, se do të merren rendimente të larta në të gjitha prodhimet, mbasi, veç të tjerave, tokat do të ujiten e do të plehërohen më mirë e në shkallë gjithnjë e më të gjerë, do të krijohen raca bagëtish shumë më të mira se këto që kemi sot etj. Këto rezultate, të dashur shokë e vëllezër, nuk do të jetë e largët dita që do t'i shikojmë, për arsye se, për të arritur rendimente më të larta, po edukohen e po mësojnë tani të gjithë kooperativistët, i gjithë populli.

S'ka dyshim se sukseset tona në këtë drejtim do të jenë të mëdha, por të mos na rritet mendja, të gjithë të bëjnë përpjekje të mëdha për të mësuar, mbasi vetëm me praktikë, pa përvetësuar të rejat e shkencës, nuk arrihet atje ku duam. Të gjitha degët e ekonomisë sonë popullore kanë përparuar vetëm në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë, e cila ka marrë eksperiencën pozitive të arritur nga mbarë bota në të gjitha fushat, e ka shoshitur mirë dhe ia ka dhënë popullit. Populli ynë i talentuar e bluan këtë eksperiencë dhe me ndihmën e saj, duke ia përshtatur kushteve të vendit, krijon vlera të mëdha. Edhe për zhvillimin e bujqësisë Partia kujdeset që populli të mësojë, që të rritet niveli i kooperativistëve, i brigadierëve; ajo përgatit gjithashtu specialistë të lartë, të cilët punojnë dhe njëkohësisht mësojnë masat që bujqësia dhe çdo sektor tjetër në vendin tonë të ecë përpara me ritme

të shpejta. Kushtet për përparim ekzistojnë te ne, pikërisht sepse udhëheq Partia, sepse ekzistojnë faktorët vendimtarë në këtë luftë të madhe revolucionare që do ta çojnë përpara ekonominë tonë, njerëzit tanë punëtorë e kooperativistë.

Edhe industria te ne ecën mirë. Në një kohë të shkurtër kemi ndërtuar mjaft vepra të reja industriale, por nuk do të qëndrojmë me kaq. Plani i katërt pesëvjeçar parashikon ndërtimin e objekteve të reja shumë të rëndësishme që, siç e dini, janë në ngritje e sipër. Plani i ardhshëm pesëvjeçar do ta fuqizojë akoma më shumë industrinë tonë të përparuar socialiste. Kjo do të bëjë që atdheu ynë të bëhet më i fuqishëm, të ngrihet më lart niveli i jetesës së popullit dhe t'i jepet një mbështetje akoma më e madhe bujqësisë. Kështu, Shqipëria jonë do të kthehet në një vend industrial me bujqësi të përparuar. Në këtë rrugë po ecim me vendosmëri, prandaj kërkohet mobilizimi i të gjithëve dhe mund të themi se ky mobilizim dhe patriotizëm i flaktë i mbarë popullit është kudo i madh, gjithë jeta e vendit tonë revolucionarizohet me ritme të shpejta.

Njerëzit tanë, të cilët e kanë të qartë të ardhmen e shkëlqyer, nuk ndiejnë lodhje, bile asnjë shenjë lodhjeje. Te të gjithë zien një dashuri e madhe për punën, për të krijuar, për të prodhuar e për të luftuar. Të gjithë jetojnë me problemet e kohës, diskutojnë, propozojnë, kritikojnë. Ky është ai revolucion i përherëshëm, në rrugën e të cilit ne shkojmë vazhdimisht përpara. Pikërisht këtu është siguria jonë, këtu e kanë burimin forca e madhe e Partisë dhe e popullit.

Krahas me këto, një rëndësi të madhe ka çështja e arsimit, e shkollës sonë. Është lumturi e madhe për Shqipërinë që i shtohen fëmijët, e ardhmja e vendit. Rinia te ne rritet e gëzuar, e lumtur, e shëndetshme dhe punëtore. Nën udhëheqjen e Partisë, sipas shembullit të klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste, rinia jonë mësohet ta kuptojë të tashmen, duke bërë krahasim me të kaluarën. Rinia e Shqipërisë është ajo fidanishte që edukohet nga Partia me një patriotizëm të zjarrtë, me kokën plot, e pastër dhe me zemrën çelik. Ky është një sukses i madh, që e shton forcën tonë dhe na bën të pathyeshëm. Prandaj duhet të punojmë vazhdimisht që ta shtojmë edhe më shumë këtë forcë, duke e ushqyer rininë çdo ditë me politikën e drejtë të Partisë, me ideologjinë marksiste-leniniste, me traditat luftarake të popullit tonë, me traditat e ushtrisë sonë dhe me punë praktike. Djemtë dhe vajzat tona, së bashku me burrat dhe gratë, t'i edukojmë të bëhen punëtorë të palodhur, njëkohësisht t'i përgatitim teknikë, inxhinierë, agronomë dhe ushtarë nga më të fortët e më të kualifikuarit, të jenë të gatshëm e vigjilentë ditë e natë, në çdo moment për mbrojtjen e gjakut, të djersës, të punës e të jetës së lirë të popullit tonë, se gjithë këto ndërtime të mëdha që po bëjmë, ky marshim vigan përpara i popullit tonë në rrugën e socializmit dhe të komunizmit, nuk kryhen pa vështirësi.

Realizimet tona të mëdha nuk mbrohen vetëm me djersë dhe me përpjekje, por edhe me një luftë të vendosur në fushën ndërkombëtare. Ju e dini fare mirë që populli shqiptar qëndron në radhët e para të luftës kundër imperializmit amerikan edhe aleatëve të tij,

kundër revizionistëve sovjetikë dhe satelitëve të tyre. Koalicioni imperialisto-revizionist, që në pamje duket si një fuqi ekonomike dhe ushtarake e tmerrshme, brenda është i krimbur, për arsye se kjo forca e tij «kolosale» udhëhiqet nga një ideologji skllavëruese, grabitqare dhe shtypëse, që ka për qëllim skllavërimin e popujve. Një forcë e tillë, edhe pse zotëron armët atomike, është aq e kalbur, saqë në kontaktin e parë me energjitë luftarake të bashkuara të popujve, me siguri do të cfilitet. Marksizëm-leninizmi këtë e provon shkencërisht.

Nuk po shkoj më larg, por dëshiroj t'ju kujtoj atë që keni jetuar ju vetë. Populli ynë, që dukej si një pikë uji në oqean përpara forcës së madhe të fashistëve gjermanë dhe italianë, të armatosur gjer në dhëmbë, pa iu trembur syri, duke pasur Partinë në krye, i priti me luftë fashistët, iu vërsul atyre si një uragan i tmerrshëm dhe i bëri hi. Tani kush shkon kundër popullit, kush kërkon të vrasë, të vjedhë dhe ta grabitë atë, në mos sot, nesër, me siguri do të humbasë. S'ka asnjë dyshim se shtetet kapitaliste apo ato që në krye kanë revizionistët, të cilët ndjekin këtë politikë, do të humbasin, popujt do t'i zhdukin ata nga faqja e dheut. Lufta e popujve, ideologjia marksiste-leniniste, që tani është futur në zemrën dhe në ndër-gjegjen e klasës punëtore dhe të popujve të mbarë botës, megjithëse akoma të paorganizuar si duhet, do të vijë shpejt koha që të japin rezultatet e veta të shkëlqyera. Në botë, kudo, ka lëvizje revolucionare popujsh, ka marksistë-leninistë dhe revolucionarë që po ngrihen dhe do të rriten dita-ditës. Shqipëria është

bërë sot për ta flamurtare e marksizëm-leninizmit, shembull dhe inkurajim për të gjithë popujt dhe komunistët e botës, të cilët po ngrihen në revolucion, në luftëra çlirimtare. Ne, shqiptarët, duke bërë një luftë të madhe për realizimin e planeve, japim edhe në këtë drejtim një ndihmë të madhe për triumfin dhe lirinë e popujve të mbarë botës.

Ne jemi të bindur se në mos sot, nesër në vendet revizioniste, ku tash duket sikur tradhtarët e kanë të sigurt fuqinë, sikur popujt gjoja janë gjunjëzuar përpara tyre, revolucioni do të shpërthejë përsëri. Bashkimi Sovjetik e ka humbur forcën e dikurshme, sepse tradhtarët hrushovianë e shkelën me të dyja këmbët rrugën e Leninit dhe të Stalinit dhe po e transformojnë këtë vend në një vend kapitalist. Gjendja tani atje mbahet në këmbë me forcë, ashtu siç e mbanin në vendet e tyre Hitleri dhe Musolini. Në kohën e tyre edhe këta fryheshin e mburreshin, por e vërteta ishte se brenda gjendja që e kalbur dhe erdhi koha që popujt u bënë varrin këtyre dhe i groposën. Kështu do të ndodhë edhe me revizionistët e gjithë tradhtarët.

Revizionistët sovjetikë arritën të pushtojnë Çekoslllovakinë për arsye se partia e komunistëve çekoslllovakë, që duhej të qëndronte në krye të luftës së popullit për liri, pavarësi e socializëm, ishte krimbur nga brenda dhe që hedhur në tradhti. Që kur vendosën ta pushtonin Çekoslllovakinë, revizionistët sovjetikë patën frikë se mos atje kërciste pushka, por me ndihmën e krerëve tradhtarë çekoslllovakë u arrit që atje të mos dëgjohej krismë pushke. Në rast se udhëheqësit revizionistë sovjetikë vendosin të largojnë ushtrinë sovje-

tike të pushtimit nga Çekoslovakia, kjo do të thotë të pranojnë botërisht dështimin e aventurës së tyre të tipit fashist në këtë vend, gjë që ata do ta paguajnë me kokë para popullit sovjetik. Duke u ndodhur në një situatë kaq të vështirë, në rrugë pa krye, gabimi i çon në gabim, ata po e shtojnë vazhdimisht shtypjen në Çekoslovakia.

Në dritën e këtyre ngjarjeve populli polak, bullgar, gjerman dhe popujt e tjerë të vendeve ku sundojnë revizionistët modernë, të ashtuquajturin mik, Bashkimin Sovjetik, e shikojnë si një vend agresor dhe ata, të cilët janë në krye të tij, si një grup ushtarak fashist, që përpiqen t'i vënë nën thundër. Popujt e këtyre vendeve nuk do të mund t'i durojnë për një kohë të gjatë aktet poshtëruese e skllavëruese të revizionistëve sovjetikë, rruga e degjenerimit dhe e shkatërrimit të të cilëve është e sigurt, ashtu siç është i sigurt shkatërrimi i forcave të imperializmit amerikan dhe i sate-litëve të tij.

Në ballë të luftës së popujve kundër imperializmit e revizionizmit qëndron Shqipëria, vendi ynë i dashur, për të cilin luftojmë dhe punojmë të gjithë së bashku. Në këto situata me të vërtetë optimiste, ne duhet t'i shtojmë forcat, të ecim përpara me guxim dhe në mënyrë të organizuar të kryejmë me përpikëri të gjitha detyrat që kemi përpara. Për sa i përket pasojave të tërmetit, mos kini asnjë shqetësim, do t'i likuidojmë shpejt.

Edhe një herë tjetër dëshiroj të përsëris se ne jemi jashtëzakonisht të gëzuar e të lumtur prej qëndrimit tuaj burror. Kjo na jep forca të mëdha, na shton kurajën për të kryer më mirë e me nder deri në fund



detyrat që na kanë ngarkuar Partia dhe ju. Entuziazmi dhe qëndrimi juaj heroik në këto çaste të vështira na i shtojnë forcat dhe besimin në vijën e drejtë të Partisë. Ne kemi shumë nevojë për t'u takuar dhe për t'u këshilluar me ju. Kjo është një ndihmë shumë e madhe për ne. Frymën luftarake që pamë gjatë qëndrimit në mes jush, do t'ua tregojmë shokëve të udhëheqjes, Partisë dhe gjithë popullit, të cilët në këto ditë të vështira janë me mendje dhe me zemër pranë jush.

Meqë nuk pata mundësi të shkoj kudo, ju lutem shumë, u transmetoni të gjithë vëllezërve dhe motrave të fshatrave, ku tërmeti ka bërë dëme, përshëndetjet e mia personale më të përzemërta. U thoni nënave, motrave, të rinjve e të rejave, grave e burrave, se Partia punon, mendon e jeton ditë e natë për ta. Ne, si ushtarë të saj, me këtë rast, porositim shokët e organizatave-bazë të Partisë të bëjnë çmos e të tregohen të palodhur për popullin, të jenë në çdo moment të parët dhe në ballë të punës dhe të luftës: atje ku ka më shumë vështirësi, atje ku puna është më e rëndë, atje ku kërkohen sakrifica. Në mënyrë të veçantë në këto momente, ata duhet të mos i zërë gjumi, sidomos pa siguruar mirë motrat e vëllezërit, të cilët kanë nevojë për ndihmë, prandaj të jenë në krye të organizimit të mirë të çdo pune. Përveç punës së pandërprerë që duhet të bëjnë ata në ara, në kooperativa e kudo në frontet ku punojnë, të mos e bëjnë gjumin tamam, po të punojnë pareshtur për ndërtimin sa më parë të shtëpive të dëmtuara, në mënyrë që fëmijët të hyjnë sa më parë në shtëpitë e reja e të mos e ndiejnë të ftohtit dhe të mos na sëmuren. Komunistët të jenë të

parët kudo, të tillë i do populli. Në qoftë se ka ndonjë që nuk vepron kështu, të mendohet mirë se një njeri i tillë nuk ka vend në Parti. Populli e di se për të gjithë komunistët, për edukimin e tyre, Partia ka një vijë. Ajo kërkon që ata të jenë të parët në kryerjen në mënyrë shembullore të detyrave dhe të fundit në kërkesa. Në rast se ndonjë heq këmbët zvarrë, nuk mund të vazhdojë gjatë në radhët e Partisë. Mundet që, për një kohë të shkurtër, ndonjë të vijë vërdallë me fjalë, t'u hedhë hi syve popullit e Partisë, por shpejt do t'i «dalë bakëri», prandaj duhet dërguar «të kallajiset» mirë, t'i vihet një çikë melhem, si të thuash, që të bëhet i aftë dhe i denjë për t'i shërbyer popullit. Po të veprojë ndryshe edhe pas kësaj, atëherë t'i gjendet vendi se Partia nuk ka nevojë për anëtarë të tillë. Ai që nuk punon mirë, që bën vazhdimisht gabime dhe nuk korrigohet, të nxirret para popullit, i cili t'ia thotë të katër të vërtetat në fytyrë.

Vëllezër dhe motra të dashura! Në emër të të gjithë Partisë, të shokëve, në emrin tim dhe të të gjithë popullit, ju uroj edhe një herë shëndet e suksese në punë. Sa për fatkeqësinë që ju ngjau mos kini mërak, pasojat e saj do të vihen shpejt në vend.

Të rrojë Partia, populli e rinia!

Të rrojë Republika Popullore e Shqipërisë!

Të rrojë populli heroik i Tepelenës!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## LUMTURIA E POPULLIT — KY ESHTË QËLLIMI I PARTISË SONË

*Nga fjala para popullit të Mallakastrës në katundin  
Ninësh gjatë vizitës pas tërmetit të 3 prillit*

**6 prill 1969**

Të dashur vëllezër dhe motra të Mallakastrës dhe të Fratarit,

Partia dhe Qeveria na kanë dërguar këtu, në këto vende heroike, kështjella të pamposhtura të luftës shekullore për liri, kështjella të pamposhtura të Luftës Nacionalçlirimtare heroike, të udhëhequr nga Partia, për t'u takuar me ju në këto ditë fatkeqësie. Me ju, sot, nuk jemi vetëm ne vëllezërit dhe shokët tuaj që erdhëm t'ju shohim, por janë të gjithë komunistët e Shqipërisë, është gjithë populli. Me zemër e me mendje, të gjithë sot janë pranë jush në këto ditë të vështira që u shkaktuan nga tërmeti. Bashkatdhetarët tanë nga të katër anët e Shqipërisë ushqejnë një dashuri të zjarrtë për ju dhe, të bashkuar si një trup i vetëm,

dëshirojnë me këtë rast t'ju vijë në ndihmë sa më parë dhe me çdo mjet që kanë mundësi.

Ky solidaritet socialist vëllazëror, të dashur vëllezër dhe motra, është arritur në sajë të vijës së drejtë të Partisë, në sajë të luftës heroike që bëri mbarë populli shqiptar, në të cilën ju, mallakastriotë dhe mallakastriote, mbani një vend nderi. Partia luftoi pikërisht që të gjithë shqiptarët të mendojnë për njëritjetrin njëlloj si për veten e vet, që ta duan shok-shokun si vëllai-vëllanë jo vetëm brenda shtëpisë, por shumë më larg saj, që nga skaji më i lartë i Malësisë së Madhe e deri në Jug, në Konispol. Partia ka punuar e punon që mendjet dhe zemrat e çdo shqiptari të punojnë si një e vetme, që në ndërgjegjen tonë të rrënjosen virtytet më të larta, se vetëm kështu gjaku i derdhur nga shokët, shoqet, nga vëllezërit dhe motrat dëshmorë nuk shkon dëm, po ngrihet si pishtar për t'i ndritur tejmbanë Shqipërinë dhe botën. I paharruar në shekuj do të jetë gjaku i tyre, që u shërben Partisë dhe popullit si fener për të ecur gjithë jetën në rrugën e unitetit, të socializmit e të komunizmit.

Vija e drejtë e Partisë bëri të fitohej lufta, të kryheshin gjithë këto vepra të mira në vendin tonë, të zgjohej e të mësohej populli si ta përmirësonte jetën e tij, jetën e çdo familjeje dhe të gjithë kolektivit, të përmirësonte bujqësinë dhe industrinë. Kjo vijë e drejtë e Partisë, ka bërë që tash, me gjithë fatkeqësinë që na ngjau, me gjithë shembjet, me gjithë humbjet dhe shkatërrimet e shtëpive, vëllezërit tanë të mos jenë të shqetësuar, por, përkundrazi, të jenë optimistë, të

kenë besim dhe siguri në të ardhmen. Prandaj në fytyrën e secilit prej jush duket sikur nuk ka ngjarë gjë. Kështu s'ndodhte e s'mund të ndodhte përpara, por ngjet tash, për arsye se populli është në fuqi, se Partia është juaja, se ajo mendon, lufton dhe punon vetëm për popullin.

Ju mallakastriotët dhe mallakastriotet jeni të sigurt se pasojat e kësaj fatkeqësie të natyrës do të ndreqen shpejt, brenda një kohe të shkurtër, prandaj dhe ju, si thotë populli, s'ua bën tërr syri. Ju s'iu trembët tërmetit shumë më të madh të vitit 1939, si nesër, 30 vjet më parë, kur Shqipëria u pushtua nga hordhitë e fashizmit italian, që ju dogji e ju shkatërroi shtëpitë, ju vrau njerëzit më të dashur të zemrës. Në atë kohë, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, me emrin e Partisë në mendje e në zemër, të udhëhequr me trimëri të madhe nga trima me fletë, nga heronj të lavdishëm të popullit shqiptar ju rrëmbyet pushkët dhe u hodhët me guxim në luftë. Në këtë luftë heroike ju përsëritët në mënyrë të shumëfishuar traditat e vjetra luftarake të mallakastriotëve dhe të të gjithë shqiptarëve. Fatkeqësia e tanishme nuk është asgjë para asaj të pushtimit fashist që ishte shumë më e rëndë dhe në shkallë kombëtare. Megjithatë populli as atëherë nuk u tremb nga vuajtjet dhe sakrificat. Edhe atyre, të cilët në fillim nuk u hodhën menjëherë në luftë, u dhanë zemër shokët, luftëtarët e orës së parë, prandaj të gjithë ndoqën pas trimat e Partisë dhe të popullit dhe Mallakastria, nën udhëheqjen dhe kushtrimin e Partisë, luftoi si e gjithë Shqipëria, i mundi fashistët italianë dhe gjermanë, doli nga lufta shumë herë më e fortë se

përpara. Të na rrojë Partia sa malet, ta duam si sytë e ballit, sepse ajo na dha mundësi të punojmë dhe të rrojmë të lirë e të lumtur!

Çështja e dashurisë për Partinë nuk është thjesht një çështje fjale. Ajo është jeta e çdo njeriu te ne, se gjithçka, çdo mendim, çdo hap që hedh njeriu, çdo gjë që bëhet për të mirën e popullit në vendin tonë udhëhiqet nga Partia, është vepër e saj.

Kini kurdoherë parasysh se Partia është juaja, sepse ka dalë nga gjiri juaj. Ata që vijnë në Parti janë nga njerëzit më të mirë të popullit, të klasës punëto-re, të fshatarësisë dhe të inteligjencies sonë. Interesi i popullit është që në Parti të vijë ajka e tij. Kjo ajkë futet në radhët e Partisë jo për të zënë vende të rehatshme, por që të bëhet shërbëto-re e devotshme e popullit. Njerëzit që pranohen në Parti duhet të jenë të thjeshtë, të drejtë, të guximshëm dhe punëtorë të palodhur. Në qoftë se një komunist nuk i ka këto cilësi, populli të thotë hapur se nuk bën të jetë në Parti, ta këshillojë organizatën-bazë të Partisë e po të jetë nevoja ta detyrojë që ta rishikojë çështjen e tij.

Ju mallakastriotët keni marrë pjesë në luftë që në fillim, prandaj në organizatat-bazë të Partisë këtu ka shumë luftëtarë me një të kaluar të lavdishme. Këta janë një thesar i madh për gjithë Partinë tonë, veçanërisht për Mallakastrën, por lidhur me këtë çështje dëshiroj të theksoj diçka. Ju, shokët e vjetër komunistë, që bëtë luftën dhe treguat heroizëm, tani duhet të punoni që pranë jush të vijnë djemtë e rinj, vajzat e reja, natyrisht nga ata që i kanë të gjitha cilësitë, se Partia kërkon t'i gjallërojë radhët e saj, duke futur

vazhdimisht në to gjak të ri. Mos u tregoni të mefshtë në këtë drejtim, shoqe dhe shokë komunistë, mos u tregoni sektarë, mendoni se Partia duhet të jetë kurdoherë e re dhe energjike. Ne, më të vjetërve në Parti, Komiteti Qendror na mëson, që gjithë jetën, derisa të na rrahë zemra, të punojmë e të luftojmë me të gjitha forcat e mundësitë për popullin. Kjo është e qartë dhe ne kurrë nuk do të hedhim pushkën derisa t'i kemi sytë hapur. Por Partia dhe Komiteti Qendror na mësojnë gjithashtu se, krahas nesh, të vijnë në Parti edhe të rinj e të reja, sepse vetëm kështu ajo do të mbetet kurdoherë e re. Dhe ne e kemi për detyrë që atë eksperiencë që kemi, t'ua japim komunistëve të rinj, t'i përgatitim për Partinë, sepse dihet, jeta e njeriut dhe sidomos aftësitë e tij për punë kufizohen me kalimin e moshës. Po, ndërsa njerëzit vdesin një ditë, populli dhe Partia nuk vdesin kurrë. Prandaj e kemi për detyrë të marrim masa të tilla që populli të rrojë i lumtur në shekuj dhe për këtë Partinë duhet ta bëjmë të çeliktë. Të mos e konsiderojmë atë kurrë si monopol të disave, vetëm të atyre që bënë luftën, por të përgatitim vazhdimisht për të hyrë në Parti të rinj e të reja. Ju e kuptoni ç'rëndësi të madhe ka kjo që po them për të ardhmen e Partisë, të popullit dhe të vendit. Ndoshta këtu në Mallakastër ky fenomen mund të ngjasë më pak, por në disa rrethe të tjera ka shfaqje sektarizmi. Ky është një problem me shumë rëndësi, prandaj të gjithë ta shikojmë drejt.

I udhëhequr nga Partia, ashtu si kurdoherë, populli ynë që karakterizohet nga një patriotizëm i flaktë, do t'i shërojë relativisht shpejt dëmet e tërmetit.

Shokët që janë ngarkuar me këtë punë kanë organizuar evidentimin e të gjitha dëmtimeve, që nga më e vogla deri te më e madhja, se çdo gjë i duhet popullit. Për këtë arsye të përdoret një metodë pune e organizuar mirë, me specialistë e me njerëz nga populli, me punëtorë e me fshatarë, që njerëzit të fillojnë sa më shpejt nga puna. Nga ana tjetër, të studiohen nevojat, të përcaktohen se cilat objekte ekonomike, sociale dhe shtëpi banimi kërkojnë meremetime, cilat kërkojnë rregullime më të pakta, cilat duhen ndërtuar krejtësisht nga themelet, si dhe të përcaktohet sa më drejt koha e përfundimit të këtyre punëve, veç e veç për secilën kategori ndërtimesh. Pas kësaj patjetër do të kemi ndërtime më të bukura se ç'kanë qenë më parë. Që tani kanë filluar të sillen në mënyrë sistematike mjetet dhe të vijjnë njerëzit që do të ndihmojnë për të realizuar vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili parashikon që ndërtimet të mbarojnë sa më shpejt e me sukses, dhe pjesa e dëmtuar e popullsisë të mos vuajë. Tashti kohën e kemi të mirë, nuk është dimër si atëherë kur ra tërmeti në rrethet e Dibrës e të Librazhdit, ku jo vetëm dëmtimet ishin më të rënda, por ishte edhe dimër i fortë që na rrezikonte veçanërisht shëndetin e fëmijëve dhe të gjithë njerëzve të atyre rrethëve. Pikërisht për këto arsye atëherë i përqendruam të tëra forcat për t'i përfunduar ndërtimet brenda një muaji. Kjo ishte e domosdoshme për kushtet e atjeshme. kurse tani që koha sa vjen e bëhet më e mirë, se kemi beharin përpara, na lejohet të mos nxitohemi, me qëllim që punimet të kryhen më me cilësi se atëherë.



Komiteti i Partisë i rrethit tuaj, organizatat-bazë të Partisë dhe gjithë komunistët në çdo front, duhet që gjatë kësaj kohe që po punohet, t'u japin medoe-mos çdo ndihmë të nevojshme familjeve të dëmtuara. Në radhë të parë, të strehohen përkohësisht, që, në asnjë moment, asnjëri të mos e ndiejë veten keq dhe që, njëkohësisht, të mos lërë prapa punët me shumë rëndësi të bujqësisë e të blegtorisë, të mos ketë pse të preokupohet se ku të futë kokën, se do t'i ndërtohet shtëpia apo jo etj. Të jeni të sigurt, motra dhe vëllezër, se strehimi i përkohshëm do t'ju sigurohet të gjithëve dhe shtëpia, sipas shkallës së dëmtimit, do t'u ndërtohet, do t'u meremetohet duke u bërë më e mirë nga sa e keni pasur më parë.

Vëllezër dhe motra të Mallakastrës e të Fratarit, ju e keni të qartë vijën e Partisë. Ajo synon ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë. Për ju që merreni me bujqësi kjo do të thotë t'i jepni një hov të madh përpara punës në frontin tuaj, zhvillimit të bujqësisë e të blegtorisë. Ju po e shikoni se bujqësia në vendin tonë, nga viti në vit, po e ndryshon faqen, se nuk është më ajo që ishte dikur. Ky përparim vjen si rezultat i vijës së drejtë të Partisë, që e filloi punën me kolektivizimin, bashkimin e forcave të punës e të mjeteve të prodhimit. Tashti është kuptuar nga të gjitha masat e popullit se pa kolektivizimin ne do të rronim në mjerim. Fshatarësia përbën shumicën e popullsisë, kurse bujqësia, me të cilën merret ajo, si një nga degët më kryesore e jetike për vendin, ishte e prapambetur. Në planet ekonomike të Partisë vendin krye-

sor e zë industria dhe krahas saj vjen bujqësia. Siç porosit vazhdimisht Partia, ne duhet të ecim përpara me të dyja këmbët, mbasi pa njëriën prej tyre, pa industrinë ose pa bujqësinë e zhvilluar ekonomia jonë nuk mund të shkojë përpara, vendi ynë nuk mund të arrijë në socializëm.

Në këtë zhvillim shtylla kurrizore duhet të jetë industria. Dhe ju e shikoni vetë ç'rëndësi të madhe i ka vënë Partia zhvillimit të industrisë. Kudo janë ngritur fabrika, kombine, hidrocentrale, janë ndërtuar rrugë, hekurudha, që shumica prej jush i kanë parë. Atje ku rinia punon për ndërtimin e hekurudhës, i dashuri xhaxho<sup>1</sup>, do të vesh edhe ti të shikosh vajzat e djemtë e popullit që punojnë dhe do të bindesh ç'punë të mrekullueshme janë duke bërë. Kur ne filluam luftën, shumë njerëz na konsideronin kalamancë, por Partia u vu në krye të popullit, dhe me luftën e veprat që udhëhoqi për të mirën e popullit, i bindi të gjithë, i bëri me vete dhe fitoi. Prandaj, ti xhaxho, kur më tej të shikosh djemtë dhe vajzat e reja si drejtojnë termocentralin e madh dhe fabrikat moderne të Fierit, të Tiranës, të Beratit e gjetkë e gjetkë, kur të shikosh se si po ndërtojnë një nga hidrocentralet e vendit tonë, atë të Vaut të Dejës, nuk do të thuash më se këta nuk janë të zotë, po do të gëzohesh. E tillë është rinia jonë e edukuar dhe e kalitur nga Partia.

Këtej në këto anë gjeologët kanë zbuluar naftë. Për ju dhe për gjithë Shqipërinë është fat i madh që

---

1 Shoku Enver Hoxha i drejtohet një të moshuari.

do të nxjerrim sasi gjithnjë më të mëdha nafte nga thellësitë e tokës dhe që do t'i përpunojmë në vend, këtu afër, në Ballsh, pra, nuk do ta nxjerrim më jashtë të papërpunuar, ashtu siç del nga toka. Me këtë mënyrë ne do t'ia shumëfishojmë vleftën asaj. Në Ballsh parashikojmë të ndërtohet një rafineri nga më të mëdhatë e vendit tonë, ku do të punojnë shumë punëtorë, një pjesë e të cilëve do të dalin nga gjiri juaj, të tjerë do të vijnë nga të gjitha anët e vendit. Kjo na vë detyrën që Partia dhe ju këtu të parashikoni që edhe rafineria të ndërtohet, edhe bujqësia të mos pengohet, prandaj bëjeni mirë planin e forcave të punës. Djemtë dhe vajzat tuaja, që do të punojnë në Ballsh, do të bëhen atje punëtorë të zotë, drejtues e specialistë të rafinerisë. Me këtë vepër, Ballshi në të ardhmen do të bëhet një qytet industrial me rëndësi, prandaj atje do të ndërtohen pallate për strehimin e punëtorëve, shkolla, kopshete, çerdhe, kinema, spitale etj. Zhvillimi i industrisë në rajonin tuaj do të sjellë një përparim të paparë për gjithë Mallakastrën dhe rrethin e Fierit, ai do të shpejtojë patjetër edhe përmirësimin e mëtejshëm të bujqësisë.

Ju e keni të qartë rrugën e zhvillimit të bujqësisë e të blegtorisë në vendin tonë, prandaj punoni me hov revolucionar, me perspektivë dhe me guxim. Çdo përparim arrihet, në radhë të parë, po të jemi të qartë politikisht, të kemi vendosmëri, trimëri e dituri dhe të punojmë vazhdimisht. Këto cilësi jo vetëm nuk ju mungojnë, përkundrazi, i keni shumë të zhvilluara. Qartësinë politike dhe vendosmërinë tuaj, forcat men-

dore dhe fizike, shpirtin luftarak dhe të kuptuarit drejt të politikës së Partisë, i bashkoni në një të vetme për të zbatuar detyrat që ju ka ngarkuar Partia në frontin e bujqësisë, në blegtori, si dhe në industri, e cila do të zhvillohet në rrethin tuaj. Kështu punohet në të gjithë vendin tonë. Prandaj kemi marrë zotime përpara Partisë dhe popullit që këtë plan pesëvjeçar ta realizojmë para afatit dhe me siguri do ta realizojmë.

Siç e dini, plani i ardhshëm pesëvjeçar do të jetë akoma më i ngjeshur, shumë më i madh se i sotmi, ai parashikon ngritjen e një industrie akoma më të fuqishme dhe zhvillimin e mekanizimit e mëtejshëm e të shumanshëm të bujqësisë. Këto çështje janë llogaritur mirë nga Partia, prandaj gjithçka do të realizohet gjer në fund, në radhë të parë, me forcat e me mendjen tonë.

Shokë dhe vëllezër, kurrë nuk duhet të kënaqemi me gjendjen e tanishme, me dituritë, zotësitë dhe me sukseset që kemi arritur gjer më sot. Prandaj gjatë realizimit të planeve tona e kemi për detyrë të mësojmë e të edukohemi vazhdimisht nga çdo pikëpamje, se përpara na presin punë të mëdha. Ju duhet të diskutoni me guxim për çdo çështje, të shfaqni mendime dhe të merrni iniciativa të drejta. Për të kryer sa më mirë detyrat e së ardhmes, dërgoni qysh tani djemtë e vajzat në shkolla dhe kurse, i ndiqni këto edhe vetë dhe mos u justifikoni me moshën, me shëndetin etj. Çdonjëri, me aq sa ka mundësi, duhet të bëjë përditë përpjekje për të mësuar pandërprerë, se kështu do të bëhet çdo ditë e më i vlefshëm për t'i shërbyer sho-

qërisë sonë të re. Partia ka nevojë për ndihmën dhe për mendimin e të gjithëve. Sa më e fortë të jetë ndihma fizike e mendore e çdonjërit, aq më përpara e më mirë do të na shkojnë punët, sa më e fortë të jetë zemra, trimëria e guximi i secilit nga ne, aq më e fortë dhe e paprekshme nga armiqtë do të bëhet Shqipëria, armiqtë kurrë s'kanë ç'na bëjnë dhe nuk do të guxojnë ta prekin Shqipërinë.

Ne, vëllezër dhe motra, e dimë se rruga e Partisë është e drejtë. Kjo, bashkë me trimërinë, me patriotizmin, me vullnetin e papërkulur në luftë e në punë dhe me bashkimin e popullit rreth Partisë e kanë forcuar vendin tonë dhe e kanë bërë Shqipërinë një fener ndriçues ideologjik për gjithë revolucionarët e botës. Ideologjia marksiste-leniniste është një armë e fortë shpëtimtare, ajo është më e tmerrshme, më e fuqishme se arma atomike, me të cilën mburren imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë. Kjo armë nuk është asgjë përpara forcës së ideologjisë marksiste-leniniste të Partisë sonë, përpara unitetit të çeliktë të popullit me Partinë dhe vendosmërisë së tyre për të ecur të papërkulur e gjer në fund në rrugën e socializmit e të komunizmit. Ja përse Partia dhe populli ynë konsiderohen nga miqtë tanë të shumtë në të gjitha anët e botës si fener ndriçues, që verbon imperializmin dhe revizionizmin dhe u tregojnë rrugën e drejtë popujve dhe revolucionarëve.

Ne nuk jemi vetëm në rrugën tonë, me ne janë revolucionarët e vërtetë, janë popujt...

*Pastaj, pasi foli për disa çështje të situatës ndër-*

*kombëtare, për dështimet e imperialistëve dhe të revizionistëve, shoku Enver Hoxha tha:*

Situata ndërkombëtare është në favorin tonë, prandaj na vihet detyrë të luftojmë për realizimin e planeve, për të ngritur gjithnjë më shumë nivelin ideopolitik, për të përvetësuar shkencën. Të gjitha këto ne duhet të përpigemi t'i vëmë në shërbim të atdheut, të ndërtimit të socializmit e të komunizmit ndërkombëtar.

Ju, shokë e shoqe të Mallakastrës e të Fratarit, këto çështje i keni të qarta, se janë të zemrës suaj, siç janë të të gjithë popullit tonë, prandaj, si kurdoherë, të ecim përpara me guxim, të mobilizojmë të gjitha forcat për të realizuar planet dhe të zbatojmë në çdo rast e në çdo gjë politikën e drejtë të Partisë. Rindërtimi i shtëpive dhe i objekteve të tjera që na dëmtoi tërmeti, siç e thashë edhe më parë, është i sigurt dhe së shpejti e gjithë kjo që na ngjau do të mbetet vetëm një ëndërr e keqe, që me kalimin e kohës do të harrohet, se do të kalojë pa shumë dhimbje e vështirësi.

Me këtë rast ju uroj shëndet të gjithëve dhe në emër të Partisë, të Komitetit Qendror dhe në emrin tim, ju lutem shumë, u jepni të falat më të përzemërta gjithë vëllezërve e motrave, shokëve e shoqeve që nuk patën mundësi të vinin në këtë takim. U thoni atyre të mos dëshpërohen, por, si kurdoherë, të vazhdojnë me zell e hov revolucionar punën që kanë përpara, se Partia është me ta në çdo moment, ajo rron me ta, rron me popullin dhe për popullin. Qëllim tje-

tër, veç lumturisë së popullit, nuk ka Partia jonë.  
Prandaj, me këtë rast, le të brohorasim të gjithë:

Lavdi Partisë sonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Të rrojë populli i Mallakastrës!

Të rrojë populli i Fierit!

Lavdi heronjve të Luftës Nacionalçlirimtare!

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

**PËRPARA VULLNETIT TË POPULLIT TONË NUK  
MUND TË QËNDROJË ASNJË PENGESË DHE  
VËSHITIRËSI SADO E MADHE TË JETË**

*Nga fjala përpara popullit të Hekalit gjatë  
vizitës pas tërmetit të 3 prillit*

**6 prill 1969**

Të dashura motra dhe vëllezër të Hekalit,

Lajmi që krahina juaj dhe disa të tjera u dëmtuan nga tërmeti, na hidhëroi shumë, por në asnjë mënyrë nuk na ligështoi. Ne kemi përballuar tërmete më të rënda se ky, siç qe ai që na ndodhi parvjet në Peshkopi e në Librazhd dhe që na shkaktoi dëme më të mëdha. Me këtë dua të them se tani jemi në gjendje të përballojmë vështirësi shumë më të rënda, duke mos lënë të cenohen interesat e popullit, të socializmit e të Republikës. Kjo është një mrekulli që është arritur në sajë të dy faktorëve vendimtarë që ekzistojnë këtu te ne dhe që veprojnë në unitet: të popullit dhe të Partisë.

Nga ky tërmet pati një humbje, na u vra vetëm



një fëmijë. Familjes së tij Partia i shpreh ngushëlloimet më të përzemërta. Për sa u përket dëmtimeve materiale, ato do t'i vëmë në vend të gjitha dhe sa më parë. Ne po ndërtojmë tani vepra të mëdha, në të cilat investojmë miliona e miliarda lekë dhe para këtyre dëmtimet e tërmetit janë fare të vogla saqë ne nuk i ndiejmë. Pasojat e kësaj fatkeqësie do të likuidohen shpejt. Është mirë që s'patëm dëme të tjera në njerëz.

Ne kemi një popull të mrekullueshëm, heroik, kemi një Parti të çeliktë marksiste-leniniste, faktorë këta që, duke vepruar së toku, në unitet, nëpër luftëra dhe në përpjekje të ndryshme, kanë krijuar mundësi të mëdha për të përballuar çdo vështirësi e çdo rrezik. Kur them luftëra e përpjekje nuk kam parasysh vetëm luftërat me armë, por edhe ato pa armë, pra situata si kjo e tanishmja që, edhe pse s'ka luftë, armët i mbajmë ditë e natë pranë dhe barutin kurdoherë të thatë.

Tridhjetë vjet më parë, kur Italia fashiste pushtoi vendin tonë, ne morëm parasysh humbjet që do të kishim në njerëz dhe në pasuri, nuk u përkulëm, por luftuam burrisht, megjithëse hoqëm të zita e ullirit. Kur u themelua, Partia i tha popullit: Më mirë të vdesim në këmbë, sesa të rrojmë në gjunjë, të robëruar, nën çizmen e armiqve të huaj dhe të bejlerëve e të agallarëve të shitur kokë e këmbë te pushtuesit. Ato ishin kohë të vështira, por vendimtare për fatet e vendit tonë, motra e vëllezër. Pikërisht në ato çaste u tregua zotësia e madhe e popullit shqiptar, nga gjiri i të cilit doli Partia Komuniste, që vuri në programin e vet

qëllimet dhe aspiratat e tij më të larta. Këto qëllime Partia do t'i realizonte në rrugën që na treguan Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Përpjekjet që do të bëjë populli, duke ndjekur këtë rrugë, tha Partia atëherë, nuk do të shkojnë kot, se pas Çlirimit ai do të vijë në fuqi dhe kur të marrë vetë pushtetin në dorë, do të realizohen ato mrekulli që parashikuan, në kohën e tyre, klasikët e marksizëm-leninizmit: Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Dhe me të vërtetë kështu po ndodh në vendin tonë.

Ju, të dashur vëllezër e motra të Hekalit dhe të gjithë Mallakastrës, ashtu si i gjithë populli ynë liridashës, keni qenë në ballë të luftës. Për lirinë e atdheut kanë dhënë gjakun bijtë dhe bijat më të mira të krahinës suaj. Partia, populli, i gjithë atdheu, kurrë nuk e harrojnë këtë. Partia e vlerëson luftën tuaj, sepse në heroizmat e djemve dhe të vajzave të Mallakastrës, ashtu si në heroizmat dhe në sakrificat e të gjithë popullit shqiptar, gjejmë burimin e forcës që na kalit, që na bën vigjilentë dhe që na mëson të ecim kurdoherë përpara në rrugën e Partisë.

Nga fshati juaj kanë dalë heronj të lavdishëm si Dervish Hekali e Rrapo Hekali. Nga Mallakastra juaj dhe e gjithë Shqipërisë, nga ky vend e nga ky popull kanë dalë trima, por edhe sot del një rini e pastër, e kulluar, e vendosur në vijën e Partisë, në rrugën e princërve, të vëllezërve e të motrave të tyre që bënë Luftën e madhe Nacionalçlirimtare. Kjo rini është e ardhmja e Partisë dhe nuk punon e nuk lufton për një ditë, për 10 e për 100 vjet, po për shekuj, për komunizmin.

Nga gjiri juaj, nga gjiri i klasës punëtore, i fsha-

tarësisë dhe i inteligjencies sonë popullore vijnë në Parti të atillë njerëz, të cilët i përtëritin dhe i zhvillojnë akoma më tej virtytet e larta të popullit për mbrojtjen e interesave të atdheut. Partia jonë ka bërë e po bën një punë të madhe për t'i ruajtur dhe për t'i ngritur në një shkallë shumë më të lartë traditat e lavdishme të popullit tonë. Ajo lufton që jeta e njerëzve tanë të bëhet çdo ditë e më e bukur, që mirëqenia e tyre të ngrihet nga çdo pikëpamje, që Republika jonë Popullore të mbetet e pamposhtur, të ndërtojë plotësisht socializmin, të kalojë në shoqërinë komuniste dhe, njëkohësisht, të ndihmojë me të gjitha forcat revolucionin botëror.

Kudo në Shqipëri sot ka një hov të madh revolucionar, të paparë ndonjëherë. Të gjithë, i madh e i vogël, të frymëzuar nga vija e drejtë e Partisë, janë hedhur në sulm në çdo drejtim për të realizuar detyrat në të gjitha frontet: në industri, në bujqësi, në arsim, në kulturë etj., për të zhvilluar luftën e klasave, luftën kundër mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve, për të punuar për emancipimin e plotë të gruas, për ngritjen e saj në përgjegjësi etj., etj. Të gjitha këto dhe shtruarja në këtë mënyrë e problemeve rrodhën nga vetë karakteri i Luftës Nacionalçlirimtare, që udhëhoqi Partia, e cila zbatoi në rrugë të drejtë teorinë marksiste-leniniste në kushtet e vendit tonë. Kjo i jep një siguri të plotë përparimit të vendit tonë në industri, në bujqësi, në arsim e në kulturë, garanton mbrojtjen e atdheut, të Republikës Popullore të Shqipërisë.

Me punën e saj të palodhur, Partia e ka ngritur

ndërgjegjen e njerëzve në një shkallë të atillë saqë vija e saj marksiste-leniniste është bërë mishi dhe gjaku i popullit. Kjo është një nga fitoret tona më të mëdha. Si të gjithë, edhe ju, motra dhe vëllezër, jo vetëm i kuptoni drejt direktivat e Partisë, por edhe i ndieni e i zbatoni ato me gjithë zemër, se janë për të mirën e të gjithëve. Për atë që i kupton, i ndien dhe i zbaton me zemër këto direktiva nuk ka vështirësi të pakapërcyeshme. Përpara këtij vullneti të paepur të popullit shqiptar, që për nga forca i ngjan një vullkani, nuk mund të qëndrojë asnjë pengesë dhe vështirësi, sado e madhe të jetë ajo. Këtë forcë të madhe revolucionare të popullit tonë kanë arritur ta kuptojnë jo vetëm miqtë, por edhe armiqtë. Vërtet armiqtë janë të shumtë, por atyre u duhet, siç thotë populli, të masin tetëmbëdhjetë herë, pa të presin një herë, në rast se do të mendojnë të futen në ndonjë aventurë kundër Shqipërisë.

Ju e dini se para Çlirimit të huajt na merrnin nëpër këmbë, po kjo ndodhte se atëherë ishim të robëruar, të shtypur, të varfër se na mungonte një parti marksiste-leniniste. Tash kohët kanë ndryshuar. Në qoftë se forcat imperialiste do të marrin guximin të na sulmojnë, ato me siguri do të dështojnë se popullin tonë do ta gjejnë kurdoherë gati me gishtin në këmbëz e me syrin në shënjestër. Në qoftë se revizionistët sovjetikë dhe vasalët e tyre të Traktatit të Varshavës do të provojnë, gjithashtu, të na godasin, edhe ata do të zbrapsen, por edhe në arrifshin, ata shpejt do të likuidohen. I themi këto të bindur se i kemi bërë mirë llogaritë.

Llogaria jonë e sigurt për mbrojtjen e atdheut janë vija e drejtë e Partisë dhe populli. Në bazë të kësaj vije të drejtë, Partia dhe populli, së bashku, të lidhur ngushtë, si mishi me thoin ndërmjet tyre, kuptojnë problemet në nivel të lartë politik dhe ideologjik dhe mbajnë vigjilencën kurdoherë të mprehur në shkallën më të lartë. Partia dhe Qeveria e kanë armatosur popullin si duhet, prandaj po të na sulmojnë armiqtë imperialistë, fashistët revizionistë sovjetikë apo kushdo tjetër qoftë, që udhëhiqen nga një ideologji antipopullore, skllavëruese, të gjithë do të gjejnë vdekjen përpara trimërisë, heroizmit, shpirtit dhe aftësisë luftarake të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia.

Tash, sikundër e dini, imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik janë në aleancë midis tyre. Dhe s'mund të ndodhë ndryshe, mbasi të dyja palët i kërcënon «rreziku i komunizmit». Në luftë kundër tyre, me ne sot është gjithë proletariati botëror, janë popujt përparimtarë, të cilët përpiqen të thyejnë zinxhirët e robërisë kapitaliste dhe revizioniste, janë komunistët revolucionarë, të cilët po organizohen në parti të reja të vërteta marksiste-leniniste dhe që luftojnë dita-ditës edhe kundër kapitalistëve të vendeve të tyre. Kundër imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik dhe revizionistëve kudo që janë, në luftë të papajtueshme me ta, është Shqipëria socialiste dhe Partia e saj e Punës. Sot zhvillohet një luftë e madhe dhe e hapët midis proletariatit e popujve përparimtarë, nga njëra anë, dhe kapitalistëve e revizionistëve, me imperializmin amerikan dhe revizionistët sovjetikë në krye, nga ana tjetër. Në këtë luftë epërsinë e kemi ne dhe e

ardhmja është me proletariatin, me popujt, me komunistët.

Për sa u përket armëve, në qoftë se i vëmë këto në balancë, do të dalë se armiqtë tanë kanë disa lloje armësh moderne, por ata nuk kanë atë që duhet për t'i shkrepur këto armë, njeriun e ndërgjegjshëm, nuk kanë atë armë të pamposhtur në shekuj që ka Shqipëria: popullin, partinë, vendosmërinë dhe shpirtin luftarak. Ata pastaj kanë frikë, e dinë që popullin nuk e kanë me vete dhe që nuk mund ta çojnë lehtë në luftë kundër popujve të tjerë. Edhe sikur ta detyrojnë e ta hedhin në një luftë të tillë të padrejtë, kjo do të ishte e përkohshme, popujt e tyre shpejt do t'i kuptojnë të vërtetën dhe qëllimet skllavëruese të kësaj lufte, prandaj nga çdo anë që ta shohësh problemin del se armiqtë do të munden. Në rast lufte, ata me siguri do të pësojnë disfata nga rezistenca jonë dhe nga morali i tyre i dobët.

Në këto situata na vihet detyrë, në radhë të parë, të jemi vigjilentë, të punojmë dhe njëkohësisht të bëjmë përpjekje për të mësuar artin ushtarak, që, me ç'shoh, këtë çështje ju e keni merak vetë. Direktivat që jep Partia në fushën e mbrojtjes, si, për shembull, për të mësuar e për të njohur në një shkallë më të lartë armët, taktikën, strategjinë etj., të bëni përpjekje për t'i studiuar me kujdes. Si ju, ashtu edhe shokët oficerë që ju mësojnë, të hapni sytë mirë në këto çështje, sepse një plumb yni, ose të zënit e një pozicioni të mirë, të pakapshëm, vlejnë sa njëqind të shtëna të armiqve. Pra shtrohet çështja që artin ushtarak, strategjinë e taktikën ushtarake ne t'i mësojmë në më-

nyrë të tillë, që edhe në qoftë se epërsinë në armë e në njerëz do ta ketë armiku, të jemi në gjendje ta thyejmë. Kjo është arsyeja që mësimin ushtarak po e futim tani nëpër shkolla, ku djemtë dhe vajzat tona, krahas lëndëve të tjera, në mënyrë të organizuar e shkencore, të mësojnë edhe artin ushtarak, artin e mbrojtjes dhe të sulmit, në atë nivel që kërkojnë Partia dhe populli.

Ne përpara nuk kishim ku ta mësonim artin ushtarak, por kur kërcënohej atdheu, merrnim krahut ndonjë dogra<sup>1</sup>, që e kishte ruajtur fshehurazi nëna apo babai, dhe ashtu si ishte, e rregullonim e dilnim në çeta. Kështu vepruam ne gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, e cila është një eksperiencë e madhe dhe e lavdishme popullore, e bazuar në të gjitha luftërat e popullit tonë për liri e pavarësi. Ai që e nënvleftëson këtë jo vetëm e ka gabim, po edhe e humbet luftën. Eksperiencën e luftës së të parëve tanë ne e zbatuam në një formë akoma më të lartë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Në qoftë se do të detyrohemi të bëjmë një luftë tjetër, përveç betejave që do të zhvillojë në front të rregullt ushtria jonë, ne do të shfrytëzojmë edhe eksperiencën e luftës partizane, që do të organizohet në një shkallë jashtëzakonisht të tmerrshme për armikun. Në këtë drejtim ne duhet t'i përgatitim që gjatë shkollës të rinjtë tanë, në mënyrë që secili, kur të ketë mbaruar shkollën jo vetëm të jetë i aftë aq sa edhe ushtari i sotëm që përgatitet për dy ose tre vjet rresht gjatë shërbimit në ushtri, por bile edhe më i zoti.

---

1 Pushkë e vjetër me lloz e me një fishek.

Kështu, pasi të kryejnë këtë shërbim djemtë dhe vajzat tona do ta kenë njohur artin ushtarak jo më si ushtarët e thjeshtë, po si oficerë. Pra ashtu si po ecim tani drejt kualifikimit në masë të njerëzve në fabrika, në ara e kudo në profesione të ndryshme, ashtu duhet të punojmë për kualifikimin e njerëzve edhe në çështjet ushtarake.

Në fabrika e në ara punojnë djemtë dhe vajzat tona. Në fillim ata mësojnë gjëra të thjeshta, por, duke punuar, bëhen specialistë të kategorive të larta. Numri i këtyre punëtorëve ose i kooperativistëve që kanë përparuar nuk është më i kufizuar si më parë, por janë me qindra, me mijëra e me dhjetëramijë djemtë e vajzat që janë sot oficerë, inxhinierë në fabrika, që punojnë në frontin e bujqësisë, të ndërtimit e të çdo sektori tjetër. Po të mos kesh disa inxhinierë, teknikë e specialistë në një fabrikë ose kombinat, puna nuk mund të shkojë mirë, sepse janë punëtorët dhe specialistët, pra janë njerëzit ata që i vënë në punë, i drejtojnë makineritë. Kështu qëndron çështja edhe në ushtri. Kështu, duke u edukuar e duke u specializuar që në moshë të re, me një art ushtarak modern të kualifikuar, nga të rinjtë që mbarojnë shërbimin ushtarak dalin oficerë të zotë. Sa më shumë kuadro të tillë të nxjerrim, aq më të mirë dhe aq më të fortë do ta bëjmë Shqipërinë, atdheun tonë.

Gjatë viteve të Luftës Nacionalçlirimtare, kur ngrinim çetat, prej të cilave dalngadalë u kalua në formacione më të mëdha, në krye të tyre ne zgjidhnim komandant e komisar nga shokët më të mirë, të cilët nuk ishin të përgatitur për këto detyra të rëndë-



sishme të mbrojtjes së atdheut, por që u përgatitën në luftë e sipër bashkë me shokët. Tani do të ketë përsëri nga një komandant e komisar në çdo formacion, por ama të gjithë këta do t'i kemi të përgatitur për këto detyra me përgjegjësi. Kështu, kur këta të bëjnë planin si ta rrethojnë dhe ta asgjësojnë armikun në rast lufte, ky plan do t'u bëhet i ditur edhe ushtarëve, të cilët do të japin mendimet dhe vërejtjet e tyre. Një plan i tillë do të jetë i plotë dhe i sigurt, fryt i mendimit të një kolektivi të tërë të kualifikuar. Do të ndodhë, ashtu siç ndodh sot në fabrika që, kur inxhinierët japin udhëzime për të prodhuar diçka të re, punëtorët, duke qenë të mësuar, i kuptojnë mirë udhëzimet teknike dhe janë në gjendje ta nxjerrin si duhet prodhimin e ri ose të ndërtojnë gjëra të reja të ndërlikuara. Në këtë rrugë po ecim ne në të gjitha drejtimet, edhe në ushtri.

Në bujqësi, gjithashtu, nuk mjafton të kenë njohuri shkencore vetëm një ose dy veta, po duhet të dinë të gjithë, bile edhe ai fshatari që bën punën më të thjeshtë, se dhe ai, nëpërmjet mësimeve, nëpërmjet eksperiencës, nëpërmjet punës së përbashkët, nëpërmjet leximit të gazetës etj., duhet të bëhet specialist në punën e tij. Kur thotë Partia të luftojmë që të ngremë rendimentet në qumësht, mish, lesh, grurë, pambuk, ullinj etj., etj., është kërkesë e domosdoshme që në këto vende të kemi njerëz me kokën plot, që ta dinë zanatin në majë të gishtave. Dihet se sot të gjithë punonjësit e bujqësisë nuk janë me shkollë, prandaj ata duhet të mësojnë. Të mësojnë edhe për pemëtarinë dhe veçanërisht për ullinjë, që kaq shumë bëhen këtu

te ju në Mallakastër. Pra është një shkencë e tërë që duhet ta mësojmë. Kur ta ngremë më lart nivelin e punonjësve tanë të bujqësisë, të shikojmë atëherë ç'rendimente do të marrim në të gjitha prodhimet dhe sa do të ngrihen ato.

Në tokën tonë ka pasuri të mëdha, të cilat ne vetë duhet t'i shfrytëzojmë, vetë duhet t'ia marrim tokës dhe t'ia japim popullit. Këtë synojnë lufta dhe përpjekjet e Partisë dhe të Qeverisë sonë, ta bëjnë popullin të aftë të drejtojë, t'i kuptojë drejt dhe sa më shpejt çështjet, t'i zbatojë dhe të prodhojë sa më shumë për të mirën dhe për lumturinë e tij. Vetëm kështu vjen bollëku dhe mirëqenia për të gjithë dhe ndërtohet shoqëria komuniste.

Krahas këtyre, të dashur vëllezër dhe motra, Partia synon dhe lufton që zemra e njerëzve të jetë e pastër, ajo lufton për drejtësinë, për vëllazërinë, me qëllim që midis njerëzve të ekzistojë dashuria, të zhduken cmira, mosbesimi, gënjeshtret e thashethemet, që janë mbeturina të trashëguara në ndërgjegjen e njerëzve nga e kaluara, nga ideologjia e klasave shfrytëzuese, e armiqve të popullit. Njerëzit lindin me cilësi të mira, por feja, kisha, teqeja, feudalët, kapitalistët, që skllavëronin popujt për interesat e tyre, krijuan, gjatë shekujve, gjithfarë ideologjish, përdorën lloj-lloj mjetesh e thurën intriga për të mburrur në ndërgjegjen e njerëzve sa më shumë ligësi. Sipas pikëpamjes komuniste këto plagë zhduken, njerëzit edukohen. Le t'i mbajmë kalamanët të pastër, ja si këta që kam këtu përpara. Këta janë të gjithë si lule të freskëta, të pastër, në sytë e tyre të bukur e sheh çdo gjë të kthjellët e pa njolla,

prandaj të kujdesemi që t'i rritim si duhet që gjithmonë të mbeten të tillë. Kjo i bie për detyrë, në radhë të parë, gjithë shoqërisë, por jo më pak përgjegjësi për edukimin e fëmijëve, u takon nënave, baballarëve, vëllezërve dhe motrave, pra, familjes, në radhë të parë, dhe pastaj tërë shoqërisë.

Në këtë drejtim nëna, sidomos, ndikon shumë, prandaj Partia na mëson që nënën, gruan shqiptare, ta duam, ta respektojmë, ta mësojmë dhe ta ndihmojmë me gjithë shpirt të ecë përpara. Gruaja, që ka qenë e shtypur në shekuj, luan një rol shumë të madh në shoqërinë tonë socialiste. Ky rol është i pallogaritshëm, se ajo përbën gjysmën e shoqërisë, gjysmën e asaj mase që jeton, punon, mendon, lufton dhe krijon. Pastaj gruaja ka edhe funksionin jetik që krijon njeriun, prandaj të gjitha vështirësitë dhe pengesat që kanë ekzistuar për gruan, për nënën, për motrën, për vajzën, në sistemet e kaluara shoqërore ne sot duhet t'i luftojmë me rreptësinë më të madhe. Është e qartë se këto gjëra nuk luftohen me një ditë, as me një vit, as me dy apo me katër vjet, por në rrugën e sigurt që ndjek Partia jonë, ato do të zhduken gradualisht.

Emancipimin e gruas Partia nuk e bën me dekrete e urdhra, as me dënime e gjyqë, por me punë të pandërprerë politike dhe ideologjike. Ajo në radhë të parë u shpjegon njerëzve dhe i bind ata për drejtësinë e kësaj çështjeje. Vetëm në këtë rrugë është i sigurt zbatimi i direktivave të Partisë.

Për sa po bën Partia jonë në fushën e revolucionarizimit të jetës së njerëzve, na vijnë telegrame përshëndetjeje nga miqtë e shokët. nga të katër anët e

botës, të cilët kërkojnë të mësojnë nga eksperiencia që kemi fituar ne në këtë drejtim.

Por ka njerëz, të cilët nuk i kuptojnë ose i kuptojnë në mënyrë gjysmake këto probleme. Detyra jonë është të punojmë me durim të madh dhe t'i bëjmë të gjithë t'i kuptojnë drejt. Të përpiqemi t'i bindim njerëzit tanë, sidomos të kaluarit në moshë, duke vepruar me ta me kujdes dhe duke i respektuar kurdoherë. Nga ana tjetër, të mos lejojmë kurrsesi që ata me mbeturinat e tyre të fesë, ose me pikëpamjet e prapambetura që kanë, të ndikojnë për keq te brezi i ri. Ne duhet të kuptojmë se këto mbeturina nuk mund të zhduken menjëherë aq më tepër te të vjetrit, por, në të njëjtën kohë, kundër mbeturinave të bëjmë luftë të pandërprerë e të organizuar mirë. Të bëjmë luftë të ashpër e të vendosur, sidomos, kundër pikëpamjeve fetare që kanë helmuar në shekuj gjithë njerëzimin.

Mjerime të mëdha i kanë ardhur dhe vazhdojnë t'i vijnë njerëzimit nga feja. Kudo në botë sot thonë se Shqipëria është i vetmi vend jofetar, ku nuk ekziston as fe, as kishë e as xhami. Njerëzit e Vatikanit bërtasin: «Ç'po bëhet kështu në këtë vend, do të lejojmë që në Shqipëri të mos ketë më kisha e xhami?». Dashkan a s'dashkan priftërinjtë e Vatikanit, Shqipëria ecën përpara në rrugën e drejtë që i tregon Partia. Ne u përgjigjemi gjithë reaksionarëve fetarë dhe jofetarë me shprehjen popullore: «Hipni këtu të shikoni Stambollin!».

Rruga që ndjek Partia jonë është e drejtë, prandaj ekziston një unitet dhe dashuri e madhe midis popullit dhe Partisë. Po të ishte ndryshe vija e Partisë,

populli do të shprehte pakënaqësi. Kushdo që shkon kundër logjikës së drejtë të popullit, ai mbaron, sepse me detyrim nuk udhëheq dot për shumë kohë.

Vija që ka ndjekur Partia jonë në të gjitha drejtimet është e drejtë. Për këtë arsye populli e do aq shumë Partinë dhe është i lidhur ngushtë me të. Partia porosit vazhdimisht, dita ditës, që secili t'i thotë asaj çdo gjë, pa druajtje, si të mirat, dhe gabimet që bën. Në rast se ndonjëri nuk e thotë hapur kur sheh gabime të shokët drejtues ose të cilido komunist, kjo do të ishte shumë e dëmshme, sepse çështja e Partisë nuk është çështje e një personi, por e gjithë popullit. Partia është në udhëheqje të popullit. Ne komunistët që na kanë zgjedhur në udhëheqje, në Komitetin Qendror, jemi njëloj si të gjithë, ushtarë të Partisë. Në qoftë se ne udhëheqësit bëjmë gabime, rrezikojmë në këtë mënyrë çështjen e madhe të popullit. A mund dhe a duhet të lejoni ju që një, ose disa njerëz të rrezikojnë gjakun, djersën dhe luftën e popullit? Në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet ta lejoni!

Prandaj Partia kërkon që cilitdo, për gabimet që bën, t'i flitet hapur. Populli jo vetëm t'i njohë e t'i dijë ato, po edhe t'i jepet mundësia të shprehë lirisht mendimet, të diskutojë nëse është i drejtë apo jo një veprim, në punon apo s'punon mirë njëri apo tjetri. Që kjo punë të bëhet ashtu si dëshiron Partia, është e domosdoshme që në këtë drejtim të ndihmojnë jo vetëm komunistët, por gjithë vëllezërit e shokët e paorganizuar në Parti rreth e rrotull tyre. Kur një mik, apo shok të thotë një të vërtetë dhe ti e sheh se është e drejtë, duhet të mendosh që ai të do me gjithë zemër.

Ne duhet t'i edukojmë të gjithë njerëzit që të vërtetën, të drejtën, ta shprehin haptazi dhe me guxim. Dhe kur populli mësohet të thotë të vërtetën në sy, të arsyetojë drejt për sjelljet dhe për veprimet e cilitdo dhe t'i shprehë hapur mendimet, kjo është një gjë shumë e mirë. Asnjëri nuk duhet të bëhet skllav i një mendimi të parrahur mirë, aq më keq të kërkojë që të tjerët, jashtë bindjes së tyre, të pranojnë mendimin e tij vetëm për faktin se ai është përgjegjës, ose pse ka një pozitë. Një koncept i tillë është i dëmshëm, ai ia rrit mendjen njeriut me përgjegjësi dhe e shkëput atë nga masat.

Kur të arrijmë që të gjithë t'i kuptojnë e t'i zbatojnë drejt këto mësimet të Partisë, atëherë shoqëria jonë socialiste do të përgatitet për në komunizëm, do të kalojë në fazën ku çdo anëtar i shoqërisë, gjatë shpërndarjes së të mirave materiale të marrë jo më shumë nga sa i duhen, po sipas nevojave. Gjer në atë kohë Partia do të ketë punuar që te punonjësit të zhvillohet një ndërgjegje aq e pastër dhe e lartë, nga e cila do të jetë zhdukur çdo mbeturinë mikroborgjeze, apo lakmi që tani shfaqet akoma në ndërgjegjen e tyre. Në shoqërinë komuniste, ku do të ketë bollëk, konceptet e njerëzve nuk do të jenë ato të sotmet. Për të arritur këtë synim të lartë punon dhe lufton Partia, të ngrejë ekonominë, bujqësinë, industrinë e, në radhë të parë, ndërgjegjen e njerëzve, sepse janë këta që krijojnë, prodhojnë e ndërtojnë çdo gjë.

Partia përpiqet vazhdimisht që njerëzit të punojnë me ndërgjegje të lartë revolucionare. Pikërisht për këtë arsye na luftojnë armiqtë kapitalistë, revizionistë

e të tjerë dhe bëjnë ç'është e mundur që revolucionarët kudo në botë, të mos arrijnë ta zhvillojnë në shkallë të lartë ndërgjegjen e tyre, sepse atëherë mbaroi kapitalizmi, do të shembet. Do të vijë koha kur secili do ta ndiejë vetë nevojën e punës e të shkollës, pa i folur njeri për rëndësinë e tyre. Kushdo në shoqërinë komuniste do të punojë se puna atëherë do të bëhet për njeriun nevojë e domosdoshme, fiziologjike, pa të cilën ai s'mund të jetojë.

Në këtë rrugë do të ecim ne, motra dhe vëllezër, duke pasur bindje të plotë në fitoren tonë. Këtë bindje e kemi se na udhëheq Partia jonë marksiste-leniniste, e çeliktë, e drejtë, se kemi një klasë punëtore, që tash është e formuar dhe shkon duke u kalitur e duke u shtuar vazhdimisht, kemi një fshatarësi kooperativiste revolucionare dhe shumë patriote, që e ndjek dhe e zbaton me besnikëri e këmbëngulje të madhe vijën e drejtë të Partisë jo vetëm për sa u përket zhvillimit dhe transformimit të bujqësisë, por sidomos të ndërgjegjes së vet. Ne shohim se punët në vendin tonë kanë marrë një zhvillim të paparë, gjë që edhe vetë ne, drejtuesve të punës së Partisë, që pak a shumë, si me thënë, i planifikojmë këto zhvillime, na mahnit. Po shikojmë se parashikimet tona në këtë drejtim, planet e vendimet që marrim gjenden shumë herë prapa hovit të popullit, i cili avancon me vrull, i kapërcen këto parashikime, ecën më përpara, prandaj na duhet të marrim medoemos masa të tilla që këto dëshira e këtë vullnet tërë flakë e zjarr ta shfrytëzojmë kurdoherë në të mirën e tij, të të gjithë vendit tonë.

Ky hov i madh e ka burimin në forcën e vijës së

drejtë të Partisë, të kësaj Partie që u brumos e u kalit me gjakun e heronjve, me sakrificat e panumërta të popullit tonë. Traditat patriotike të gjyshërve e të stërgjyshërve tanë, të cilët kanë luftuar e kanë kalitur me radhë brezat pasardhës e që u pasuruan akoma më shumë me traditat luftarake të popullit tonë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ne po i çojmë më tej. Në këtë drejtim Partia jonë gjen një terren të favorshëm për ta ngritur, me punën e saj, në një nivel shumë më të lartë patriotizmin e popullit. Shikoni ç'patriotizëm i flaktë ekziston tani te masat punonjëse të vendit tonë. S'arrin të bëjë thirrje Partia, se të tërë ngrihen në këmbë.

I njëjti vrull vihet re në të katër anët e atdheut dhe për të gjitha çështjet: për arsimin, kulturën, shëndetësinë etj. Në çdo fshat ne kemi tani shkollë fillore. Arsimi tetëvjeçar është bërë i përgjithshëm. Po vendit tonë s'i mjaftojnë vetëm shkollat fillore e tetëvjeçare. Sa vjen e rriten kërkesat edhe për shkollat e mesme dhe të larta. Dhe dyert e universitetit, të shkollave të tjera të mesme e të larta, të arsimit të përgjithshëm e teknik, si dhe të kurseve të ndryshme janë të hapura për bijtë e për bijat e popullit.

Ne po ndërtojmë një program të tillë për shkollën tonë të re që t'i përshtatet sa më mirë zhvillimit të vendit. Në vendet ku sundojnë revizionistët, si në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera, në fushën e arsimit e kanë ndërruar fare vijën, bile kanë ndryshuar edhe atë sistem arsimor që morëm ne si eksperiencë pozitive. Kjo vjen ngaqë revizionistët modernë e kanë



tradhtuar përfundimisht marksizëm-leninizmin. Me reformën arsimore që po bëjmë në shkollën tonë parashikojmë të përfshijmë gjithë popullin. Nuk do të shkojë shumë kohë dhe kjo do të duket si diçka krejt e natyrshme, si nevojë e jo si barrë e rëndë prej së cilës njeriu të fshijë djersët nga zori. Secili, edhe nga ju, do të vejë në shkollë, po çfarë do të mësojë atje? Ai do të mësojë, për shembull, si duhet të kultivohen ulliri, pambuku etj., pra do të mësojë për ato çështje që i nevojiten në jetë, në punën e përditshme. Kjo asnjëriut nuk do t'i duket e rëndë dhe e panevojshme, por domosdoshmëri. Po të jesh brigadiere e parcelave të ullinjve, do ta ndiesh patjetër nevojën për të shkuar në shkollë, sepse të duhet të mësosh për mbjelljen, për shërbimet që duhet t'i bësh për të arritur prodhime të bollshme. Gjithë procesi i punës në këtë drejtim do të jetë i lidhur dhe i kurdisur si një orë, veglat e së cilës janë të vajisura dhe punojnë në mënyrë harmonike. Këtë vetëm vija e drejtë e Partisë sonë e siguron.

Ju, të dashur shokë dhe shoqe të Hekalit, keni mundësi të mëdha për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Organizoheni mirë këtë punë dhe ndihmat që merrni nga shteti, nëpërmjet mekanizimit, kredive për ujitje etj., i shfrytëzoni në maksimum. Unë po ju them që si juve, ashtu edhe gjithë fshatarësisë sonë nuk do t'u mungojë ndihma e Partisë për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë. Ju përpiquni që këtë ndihmë ta shfrytëzoni më së miri. Kjo arrihet me punë, me mësim, me organizim e me disiplinë të fortë e të ndërjegjshme. Në qoftë se këto i keni parasysht në çdo moment, do të arrini rezultate të mëdha.

Këtu në krahinën e Mallakastrës ju keni ndërtuar kanale ujitëse dhe keni në plan të hapni e të ndërtoni të tjera. Partia dhe Qeveria do t'ju ndihmojnë në këtë drejtim. Po ta organizoni punën si duhet, të jeni të bindur që për tre-katër vjet edhe në Hekal keni për të pasur ujë. Që t'i arrihet më shpejt këtij qëllimi, kjo varet nga ju. Në qoftë se bëni përpjekje të merrni rendimente akoma më të larta në ullinj, në grurë, në misër, në qumësht etj., ky objektiv mund të arrihet jo në tre vjet, po edhe në dy vjet, apo në një vit. Për këtë duhet që gjithë fshatarësia jonë kooperativiste të përpiqet t'i krijojë mundësi të atilla shtetit, që ky të mund të sjellë më shumë mjete për të hapur kanale, për të sjellë tubacione përpara kohës së planifikuar etj. Mundësitë e shtetit tani janë të shumta, po ne duhet t'i zbulojmë e t'i vëmë në dorën tonë të gjitha. Të punojmë me të gjitha forcat për t'i kapërcyer kufijtë që kemi caktuar, me qëllim që të shpejtojmë si realizimin e planeve në çdo sektor tjetër, ashtu edhe sjelljen e ujit, se atëherë gjithë fusha jua do të bëhet kopsht me lule. Ujitja ka rëndësi të madhe për bujqësinë, prandaj punoni për të se edhe shteti do t'ju ndihmojë. Me kushtet e favorshme që po na krijohen, planct që kemi parashikuar mund edhe të lëvizin, dua të them se mund t'i shtojmë ca investimet. Të gjitha perspektivat që ju hap Partia, t'i shikoni me kujdes, për të mirën e kooperativës suaj, po sigurisht në kuadrin e interesit të përgjithshëm të të gjithë shoqërisë sonë socialiste.

Ndjeva kënaqësi kur pashë tokat e reja që keni hapur dhe mendoj se në këtë drejtim keni punuar

bukur. Edhe grurin e keni të mirë këtë vit. Tani ju mbetet të bëni një punë të madhe për të shtuar sipërfaqet e ujitshme. Frytet e punës suaj do t'i gëzojnë brezat që vijnë. Ne po punojmë që t'ua përgatitim jetën për ta bërë atë çdo ditë e më të mirë.

Megjithatë, pa pritur ardhjen e ujit, pra qysh sivjet, ju keni mundësi të mëdha t'i ngrini rendimentet, sepse vërtet keni pak tokë, por e keni të mirë. Prandaj, po të zbatoni një agroteknikë të përparuar, t'u bëni shërbimet e duhura të gjitha bimëve, të mbillni e të tëharrni në kohë, të përdorni farëra të zgjedhura, të mbani e të ushqeni si duhet bagëtitë e imëta dhe të trasha, duke shkuar çdo vit drejt përmirësimit të racës së tyre që të merrni prodhime të larta, atëherë edhe në kooperativën tuaj bujqësia dhe blegtoria do të zhvillohen e do të përparojnë më tej, do të ngrihen në një nivel më të lartë. Në qoftë se do të zgjeroni fidanishtet e pemëve frutore, duke treguar njëkohësisht kujdes për ato që na kanë lënë trashëgim të parët, rezultatet do të jenë të kënaqshme edhe në këtë drejtim.

Ne pamë këtu te ju se ullinjtë i keni punuar mirë, gati njëlloj si në Ndërmarrjen Bujqësore të Vlorës. Ju lumtë, shoqe dhe shokë të Hekalit, por ato shërbime që u bëni ju ullinjve, duhen bërë në tërë krahinën tuaj, Mallakastrën. Në emrin tim u thoni mallakastroëve të vijnë e të marrin shembull në Hekal. Veçse nga kjo punë e mirë që keni bërë me ullinjtë, të mos ju rritet mendja, motra dhe vëllëzër, se keni akoma shumë për të bërë për mbjelljen e pemëve të tjera frutore e të drurëve për blerimin e këtyre anëve jo vetëm për

bukuri, por sidomos për prodhimet që do të merrni prej tyre. Kini kujdes që vjeljen e ullinjve të mos e bëni duke i shkundur me shkopinj, se kështu drurët dëmtohen, por të përdorni mënyra të tjera më të mira, që janë krijuar nga mendja e popullit.

Me zhvillimin e industrisë së naftës në këto anë, ju do të keni një favor të madh. Nafta është një pasuri e vlefshme për gjithë shoqërinë tonë, prandaj del detyrë që shumë nga djemtë tuaj të bëhen naftëtarë. Kjo do t'ju japë juve mundësi të shtoni të ardhurat. Por, që një pjesë e djemve tuaj të shkojnë të punojnë në sektorin e naftës, duhet të ngrihen me shpejtësi niveli i mekanizimit të bujqësisë dhe niveli agroteknik i anëtarëve të kooperativës, se kështu do të mund të zëvendësohet puna e atyre që do të largohen nga bujqësia për të punuar në sektorin e naftës. Për këtë do t'ju ndihmojnë Partia dhe pushteti, që janë tuajt. Ata tani po hartojnë plane të reja për veprat e tjera që do të ndërtojmë në të ardhmen për popullin.

Ju këtu në Mallakastër keni favorin që industria me bujqësinë janë të pleksura. Industria është kryesorja, atje punon klasa punëtore, e cila do të vazhdojë të punojë në sektorin e naftës dhe do të shtohet në numër, se atje do të shkojnë të punojnë shumë si ju. Gjatë punës këta do të kaliten me frymën proletare të klasesë punëtore, kështu që fabrikat, makineritë e çdo pasuri tjetër do t'i konsiderojnë si pronë të përbashkët shoqërore dhe do t'i ruajnë si sytë e ballit.

Në përgjithësi fshati në gjithë vendin tonë ka arritur rezultate madhështore, por duhet të bëjmë akoma një luftë të madhe që fryma e klasesë punëtore të

hyjë shumë më shpejt, si kudo edhe këtu te ju në Mallakastër. Ata djem që do të venë të punojnë në sektorin e naftës, do të sjellin në familjet e tyre kooperativiste përparimin, disiplinën proletare në punë, se edhe në nxjerrjen e naftës, si kudo ku punon klasa punëtore, ka disiplinë të fortë. Naftëtari punon tetë orë, ai e ka të llogaritur kohën e punës në mënyrë matematike. Kështu punon dhe e shfrytëzon kohën e punës klasa punëtore, kështu edukohet ajo me disiplinë të fortë. Prandaj, kur t'ju vijnë në shtëpi djemtë që do të punojnë si naftëtarë, ata do t'i thonë babait, vëllait, nënës ose motrës: «Ç'po bëni kështu ju këtu, pse s'punoni si duhet në arë. Nuk është i drejtë qëndrimi që mbani ndaj punës. Kështu si veproni ju, hani në kurriz të të tjerëve» etj.

Dhe kur të punoni tetë orë çdo ditë, të shikoni atëherë ç'mrekulli do të bëhen në fushat e Hekalit e të gjithë Shqipërisë, se këto të meta, shoqe dhe shokë, nuk vihen re vetëm te ju. Fshatarësia kooperativiste, megjithëse po bën hapa të mëdhenj përpara, nuk e ka kuptuar akoma si duhet vlerën e madhe të kohës së punës. Për shfrytëzimin e kohës së punës ju këtu keni akoma shumë për të bërë, prandaj në këtë çështje bëni shumë kujdes.

Sot erdhëm të takohemi me ju se na kishte marrë malli. Në qoftë se kam kohë që nuk kam ardhur, kjo nuk do të thotë se ju kam harruar, shpirtin dhe zemrën unë dhe shokët e mi i kemi kurdoherë edhe këtej nga ju, por shpesh pengohemi edhe nga punët e tjera. Ne përpiqemi ta ndajmë punën në mënyrë që të gjithë shokët e udhëheqjes të jenë vazhdimisht e sa më

shpesh në gjirin e popullit, të çojnë në Parti, në bazë, udhëzimet dhe direktivat e Komitetit Qendror, të bisedojnë me popullin, të këmbëjnë mendimet me të. Për këtë qëllim e gjithë udhëheqja e Partisë është në lëvizje.

Ju, shoqe e shokë të rinj, e shihni që pleqtë e Mallakastrës i duam e i respektojmë shumë, se ata kanë vuajtur e kanë luftuar dhe na vjen keq që vizita si kjo, nuk kemi mundësi të bëjmë më shpesh. Këto kisha për t'ju thënë. Më falni që ju mbajta ca gjatë në diell dhe ju lashë pa drekë. Edhe ne tani do të vemë të hamë bukë e kripë te xha Sulo Mustafai<sup>1</sup>.

Ju uroj të gjithëve shëndet dhe suksese të mëtejshme në punë!

Rroftë populli i Mallakastrës!

Rroftë populli i Hekalit!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

<sup>1</sup> Në atë kohë kryetar i këshillit popullor të Hekalit.

## PAZARLLËQE IMPERIALISTO-REVIZIONISTE NË PRAPASKENË KUNDËR POPUJVE ARABË

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

9 prill 1969

Krerët e imperializmit amerikan dhe klika renegate revizioniste sovjetike vazhdojnë të luajnë të gjitha kartat për të realizuar planin e tyre neokolonialist, për ndarjen e zonave të influencës në Lindjen e Afërt e të Mesme. Në këtë kuadër ata kanë zhvilluar një varg takimesh dhe bisedimesh në prapaskenë, gjatë të cilave përgatitën terrenin edhe për mbajtjen e një konference katërpalëshe (SHBA, Bashkimi Sovjetik, Francë dhe Anglia) në rangun e përfaqësuesve të përhershëm të këtyre fuqive në Këshillin e Sigurimit. Dhe takimi i tyre i parë u bë më 3 prill në Nju-Jork. Në komunikatën zyrtare pas këtij takimi, ndër të tjera, theksohet se «u fillua shqyrtimi i problemit se në çfarë mënyrë ato (katër fuqitë) mund të ndihmojnë zgjidhjen politike paqësore në Lindjen e Afërt». Për këtë, nënvizon komunikata, «qëndrimi i tyre bazohet në rezolutën e Këshillit të Sigurimit të 22 nëntorit të vitit 1967».

Propaganda imperialisto-revizioniste po e trumbë-

ton me bujë këtë takim, si një «ngjarje të rëndësishme», si «shprehje të vullnetit të mirë» për vendosjen e paqes në Lindjen e Mesme etj. Ajo mundohet të krijojë përshtypjen në popujt arabë dhe në opinionin publik në përgjithësi se kjo iniciativë e dy fuqive, SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik, gjoja synon në vendosjen e stabilitetit dhe të paqes në Lindjen e Mesme, në «qëllimin e mirë» për t'i dhënë fund konfliktit midis Izraelit dhe vendeve arabe.

Por këto deklaratat demagogjike nuk mund të mashtrorjnë popujt, nuk mund të mbulojnë qëllimet e vërteta djallëzore që frymëzojnë krerët e imperializmit amerikan dhe udhëheqjen revizioniste sovjetike. Në të vërtetë, planet e tyre, përkrahja e hapët dhe e maskuar për sionistët izraelitë, i ka inkurajuar këta të fundit për të intensifikuar veprimtarinë e tyre agresive kundër Republikës Arabe të Bashkuar, Sirisë dhe Jordanisë, për të shpallur haptazi dhe me kryeneçësi planet aneksioniste. Për këtë dëshmojnë deklaratat e kryeministres Golda Mejer, të zëvendëskryeministrit Aban, të ministrit të Mbrojtjes izraelit Moshe Dajan etj. Ndërsa në Nju-Jork përfaqësuesit e të katërve vazhdojnë takimet e tyre, trupat izraelite po kryejnë provokacione sistematike kundër vendeve arabe. Bombardimi i djeshëm me artileri nga forcat izraelite i Port-Teufikut, El-Shatit dhe Ismailias, në zonën e kanalit të Suezit, si dhe sulmi barbar ajror mbi qytetin e Akabasë, dëshmojnë qartë për agresivitetin e papërmbytur të Izraelit.

Nën maskën e «arbitrave» gjoja të paanshëm e të «dashamirëve» të popujve arabë, siç mundohen ta



heqin veten revizionistët sovjetikë, fshihen synimet e tyre prej neokolonialistësh, për t'u imponuar arabëve një zgjidhje të tillë të çështjes që në fakt do të çonte në nënshtrimin e tyre, në krijimin e kushteve që do t'u lejonin imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë të ndanin zonat e influencës në këtë rajon me rëndësi ushtarako-strategjike për ta, të grabitnin pasuritë e popujve të kësaj zone dhe të sabotonin e të likuidonin luftën çlirimtare të popullit palestinez.

Fijet e këtij komploti të madh antiarab filluan të enden qysh prej kohësh. Ai u vulos në takimin e Glasboros, që u mbajt në qershor të vitit 1967, vetëm pak ditë pas agresionit izraelito-imperialist kundër popujve arabë. Këto fiqe u endën më tej me rezolutën famëkeqe të Këshillit të Sigurimit të 22 nëntorit 1967, pjellë e makinacioneve sovjeto-amerikane. Kjo rezolutë, siç dihet, mohon të drejtat sovrane të Republikës Arabe të Bashkuar mbi kanalin e Suezit, gjirin e Akabasë dhe ngushticat e Tiranit dhe nuk i detyron agresorët izraelitë që të largohen nga të gjitha territoret e pushtuara arabë. Por, me sa duket, kjo rezolutë nuk mundi të realizojë qëllimet neokolonialiste të Uashingtonit dhe të Moskës. Zhvillimi i ngjarjeve të mëvonshme tregoi se si imperialistët amerikanë, edhe revizionistët sovjetikë vazhduan të përpilonin plane të reja, me formulime të ndryshme në paraqitje, por në esencë për të njëjtat qëllime. Në përputhje me këtë, imperialistët amerikanë paraqitën propozimet e tyre, të cilat u konkretizuan më mirë në shtojcat dhe në «përmirësimet» që iu bënë me planin prej pesë pikash të revizionistëve sovjetikë. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me

një marrëveshje të fshehtë, të përbashkët, me qëllim që të krijohet te popujt arabë përshtypja sikur plani sovjetik mban parasysh interesat e tyre. Por në të vërtetë plani i revizionistëve sovjetikë shkon edhe më tej rezolutës famëkeqe të Këshillit të Sigurimit të 22 nëntorit 1967. Ai kërkon, përveç zbatimit të kësaj rezolute, edhe «krijimin e një zone të sigurimit dhe të qetësisë» në kufijtë midis Izraelit dhe vendeve arabe, duke vendosur në të një të ashtuquajtur forcë ndërkombëtare. Kjo forcë nuk do të jetë tjetër veçse një xhandarmëri në duart e dy fuqive neokolonialiste për të bërë presion dhe për të përgjunjur patriotët arabë, për të mbytur luftën çlirimtare të popullit palestinez. Ja përse patriotët arabë hedhin poshtë me neveritje këtë komplot antiarab. «Qëndrimi i popullit arab, i cili hedh poshtë rezolutën e Këshillit të Sigurimit, — thuhet në deklaratën e botuar muajin e kaluar nga Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës, — duhet të përfshijë edhe refuzimin e planit sovjetik, sepse si rezoluta e Këshillit të Sigurimit, ashtu edhe projektplanin sovjetik kanë për qëllim të zhdukin çështjen palestineze».

Megjithëse popujt arabë dhe patriotët palestinezë kanë denoncuar dhe kanë hedhur poshtë planet neokolonialiste amerikane e sovjetike për Lindjen e Mesme, krerët e dy superfuqive vazhdojnë të komplotojnë në prapaskenë, duke u përpjekur të gjejnë mënyra e forma të ndryshme, të përpunojnë plane të reja që në fakt drejtohen kundër interesave sovranë të arabëve! Me qëllim që t'u hedhin pluhur syve arabëve, ata nuk dalin tani në skenë vetëm, por në një bllok të përfat

qësuesve të të katër fuqive. Ata thonë se do të mundohen të gjejnë së bashku, që të katër, rrugë të reja për «zgjidhjen paqësore» të konfliktit në Lindjen e Afërt e të Mesme. Por, në fakt, janë përfaqësuesit e imperializmit amerikan dhe të revizionizmit sovjetik ata që luajnë rolin vendimtar në takimin e fshehtë të të katërve. Vetë agjencitë e tyre të lajmeve njoftonin se në prag të këtij takimi u zhvilluan një sërë bisedimesh në Uashington dhe në Nju-Jork midis përfaqësuesve kryesorë të imperializmit amerikan, duke përfshirë edhe vetë presidentin Nikson, dhe ambasadorit sovjetik në SHBA, A. Dobrinin, e emisarëve të tjerë të Moskës. Konferencës së të katërve, që po vazhdon punimet e saj në Nju-Jork, i është parashtruar për shqyrtim e aprovim projekti i përbashkët amerikano-sovjetik, i përpunuar që më parë. Baza e këtij projekti, ashtu siç theksohet edhe në komunikatën zyrtare, botuar pas takimit të parë, mbetet rezoluta famëkeqe antiarabe e Këshillit të Sigurimit e 22 nëntorit 1967.

Të gjitha këto tregojnë se bisedimet e fshehta katërpalëshe në Nju-Jork nuk kanë të bëjnë aspak me ndonjë «vullnet të mirë» të fuqive imperialiste për paqen dhe stabilitetin në Lindjen e Mesme. Ato nuk janë vetse pazarllëqe imperialisto-revizioniste për të futur në kurth popujt arabë, për t'u imponuar atyre komplotin neokolonialist. Prandaj opinioni publik arab ka hedhur poshtë «kujdestarinë e huaj», ka denoncuar të ashtuquajturën zgjidhje paqësore të çështies së Lindjes së Mesme nga katër fuqitë e mëdha. Gazeta irakiane «Al Hurija», duke dënuar komplotet antiarabe, shkruante se «çështja palestineze nuk ka nevojë

për kujdestari ndërkombëtare, të imponuar nga të katër fuqitë».

Populli shqiptar, mik i singertë i popujve arabë dhe përkrahës i vendosur i çështjes së drejtë për të cilën ata luftojnë, denoncon komplotet e reja imperialisto-revizioniste kundër interesave sovranë të arabëve. Ne shprehim bindjen se popujt arabë nuk do ta lejojnë veten të bien në këtë kurth të ri të armiqve. Jeta po i bind edhe më shumë ata se për realizimin e aspiratave të tyre nuk duhen mbështetur shpresat te «ndihmat» dhe te përkrahja false e miqve të rremë, revizionistëve sovjetikë, as te bisedimet e paparim imperialisto-revizioniste. Aspiratat e popujve arabë, çlirimi i të gjitha territoreve të pushtuara nga agresorët izraelitë, realizimi i së drejtës së popullit palestinez për çlirimin e tij arrihen nëpërmjet luftës së armatosur dhe përpjekjeve pa kompromis, duke u mbështetur në luftën e masave popullore, si dhe në përkrahjen e solidaritetin e miqve të vërtetë, e forcave liridashëse antiimperialiste.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 84 (6436), 9 prill 1969*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 344*

## **PRESIONET USHTARAKE — BAZË E DIKTATIT DHE E SHANTAZHIT POLITIK TË UDHËHEQËSVE REVIZIONISTË SOVJETIKË**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**11 prill 1969**

Aventurat ushtarake dhe agresionet e armatosura të tipit fashist përbëjnë tiparin kryesor të politikës së jashtme aktuale të revizionistëve sovjetikë. Pushtimi i Çekosllovakisë është një shembull konkret nga më tipikët, por jo i vetmi. Ai është shprehje e zbatimit praktik të politikës famëkeqe të diktatit dhe të shantazhit, nëpërmjet përdorimit të presioneve ushtarake që udhëheqësit e Kremlinit zbatojnë kundër «aleatëve» të tyre dhe vendeve të tjera. Ai është zbatim konkret i strategjisë së përbashkët imperialiste sovjeto-amerikane për ndarjen e zonave të influencës dhe për sundimin e botës nga këto dy fuqi të mëdha.

Këto vitet e fundit dhe veçanërisht para dhe pas pushtimit të Çekosllovakisë, në politikën e jashtme sovjetike ushtarakët luajnë një rol vendimtar dhe këta nuk mund të veprojnë veçse ushtarakisht, me metoda militariste. Në bazë të veprimtarisë së udhëheqjes re-

vizioniste sovjetike qëndron shantazhi ushtarak; arsye-timi dhe zgjidhja e çdo problemi të tyre qëndron në deduksione dhe veprime agresive. Marrëdhëniet politike, ideologjike, ekonomike të revizionistëve sovjetikë me aleatët, satelitë të tyre, bazohen të gjitha në Traktatin e Varshavës, që është bërë arma kryesore e shantazhit. «Në qoftë se nuk më bindesh me të mirë, ose të rrëzoj me intriga nga brenda, ose vë në lëvizje ushtrinë sovjetike, të maskuar nën etiketën e Traktatit të Varshavës dhe të pushtoj». Ky është i tërë koncepti politik i kësaj bande militariste fashiste që sundon në Bashkimin Sovjetik. Të gjithë satelitët i tremben këtij kërcënimi dhe asnjë nuk e dëshiron, por janë vënë nën darën e hekurt të krerëve sovjetikë.

Sigurisht, rrugën e aventurizmit ushtarak, udhëheqësit renegatë të Bashkimit Sovjetik nuk e zgjedhën nga e mira. Ata kaluan në masa ekstreme dhune pasi nuk mund të sundojnë më me mjete paqësore, pasi demagogjia e gënjeshtër nuk zënë më vend. Kriza e rëndë që ka pllakosur mbarë frontin revizionist, shturja, konfuzioni dhe degjenerimi i radhëve të tij i kanë vënë carët e rinj të Kremlinit përpara alternativës: ose të pranojnë falimentimin e tyre të plotë si në politikën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtmen, gjë që ata s'mund ta bëjnë, ose të përdorin grushtin ushtarak për të zgjatur edhe ca jetën.

Mbajtja, që prej më se 20 vjetësh, e forcave ushtarake sovjetike në vendet e Evropës Lindore, e cila u përngjet si dy pika uji bazave dhe stacionimit të trupave amerikane të NATO-s në Evropën Perëndimore, është një shembull tipik që tregon fare qartë se kli-

ka revizioniste sovjetike kërkon, me anë të forcave të armatosura, të zbatojë diktatin e saj mbi popujt e kësaj zone.

Si mund të quhet vend socialist Çekosllovakia e sotme kur ajo nuk mund të rrojë e lirë, e pavarur dhe u dashkan trupat sovjetike për të ruajtur «socializmin» dhe për ta mbrojtur vendin nga «agresionet kapitaliste»? :

Për çfarë regjimesh socialiste mund të bëhet fjalë në Poloni, në Republikën Demokratike Gjermane, në Hungari etj., të cilat kanë nevojë për forca të huaja të armatosura që të qëndrojnë në këmbë? Sigurisht, nevoja për t'u bërë ballë kërcënimeve të imperializmit nuk e përjashton ekzistencën e aleancave midis vendeve socialiste. Por kjo nuk kërkon medoemos vendosjen e trupave të një fuqie të madhe si Bashkimi Sovjetik, i cili për më tepër na mburret ditë e natë se zotëron një forcë të fuqishme goditëse e të shpejtë si rrufeja, për t'i bërë ballë çdo agresioni, që do të shpërthente jo vetëm kundër vendit të vet dhe fqinjëve, por edhe ndaj miqve që janë me mijëra kilometra larg!

Krërët e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve satelite flasin shumë për rrezikun që vjen nga Gjermania Perëndimore e rimilitarizuar. Që ekziston një kërcënim i tillë, ky është realitet. Por revizionistët sovjetikë në fshehtësi janë në miqësi të ngushtë me udhëheqësit e Bonit, kanë marrëdhënie të mira diplomatike me RF të Gjermanisë dhe shkëmbime tregtare reciproke mjaft të zhvilluara. Këtë e vërteton e gjithë praktika e deritanishme, e pohoi edhe ministri i Punëve të Jashtme të RF të Gjermanisë, Vili Brandt. Ata po përgatiten t'u

bëjnë koncesione të reja gjermanoperëndimorëve për hyrjen e daljen lirisht në Berlinin Lindor e Perëndimor dhe po zhvillojnë tratativa të tjera për marrëveshje në fusha të ndryshme.

Revizionistët sovjetikë, të cilët mbajnë forca në vendet e tjera, e justifikojnë këtë me rrezikun amerikan e gjermanoperëndimor.

Hija e tankeve, që krerët sovjetikë kanë lëshuar mbi vendet e tjera, lëvizjet e shpeshta të njësive të armatosura ose manovrat e shumta ushtarake, si dhe prania e lëvizjet e flotës ushtarake sovjetike në Mesdhe, në Atlantik e në Oqeanin Paqësor kanë vetëm një qëllim — të sigurojnë nënshtrimin e të tjerëve ndaj hegjemonisë dhe diktatit sovjetik.

Ç'kuptim tjetër mund të kenë manovrat e mëdha ushtarake të Traktatit të Varshavës që zhvillohen tani në disa nga vendet satelite, përveçse t'i frikësojnë dhe t'u kujtojnë atyre se duhet t'i binden sundimit të revizionistëve sovjetikë? Mareshali Jakubovski i viziton shumë dëndur kryeqytetet e vendeve të Traktatit të Varshavës. Por prania e këtij korbi revizionist, kudo që është shfaqur, ka qenë mjaft ogurcezë. Siç vepron te Dallesi në kohën e tij, vepron sot revizionistët sovjetikë me mareshalin Jakubovski. Dallesi ishte të paktën Sekretar i Departamentit të Shtetit Amerikan dhe i fshihte planet e tij agresive ushtarake në valixhen diplomatike, kurse Jakubovski i ka afishuar në kapelën, në spaletat dhe në dekoratat që i mbushin gjoksin. Ky komandant i Traktatit të Varshavës është bërë një nxitës luftë, shëtitës që po i del boja, është bërë një «gogol» qesharak, që shkon andej-këtej në



vendet ku sundon thundra e revizionistëve sovjetikë për të kërcënuar ushtarakisht, për të pushtuar, për të përgatitur puçe ushtarako-politike, për të bërë presione ekonomike, për të marrë koncesione për klikën sunduese të Kremlinit.

Jakubovski shkon nga Polonia në Hungari, nga Hungaria në Bullgari, nga Bullgaria në Çekosllovakia, nga Çekosllovakia në Rumani e anasjelltas, inspekton forcat sovjetike pushtuese, organizon agjenturën sovjetike në radhët e oficerëve të ushtrive «aleate», kontrollon situatën politike në çdo vend satelit dhe merr masa presioni. Thuhet se ai merret gjoja me organizimin e «manovrave të përbashkëta», por punët e tij të errëta kanë të bëjnë me organizimin e përgatitjeve për ndërhyrje të armatosura ose me zbatimin e tyre. Manovrat që organizoi Jakubovski vjet në korrik në Çekosllovakia ishin preludi i 21 gushtit.

Politika e shantazhit ushtarak nga revizionistët sovjetikë nuk zhvillohet vetëm në gjirin e «Varshavës» dhe nuk është vetëm gogoli Jakubovski që vërtitet sa andej-këtej në Evropë. Është edhe gogoli Greçko, i cili, si ministër i Mbrojtjes i Bashkimit Sovjetik, udhëton me tanke dhe me plane ushtarake në çantë në Kajro, në Bejrut, në Algjer, në Damask, në Irak, në Pakistan dhe tani së fundi në Indi. Të gjitha këto lëvizje të tij pasqyrojnë synimet agresive ushtarake të revizionistëve të Kremlinit, lidhjen e këtyre vendeve me planet e tyre, moszgjidhjen e problemeve të mprehta të këtyre zonave.

Por revizionistët sovjetikë nuk mund të trembin më njeri me politikën e tyre të falimentuar të shanta-

zhit e të presionit me anë të bajonetave. Aventurat e tyre kanë dështuar dhe do të dështojnë me turp përpara vendosmërisë së popujve, përpara luftës së patundur për të mbrojtur interesat e tyre të lartë, lirinë e pavarësinë, të drejtën për të qenë zot në vendin e tyre. Përgjigjen më të mirë politikës militariste, aventureske e provokatore që ndjekin revizionistët sovjetikë dhe që bazohet vetëm në forcën e armëve, ua ka dhënë me kohë Shqipëria, që kur u qëndroi me trimëri presioneve, ndërhyrjeve e kërcënimeve të Nikita Hrushovit, që kur denoncoi Traktatin e Varshavës, të cilin klika e Brezhnjev-Kosiginit e ka kthyer në një instrument të thjeshtë agresioni. . .

Strategjia globale e ekspansionit hegjemonist të revizionistëve sovjetikë nëpërmjet agresionit duket tanimë fare qartë. Etapë e parë e realizimit të saj është dominimi i plotë ushtarak, nën maskën e Traktatit të Varshavës, i territoreve që përfshihen në të ashtuquajturën zonë të influencës sovjetike. Këtë hap të parë aventuresk revizionistët sovjetikë shpresojnë ta realizojnë pa dhimbje dhe pa reperkusione për aleancën sovjeto-amerikane. Qëndrimi i qeverisë amerikane ndaj pushtuesve, më shumë dashamirës sesa indiferent, është një shembull mjaft konkret. Në këtë drejtim, shkon edhe «Thirrja për sigurimin evropian» që udhëheqësit sovjetikë, në emër të Traktatit të Varshavës, u bënë nga mbledhja e Budapestit vendeve kapitaliste të Evropës. Duke e siguruar borgjezinë e madhe evropiane, e para së gjithash imperializmin amerikan, për qetësi në kufijtë ushtarakë midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës, ata u kërkojnë atyre të qëndrojnë asnjans.

kur cari moskovit kërkon të vendosë «rregull» në çifligjet e tij të Lindjes.

«Sigurimi evropian», siç e kuptojnë revizionistët, do të thotë sigurim i statukuosë së tanishme, domethënë sigurim i aleancës sovjeto-amerikane për të ruajtur pozitat sunduese që kanë tani në vende të ndryshme të Evropës imperialistët e SHBA-së dhe revizionistët sovjetikë.

Në propagandën revizioniste më shumë dhe në atë imperialiste më pak, shpesh bëhet fjalë për «iniciativa» në lidhje me likuidimin e NATO-s e të Traktatit të Varshavës. Por këto zhurma janë spekulime të thjeshta, blofe pa asnjë vlerë. Tanimë kushdo e kupton se «propozimet», «thirrjet» etj. për prishjen e blloqeve janë të perealizueshme, pasi ato mbahen në këmbë, pikërisht, për të ruajtur interesat e veçantë të imperializmit sovjetik e atij amerikan në Evropë dhe për të përjetësuar këtë statukuo.

Tani edhe në vendet revizioniste, në njërën formë ose në tjetrën, po u bëhet një rezistencë e dukshme hegjemonisë sovjetike, presioneve politike, ekonomike e ushtarake të udhëheqjes revizioniste të Bashkimit Sovjetik. Pothuajse kudo asaj i ka hasur sharra në gozhdë. Çekosllovakia është një shembull mjaft kuptimplotë. Kanë kaluar shtatë muaj nga ndërhyrja e armatosur, por populli çekoslovak nuk është gjunjëzuar dhe nuk i është nënshtruar diktatit revizionist të udhëheqësve sovjetikë. Bojkotimi i plotë dhe izolimi i pushtesve, shprehja e hapët e urrejtjes dhe manifestimet e guximshme kundër pushtimit janë bërë tani armë të fuqishme kundër shkelësve të atdheut të tij.

Tanket që dërgoi klika e Brezhnjevrit dhe e Kosiginit nuk mundin dhe as do të mundin kurrë të shtypin frymën liridashëse të popullit çekoslovak. Sa më gjatë qëndrojnë në territorin çekoslovak trupat e huaja të pushtimit, sa më të shpeshta bëhen ndërhyrjet në punët e brendshme të Çekosllovakisë, intrigat dhe presionet e pushtuesve revizionistë sovjetikë, aq më shumë forcohet bashkimi i popullit çekoslovak, aq më shumë shtohet vendosmëria për të mos u përkulur dhe për të mos u tërhequr përpara presioneve, frikësimeve e shantazheve të robëruesve të tij. Demonstratat e fundit kundër pushtimit të vendit nga revizionistët sovjetikë, që përfshinë gjithë Çekosllovakinë, janë një dëshmi tjetër që provon se popullin çekoslovak nuk e nënshtrojnë as tanket e Greçkos e të Jakubovskit, as kapitullimi dhe kolaboracionizmi i klikës Dubçek-Svoboda.

Jo vetëm çekët, por as rumunët, as hungarezët, as polakët e as gjermanët nuk kanë shumë qejf të lidhen me aventurat e reja të revizionistëve sovjetikë. Ata kërkojnë tani si t'i shpëtojnë zgjedhës ushtarake fashiste të Jakubovskit dhe bëjnë një mijë manovrime si t'u bëjnë bisht presioneve dhe diktateve të urryera të Moskës. Llogaria e tyre është e thjeshtë: sa më shumë telashe që do të ketë Kremlini, aq më lehtë do të jetë për ta.

Politika e synimeve hegjemoniste ekspansioniste e udhëheqësve revizionistë sovjetikë kërcënon edhe Jugosllavinë. Klika revizioniste sovjetike gjendet tani në kontradikta koniunkturale me udhëheqësit revizionistë të Beogradit. Pavarësisht nga ç'baza dhe nga ç'qëllime

niset, është fakt se titizmi jugosllav ka luftuar dhe lufton kundër hegjemonisë së revizionistëve sovjetikë në vendet e Evropës Lindore. Që këtu fillojnë edhe fërkitimet midis tyre.

Presionet dhe kërcënimet ndaj Jugosllavisë janë shtuar, sidomos, para dhe pas ndërhyrjes në Çekoslovakia. Ato mbahen në rendin e ditës dhe nxiten nga revizionistët sovjetikë e satelitët e tyre bullgarë edhe si kundërpeshë ndaj Titos, i cili u nxjerr telashe në arritjen sa më shpejt dhe «urtë e butë» të qëllimeve të tyre ndaj Rumanisë.

Por pavarësisht nëse sundimtarët e Moskës e të Beogradit do të prishen përfundimisht apo do të pajtohen e do të përqafohen përsëri, një gjë është e sigurt: krerët e Kremlinit e dinë fare mirë se një sulm eventual nga ana e tyre në kufijtë jugosllavë do të haste në një luftë të rreptë dhe heroike nga popujt e Jugosllavisë, të cilët, gjatë gjithë historisë së tyre, kanë luftuar për liri e pavarësi kundër shkelësve të huaj. Një agresion i revizionistëve sovjetikë kundër Jugosllavisë do të ishte katastrofik për ta nga çdo pikëpamje.

Vija e demarkacionit politik e ideologjik që na ndan ne nga udhëheqja e sotme jugosllave, është tanimë e njohur. Por populli shqiptar, duke ruajtur njëkohësisht fort parimet nga të cilat udhëhiqet dhe duke u qëndruar besnik traditave të tij të lashta liridashëse, përparimtare e antiimperialiste, ashtu si edhe në të kaluarën, do të përkrahë pa asnjë druajtje rezistencën e popujve të Jugosllavisë ndaj agresionit.

Tanimë është e qartë se, ashtu siç bëri Hitleri, edhe klika revizioniste e Bashkimit Sovjetik aventurat

i përgatit njërën pas tjetrës, për të arritur në një konflagracion të madh. Në etapën e tanishme, siç e përmendëm edhe më lart, revizionistët sovjetikë kërkojnë të dominojnë ushtarakisht aleatët e tyre, të sigurojnë, si të thuash, frontin e brendshëm. Por në qoftë se kjo u ka ecur lehtë deri më sot, hapi i mëtejshëm aventuresk, sulmi mbi Jugosllavinë e Shqipërinë, jo vetëm do t'u kushtojë kokën revizionistëve sovjetikë, por, sigurisht, do të ishte preludi i një lufte të madhe botërore, për arsye se as Jugosllavia e as Shqipëria nuk janë fiq të njomë që të shkojnë lehtë në fytin e Greçkëve e të Jakobovskëve. Ato janë kocka të forta që u copëtojnë gurmazin.

Kjo fazë e dytë jo vetëm që do të rezultonte me disfatën ushtarake, por ajo do të kishte edhe pasoja katastrofike politike në të gjithë frontin ku revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë maskën si një fuqi antiimperialiste dhe si një forcë çlirimtare.

Shqipëria socialiste dhe populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës, janë të paprekshëm dhe do të dërrmojnë pa nishan cilindo që do të guxojë t'i sulmojë.

Plane të shumta agresive po thurin revizionistët sovjetikë. Por rruga e tyre është e mbushur me pengesa të pakapërcyeshme, që do t'i çojë patjetër nga disfata në disfatë, deri në shkatërrimin përfundimtar. Ne besojmë se edhe popujt sovjetikë nuk do të lejojnë të vihen në rolin e hordhive naziste gjermane në sulmet që bëri Hitleri mbi popujt e tjerë, e në radhë të parë mbi ata të Bashkimit Sovjetik. Populli i madh sovjetik, klasa punëtore ruse, punonjësit e gjithë Bash-

kimit Sovjetik, që kanë tradita të mëdha revolucionare dhe që në të kaluarën kanë dhënë prova të shkëlqyera të internacionalizmit proletar, nuk do ta lënë veten që klika renegate revizioniste e Brezhnjev-Kosiginit t'i kthejë ata në pushtues dhe grabitës të lirisë së popujve të tjerë. Ata nuk do të lejojnë në asnjë mënyrë që atdheu i Revolucionit të Tetorit, atdheu i Leninit, i Stalinit e i Sovjetëve, të kthehet prapa në Rusinë e carëve, në xhandar të reaksionit botëror. Idetë e lavdishme të marksizëm-leninizmit, që qëndrojnë të gjalla në zemrat e njerëzve të thjeshtë sovjetikë, nuk mund të shuhen kurrë, sado e egër të jetë shtypja revizioniste dhe sado e djallëzuar të jetë propaganda e klikës uzurpatore që sundon në Kremlin. Popujt e Bashkimit Sovjetik ndodhen përpara një përgjegjësie të madhe historike, ndoshta më e madhja që u ka takuar atyre ndonjëherë. Çështja shtrohet: o me popujt liridashës kundër planeve agresive të klikës tradhtarë revizioniste sovjetike, o me të kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër revolucionit e socializmit. Ne besojmë se ata do të zgjedhin rrugën e nderit, do të ngrenë përsëri flamurin e revolucionit dhe do ta çlirojnë veten nga murtaja revizioniste që i ka pllakosur.

Krerët e Kremlinit i mbështetin politikën ekspansioniste dhe planet e tyre agresive në forcën e tankeve. Por ushtria e sotme sovjetike, e cila komandohet nga klika ushtarake të degjeneruara dhe udhëhiqet nga një ideologji tradhtarë, që si bazë ka raprezaljet dhe politikën e bajonetave, nuk ka dhe nuk mund të ketë atë kompaktësi, atë shpirt luftarak dhe atë forcë që tregoi, nën udhëheqjen e Stalinit, kundër hitlerianëve.

Në atë kohë ushtria sovjetike i kishte këto cilësi, pasi vetë ajo dhe lufta e saj kishin karakter çlirimtar. Tani këto ajo i ka humbur, sepse nuk udhëhiqet më nga marksizëm-leninizmi dhe nga parimet e internacionalizmit proletar. Qoftë Lenini në udhëheqjen e Revolucionit të Tetorit, qoftë Stalini në udhëheqjen e Luftës së Madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik, kishin respekt dhe besim të madh në luftën revolucionare e çlirimtare të klasës punëtore dhe të popujve të botës, të cilët dhanë një kontribut të shquar në fitoren e revolucionit të proletariatit rus dhe në shkatërrimin e Gjermanisë fashiste.

Klika aktuale ushtarake sovjetike ka arritur në të tilla pozita reaksionare sa të nënvleftësojë në realitet këtë forcë të madhe luftarake për mbrojtjen e lirisë, të demokracisë e të socializmit. Çka ishte e vërtetë dhe reale në vlerësimin e drejtë të Leninit, Stalinit dhe të Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik kur ata flitnin për kontributin dhe ndihmën e proletariatit botëror e të popujve, në gojën e revizionistëve është vetëm një parullë boshe. Krerët renegatë të Kremlinit mendojnë se forca e gjallë vitale dhe e pamposhtur e klasës punëtore dhe e popujve në rast agresioni nga ana e tyre, nuk do të mund t'i qëndrojnë forcës brutale të fashistëve të rinj. Këtu del qartë megalomania e kësaj klike gjeneralësh e mareshalësh të degjeneruar, të cilët të kaluarën e vërtetë heroike të ushtrisë sovjetike e përdorin vetëm për mburrje dhe për spekulime politike.

Në fakt, ushtrinë sovjetike ata e kanë katandisur keq dhe po e çojnë në atë rrugë katastrofike ku e çuan ushtarakët borgjezë — Vejgandi, Peteni e të tjerë —



ushtrinë franceze fitimtare të Luftës së Parë Botërore.

Edhe Hitleri e Musolini kishin po të tilla pikëpamje megalomane për forcën e tyre ushtarake dhe nënvleftësonin e minimizonin rezistencën e popujve. Të bazuar në këtë megalomani e vlerësim të gabuar, ata mendonin se, me anën e një «luftë-rrufe», do t'i shtypnin dhe do t'i nënshtonin popujt. Por rezultoi e kundërta. Dhe ne u themi revizionistëve sovjetikë se nuk i provoi në kurriz vetëm Bashkimi Sovjetik «luftë-rrufe» dhe bombardimet hitleriane. Këto i provuan jo më pak, edhe populli shqiptar, edhe populli jugosllav, edhe popuj të tjerë. Megjithëse të vegjël, me gjithë «luftë-rrufe» e sulmet e rënda, hitlerianët nuk na zhdukën dot dhe as na mundën. Ne dolëm fitimtarë mbi ata. Është e vërtetë se ne kishim ndihmën kolosale ushtarake të Bashkimit Sovjetik dhe të popujve të tjerë, por në rast se ju, revizionistë sovjetikë, do të ndërmerreni aventura si ato që bëri Hitleri kundër nesh, ne nuk do të jemi vetëm dhe prapë do t'ju mundim. Ju do të mbeteni të izoluar, ashtu siç u izolua Hitleri.

Revizionistët sovjetikë po i bien daulles dhe na akuzojnë ne, shqiptarët, se gjoja kemi harruar kontributin e madh që ka dhënë ushtria sovjetike në çlirim e Evropës, duke përfshirë edhe atë të Shqipërisë. Ne po ua përsëritim këtyre zotërinjve një herë e njëqind herë: Shqiptarët nuk e kanë harruar e nuk e harrojnë rolin dhe kontributin e ushtrisë sovjetike dhe të Stalinit në çlirimin e Evropës dhe të Shqipërisë nga murtaja naziste. Por ushtria e sotme sovjetike nuk është më Ushtria e Kuqe e Revolucionit të Tetorit dhe e Luftës së Madhe Patriotike të Bashkimit Sovje-

tik, partia e sotme revizioniste sovjetike nuk është më Partia e bolshevikëve, e Leninit dhe e Stalinit. Revolucionin dhe traditat e lavdishme të ushtrisë sovjetike ju i tradhtuat, ndërsa ne, si marksistë-leninistë dhe internacionalistë të vërtetë, i kemi mbrojtur dhe do t'i mbrojmë deri në fund dhe pa asnjë rezervë.

Politika e shantazheve dhe e presioneve që ndjekin udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik, është në dobi të imperializmit dhe e inkurajon atë të intensifikojë edhe më tepër veprimtarinë agresive kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër lëvizjes revolucionare të klasës punëtore në vendet kapitaliste. Është fakt se imperializmi amerikan, në situatën e krijuar nga tradhtia revizioniste, po përpiqet me të gjitha mjetet që zotëron, me forcën e armëve, me dollarë, me puçe kundërrevolucionare, intriga, shantazhe etj., të shtrijë sundimin e tij politik, ekonomik e ushtarak dhe të skllavërojë popujt e Azisë, të Afrikës e të Amerikës Latine. Revizionistët kërkojnë që popujt të tërhiqen dhe të kapitullojnë përpara sulmeve të imperializmit dhe të pranojnë pa rezistencë zgjedhën e tij.

Por asnjëri nuk gënjehet nga kjo propagandë e ndyrë. Imperializmi amerikan është armiku i përbashkët, i egër dhe i rrezikshëm i të gjithë popujve të botës, nxitësi kryesor i agresioneve dhe i luftërave. Prandaj popujt liridashës, revolucionarët e vërtetë të të gjitha vendeve, nuk gënjehen dhe nuk e harrojnë kurrë luftën kundër imperializmit. Ata i bashkojnë e i forcojnë gjithnjë e më fort radhët e frontit antiimperialist dhe hidhen në luftë të vendosur kundër planeve dhe veprimtarisë agresive të SHBA-së dhe reaksionit

ndërkombëtar, me besim të plotë në fitoren e tyre të pashmangshme.

Udhëheqja revizioniste sovjetike tani ndodhet e mbërthyer fort në darën e kontradiktave të pazgjidhshme. Situata e vështirë në të cilën ndodhet, e shtyn drejt aventurave dhe përdorimit të hapët të presioneve ushtarake. Njëkohësisht, aventurizmi i saj ngjall kudo një rezistencë dhe luftë të vendosur nga ana e popujve, gjë që e bën edhe më të vështirë situatën për të. Dhe ndryshe nuk mund të ndodhë. Ajo tanimë është futur në rrugën e turpshme të agresioneve fashiste, e cila nuk mund ta çojë asgjëkundi tjetër përveçse në varr. Durimi i popujve kundër pushtuesve dhe klikave vendëse të shitura te sovjetikët nuk mund të zgjatë. Lëvizja e rezistencës dhe e kundërshtimit ka filluar me kohë, ajo do të shtohet, do të fryhet, do të shpërthejë e furishme edhe në sipërfaqe. Popujt, të cilët ata i kërcënojnë me forcën ushtarake, nuk tremben dhe nuk tërhiqen përpara presioneve. Ata qëndrojnë vigjilentë dhe kurdoherë të gatshëm për të mbrojtur deri në fund lirinë e pavarësinë e tyre, për t'i dhënë grushte vdekjeje çdo agresioni, i madh apo i vogël qoftë, me armë moderne apo pa të tilla.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 86 (6438), 11 prill 1969*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 349*

## TOK ME EDUKIMIN TEKNIK, DUHET EDHE NGRITJA POLITIKE

*Fjala para pjesëmarrësve në garat e xhenierëve*

**13 prill 1969**

Ju uroj, shokë ushtarë dhe oficerë, festën tuaj, ditën e armës së xhenierëve. Gjithashtu ju përgëzoj në emër të Partisë, për këto përparime të mëdha që keni bërë, për këto armë që keni përgatitur me duart tuaja, për këtë forcë krijuese tuajën.

Këto armë kanë një efekt të madh vdekjeprurës, shkatërrues për armikun. Të tilla armë duhet të hyjnë plotësisht në përdorim jo të mbeten vetëm si ekzemplarë, sa për të treguar mundësitë që kemi. Tani këto mundësi duhet t'i shikojmë konkretisht që t'i kthejmë në realitet. Unë mendoj që ju, ushtarët dhe oficerët, nuk duhet të kënaqeni vetëm me demonstrime, por të synoni dhe të punoni që të gjitha këto armë të jenë në gatishmëri të plotë, që ato të jenë të përdorshme jo vetëm nga ushtria aktive, por edhe nga i gjithë populli i armatosur.

Partia na mëson të bëjmë të gjitha përpjekjet që

ta përvetësojmë si duhet artin ushtarak. Për këtë duhet që politikisht të jemi të ngritur, pra, jo vetëm të mësojmë përdorimin në mënyrë të perfeksionuar të armëve, por njerëzit tanë, në radhë të parë, të kuptojnë rëndësinë politike të çfarëdo gjëje; atëherë armët që juve ju ka dhënë Partia në dorë janë të pamposhtura, se ju jeni të pamposhtur.

Sigurisht, edhe armiku ka armë. Mund të ketë armë edhe më moderne se tonat, mirëpo ai njeriun tonë nuk e ka. Njeriu që do t'i përdorë armët e tij është i frymëzuar nga një politikë dhe nga një ideologji reaksionare, shtypëse, skllavëruese. Dhe meqenëse këta njerëz, që janë edhe ata njerëzit e popullit, përpara rezistencës së forcës së popujve e të ushtrisë sonë, nuk mund të durojnë, edhe armët e tyre bëhen të pavlefshme, sepse ata, si me thënë, demoralizohen; ndërsa ushtari ynë di pse lufton, populli ynë di pse lufton, ndaj qëndrojnë të patundur, prandaj armët tona bëhen të fuqishme, të pamposhtura. Këtu është roli, rëndësia e faktorit njeri në luftë, prandaj tok me edukimin teknik duhet edhe ngritja politike e njerëzve tanë.

Përveç kësaj, sikundër ju mëson Partia, çështja e mbrojtjes, e sulmit dhe e veprimeve të tjera luftarake lypin zgjuarsin të madhe jo vetëm të komandantit, por edhe të ushtarit. Ushtari duhet të jetë po aq i zgjuar, po aq planovik, si dhe komandanti, të dijë të bëjë planin e mbrojtjes, planin e sulmit. Me një fjalë, të gjithë ushtarët të ngrihen në nivelin e oficerëve. Pavarësisht se në çdo nënrepart e repart ka komandantë, ka komisarë, Partia lufton që të gjithë ushtarët

të jenë të aftë si komandantë e komisarë, dhe të gjithë të shkojnë në luftë nën drejtimin e komandantit dhe të komisarit. Pra, me njerëz të tillë të përgatitur, kur bëhet plani i sulmit, ky do të jetë një plan i mirë, sepse do të jetë hartuar nga të gjithë ju që formoni repartin ose nënrepartin.

Po të veprohet kështu, merreni me mend se sa i drejtë do të jetë plani i sulmit ose i mbrojtjes, sa i studiuar do të jetë ai dhe sa bukur do të zbatohen planet, sepse të gjithë kanë marrë pjesë në hartimin e tij. Prandaj, siç na mëson Partia, ushtarët te ne nuk përgatiten si automatë, kurse në vendet kapitaliste e revizioniste ushtarët janë automatë pse ata s'janë të bindur, pasi janë njerëz të popullit dhe nuk duan të venë në luftë kundër popujve, ata janë automatë sepse atje nuk sundon ideologjia e zhvillimit të iniciativave krijuese të njerëzve, por sundon ligji i oficerëve reaksionarë, të cilët nuk duhen nënvleftësuar nga njerëzit tanë, sepse janë edhe ata të zotë, mirëpo zotësia e tyre nuk mund të arrijë kurrë zotësinë e oficerëve dhe të ushtarëve tanë. Në ato vende është në fuqi forca e ligjit të egër kapitalist, atje ligji bën ligjin, kurse te ne është ligji i Partisë, i popullit, është vullneti, heroizmi, janë ndjenjat, mençuria e të gjithëve. Prandaj ushtria jonë është e fortë.

Partia na mëson që vendi ynë të jetë i përgatitur në mënyrë të gjithanshme ndaj çdo rreziku eventual. Nga rreziqet që na kërcënojnë ne rritim vigjilencën, por frikë nuk kemi, sepse bazohemi në forcat e popullit tonë, në forcën e ushtrisë sonë, në forcën e ideolo-

gjisë sonë, pastaj me ne janë edhe miqtë, popujt liridashës në botë.

Imperialistët dhe revizionistët përpiqen të forcojnë aleancat e tyre, zhvillojnë dhe manovra ushtarake. Të gjitha këto janë forma përgatitjeje për luftë, se ata luftën e kanë në gjak. Si imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë shtypin popujt në vendet e tyre, synojnë dhe përpiqen të shtypin edhe popujt e tjerë, gjithë lëvizjet revolucionare të popujve.

Prandaj kudo në botë popujt janë në greva, në demonstrata, bile luftojnë dhe me armë. Një hap përpiqen të hedhin imperialistët dhe revizionistët, por një mijë pengesa hasin nga popujt, një mijë vështirësi u krijohen nga kontradiktat që kanë. Shihni Çekosllovakinë, Gjermaninë, Bashkimin Sovjetik, Italinë, Francën, Amerikën e të gjitha vendet ku sundon kapitali, atje ka turbullira të jashtëzakonshme. Këto turbullira nuk do të shuhen, por do të zmadhohen në disfavorin e armiqve të popujve, në favor të revolucionit.

Prandaj vëllezër, shokë, ushtarë e oficerë, rruga e Partisë është rrugë e drejtë, është rruga e fitoreve në interes të socializmit, të mirëqenies së popullit. Juve, ushtarë e oficerë, Partia ju ka ngarkuar një detyrë të madhe. Këtë detyrë ta plotësoni me heroizëm, me vullnet të pamposhtur, me mençuri e me pjekuri politike. Të gjitha mundësitë ju janë krijuar. Partia ka besim të madh te ju, shokë ushtarë, sepse jeni bijtë e popullit, dhe te ju shokë oficerë, sepse jeni kuadro që keni një stazh të gjatë, që keni një eksperiencë të madhe, që e keni treguar zotësinë dhe besnikërinë tuaj gjatë gjithë jetës suaj revolucionare.

Me këtë rast, dëshiroj edhe një herë t'ju uroj fitore të reja në përpjekjet tuaja për zbatimin e direktivave të Partisë sonë të lavdishme.

Rroftë Partia!

Rroftë ushtria!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*



## VEPRAT TUAJA PËRBËJNË NJË USHIQIM TË PËRDITSHËM PËR POPULLIN

*Fjala në pritjen e dhënë me rastin e mbylljes  
së punimeve të Kongresit të 2-të të Lidhjes  
së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë*

26 prill 1969

Të dashur shoqe dhe shokë, shkrimtarë dhe artistë,

Dëshiroj të shpreh sonte, para jush, ndjenjat e gëzimit të madh që na kanë pushtuar të gjithë ne gjatë këtyre tri ditëve që zhvilloi punimet Kongresi juaj i 2-të. Këto janë ndjenja të pastra dashurie, respekti dhe admirimi për ju, shoqe dhe shokë të dashur.

Jo vetëm ne, që ndoqëm nga afër punimet e kongresit, por të jeni plotësisht të bindur se përpjekjet tuaja mendore dhe fizike, që ju, si bij dhe ushtarë besnikë, i keni vënë me entuziazëm e besim të paturdur në shërbim të popullit, të atdheut dhe të Partisë, i ndiejnë thellë gjithë Partia dhe populli. Ata ju falënderojnë me gjithë shpirt.

Shkrimtarët dhe artistët janë ndarë sonte këtu në

dy salla, për arsye se, siç e shihni edhe vetë, njëra nuk i merrte dot të tërë, se radhët e shkrimtarëve dhe të artistëve tanë po shtohen nga dita në ditë dhe të gjithë punojnë për një qëllim. S'ka dyshim se, kur të mbliidheni në Kongresin tuaj të 3-të, do të jeni aq shumë, sa do t'ju duhet një sallë shumë e madhe. Përgatitjes, shtimit, rritjes dhe edukimit të shkrimtarëve dhe të artistëve Partia u kushton vëmendje të madhe. Pra si në çdo fushë, edhe në këtë sektor të rëndësishëm, të letërsisë dhe të arteve, Partia ka zbatuar dhe zbaton drejt vijën e masave që na mëson marksizëm-leninizmi.

Partia, shoqe dhe shokë, jo vetëm në këtë kongres, por vazhdimisht e ka vlerësuar rëndësinë e madhe që ka për ndërtimin e shoqërisë sonë të re zhvillimi në rrugë të drejtë i letërsisë dhe i arteve, që ndihmojnë për mobilizimin e masave në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Duke i qëndruar kurdoherë besnike parimeve marksiste-leniniste të ndërtimit të socializmit e të komunizmit, Partia ka marrë e do të marrë, gjithashtu, edhe në të ardhmen masa të atilla, që do të ndihmojnë për rritjen e ndërgjegjes socialiste të punonjësve, në mënyrë që edukimi shpirtëror, politik dhe ideologjik i tyre të mos mbetet prapa, por të ecë kurdoherë krahas me ritmin e zhvillimit të vullshëm ekonomik të vendit. Sa më të kalitur të jenë njerëzit tanë politikisht dhe ideologjikisht, sa më drejt të mendojnë e të veprojnë këta sipas mësimëve të Partisë, aq më shpejt, aq më mirë e më me vrull revolucionar do të ndërtohet shoqëria jonë socialiste dhe komuniste.

Partia vë re me kënaqësi të madhe se në dritën e mësimeve të marksizëm-leninizmit i gjithë populli ynë tashmë ka hyrë vendosmërisht në fazën e një transformimi rrënjësor, duke çarë rrugë të lavdishme në shtigje të paçelura ndonjëherë dhe në kushte jashtëzakonisht të vështira të rrethimit të vendit tonë nga armiqtë e socializmit, të komunizmit dhe të popujve, siç janë imperializmi, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmi modern, me atë sovjetik në krye.

Të gjithë e kemi të qartë se ndërtimi socialist në vendin tonë ndjek rrugën marksiste-leniniste. Ne kemi qenë dhe jemi plotësisht të vendosur që në çdo hap që bëjmë, në çdo realizim, në çdo plan perspektiv, të mbështetemi fuqimisht në ideologjinë tonë, në marksizëm-leninizmin. Ashtu si kurdoherë, gjatë gjithë jetës së saj, edhe në situatat e vështira aktuale për lëvizjen komuniste botërore, Partia e Punës e Shqipërisë e mbron marksizëm-leninizmin si sytë e ballit dhe e zbaton atë drejt e në mënyrë krijuese në kushtet e veçanta të brendshme dhe ndërkombëtare të vendit tonë. Me luftën, punën dhe sukseset që ka arritur, Partia jonë fiton vazhdimisht eksperiencë të re dhe jep kontributin e saj modest, por të dukshëm, në shkallë botërore në luftën kundër borgjezisë kapitaliste dhe pjellës së tij revizionizmit modern.

Komunistët dhe patriotët e vendit tonë, të paorganizuar në Parti, si ushtarë besnikë të Partisë, kanë luftuar dhe luftojnë me një vendosmëri të paparë për ndërtimin e shoqërisë socialiste dhe komuniste në Shqipëri, duke përballuar me sukses vështirësi e komplete të panumërta e të rrezikshme nga ana e impe-

rialistëve dhe e revizionistëve modernë. Heroizmi i popullit shqiptar në këtë luftë të pabarabartë, por kurdoherë fitimtare për ne, tregon vitalitetin e madh të doktrinës sonë të pavdekshme, të Partisë dhe të masave tona punonjëse të lidhur me një unitet të çeliktë ndërmjet tyre. Pikërisht këta faktorë vendimtarë kanë bërë që, edhe në kushte shumë të vështira, atdheu ynë të arrijë gjithë ato suksese madhështore dhe të bëjë transformime rrënjësore që të gjithë i dimë dhe nuk është nevoja t'i përmend sonte këtu të tëra me radhë. Megjithatë le të ndalemi në një sektor, në atë të bujqësisë.

Po t'i hedhim një sy të shpejtë gjithë asaj pune të madhe që kemi bërë që nga Çlirimi e deri tash në fshatin tonë, do të shikojmë se atje kanë ndodhur ndryshime rrënjësore politike, ideologjike, shoqërore dhe ekonomike. Natyrisht, këto ndryshime nuk janë bërë përnjëherësh, por me etapa, çdonjëra nga të cilat ka qenë e studiuar mirë e me kujdes të veçantë nga Partia. Ishte e domosdoshme të kalohej shkallë-shkallë nga një etapë në tjetrën për të arritur në këtë situatë kaq revolucionare që kemi sot në vendin tonë. Ju e mbani mend se si u ngritën peshë zemrat e fshatarëve tanë nga dashuria e madhe që ushqenin ata për Partinë, e cila i udhëhoqi në luftën për çlirimin nga zgjedha e çifligarëve dhe e kulakëve dhe me Reformën Agrare u dha tokën.

Ligji mbi Reformën Agrare, në ato momente kur hyri në fuqi, pati një përmbajtje të thellë klasore. Në shpërndarjen e mjeteve të prodhimit në fillim mund të bëheshin edhe gabime, sepse, duke u nisur nga etja e

madhe e fshatarit për tokë dhe nga mundësitë shumë të pakta që kishte shteti ynë në atë periudhë për mekanizim etj., fshatarëve mund t'u jepnim sasi më të madhe hektarësh. Por Partia si kurdoherë nuk gaboi edhe në këtë çështje, ajo nuk ra në grackat e të ashtuquajturave reforma agrare të borgjezisë që, në të vërtetë, janë vetëm një mashtrim, sepse në kohën kur janë bërë, janë udhëhequr nga tjetër ideologji dhe nga qëllime të tjera krejt të ndryshme. Ato qëllime dhe ideologji i çuan vendet kapitaliste, dhe do të çojnë patjetër edhe ato revizioniste, në krijimin e koncerneve të mëdha të tokës, në rrugën e grabitjes me forcë të tokave të fshatarëve, duke i lënë ata pa tokë, në rrugë të madhe, në krijimin e tregut të zi dhe të konkurrencës së tmerrshme të prodhimit privat, të agjentëve të fermave ose të kooperativave me karakter kapitalist. Partia jonë nuk ra, gjithashtu, as në grackën e deviatorëve që dolën në atë kohë në radhët e saj, të cilët, gjoja me bujari, u përpoqën t'i jepnin fshatarit sasi të mëdha toke e kafshësh, duke arsyetuar se vija e Partisë kishte gjetur mbështetjen vendimtare të fshatarësisë.

Fshatarësia jonë patriotike i kuptoi drejt dhe qartë masat e urta të Partisë, si për sa i përket Reformës Agrare, ashtu edhe për përgatitjen e perspektivës së zhvillimit të bujqësisë në vendin tonë. Ajo e kuptoi se Reforma Agrare ishte një masë me karakter klasor, e udhëhequr nga Partia e klasës punëtore, që bashkë me luftën për çlirimin nacional nga pushtuesit e tradhtarët, përmbysi në Shqipëri pushtetin e kapitalistëve dhe të çifligarëve, duke u dhënë atyre kështu një goditje përfundimtare jo vetëm nga ana politiko-ideolo-

gjike, por edhe në fushën ekonomike. Partia i kufizoi në minimum pronat e kulakëve dhe i dha fund njëherë e përgjithmonë sundimit të agallarëve mbi fshatarët. Kapitalistët e fshatit në këtë kohë u katandisën ekonomikisht shumë më keq se fshatarët e varfër të kohës së tyre, kurse politikisht ata e humbën përgjithnjë pushtetin. Këto masa i bënë fshatarët të kuptojnë se toka dhe e tërë Shqipëria tashmë ishin të tyre, se në Parti dhe në pushtet drejtonin bijtë e popullit punonjës, bijtë e punëtorëve e të fshatarëve, bijtë e inteligjencies sonë të lidhur ngushtë me ta. Ky ishte një kuptim i madh i vijës së Partisë.

Në këtë etapë lufte e përpjekjesh një rol të rëndësishëm keni luajtur dhe ju, shkrimtarët e artistët revolucionarë, bij të popullit dhe të Partisë, që ju vlonte në gji zjarri i luftës klasore. Nga shpirti dhe zemra juaj, nga mendjet dhe nga duart tuaja, keni nxjerrë vjersha, poema, tregime, romane, vepra muzikore, piktura, skulptura etj., me të cilat, në ato momente vendimtare, kur hidheshin bazat e shoqërisë sonë të re, keni frymëzuar breza të tërë.

Punuam me të gjitha mundësitë tona. Natyrisht, edhe të meta ka pasur. Gabime e të meta keni pasur gjithashtu edhe ju në shkrimet tuaja, por këto ishin të atilla që buronin nga vështirësitë e rritjes të asaj periudhe plot luftë dhe përpjekje që kishin për qëllim ta çonin kurdoherë përpara çështjen e madhe të Partisë. e cila nga etapa në etapë eci vazhdimisht në lidhje të ngushtë me popullin, me klasën punëtore, me fshatarësinë, me ju, shoqe dhe shokë të inteligjencies.

Të gjithë e kemi jetuar momentin historik kur

Partia hodhi idenë e kolektivizimit, idenë e krijimit të kooperativave bujqësore në vendin tonë. Vija e Partisë, si në çdo problem, edhe në këtë çështje ka qenë plotësisht e drejtë. Këtë punë e filluam me shumë kujdes, e ndoqëm pa u nxituar, se kishim të bënim me ndërgjegjen e fshatarit, të cilin duhet ta bindnim për gjithçka, pra, s'ka qenë gjë e thjeshtë. Në këtë etapë të re Partia e frymëzoi shpirtërisht fshatarësinë, i dha njëkohësisht ndihma të konsiderueshme materiale, dhe, si rrjedhim, gradualisht e me vullnet të plotë kolektivizimi, më parë në fusha, pastaj edhe në malësi, përfundoi me shumë sukses në mbarë vendin tonë. Gjatë luftës e punës për kolektivizimin, niveli i fshatarësisë sonë u ngrit politikisht, ideologjikisht, ai bëri hapa të mëdhenj edhe teknikisht, duke arritur në nivelin që po jetojmë.

Partia që në fillim mori masa të rëndësishme teknike dhe materiale për tharjen e kënetave e moçaleve, investoi fonde të mëdha materiale e monetare për mekanizimin e bujqësisë, për sistemin e tokave, për sigurimin e farërave të zgjedhura e të racave të bagëtitive nga më prodhueset etj. Ky proces nuk ka mbaruar, ai është vazhdimisht në ngjitje dhe, tok me forcimin organizativ të kooperativave bujqësore, do të marrë një zhvillim përherë e më të madh. Kjo do të sjellë si rezultat ngritjen e rendimenteve në të gjitha prodhimet bujqësore e blegtorale, organizimin më të mirë të forcave prodhuese në fshat, si dhe perfeksionimin në një shkallë gjithnjë e më të lartë të sistemit të sotëm të të gjithë zhvillimit bujqësor të vendit tonë dhe të marrëdhënieve midis kooperativave. Rruga në-

për të cilën po ecim në bujqësi këtu synon të çojë në stabilizimin e të ardhurave të fshatarësisë, në rritjen e vlerës së ditës së punës të kooperativistit.

Tani, nga etapa e kolektivizimit po kalojmë në një etapë tjetër më të zhvilluar, në atë të bashkimit të disa kooperativave në një ekonomi më të madhe. Kjo është një shkallë më e lartë në shoqërizimin e mjeteve të prodhimit dhe do të vazhdojë përderisa vetë jeta të na mësojë për t'u ngjitur në një etapë tjetër të re, më të lartë. Sa më e ngritur dhe më e armatosur politikisht dhe ideologjikisht të jetë fshatarësia jonë kooperativiste, aq më shpejt do të zhvillohet procesi që do të na çojë drejt fazës së re më të përparuar të bujqësisë sonë socialiste. Ne drejt kësaj po shkojmë, të arrijmë që në të ardhmen prona kooperativiste të kthehet në pronë të të gjithë popullit. Por të kemi parasysh se gjersa të vijë ajo kohë do të duhen akoma disa pesë-vjeçarë. Megjithatë ajo do të vijë medoemos se për këtë po luftojmë. Kjo është ajo perspektivë e ndritur që i hap Partia fshatarësisë kooperativiste, për arritjen e së cilës Partia dhe shteti do të japin çdo ndihmë nga ana materiale, por gjithashtu do të luftojmë më me forcë se deri tani, sidomos, për edukimin politik dhe ideologjik të masave kooperativiste.

Edhe për zhvillimin e industrisë sonë, që është e do të jetë kurdoherë dega drejtuese e zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste, Partia ka ecur me pjekuri dhe me vendosmëri. Ajo ka ngritur një industri moderne që rritet vazhdimisht, krahas së cilës kalitet një klasë punëtore e re. Fabrikat ekzistuese, dhe të tjerat që do të ndërtojmë në të ardhmen, janë pronë



drejtpërsëdrejti e popullit. Me ato pak fabrika e punishte të vogla e pa rëndësi që kishte Shqipëria para Çlirimit nuk mund të thuhet se në vendin tonë ekzistonte një industri e zhvilluar. Kjo ishte karakteristikë e veçantë për vendin tonë në atë kohë.

Partia jonë, e udhëhequr me besnikëri nga mësimet e marksizëm-leninizmit, krijoi, rriti e kaliti një klasë punëtore të re, e cila mban fort në duart e veta pushtetin politik, ekonominë dhe çdo gjë tjetër që ishte më parë në duart e borgjezisë së vendit tonë, tashmë e përmbysur nga lufta e armatosur e popullit, nën drejtimin e Partisë. Për sa i përket industrisë, këtë klasa jonë punëtore e ndërtoi vetë, krejt të re, të fuqishme dhe moderne me forcat, mendjen dhe aftësitë e saj, nën udhëheqjen e Partisë. Për t'i bërë të ndërgjegjshëm punëtorët tanë trima, revolucionarë dhe besnikë, për punën madhështore që kanë bërë me mundin, djersën dhe me diturinë e tyre, Partia hodhi menjëherë idenë që këta të luftojnë për t'i krijuar vetë mjetet e prodhimit me mendjen, diturinë dhe zotësinë e tyre. Kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme për formimin politik-ideologjik të punëtorëve dhe për zhvillimin e luftës së klasave. Le të mundohen të propagandojnë kapitalistët dhe revizionistët se prona në vendet e tyre, duke qenë shtetërore, është e të gjithëve, punëtorët nuk do ta besojnë, nuk janë të bindur se ajo është e tyre, se nuk janë ata vetë zotër të mjeteve të prodhimit, prandaj edhe as që u dhimbsen. Kurse te ne, te klasa jonë punëtore është rrënjësor pikëpamja që këto pasuri, të cilat ajo i ka krijuar vetë me gjakun dhe me djersën e ballit, janë pronë e për-

bashkët socialiste, prandaj lufton jo vetëm t'i zhvillojë, gjithnjë e më shumë në rrugën që i tregon Partia, por njëkohësisht rrit edhe vigjilencën për t'i ruajtur ato si sytë e ballit. Kjo do të thotë që luftën e klasave ajo të mos e dobësojë për asnjë moment, por ta zhvillojë ditë e natë kundër të gjithë armiqve të hapët apo të fshehtë, që përpiqen të na dëmtojnë ose që ngrenë veshët në momente dhe situata që mendojnë se janë të favorshme për ta, për të dëmtuar rendin tonë socialist. Lufta e klasave në vendin tonë zhvillohet në kushte krejt të kundërta nga ç'zhvillohet në vendet ku fuqinë e kanë në dorë revizionistët modernë, të cilët nuk janë tjetër veçse agjencia, shërbëtorë të kapitalit të madh botëror. Ndaj me klikat sunduese revizioniste, të cilat kanë ardhur në fuqi në krye të këtyre vendeve, ka kohë që ne i kemi prerë marrëdhëniet rrënjësisht dhe në mënyrë përfundimtare. Të gjithë marksistë-leninistët e vërtetë në botë janë gjithashtu për luftë gjer në fund me këto klika tradhtarësh. Ne do të fitojmë me siguri kundër tyre.

Për të arritur në këtë etapë të re të ndritur të ndërtimit socialist në bujqësi e në industri, ku synon Partia, ashtu siç na ngarkon të gjithëve ne ushtarëve të saj, anëtarë partie dhe të paorganizuar në Parti, edhe ju shkrimtarëve dhe artistëve Partia ju ngarkon detyrën e madhe për t'i shkuar deri në fund luftës për revolucionarizimin shpirtëror të njeriut, që edhe ju, siç keni bërë gjer tani, të ndikoni me veprat tuaja në transformimin e njeriut tonë të ri, për ta ngritur atë në nivelin që kërkon koha, për të kaluar

në shoqërinë komuniste. Në këtë rrugë Partia po i përgatit njerëzit hap pas hapi dhe me këmbëngulje.

Që Partia është në rrugë të drejtë, këtë e tregon akoma më mirë edhe përkrahja e pakufishme që i jep asaj populli, i cili është futur në këtë revolucion të madh e të pandërprerë që po udhëheq ajo. Njerëzit tanë në tërësi e kuptojnë vijën e drejtë të Partisë. Është tjetër çështje se mund të ketë ndonjë, që, në një drejtim ose në një tjetër, nuk e kupton dhe nuk e zbaton akoma plotësisht një direktivë, por që të ketë njerëz që t'i kundërvihen vijës së Partisë, e themi me bindje se kjo te ne ndodh rrallë. Në qoftë se ka aty-këtu njerëz, të cilët nuk i shohin dhe nuk i kuptojnë si duhet disa probleme që ngre Partia, nuk e shohin akoma qartë perspektivën e madhe të këtyre ndryshimeve dhe, si rrjedhim, në qëndrimet ideologjike dhe në veprimet e tyre praktike personale nuk mbajnë atë pozitë korrekte që kërkon Partia, për shembull, ndaj familjes, grave, vajzave, fëmijëve e të tjerë, këtë nuk duhet ta cilësojmë si rezistencë kundër vijës së ndritur të përgjithshme të Partisë, për arsye se në shumicën dërrmuese njerëzit tanë janë me Partinë. Vetëm armiqtë e popullit dhe të Republikës i kundërvihen me ndërgjegje vijës së drejtë të Partisë.

Të kemi parasysh se ndryshimet që përpiqet të realizojë vazhdimisht Partia në rrugën e ndërtimit të socializmit e të komunizmit, nuk shkojnë si thika në gjalpë, sepse jo të gjithë e me një të thënë i kuptojnë ideologjikisht e politikisht të gjitha problemet që shtron Partia. Për këtë qëllim vazhdimisht bëhet një punë e gjithanshme bindëse me njerëzit, që kërkon, sipas rre-

thanave, zgjuarsi, zotësi dhe shpirtgjerësi ndaj njerëzve tanë. Duke vepruar kështu populli ynë heroik dhe patriot i kupton gjithnjë e më mirë pjekurinë, heroizmin dhe vendosmërinë e Partisë sonë të Punës, qëllimet e larta që ndjek ajo për ta çuar vendin tonë nga fitorja në fitore. Edhe në këtë çështje një rol veçanërisht të rëndësishëm për edukimin e masave me frymën e Partisë luajnë, gjithashtu, shkrimtarët dhe artistët në sferën e veprimtarisë së tyre. Prandaj, së bashku me ta, ta organizojmë punën në atë mënyrë dhe në atë shkallë që kërkon ecja jonë përpara, me qëllim që shkrimtarët dhe artistët tanë, me format e bukura artistike që do të përdorin për përvetësimin e kësaj krijimtarie nga masat, të bëhen propagandistë të vijës së Partisë.

Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, në periudhën kur jetonte Stalini, ecnin në rrugën leniniste. Por me ardhjen në fuqi të revizionistëve hrushovianë, të cilët tradhtuan marksizëm-leninizmin, këto vende u tërhoqën nga rruga e revolucionit, ndërprejnë ndërtimin e socializmit në fshat e në qytet, duke u shndërruar nga revizionistët modernë, gradualisht në vende me ideologji dhe me politikë reaksionare borgjeze, me ekonomi që hyri dhe po ecën gjithnjë e më thellë në rrugën kapitaliste. Në veprat që shkroi nga fundi i jetës së tij Stalini la orientime të drejta marksiste-leniniste për zgjidhjen e shumë problemeve ekonomike dhe tregoi rrugët që duheshin ndjekur për të shkuar në komunizëm. Por, pas vdekjes së tij, hrushovianët, nëpërmjet vendimeve të shumta që mori renegati Nikita Hrushov dhe më vonë pasuesit e tij,

i thanë «ndal» kursit të ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, dhe e kthyen pas rrotën e zhvillimit socialist të ekonomisë, të industrisë dhe të bujqësisë sovjetike. Si pasojë, atje dhe në vende të tjera, si në Jugosllavi, në Poloni e gjetkë, ku ky «ndal» qe bërë shumë vjet përpara, dita-ditës po vijnë në fuqi kulakët, po krijohen ndërmarrje bujqësore të mëdha kapitaliste, po ndiqet rruga në të cilën kanë ecur dhe po ecin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca, Italia etj., etj., domethënë, drejt pasurimit gjithnjë e më të madh të kapitalistëve monopolistë dhe varfërimit të vazhdueshëm të masave të gjera fshatare.

Ky proces po vërtetohet edhe në industrinë e këtyre vendeve. Atje po ndodh e njëjta gjë si në vendet kapitaliste, ku kapitalistët, pronarët e mëdhenj të fabrikave, të uzinave, të minierave etj., i shfrytëzojnë punëtorët egërsisht, nëpërmjet punës së rëndë që bëjnë si skllëvër për të krijuar mbivlerën, burimin e fitimit kapitalist. Kapitalistët, kudo që janë në fuqi, përpiqen me të gjitha mjetet të përvetësojnë mbivlerën dhe në të njëjtën kohë ta mbulojnë këtë. Për të mashtruar proletariatin, ata përpiqen të shfrytëzojnë edhe inteligjencien e vendit të tyre. Shumica e shkrimtarëve, artistëve, kompozitorëve, inteligjencia në përgjithësi në vendet kapitaliste zbaton politikën që ndjek borgjezia për të trullësuar mendjet dhe ndërgjegjet e punonjësve. Me veprat e tyre ata mbulojnë të këqijat e kapitalizmit dhe frenojnë zemërimin e proletariatis, në mënyrë që ky të mos arrijë të ngrihet në luftë, në revolucion për të sulmuar pozitën e kapitalizmit dhe

për të marrë në duart e veta pushtetin dhe mjetet e prodhimit.

Për të zgjatur sa më tej sundimin e saj mbi proletariatin dhe mbi të gjithë punonjësit e tjerë të qytetit dhe të fshatit, borgjezia përgatit edhe inteligjencien e vet teknike, të cilën përpigjet ta futë në luftë me klasën punëtore. Për t'ia arritur këtij qëllimi, me synim që të mos arrihet uniteti i tyre nën drejtimin e klasës punëtore dhe të paralizohet lufta klasore, ajo krijon diferencime të mëdha morale e materiale në mes klasës punëtore nga njëra anë dhe teknikëve, inxhinierëve e gjithë specialistëve të tjerë, nga ana tjetër. Këtu, natyrisht, fshihen interesa të shumtë, të cilët kapitalizmi i studion me vëmendje, i mat me kujdes dhe pastaj merr masa, por kurdoherë në dobi të vet.

Për të krijuar te njerëzit iluzione mbi të ashtuquajturat shoqëri industriale, shoqëri të konsumit etj., etj., borgjezia bën propagandë të madhe. Këtij qëllimi i shërbejnë teoritë teknokrate që gjejnë një përhapje të gjerë sot në vendet perëndimore. Përfaqësuesit e këtyre teorive sot na dalin me teza të tilla, si: «Kapitalizmi tani po transformohet», «sot nuk ekziston më kapitalizmi klasik», «nuk janë më kapitalistët dhe drejtorët e koncerneve që drejtojnë, por teknikët dhe inxhinierët» etj. Por të gjithë e dimë se këta s'kanë asgjë në dorë, se janë vetëm shërbëtorë të kapitalizmit, të monopoleve e të koncerneve të mëdha. Mund të ndodhë aty-këtu që disa teknikë e specialistë të marrin ndonjë post të lartë në shoqërinë kapitaliste, por përsëri nuk janë këta që e drejtojnë shoqërinë, sepse pas

tyre qëndrojnë kurdoherë peshkaqenët e mëdhenj kapitalistë, të cilët vendosin për gjithçka.

Borgjezia monopoliste, për të krijuar iluzionin se tani kapitalizmi gjoja po transformohet, praktikon shtetëzimin e disa degëve të industrisë. Ajo e bën këtë për të luftuar doktrinën e pavdekshme të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, për ta paraqitur çështjen sikur tashmë «marksizmi është vjetruar», sikur tani ai gjoja nuk ka më vlerë, se periudha e tij qenka kapërcyer, se tani, sipas profkave të tyre, lufta e klasave nuk qenka më e nevojshme etj.

Propagandës së borgjezisë reaksionare ndërkombëtare, për të luftuar marksizmin, i vijnë në ndihmë edhe teoritë e revizionistëve modernë, sipas të cilave, sot kudo në botë po duken gjithnjë e më shumë «elementet e socializmit». Kur flasin për «elemente të socializmit» revizionistët modernë e kanë fjalën për maskat e kapitalizmit botëror, për teoritë e shumta që përhap ai pa u kursyer, si ajo e teknokratizmit, e shtetëzimeve etj., etj., duke u përpjekur t'i paraqesë këto si transformime «progresiste», me anën e të cilave proletariati do të arrijë në socializëm «pa luftë», «pa revolucion» etj., etj. Këto orvatje të revizionistëve janë përpjekje për të shuar rezistencën e proletariatit dhe të masave të tjera të shfrytëzuara kundër pronarëve kapitalistë, për të zbutur dhe po të jetë e mundur për të shuar fare luftën e klasave në vendet kapitaliste. Këto teori të tradhtarëve të socializmit shërbejnë, pra, për të mbrojtur e për të përjetësuar kapitalin dhe për të bërë «pa dhimbje» kthimin nga socializmi në kapitalizëm. Kjo është arsyeja që revizionistët sovjetikë duan t'i mbu-

shin mendjen popullit të tyre se mjetet e prodhimit në Bashkimin Sovjetik janë pronë shtetërore.

Edhe Titoja pretendon se vetadministrimi bazohet në pronën shtetërore mbi mjetet e prodhimit, por punëtorët në Jugosllavi tashmë e kanë kuptuar falsitetin e kësaj forme administrimi. Këtë e vërteton edhe diçka që ka ndodhur kohët e fundit në një qytet të Kroacisë. Punëtorët e një ndërmarrjeje atje u revoltuan për arsye se rrogat i kanë fare të vogla, në një kohë kur shefat e tyre, gjoja komunistë dhe bij të klasës punëtore, marrin shpërblime shumë të mëdha. Nga zemërimi ata i vunë zjarrin fabrikës. Kjo tregon se ata e kanë kuptuar karakterin kapitalist të transformimit të pronës në Jugosllavi, që vetëm për demagogji e veshin me petka socialiste.

Në vendet kapitaliste, nëpërmjet demagogjisë ndiqen dy synime: të paralizohet lufta e klasave dhe të fshihet karakteri kapitalist i pronësisë mbi mjetet e prodhimit. Atje mjetet e prodhimit nuk janë të klasës punëtore. Për t'i shoqëruar këto mjete, proletariati i këtyre vendeve duhet të ngrihet në luftë të ashpër klasore, në revolucion, që do ta përkrahë edhe ajo pjesë e inteligjencies, inxhinierët, teknikët e specialistët, të cilët janë të lidhur me të dhe nuk e kanë shitur ndërgjegjen si krerët e tyre të kapitali. Kjo ka për të ndodhur kudo, sepse rrota e shoqërisë, duan apo s'duan disa, kurdoherë do të shkojë përpara.

Marksit na mëson dhe jeta e ka vërtetuar se kapitalistët investojnë shuma kolosale për zhvillimin e mekanizimit të degëve të ndryshme të ekonomisë. Këto ata i bëjnë se s'mund të veprojnë ndryshe, se nuk



mund të rrojnë pa një zhvillim të tillë, në qoftë se nuk duan të humbasin në luftën e ashpër të konkurrencës. Një masë e tillë është në interesin e secilit vend kapitalist, po edhe të të gjithë kapitalistëve në shkallë botërore, por në dëm të proletariatit, se një pjesë të punëtorëve kapitalizmi e hedh në rrugë të madhe. Ja përse proletariati duhet dhe do ta bëjë medoemos revolucionin që do të përmbysë nga themelet borgjezinë kapitaliste.

Për zhvillimin e shoqërisë sonë socialiste Partia ecën në rrugën marksiste-leniniste, sipas mësimëve të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit dhe asnjëherë nuk do të lëvizë prej tyre, se ato na treguan dhe na tregojnë rrugën e çlirimit të njeriut jo vetëm nga prangat ekonomike, po dhe nga ato shpirtërore të ideologjisë skllavëruese borgjeze kapitaliste. Këtë qëllim kanë edhe masat që jemi duke marrë ne tani për revolucionarizimin e shkollës.

Me reformën e madhe arsimore Partia jonë bën të kundërtën e asaj që ekziston në kapitalizëm, ku borgjezia ua ka kufizuar shumë punonjësve mundësitë për të marrë arsim dhe kulturë. Ka edhe kapitalizmi inxhinierë, teknikë e specialistë, sepse ata i duhën patjetër për zhvillimin e industrisë së vet, por, siç vura në dukje edhe më lart, ai përpiqet me të gjitha mënyrat që njerëzit e shkencës dhe të teknikës t'i veçojë nga proletariati, duke u dhënë atyre disa lëmosha, disa thërrime nga tepricat e fitimeve të veta kolosale, për të njollosur ndërgjegjen e tyre e për t'i përdorur kështu si vegla për paralizimin e çdo tendence revolucionare të proletariatit.

Edhe në fushën e arsimit ne ecim në rrugë të drejtë, po hapim kudo shkolla të reja të të gjitha kategorive, me qëllim që arsimi në vendin tonë të bëhet i masës e jo privilegj i disave. Ne i edukojmë nxënësit e studentët qysh në bankat e shkollës, që dituritë t'i vënë në shërbim të të gjithë popullit. Inxhinierët, teknikët dhe të gjithë specialistët tanë edukohen me këtë frymë, prandaj ata janë të lidhur ngushtë me klasën punëtore, me fshatarësinë dhe janë bërë faktor i rëndësishëm për ndërtimin e socializmit, për industrializimin e vendit, për zhvillimin socialist të fshatit.

Industrializimi i mëtejshëm i vendit, automatizimi gjithnjë e më shumë i proceseve të punës në të gjithë sektorët, në të ardhmen do të kërkojnë njerëz të kualifikuar, teknikë, specialistë dhe inxhinierë, numri i të cilëve do të rritet vazhdimisht. Por porosia e Partisë është që gjithë këta inxhinierë e teknikë të jenë kurdoherë të lidhur ngushtë me punëtorët, të bëhen një me ta jo sa për formë, por me gjithë shpirt, me ndjenja, me zemër, sepse kanë një idcologji të përbashkët.

Ky proces do të arrihet, për arsye se Partia me punën e madhe që po bën në fushën e arsimit, synon që në shkolla të përgatiten jo vetëm inxhinierët e teknikët e nevojshëm, por të bëjnë përpjekje në masë, për të ngritur sa më lart nivelin e tyre edhe punëtorët, të cilëve u janë krijuar të gjitha kushtet. Kjo, sigurisht, nuk arrihet as me një vit, as me dy vjet, por në perspektivë, duke synuar të arrijmë atje ku duhet.

Me reformën arsimore ne dëshirojmë të përgatitim në rrugën marksiste-leniniste, në radhë të parë,

njerëz me shpirt e ndjenja revolucionare, që të hedhin poshtë e të godasin çdo mbeturinë të huaj që kanë në ndërgjegje e që pengon kalitjen e tyre, në radhë të dytë, teknikë e specialistë të zotë. E shohim vetë në praktikën e përditshme ç'të mira të mëdha na sjell kjo. Kudo, në çdo fabrikë e ndërmarrje, në çdo kolektiv punëtorësh që të shkosh te ne të bie në sy një unitet i jashtëzakonshëm në mes punëtorëve, teknikëve dhe inxhinierëve. Ky unitet e ka burimin te qartësia dhe te besimi që kanë të gjithë punonjësit në vijën e drejtë të Partisë dhe në faktin që teknikët dhe inxhinierët tanë janë njerëz të thjeshtë të popullit, siç jeni edhe ju shkrimtarët, poetët e artistët, që keni përqaftuar vijën e Partisë.

Të mos na trembin disa shfaqje e të meta në punët tona, shoqe dhe shokë, se të tilla ka e, natyrisht, do të ketë edhe në të ardhmen, por të luftojmë e të punojmë që t'i ndreqim ato me guxim dhe të ecim gjithnjë përpara. Ashtu si kudo, edhe në fushën e krijimtarisë letraro-artistike punohet për interesin e përgjithshëm, të cilit i nënshtrohen interesat vetjakë të çdonjërit prej jush. Për të krijuar ju sakrifikoni nga orët e lira të pushimit, gjumin, rehatin etj. Të gjitha këto i bëni me ndërgjegje dhe vërtetojnë akoma më mirë se ju keni përqaftuar dhe ecni në vijën marksiste-leniniste të Partisë.

Në rrugën ku na udhëheq Partia, ne po ecim drejt ndërtimit të plotë të socializmit, kemi ngritur një industri të fuqishme, një bujqësi të përparuar, arsim e kulturë të zhvilluar. Në të ardhmen do të ndërtojmë

më shumë vepra të tjera të reja, bile në një kohë më të shpejtë se gjer tani, për arsye se për zbatimin e vijës së drejtë të Partisë është mobilizuar si asnjëherë tjetër i gjithë populli me frymë të lartë vetëmohimi dhe entuziazmi revolucionar.

Populli ynë e ka të qartë ku synon propaganda mashtruese borgjezo-revizioniste, që kritikon trajtimin marksist-leninist që u bëjmë ne stimujve moralë, duke i mohuar këta dhe duke ngritur lart jashtë mase rolin e stimujve materialë. Armiqtë e socializmit, për të na tërhequr vëmendjen ngrenë në qiell me të madhe jetën e tyre, sikur atje jetojnë mirë të gjithë. Por populli ynë është i vendosur të punojë për të ngritur akoma më lart nivelin tonë të jetesës, të krijojë bollëkun në ushqime, veshmbathje, banesa e në çdo gjë tjetër të nevojshme për jetën e të gjithë punonjësve tanë në shkallë kombëtare dhe jo vetëm për një rreth të ngushtë njerëzish si në vendet borgjeze e revizioniste.

Për sa i takon shpërblimit ne zbatojmë në praktikë parimin marksist sipas të cilit në socializëm secili shpërblehet sipas punës që bën. Megjithatë ne nuk lejojmë që midis pagave të punonjësve të ketë diferenca të mëdha dhe privilegje të padrejta, siç ndodh në vendet kapitaliste dhe revizioniste. Në vendin tonë janë ulur pagat e larta, pagat mesatare kanë mbetur pa u prekur, ndërsa pagat e ulëta janë rritur. Këto masa të drejta, që kanë marrë Partia dhe shteti ynë, nuk kanë krijuar asnjë shqetësim në popull. Përkundrazi, të gjithë punonjësit, duke kuptuar drejt qëllimet e larta të

Partisë, janë revolucionarizuar më shumë. Çdo njeri te ne sot shkon me ndërgjegje të lartë socialiste në frontin më të vështirë të punës, atje ku e kërkojnë nevojat e atdheut dhe ku e dërgon Partia, edhe pse qëllon nganjëherë që i zbritet paga. «Jam ushtar i Partisë», thotë tjetri dhe vete atje ku e thërret detyra, se e di që punon për të mirën e të gjithë shoqërisë dhe për të mirën e tij. Një gatishmëri e tillë nuk mund të ndodhë në vendet kapitaliste e revizioniste, ku mundi dhe djersa e punonjësve shfrytëzohen pa mëshirë nga klasat shfrytëzuese që janë në fuqi.

Populli ynë, i udhëhequr nga Partia, e ka të qartë që lumturinë do ta krijojë me forcat e veta, me punë, me luftë dhe me sakrifica të përditshme. Le të llomotitin sa të duan armiqtë! Pavarësisht se ne nuk i kemi arritur ato nivele aq të larta zhvillimi si në disa vende të tjera, shpirti ynë është i pastër e pa balloma, zemrat tona janë të çeliktë. Ne ecim kurdoherë përpara në atdheun tonë të lirë, jemi të ndërgjegjshëm e krenarë për ato që po bëjmë se ndërgjegjen nuk e kemi shitur, shpirti ynë nuk është i skllavëruar, por i lirë. Me punën dhe me luftën tonë në të ardhmen do të kemi të gjitha të mirat, por, siç thashë, si një popull i lirë, që jeton në një shoqëri socialiste, ato do t'i krijojmë jo vetëm për disa, po për të gjithë. Në këtë çështje vendimtare Partia jonë jep, në kushtet e vendit tonë, një kontribut modest në zhvillimin e mëtejshëm të marksizëm-leninizmit.

Shoqe dhe shokë, shkrimtarë dhe artistë, dëshiroj edhe një herë të theksoj rëndësinë e punës, e të kri-

jimtarisë suaj të çdo gjinie dhe t'ju them se ato që nxirrni nga duart përbëjnë një ushqim të përditshëm për qindra e mijëra njerëz, për gjithë popullin shqiptar. Me shkrimet e veprat që realizoni në format artistike nga më të ndryshmet, ju përpiqeni t'ua bëni të qartë masave vijën e drejtë të Partisë në të gjithë sektorët e jetës, duke e materializuar sa më mirë e më bukur këtë vijë në muzikë, në pikturë, në krijimtarinë letrare, në pjesët teatrale etj.

Do të ishte një mënyrë sektare të menduari po të pretendohesh se shpjegimin e vijës së Partisë te masat e gjera punonjëse e bëjnë vetëm shokët e Partisë, instruktorët, me leksionet që përgatitin. Këto materiale shërbejnë shumë për edukimin ideologjik e politik të masave punonjëse, por Partia përdor për këtë qëllim edhe forma e mjete të tjera, të cilave u jep, gjithashtu, rëndësi të jashtëzakonshme për ta bërë të qartë vijën e saj, që masat ta përqafojnë atë sa më shpejt e ta zbatojnë me zell. Duke e parë problemin me këtë sy, një rëndësi të madhe e të veçantë marrin shkrimet e veprat tuaja të çdo lloji. Me qëndrimin që mbani në krijimet tuaja, ju keni treguar pjekuri politike dhe ideologjike, frymë të lartë partishmërie që, si te të gjithë, kalitet çdo ditë edhe te ju. Kjo duket qartë me përkrahjen aktive që ju u keni dhënë dhe u jepni të gjitha masave revolucionare që ka ndërmarrë Partia.

Fryma e përgjithshme që zotëron në mbarë vendin tonë socialist është shumë optimiste se njerëzit tanë e kanë tashmë të qartë se gjithçka i ka premtuar Partia popullit është realizuar, se Partia ka qëndruar dhe që-

ndron kurdoherë pranë popullit, në ditë të mira e të vështira, prandaj ai e do Partinë si shpirtin, si jetën e tij, për të nuk ka gjë më të shtrenjtë se Partia.

Partia ka qenë gjithmonë edhe pranë jush, shokë shkrimtarë dhe artistë dhe ju ka ndihmuar në çdo rast, sepse ju jeni bijtë e saj, ndihmësit e saj, jeni nga ata që bëni përpjekje që masat ta kuptojnë drejt e thellë vijën e Partisë, duke kontribuar kështu edhe ju, me të gjitha forcat, në zhvillimin progresiv të shoqërisë sonë socialiste. Kur Partia ju këshillon të futeni në gjirin e popullit, të qëndroni e të jetoni gju më gjü e bashkë me të, të dëgjoni me vëmendje zërin e tij, këtë e bën sepse e di që vetëm kështu çdo vepër juaja do ta ngrejë peshë popullin për të realizuar detyrat e mëdha e të lavdishme që ka përpara për të kryer.

Ju mësoni e shkëmbeni mendime dhe eksperiencë me njëri-tjetrin për ta çuar gjithnjë e më përpara punën. Vështirësi e të meta kemi e do të kemi, por si kurdoherë do të përpiqemi që vështirësitë t'i kapërcejmë dhe të metat t'i zhdukim me vendosmëri. Partia ka bindjen se çdo ditë, çdo muaj e çdo vit ju do të bëheni një armatë e fuqishme, do të shtrëngoni radhët rreth saj, do të frymëzoheni orë e çast nga vija e saj e drejtë, do të lidheni ngushtë me klasën punëtore dhe me fshatarësinë kooperativiste.

Në Kongresin tuaj u dukën qartë entuziazmi i madh dhe shqetësimi i shkrimtarëve dhe i artistëve të moshuar e me një stazh të gjatë letraro-artistik për të ndihmuar brezin e ri të shkrimtarëve dhe të artistëve, sidomos për të shtuar radhët me të rinj e të reja nga klasa punëtore.

Shoqe dhe shokë të dashur,

Ne punojmë dhe luftojmë në shoqërinë tonë në unitet të çeliktë, rritemi dhe jetojmë në thjeshtësi. Thjeshtësia është një nga stollitë kryesore të njerëzve tanë. Pa dashur t'ju bëj komplimente, dëshiroj të them se te punonjësit e afirmuar të arteve dhe të kulturës vëmë re me kënaqësi një fond të pasur thjeshtësie, karakteristikë kjo e njerëzve të lidhur me masat. Kjo është një garanci e madhe për Partinë dhe për popullin. Cilësi të kësaj natyre nuk i gjen te shkrimtarët dhe artistët revizionistë që, siç e dini fare mirë edhe ju vetë, janë borgjezuar. Ata nuk kanë vlera shpirtërore, ideologjike e politike, se nuk janë brumosur dhe nuk ecin në frymën e marksizëm-leninizmit, prandaj as shkrimet e tyre nuk mund të barazohen me krijimet tuaja.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Në emër të Komitetit Qendror, të Qeverisë dhe në emër të të gjithë shokëve që marrin pjesë në gëzimin tuaj, edhe një herë, ju uroj nga zemra, si ju që jeni sonte të pranishëm këtu, ashtu edhe të gjithë shkrimtarët e artistët e vendit tonë, suksese akoma më të mëdha në veprën tuaj të lavdishme. Të jeni të bindur se Partia do të bëjë akoma më shumë që t'ju kalitë shpirtërisht e fizikisht, t'ju zhvillojë ndjenjën revolucionare të klasës, t'ju lidhë ngushtë me punën e me



djersën e popullit. Në këto drejtime asnjëherë nuk do të mungojnë kujdesi dhe dashuria e Partisë për ju, shokë dhe shoqe, besnikë të popullit dhe të Partisë.

Të rrojnë shkrimtarët dhe artistët tanë!

Të rrojë Partia!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 40-TË ..... V—IX

1969

KRIZA E LINDJES SË MESME — Shënime (6 janar 1969) ..... 1—9

DEMAGOGJIA E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË NUK MBULON DOT FYTYRËN E TYRE TRADHTARE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (9 janar 1969) ..... 10—55

TË MENDOHEM MIRË PËR ZGJEDHJEN DHE PËR KOORDINIMIN E PROBLEMEVE QË SHQYRTOHEN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (13 janar 1969) ..... 56—69

KUSH MBRON INTERESAT E POPULLIT E LIDHET ME TË — MBETET KURDOHERË I GJALLË NË NDJENJAT DHE NË ZEMRËN E TIJ — Nga biseda me ambasadorin e Republikës Islamike të Pakistanit (15 janar 1969) ..... 70—77

DREJTIMI MË I PËRSOSUR QËNDRON NË VEPRIMTARINË KRIJUESE TË PËRBASHKËT — Letër drejtuar brigadierit Alo Qosja nga Sojniku i Gramshit (23 janar 1969) ..... 78—81

GJYKATA ËSHTË PJESË E PANDARË E PUSHTETIT POPULLOR — Nga diskutimi në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor (25 janar 1969) ..... 82—83

SUKSESET TONA JANË REZULTAT I VIJËS SË DREJTË TË PARTISË — Fjala e mbylljes në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë (29 janar 1969) .....	84—86
LËNDA E DRURIT ËSHTË SI BUKA PËR INDUSTRIJË DHE PËR NEVOJAT E TJERA TË POPULLIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (30 janar 1969) .....	87—100
PËR LUFTËN KUNDËR ZAKONEVE PRAPANIKE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (31 janar 1969) .....	101—112
ZBËRTHIMI I DIREKTIVAVE TË PARTISË S'ËSH-TË DETYRË VETËM E PROPAGANDËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (10 shkurt 1969) .....	113—126
PARTIA U BESON MËSUESVE EDUKIMIN DHE RRITJEN E BREZIT TË RI — Bisedë me arsimtaren Athina Mile dhe bashkëshortin e saj, Frrok Gjini (12 shkurt 1969) .....	127—144
PARTIA KËRKON PËRPIKËRI NË KRYERJEN E DETYRAVE LUFTARAKE — Bisedë me oficerët dhe punonjësit e repartit «N» të aviacionit (25 shkurt 1969) .....	145—149
ËSHTË JASHTËZAKONISHT MIRË KUR MENDIMET THUHEN HAPUR — Nga diskutimi në mbledhjen e zgjeruar të Byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit (25 shkurt 1969) .....	150—174
SI DUHET T'I KUPTOJMË DHE T'I ZGJIDHIM DREJT DISA ÇËSHTJE TË EKONOMISË SONË SOCIALISTE — Fjala në mbledhjen me punëtorë, kooperativistë dhe kuadro të rrethit të Beratit (26 shkurt 1969) .....	175—204

TË GDHENDURIT E GURIT ËSHTË NJË NGA MJESHTRËTË MË TË BUKURA — Bisedë me pionierët e shkollës «7 Nëntori» të qytetit të Beratit (26 shkurt 1969) .....	205—213
DEMOKRACIA KOOPERATIVISTE ÇON PUNËN PËRPARA — Nga fjala në drekën e shtruar në kooperativën e bashkuar «8 Nëntori» të Kutallisë në rrethin e Beratit (27 shkurt 1969) .....	214—256
INTEGRIMI ME BORGJEZINË — KURS I RI I KONGRESIT TË 12-TË TË REVIZIONISTËVE ITALIANË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (2 mars 1969) .....	257—270
TË BËJMË NJË PUNË MË TË MIRË PËRGATITORE PËR LËVIZJEN E KOOPERATIVISTËVE NGA VERIU NË JUG DHE ANASJELLTAS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 mars 1969) .....	271—285
TË RRIETET MË TEJ CILËSIA E PUNËS IDEOSHKENCORE ME STUDENTËT DHE PEDAGOGËT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (3 mars 1969) .....	286—295
KRAHAS INDUSTRISË TË ZHVILLOJMË EDHE BUJQËSINË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 mars 1969) .....	296—304
TË MËSOJMË NGA SHOKËT PUNËTORË TË ZGJEDHUR NË UDHËHEQJE TË ORGANIZATAVE TË PARTISË DHE T'I NDIHMOJMË ATA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 mars 1969) .....	305—308
BASHKËPUNIMI SOVJETO-AMERIKAN SUNDOI MBLEDHJEN E BUDAPESTIT TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (22 mars 1969) .....	309—319

- EDUKIMIT IDEOPOLITIK TË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE T'I JEPET RËNDËSI E DORËS SË PARË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (4 prill 1969) ..... 320—332
- RIPËRTËRITJA E PARTISË DHE E ORGANEVE TË SAJ ME GJAK TË RI KA TË BËJË ME TË ARDHMEN E VETË PARTISË E TË VENDIT TONË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (5 prill 1969) ..... 333—340
- PËR PASOJAT E TËRMETIT MOS KINI ASNJË SHQETËSIM, DO T'I LIKUIDOJMË SHPEJT — Nga fjala para popullit të krahinës së Krahësit në rrethin e Tepelenës gjatë vizitës pas tërmetit të 3 prillit (6 prill 1969) ..... 341—358
- LUMTURIA E POPULLIT — KY ËSHTË QËLLIMI I PARTISË SONË — Nga fjala para popullit të Mallakastrës në katundin Ninësh gjatë vizitës pas tërmetit të 3 prillit (6 prill 1969) ..... 359—371
- PËRPARA VULLNETIT TË POPULLIT TONË NUK MUND TË QËNDROJË ASNJË PENGESË DHE VË-SHTIRËSI SADO E MADHE TË JETË — Nga fjala përpara popullit të Hekalit gjatë vizitës pas tërmetit të 3 prillit (6 prill 1969) ..... 372—394
- PAZARLLËQE IMPERIALISTO-REVIZIONISTE NË PRAPASKENË KUNDËR POPUJVE ARABË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (9 prill 1969) ..... 395—400
- PRESIONET USHTARAKE — BAZË E DIKTATIT DHE E SHANTAZHIT POLITIK TË UDHËHEQËS-VE REVIZIONISTË SOVJETIKË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (11 prill 1969) ..... 401—415

---

TOK ME EDUKIMIN TEKNIK, DUHET EDHE NGRITJA POLITIKE — Fjala para pjesëmarrësve në garat e xhënierëve (13 prill 1969) .....	416—420
VEPRAT TUAJA PËRBËJNË NJË USHQIM TË PËRDITSHËM PËR POPULLIN — Fjala në pritjen e dhënë me rastin e mbylljes së punimeve të Kon- gresit të 2-të të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Ar- tistëve të Shqipërisë (26 prill 1969) .....	421—445